

RAPORTI VJETOR 2023
RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

Lënda: Informacion mbi veprimtarinë e RTSH-së gjatë vitit 2023

KRYETARIT TË KËSHILLIT DREJTUES
ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES

Të nderuar Kryetar dhe anëtarë të Këshillit Drejtues,

Në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë me nr. 98, datë 22. 12. 2016 “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), për sa i takon raportimit periodik ndaj Këshillit Drejtues (KD) të RTSH, në përgjigje të shkresës suaj përcjellëse me nr. 290/5 prot. Dt. 05. 02.2024 të shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe në vijimësi të komunikimeve me e-mail, lutem bashkëlidhur do të gjeni, raportimin mbi veprimtarinë e RTSH-së për periudhën Janar- Dhjetor 2023.

Gjatë vitit të shkuar Këshilli Drejtues i RTSH për shkak të dorëheqjes së ish Drejtorit të Përgjithshëm z. Enkel Joti, rihapi garën për kreun e ri të drejtimit të institucionit. Në mesin e muajit qershor 2023, KDRTSH me votën unanime të anëtarëve të saj, zgjodhi në kye të medias publike të Shqipërisë, z. Alfred Peza.

Këto dy momente e kanë ndarë në mënyrë pothuajse të barabartë, kohën e drejtimit të RTSH, përgjatë vitit të shkuar kalendarik. Pavarësisht kësaj, raporti në vijim paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse të punës së institucionit, përgjatë 12 muajve të vitit që kemi lënë pas.

RTSH edhe gjatë vitit 2023 e ka bazuar punën dhe veprimtarinë e vet në Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin 98/ 2016 “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar RTSH”, në frymën dhe germën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në aktet e tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë punën dhe veprimtarinë e institucionit tonë mediatik publik.

Radio Televizioni Shqiptar ka bërë të gjitha përpjekjet, sidomos gjatë muajve të fundit që të përmbushë gjithmonë e më mirë, Deklaratën e Qëllimit që buron nga Statuti. Si një Ofrues i Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA), RTSH mbetet i përkushtuar ndaj idealeve më të larta të transmetimit të shërbimit publik kombëtar.

Kjo gjë po realizohet nga ana e RTSH përmes ofrimit për audiencën e gjerë, të shërbimeve profesionale mediatike, me standardet më të larta cilësore audio dhe audiovizive. Përmes tyre stafi i RTSH po përmbush gjithmonë e më mirë misionin e vet për të informuar, edukuar dhe argëtuat publikun duke i shërbyer në këtë mënyrë kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë shqiptare, përfshirë edhe pakicat tona kombëtare.

Përgjatë sezonit radioteleviziv nga shtatori 2023 e që përfundon në korrik 2024, stafi i RTSH prodhon mesatarisht rreth 120 programe në javë, me cilësi profesionale gjithmonë e më të larta, si nga pikëpamja sasiore ashtu edhe cilësore. Si për nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja. Si për nga shumëllojshmëria, ashtu edhe për nga kujdesi në përmbushje të nevojave për të gjitha fashat shoqërore përfshi edhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji “Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Aktualisht 18 kanalet televizive të rrjetit të RTSH, 7 kanalet e radios dhe 3 kanalet e saj online janë rikthyer pas shumë vitesh në “pistën e garës së madhe” për audiencën, përkrah mediave më të mira kombëtare private në Shqipëri. Gjithmonë e më shumë programe, kanale mediatike dhe produkte audiovizive, po shkojnë më shpejt e në mënyrë më profesionale drejt publikut shqiptar, i cili sipas indikacioneve matëse të reagimit të audiencës po mirëpritën çdo ditë e më shumë dhe gjithnjë e më mirë prej saj.

Dhënia e identitetit të qartë programor të secilit prej kanaleve të rrjetit të RTSH dhe dhënie e një identiteti të qartë profesional nga pikëpamja e formës dhe përmbajtjes të çdo programi, është një nga sfidat ku është fokusuar puna e stafëve tona. Pasurimi sasior dhe cilësor i grilave programative të kanaleve të RTSH, i shërben publikut për të qenë më i qartë në procesin e kërkimit dhe ndjekjes së tyre, duke ndihmuar vetë median tonë që të ketë në tërësinë e vet një identitet në shërbimit gjithnjë e më profesional e cilësor ndaj shqiptarëve.

Identiteti i kanaleve e programeve dhe harmonizimi i tyre nga rrjeti i RTSH, në funksion të rritjes së konkurrencës përballë mediave audiovizive private sipas fashave orare dhe nevojave të audiencës për më shumë informim, argëtim dhe edukim të saj ka ndikuar në rritjen e shikueshmërisë dhe shtimin e besueshmërisë publike.

Pas afro një dekade mungese, në sezonin aktual radioteleviziv falë investimeve të reja dhe përkushtimit profesional, janë rikthyer në ekranin e RTSH spektaklet televizive duke rritur ndjeshëm shumëllojshmërinë e programeve, e përmes tyre edhe të audiencës. Studio Nr. 1 e rinovuar totalisht në RTSH, me koncept 360 gradë ledëall- videowall, vlerësohet gjerësisht si më e mira aktualisht në tregun televiziv shqiptar. Ndërtimi dhe funksionimi i saj, është bërë një garanci për suksesin e disa prej programeve më të rëndësishme në RTSH, duke ndikuar në rritjen e profesionalizmit nga ana e stafit por edhe në shtimin e audiencës nga ana e publikut.

Këto bashkë edhe me investimet në burime njerëzore dhe në platformat online, kanë ndikuar në shtimin e shpërndarjes së produkteve tona audiovizive rrjetin e gjerë global, duke shkuar më shpejt, më me cilësi e në mënyrë më profesionale tek një audiencë gjithmonë e në rritje.

Redaksia e online është një nga strukturat që ka pësuar përgjatë muajve të fundit, ndryshimin më të thellë përsa i përket mënyrës së funksionimit, duke sjellë një ndryshim po kaq të madh edhe në aktivitetin e ndjekësve të RTSH në hapësirën online.

Kjo redaksi është shpërngulur për tu akomoduar në një hapësirë të re, më të blloshme, më të kompletuar nga ana e infrastrukturës dhe pajisjeve teknologjike, duke qenë në një godinë e shumë pranë newsroomeve të rtsh 1 dhe rtsh 24. Drejtuesit dhe stafi i kësaj strukture, i janë nënshtruar trajnimeve të vazhdueshme brenda e jashtë vendit, për tu ngjitur në lartësinë e sfidave të reja që na presin në këtë fushë.

Për pasojë, vetëm në muajt e fundit të 2023 e në vazhdim përgjatë muajve të parë të 2024, aktiviteti i RTSH në hapësirën virtuale është shumëfishuar. Aktiviteti në youtube është rritur afër 150% në raport me 9 më parë, e për pasojë janë shumëfishuar të ardhurat që përfitohen nga ky aktivitet në raport me mesataren mujore të një viti më parë.

Në rrjetet sociale po gjatë kësaj periudhe, aktiviteti i RTSH, ka pësuar rritjen më të shpejtë në tregun e mediave shqiptare radiotelevizive. Ajo shkon nga rreth 70% më shumë të numrit të ndjekësve në instagram, në rreth 150% në facebook.

Veçohet rritja me 2500% e numrit të ndjekësve dhe e pëlqimeve në tik tok, përgjatë muajve të fundit, e cila mbetet platforma më popullore në botë. Kjo e ka bërë aktivitetin e RTSH në këtë rrjet social, në shifra të krahasueshme me dy Televizionet kryesore kombëtare private, “Top Channel” dhe “Klan”. Ritmet krahasimore të rritjes tregojnë se nëse vijohet kështu, brenda një viti RTSH ka premisa për t'ia kaluar dhe të ngjitet për herë të parë, në krye të garës mes tyre për audiencën në tik tok.

Sipas analizave me të dhëna konkrete, shumë nga programet e RTSH, aktualisht janë pjesë e garës së madhe me mediat kombëtare private për shikueshmëri në treg, ndikim dhe për përmbushjen gjithmonë e më mirë të nevojave publike me produkte të ndryshme audiovizive.

Një numër jo i pakët i emisioneve, edicioneve informative, zhanreve të ndryshme audiovizive dhe programeve të kanaleve të rrjetit të RTSH, janë ose më të ndjekurat aktualisht në të gjithë tregun mediatik shqiptar, ose në konkurrencë “kokë më kokë” me programet e tjera të të njëjtit lloj dhe të transmetuara në të njëjtat fasha orare transmetimesh. Duke rritur çdo ditë e më shumë në këtë mënyrë, peshën, rëndësinë dhe kontributin e RTSH për informimin sasiore por mbi të gjitha cilësor e profesional të publikut shqiptar.

Futja e sistemit të matjes së audiencave televizive përmes një kompanie ndërkombëtare lider në këtë fushë e cila është e besueshme, profesionale, e paanshme dhe me reputacion të padiskutueshëm do ta ndihmonte jo vetëm RTSH por të gjithë median shqiptare për të orientuar çdoherë e më mirë në mënyrë profesionale punën e saj drejt nevojave, shijeve dhe interesit më të gjerë publik.

Shqipëria mbetet aktualisht vendi i vetëm në Europë që nuk e aplikon këtë instrument matës, ndërkohë që AMA (Autoriteti i Mediave Audiovizive) ka iniciuar e po e nxit këtë proces që shpresojmë të përmbyllet brenda vitit 2024.

RTSH përmes Drejtorit të Përgjithshëm ka marrë pjesë aktive në këtë përpjekje si pjestar i bordit të sapo krijuar për këtë qëllim, duke besuar se do të jetë përfituesi kryesor i këtij instrumenti, duke patur parasysh se jemi e vetmja media audiovizive në Shqipëri që mbulojmë me sinjal pothuajse gjithë popullsinë dhe sipërfaqen më të madhe të territorit të vendit.

Rritja që po pëson RTSH në prodhim, shikueshmëri dhe dëgjueshmëri nëse do mbështetet edhe nga matja e saktë e audiencave në peisazhin audioviziv shqiptar, do ndihmonte veç të tjerash në rritjen e të ardhurave të institucionit. Kjo anomali në treg ka ushqyer “arrogancën” e mediave të mëdha private ndaj kompanive të marketingut, duke bërë që RTSH të përfitojë nga “torta” rreth 55 milionë euroshe e reklamave që qarkullojnë gjatë një viti në Shqipëri, vetëm thërrimet e saj.

Sfida kryesore e ekipit drejtues mbetet jo vetëm rikthimi i RTSH-së sërish të madhe në epokën digjitale, por edhe hedhja e themeleve për ndërtimin pas kësaj të një media publike në Shqipëri, për gjeneratën e ardhëshme. Ky proces nuk është aspak i thjeshtë, po të kemi parasysh degradimin e pësuar përgjatë 33 viteve të postkomunizmit, që e kishin rrënuar RTSH në pothuajse të gjitha aspektet e punës dhe veprimit të saj.

Puna aktualisht është fokusuar tek sfida e rikthimit të RTSH në qendrën më të madhe të prodhimit të produkteve audiovizive në Shqipëri, përmes ndryshimit të mentalitetit dhe kulturës e kushteve të punës, rritjes profesionale dhe trajnimit të stafëve, rritjes së kapaciteteve teknike e infrastrukturore, investimeve të reja në teknikë e infrastrukturë, në krijimin e ambjenteve bashkëkohore për punën dhe futjen e ideve e teknologjive të reja.

RTSH përgjatë muajve të fundit, ka kaluar nga faza alarmante e emergjencës së nivelit më të lartë përse i përket sigurisë dhe kapaciteteve që garantojnë prodhim e transmetim cilësor e profesional, në fazën e normalitetit teknik e teknologjik falë investimeve, punës dhe përkushtimit të stafit të saj. Kjo na jep qetësinë për të sotmen dhe garancinë për avancimin drejt investimeve, për ta futur edhe RTSH sa më shpejt drejt erës së gjeneratës së re teknologjike të transmetimeve audiovizive

nën shembullin e mediave publike të hapësirës së EBU (European Broadcasting Union) pjesë e së cilës është edhe Shqipëria.

Në disa drejtime, në sajë të vizionit e projektit të ri drejtues, RTSH është aktualisht në pararojë të përfaqimit të medimeve të reja në hapësirën e EBU, siç është ajo e podcasteve.

RTSH është në pararojë edhe për futjen e gjeneratës së re të teknologjisë, përmes plejadës së parë satelitore “Starlink” që ofron internet me shpejtësi të lartë dhe me vonesë të ulët. Futja e kësaj teknologjie e bën RTSH të pakonkurueshme në treg përse i përket sigurisë dhe cilësisë së lartë të transmetimeve në distancë nga zonat me probleme valësh dhe me internet të shpejtësisë dhe cilësisë së dobët.

Por ky nuk është i vetmi hap që kemi hedhur drejt RTSH së gjeneratës së ardhshme. Sepse as Inteligjenca Artificiale (AI) nuk është më e huaj për RTSH, ku stafi aktual ka nisur prodhimin e produkteve të para me ndihmën e saj, duke rritur rendimentin në disa procese pune por edhe cilësinë e tyre.

Një nga detyrat e drejtuesve dhe stafit të RTSH në përgjithësi, e cila buron nga Deklarata e Qëllimit të Statutit të saj, është garantimi i një mbulimi të paanshëm të lajmeve të vendit dhe të atyre ndërkombëtare. Është një fakt i ekspozuar publikisht prej shumë muajsh, që RTSH është në rrugën e duhur, për ta përmbushur sa më mirë këtë detyrim të saj. Vlerësimet janë se edicionet dhe programet informative të medias publike shqiptare, janë sot ndër më profesionale, më të balancuarat, gjithpërfshirëset e ndër më të besueshmet në treg.

Stafi i RTSH përmes lajmeve, kronikave, lidhjeve direkte, reportazheve dhe intervistave është gjithmonë e më pranë publikut, halleve, shqetësimeve, problemeve, zgjidhjeve por edhe tematikave të tjera në interes të saj. Historitë njerëzore, ato të suksesit, gjetja dhe pasqyrimi i shembujve pozitivë dhe frymëzues për komunitetin, promovimi dhe nxitja modeleve të reja të dobisë e mirësisë shoqërore, po nxisin një frymë që krijon një klimë gjithmonë e më pozitive për individët, familjet, komunitetet dhe shoqërinë në tërësi.

Sikundër edhe kritikant, ngritja e problemeve me interes të gjerë shoqëror, krijimi i presionit pozitiv profesional ndaj të zgjedhurve vendorë e qëndrorë, ndaj pushteteve dhe administratës në të mirë të shoqërisë, të publike dhe në të mirë të interesit kombëtar, kanë ndikuar që logo e RTSH përmes programeve të saj informative e tematike, të ketë një besueshmëri e pëlqyeshmëri gjithmonë e më të lartë publike.

Për ta përmbushur më së mirë këtë obligim, stafi drejtues i RTSH ka punuar dhe ia ka arritur që të ngrejë në nivelet më të larta profesionale njerëzore, por edhe nga ana teknike e infrastrukurore kanalën televiziv informativ RTSH 24.

Nga 1 maji 2024, ky kanal ka një pavërësi të plotë teknike e infrastrukurore transmetimi e prodhimi nga RTSH 1, duke patur staf të dedikuar, studio të reja, faqosje e paketë të re dhe moderne grafike që i mundëson të garojë si i barabartë me të gjitha televizionet e tjera informative private, në garën për shpejtësinë, saktësinë dhe profesionalizmin në dhënien e trajtimin e informacionit.

Një nga sfidat e tjera për të cilën po punohet, në përmbushje të Deklaratës së Qëllimit, është edhe ai i realizimit të programeve, të cilat duhet të pasqyrojnë te dëgjuesit dhe shikuesit e të gjitha moshave larminë e jetës shqiptare. Nga ana tjetër, RTSH është e obliguar dhe po punon për ta realizuar këtë, përmes përgatijes së programeve cilësore e me vlera për pasurimin e botës mendore dhe shpirtërore të njerëzve.

Këtu qëndron edhe një ndër dallimet më thelbësore mes medias private si biznes i informimit dhe argëtimit, me RTSH si një media publike e përkushtuar në më të mirën profesionale të interesave të saj. Në bashkëpunim edhe me Këshillin për shikuesit e dëgjuesit, RTSH po rrit standardet profesionale dhe cilësinë e programeve, në interes të publikut të gjerë shqiptar.

Stafi drejtues nuk e harron asnjëherë që Radio Televizioni Shqiptar është një institucion publik i një rëndësie të veçantë kombëtare që kryen një shërbim publik në fushën e medias audiovizive, me qëllimin për të siguruar nevojat demokratike, sociale dhe kulturore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe të shqiptarëve në mbarë botën.

Duke shfrytëzuar një nga veçoritë më unikale të historisë sonë, prej disa javësh RTSH është bërë media e parë shqiptare që ka hapur kanalën e saj në Spotify, platformën më të madhe audiofonike në botë. Përmesa saj po ofrohet një gamë gjithmonë e më e pasur produktesh të të gjitha zhanreve, për të cilat zotërohen të drejtat e transmetimit dhe të pronësisë. Brenda pak ditësh e javës ky kanal ka patur që në start një pëlqyeshmëri të madhe, duke ofruar brenda saj çdo ditë e më tepër, një numër të lartë ndjekësish, dëgjimesh e klikimesh.

Stafi drejtues i RTSH po punon veç të tjerash, për ti dhënë një identitet të qartë programor kanalit të 3-të të televizionit fokusuar tek diaspora shqiptare kudo ku ajo jeton e punon. Për këtë janë realizuar një sërë programesh të cilat pasqyrojnë gjithmonë e më mirë, jetën dhe veprimtarinë, hallet dhe shqetësimet e komunitetit shqiptar nëpër botë, duke nxitur e promovuar integrimin e tyre në shoqëritë ku kanë zgjedhur të jetojnë e punojnë por edhe modelet e suksesit dhe historitë që nxjerrin në pah vetitë më të mira të shqiptarit. Megjithatë ka ende shumë për të bërë, derisa RTSH 3, të marrë trajtën e një televizioni të mirëfilltë në shërbim të plotë të diasporës shqiptare.

Për të arritur nivelet më të larta të shërbimit ndaj audiencës, RTSH-ja po punon çdo ditë për të zbatuar vlerat themelore të përbashkëta të mediave të shërbimit publik, që ngrihet mbi 7 kolonat e saj fundamentale:

- Gjithëpërfshirja – për të arritur të gjithë shqiptarët, kudo që ata jetojnë e punojnë në Shqipëri, rajon e në botë.
- Besueshmëria – përmes prodhimit të programeve gjithmonë e më profesionale si në formë ashtu edhe në përmbajtje.
- Përsosmëria – përmes rritjes së vazhdueshme të integritetit dhe profesionalizmit.
- Diversiteti – duke pasur një qasje sa më të balancuar dhe pluraliste ndaj të gjithë aktorëve dhe faktorëve të shoqërisë.
- Llogaridhënia - për të dëgjuar të gjitha nevojat racionale të audiencës dhe për t'u angazhuar në një debat kuptimplotë në përmbushje të këtij detyrimi jashtë lojës politike dhe interesave të tjera të ditës.
- Inovacioni – për të qenë një qendër e aplikimit të teknologjive më të reja, më cilësore e më të avancuara që e bëjnë RTSH me kalimin e kohës një forcë lëvizëse për risi dhe krijimtari.
- Paanshmëria – për të ofruar informim objektiv, të plotë dhe të padiferencuar, jashtë çdo ndikimi ideologjik, politik, social, fetar, financiar, kulturor.

Brenda më pak se një viti, rreth 70% e ambjenteve të përbashkëta, si ato të punës individuale ashtu edhe ato kolektive të RTSH, i janë nënshtruar rinovimit total, rivitalizimit të plotë ose rikthimit në identitet duke harmonizuar respektin ndaj të shkuarës. Kjo qasje synon zhvillimin e projektit përmes krijimit të një mjedisi me standardet më të larta të kushteve të punës, shtimin e klimës pozitive profesionale, që të jetë stimulues për rritjen e cilësisë së transmetimeve audiovizive por edhe sfidues për të ardhmen.

Një nga projektet e para në këtë drejtim ka qenë ai për transformimin me themel të Newsroom- it të RTSH 1 dhe i të gjithë ambjenteve të tjera të punës, mbledhjeve e pushimit për gazetarët, operatorët dhe montazhierët duke krijuar hapësira më profesionale dhe me kushte me optimale për punën e përditshme. Të sigurtë se kjo do të ndikojë veç të tjerash, edhe në rritjen e rendimentit të punës së tyre dhe shndërrimin sëshpejti të RTSH-së në një institucion profesional model.

Aktualisht në RTSH çdo krijues, çdo gazetar, moderator, drejtues, punonjës i administratës dhe i sektorëve të tjerë të institucionit, ka postin e vet të paisur me gjithçka të nevojshme për një punë me standarde profesionale. Stafet kanë gjithashtu e do të kenë akoma edhe më shumë në të ardhmen edhe ambjente të përbashkëta me kushtet më optimale, si në çdo media tjetër kryesore private në Shqipëri, të krahasueshme edhe me mediat e tjera publike të rajonit dhe disa prej mediave të hapësirës së EBU.

Të gjitha këto investime janë realizuar falë përkushtimit dhe pasionit të stafit të RTSH, me të njëjtin buxhet të viteve të shkuara. Madje edhe më pak, po të kemi parasysh efektet financiare që shkaktoi në buxhet, rritja e fundit e pagave të punonjësve të RTSH e cila nuk u shoqërua me rritje të ardhurave nga taska e aparatit, nga buxheti i qeverisë apo nga vetë institucioni përmes marketingut apo marrëdhënieve të tjera financiare me palët e treta.

Nisur nga kjo kërkoj ndihmën e anëtarëve të ndëruar të Këshillit Drejtues të RTSH dhe të Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, që ta ndihmojnë transmetuesin publik me ndikimin dhe përmes lobimit të tyre, që të ndikojnë në rrijten e të ardhurave në buxhetin e RTSH për të mundësuar realizimin më shpejtë të projekteve për realizimin e programeve akoma cilësore, duke rritur standardet e punës së punonjësve dhe të ardhurave të tyre në nivele të krahasueshme me konkurrentët kombëtarë privatë në treg.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar marrëdhënieve të bashkëpunimit bilateral me mediat publike të vendeve fqinjë por edhe të shteteve të tjera brenda hapësirës së EBU. Në fund të muajit Gusht 2023 kemi hapur për herë të parë zyrën e përbashkët mes RTSH-së dhe RTK-së në kuadër të një marrëveshjeje të firmosur në Prishtinë , ku të dyja palët angazhohen që 24 orë për 24 orë, të kenë akses, të kërkojnë e të marrin e japin produkte audiovizive në interes të dy vendeve tona e në interes të audiencës në Shqipëri dhe Kosovë .

Marrëveshje të tjera bashkëpunimi janë firmosur edhe me Radio Televizionin Publik të Malit të Zi, të Turqisë duke vijuar edhe traditën e mëparshme në marrëdhënie të këtij lloji me RAI në Itali, por edhe me radiotelevizione të tjera publike. RTSH ka aktivitetin dhe zërin e saj në EBU, duke qenë një anëtar shumë aktiv me të drejta të plotë në këtë union, duke rritur nivelin e informacionit dhe të shkëmbimit të përvojave më të mira në industrinë audiovizive.

Gjatë kësaj periduje ka përfunduar rikostruksioni i plotë përmes rikthimit në identitet dhe modernizimit të sallës së Orkestrës Sinfonike të RTSH-së, duke risjellë pas më shumë se 30 vitesh mundësinë e regjistrimeve audio të koncerteve, kalendarit e repertorit të saj artistik dhe duke patur mundësinë për herë të parë për transmetime live apo regjistrime televizive. Ky investim e ka shndërruar sallën e orkestrës simfonike, në një studio multifunkionale, duke e shndërruar atë në gurin e diamantit të aseteve të RTSH.

Është bërë rikostruksioni total i të gjitha studiove kryesore të Radio Tiranës, duke i hapur rrugën pas kësaj, projektit ambicioz të vizualizimit të të gjitha programeve radiofonike. Kjo do të shtonte nurmin e programeve radiotelevizive dhe të produkte radiofonike ne video, për të shkuar tek publiku edhe përmes këtij dimensionit me anë të ëëbsite, youtube dhe rrjeteve sociale.

Kemi rikthyer në funksion pas shumë e shumë vitesh që ka qëndruar e mbyllur, Sallën e Vizionimit ose atë që njihet si “Kinemaja”, nga ku mund të shihen, kontrollohen, diskutohen e analizohen prodhimet e reja të zhanreve me minutazh të gjatë, prodhime të stafit të RTSH përpara së të dalin në transmetim.

Pas përfundimit dhe projektimit nga ana e grupit të punës jemi në fazën e realizimit të template-s së websites së RTSH-së me standartet më të larta profesionale ku mundësohet hyrja jonë në fushën e konkurrencës reale edhe në këtë hapësirë të pa eksploruar mirë profesionalisht deri më sot.

Kemi përfunduar në letra projektin e pavarësimit teknik dhe infrastrukturor të RTSH Sport , me dy studio të reja për programet dhe edicionet e lajmeve, me të gjitha ambjentet ndihmëse që e bëjnë atë një televizion tematik sportiv të gatshëm për të konkuruar në treg, me programe 24 orë në 7 ditë të javës, gjithashtu e pavarur nga ana infrstrukturore e teknike nga RTSH 1.

Pas shumë vitesh ne kemi rikthyer si pronë të gjitha të dhënat e RTSH-së deri dje të regjistruara si pronë private, të platformës së mbyllur vite më parë të njohur si “RTSH tani” (OTT) dhe po punohet për ta riaktivizuar atë në rrjetin e gjerë global për të konkuruar edhe më në fund edhe në këtë dimension të rëndësishëm të hapërirës virtuale ku është zhvendosur çdo ditë e më shumë gara për audiencën radiotelevizive edhe në Shqipëri.

Për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve, specialistëve dhe drejtuesve të institucionit, e kemi vendosur theksin tek forcimi i Akademisë së RTSH-së. Një strukturë sipas modeleve më të mira të EBU dhe që po mer peshën dhe rëndësinë që i takon, për shkak të nevojave të medias sonë publike për rritjen e aftësive profesionale të stafit në kushtet e ndryshimeve që po ndodhin përgjatë procesit të reformimit të thellë të RTSH.

Një tjetër projekt në zhvillim është ai i rivitalizimit të asaj që njihet si “Atelieja e Re”, që pritet ta shndërrojë atë në sallën më të madhe të spektakleve në tregun televiziv shqiptar, e që është pronë deri dje e pashfrytëzuar e RTSH. Kjo studio e re e përmasave ndërkombëtare, do ta çojë në një nivel të ri shumë më të lartë, mundësinë e RTSH për të zhvilluar programe argëtuese të përmasave të mëdha të munguara prej shumë dekadash në ekranin e saj.

Përmes programeve të shumta e të larmishme, spektakleve, produkteve artistike, reportazheve, specialeve, dokumentarëve, transmetimeve live, prodhimit edhe të filmave televizivë në të ardhmen e afërt, synohet rikthimi i Radio Televizionit Publik Shqiptar sërish të madh si dikur, edhe tani në epokën digjitale.

Një nga shqetësimet që kam ngritur edhe më parë, e që është shumë shqetësues, ka qenë realiteti i marrjes nga ana e RTSH të pothuajse çdo gjëje me qera nga operatorët privatë në treg. RTSH aktualisht ia ka dalë që të ketë pavarësi totale nga të tretët në lidhje me realizimin e nevojave të veta për transmetime live apo regjistrime, një zë që i merrte buxhetit të RTSH-së shuma të konsiderueshme, të cilat mund të shkojnë për programacionin dhe prodhimin kryesisht.

Një sfidë e madhe për stafin e ri drejtues, mbetet realizimi i procesit të digjitalizimit të arkivit që përmbledh brenda saj historinë unike 85 vjeçare të radios dhe atë 64 vjeçare të Televizionit. Për këtë jemi në kontakte me shumë institucione të specializuara brenda dhe jashtë Shqipërisë, me drejtuesit kryesorë të EBU, me kolëgjet e mediave publike të vendeve që e kanë përfunduar këtë proces por edhe me kompani të mëdha ndërkombëtare që operojnë në këtë fushë. Brenda këtij viti kalendarik (2024) besojmë shumë se do të kemi një marrëveshje që do ta çonte përpara këtë proces shumë të rëndësishëm.

Në formë më të detajuar, më poshtë do të gjeni një përmbledhje të veprimtarive dhe aktivitetit të secilës strukturë në RTSH, deri në dhjetor 2023.

DREJTORIA E EKONOMISË

Realizimi i treguesve të mësipërm analizohet duke u bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues të RTSH, Nr.7 datë 27 Shkurt 2023, mbi miratimin e buxhetit të RTSH për vitin 2023.


Struktura e të ardhurave të RTSH gjatë vitit 2023

A. Struktura e të ardhurave të realizuara:

Në mënyrë të detajuar burimet, nëpërmjet të cilave RTSH ka realizuar të ardhurat gjatë kësaj periudhe janë:

BURIMI	Të ardhurat në 000 lekë
Financimi nga Buxheti i Shtetit 29.2%	618,000
Tarifa mbi Aparatin Marrës radio televiziv 60.7%	1,282,967
Kontratat e shfrytëzimit të infrastrukturës së transmetimit 5.8%	123,215
Reklamat, njoftimet kronikat etj 3.4%	71,995
Të ardhura të tjera, shitja e mat.arkivore, ripërsëritje transm, qira, grante etj. 0.8%	17,121
TOTALI	2,113,298

Në mënyrë të përmblodhur, të ardhurat sipas burimeve të financimit janë realizuar në raportet dhe në strukturën e mëposhtme:



B.Realizimi i të ardhurave në krahasim me planifikimin gjatë vitit 2023:

Të ardhurat janë realizuar në masën 76.1% në krahasim me planifikimin.

Në mënyrë analitike realizimi i të ardhurave në total prej 2,113,298 mijë lekë dhe mungesat në vlerë absolute 664,757 mijë lekë, analizohen më poshtë

I-Të ardhurat nga buxheti janë realizuar në nivelin 92.5%.

a) Në Programin e parë Bashkatdhetarët dhe Shërbimi Satelitor, në zbatim të nenit 116/a,b,c të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit” përfshin :

- a) shërbimin e transmetimeve audio për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;
- b) shërbimin e transmetimeve audio për publikun e huaj;
- c) shërbimin e transmetimeve audiovizive për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë; është tërhequr financimi në vlerën totale 240,000 mijë lekë, duke u realizuar 100% .

b) Në Programin Projekte Filmike e Artistike, në zbatim të nenit 116/d të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit”/d) Projekte të rëndësishme prodhimi filmik dhe veprimtari artistike të mëdha mbarëkombëtare, të prodhuara nga RTSH-ja; është tërhequr financimi buxhetor në vlerën totale 68 mijë lekë për projektet filmike e artistike parashikuar për vitin 2023: Eurosong 2023, Junior Eurosong, Festivalin e 62 të Këngës në RTSH, programet artistike, filmike, festive të fundvitit.

				<i>Në 000 lekë</i>
Nr	Emërtimi	Planifikimi Janar - Dhjetor 2023	Realizimi Janar - Dhjetor 2023	% e realizimit
I.	Financimi nga buxheti	668,000	618,000	92.5%
a	Bashkatdhetarët&Sateliti	240,000	240,000	100.0%
b	Projekte Filmike&Artistike	68,000	68,000	100.0%
c	Orkestra Simfonike RTSH	90,000	90,000	100.0%
d	Projekte Tekn.Teknologji te reja SLA	270,000	220,000	81.5%
II.	Të ardhura nga tarifa aparatit TV.	1,779,055	1,282,967	72.1%
III.	Të ardhura te institucionit	331,000	212,331	64.1%
a	Sherbim ambjente transmetuese, tr.fm	125,000	123,215	98.6%
b	Reklama,njoftime etj.	150,000	71,995	48.0%
c	Të ardhura të tjera	56,000	17,121	30.6%
TOTALI		2,778,055	2,113,298	76.1%

c) Në Programin e tretë Orkestra Simfonike e RTSH-së, në zbatim të nenit 116/dh të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit”/ dh) orkestrën simfonike të RTSH-së dhe kinematografisë, është tërhequr financimi në vlerë totale 90 mln lekë. Ndonëse shpenzimet janë tërhequr nga buxheti 100% në nivelin e planifikuar, në fakt RTSH ka plotësuar diferencën e shpenzimit të këtij zëri e cila nuk arrin të mbulohet nga financimi buxhetor.

d) Në Programin e Projekteve Teknike për futjen e Teknologjive të reja, në zbatim të nenit 116/ç të Ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit”/ ç) projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim; parashikuar shpenzime për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit etj. në masën 81.2%, ose në vlerë nga planifikimi 270,000 mijë lekë, në vlerën 220,000 mijë lekë fakt. Kjo për arsyen sepse me Aktin normativ Nr. 6, datë 14.12.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022, “për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, RTSH ka përfituar një shtesë buxhetore prej 50,000,000 lekë, në financimin e vitit 2023. Por tërheqja e këtij financimi është mundësuar nga Thesari i Shtetit në muajin Janar 2024, dhe do të raportohet në të ardhurat e vitit 2024, periudhë kjo kur edhe është realizuar.

II. E ardhura nga tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv.

Tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv është realizuar në vlerën 1,282,967 mijë lekë ose në masën 72.1% në krahasim me planin vjetor, ose mungesë në vlerë absolute ~496,088 mijë lekë. Gjatë vitit 2023, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa përfshijnë periudhën Janar -Dhjetor 2023, dhe këto të ardhura janë arkëtuar brenda periudhës së parashikuar mujore.

Mosrealizimi në këtë zë vjen kryesisht si rezultat i planifikimeve në buxhet në fillim të vitit, bazuar në kërkesat për ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr.29, datë 18.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Radio Televizionit Shqiptar për tarifën e aparatit.

Konkretisht, është kërkuar ndryshimi i udhëzimit me:

- një rritje të tarifës deri në 200 leke nga 100 leke që është aktualisht.
- uljen e komisionit të agjentit tatimor (OSHEE), nga 10% në 2%.
- faturimi i shërbimit për përdorimin e aparateve televizive për përdoruesit jo-familjarë bazuar në numrin e aparateve/dhomave.

Gjatë viteve të fundit, arkëtimi i tarifës në muaj të veçantë ka rezultuar më i ulët se planifikimi dhe ka krijuar problematika në realizimin e të ardhurave të buxhetit të përgjithshëm, dhe për rrjedhojë edhe në shpenzimet e RTSH-së.

Risku në realizimin e kësaj të ardhure qëndron, si në arritjen e realizimit 100% të nivelit të planifikimit, ashtu edhe në atë që arkëtimet të kalojnë në fondet e RTSH-së brenda muajit korrent.

III. Të ardhurat e vetë RTSH-së janë realizuar në masën 64.1%.

a. Të ardhurat nga shërbimi në ambjentet transmetuese të RTSH dhe transmetime fm

janë realizuar me 98.6%. Të ardhurat nga shërbimi në stacionet e RTSH-së dhe transmetimi në FM paraqiten më të stabilizuara se të ardhurat e tjera të vetë institucionit përse i takon realizimit të tyre, me një mos realizim në vlerë prej afro 1,785 mijë lekë. Vlen të theksohet se një pjesë e operatorëve lokalë nëpër alokmente janë larguar nga rrjeti i RTSH, duke sjellë si rrjedhojë edhe diferencën në mosrealizim të të ardhurave të planifikuara në këtë zë.

b. Të ardhurat nga reklamat, njoftimet etj, janë realizuar në masën 48%.

Planifikimi është bërë mbi bazën e parashikimeve nga Drejtoria e Shitjes dhe Promocionit, por gjatë vitit 2023 realizimi nuk qëndron në nivelet e parashikuara nga kjo Drejtori.

Në mënyrë analitike të ardhurat e realizuara paraqiten:


- Drejtoria e Shitjes dhe Promocionit në vlerën 67,575 mijë lekë
- Qendra Vendore Audiovizive Gjirokastër në vlerën 1,169 mijëlekë
- Qendra Vendore Audiovizive Shkodër në vlerën 315 mijë lekë
- Qendra vendore Audiovizive Korçë në vlerën 2,936 mijë lekë

c. Në zërin e të ardhurave të tjera janë realizuar të ardhurat e parashikuara, në nivelin 30,6%. Në këtë zë janë përfshirë të ardhurat nga qira tokash, ndërtesa, bankomatesh etj, shitja materialeve arkivore, Te ardhura nga platforma Youtube, Të tjera të ndryshme.

Mosrealizimi në zërin e të ardhurave të tjera vjen kryesisht nga të ardhurat e realizuara nën parashikimin nga platforma Youtube, që për vitin 2023 sipas parashikimit duhet të ishin rreth 30,000 mijë lekë, dhe ndërkohë janë në një realizim prej afro 8,400 mijë lekë. Gjithashtu me ndikim në mosrealizimin e të ardhurave të tjera është edhe mos shpërndarja nga kompania

Eutelsat gjatë vitit 2023 e të ardhurave nga dividendi si pjesëmarrje e RTSH në kapitalin aksioner të saj. Të ardhura këto që për vitin 2023 ishin parashikuar në shumën 13,000 mijë lekë.

C. Realizimi i të ardhurave gjatë tre viteve të fundit:



				<i>Në 000 lekë</i>
Nr	Emertimi	Realizimi Viti 2021	Realizimi Viti 2022	Realizimi Viti 2023
I.	Financimi nga buxheti	573,736	567,600	618,000
	Bashkatdhetarët&Sateliti	220,000	240,000	240,000
	Proojekte filmike dhe artistike	60,000	67,600	68,000
	Orkestra Simfonike RTSH	60,000	62,400	90,000
	Projekte Tekn.Teknologji te reja SLA	216,000	197,600	220,000
	Investime	17,736	0	0
II.	Të ardhura nga tarifa aparatit TV.	1,265,225	1,282,469	1,282,967
III.	Të ardhura te institucionit	296,943	379,382	212,331
	Shërbim ambjente transmetuese, tr. fm	137,397	118,250	123,215
	Reklama, njoftime etj.	143,546	217,057	71,995
	Të ardhura të tjera	16,000	44,075	17,121
TOTALI		2,135,904	2,229,450	2,113,298

Nisur nga të dhënat e tabelës:

-Të ardhurat nga financimi buxhetor kanë një rritje të lehtë gjatë vitit të fundit, kryesisht prej rritjes në zërin e Orkestra Simfonike RTSH..

-Të ardhurat nga tarifa shërbimit të përdorimit të aparatit tv paraqiten pothuajse në të njëjtin nivel gjatë tre viteve të fundit. Gjatë vitit 2023 të ardhurat nga ky zë kanë qenë në shumën 1,283 mijë lekë.

D.Të drejtat e pritshme për arkëtim

Kliente për shitje dhe shërbime në vlerën 239,151 mijë lekë, si në tabelën më poshtë:

	<i>Në 000 lekë</i>
Lloji I detyrimeve te klienteve	Vlera
Te pritshme te arketohen (te ardhura teknike)	94,341
Te pritshme te arketohen (te ardhura marketing)	47,548
Te drejta nga kontrata shkembimi	48,464
Te drejta ne proces gjyqesor te pritshme te arketohen	7,040
Detyrime kliente pa shprese arketimi	41,758
Totali kliente	239,151

Nga sa më sipër “Klientë”, në vlerën prej 197,393 mijë lekë në vitin 2023 përfshin të gjitha detyrimet e të tretëve të krijuara në Drejtorinë e Përgjithshme dhe QVA Korçë, Shkodër, Gjirokastrë. Pothuajse këto detyrime janë të likujduara ose në proces likuidimi në vijim. Llogaria 416 “Klientë e llogari të ngjashme”, me vlerë totale 41,758 mijë lekë, e cila përmban detyrime të mbartura nga Njësia Teknike me një shumë detyrimi të paarkëtuar nga subjektet debitore në vlerën 1,168 mijë lekë (krijuar në ish drejtoritë e Radio Tiranës dhe Drejtoria Stacioneve Transmetuese RTSH para vitit 2000), si edhe Drejtoria e Përgjithshme e RTSH rezulton me një shumë detyrimi të paarkëtuar nga subjektet debitore në vlerën 40,590 mijë lekë të periudhës 2004-2005, detyrime këto për disa nga të cilat ka kaluar afati i parashkrimit.

Të drejta të pritshme për arkëtim nga institucione në fund të vitit 2023 është në vlerën 421,794 mijë lekë me një rritje prej 50,524 mijë lekë nga viti 2022, dhe përfaqëson detyrimin tatimor të shtetit ndaj RTSH-së për TVSH-në kreditore.

Lista e subjekteve me detyrimet përkatëse relatohet rregullisht në Drejtorinë e Shitjes dhe Promocionit dhe në Drejtorinë Juridike. Sikurse është vepruar edhe vitet e tjera, për disa subjekte kanë nisur procedurat për ndjekjen e detyrimeve në rrugë gjyqësore.

Në kushtet kur RTSH përballlet me kostot tepër të larta të procesit të digjitalizimit, shtimit të numrit të kanaleve të transmetimit e larmishmërisë së programacionit, mos financimi buxhetor bazuar në


kërkesat e RTSH për shpenzimet faktike të politikave e programeve buxhetore, krijojnë vështirësi në stabilitetin financiar të RTSH-së.

Realizimi i shpenzimeve në krahasim me planifikimin gjatë vitit 2023:

				<i>Në 000 lekë</i>
Nr	Emertimi	Planifikimi Viti 2023	Realizimi Viti 2023	Realizimi ne %
1	Paga, shpërblime, sig.shoqeror	1,127,205	1,107,959	98%
2	Materiale, lende djegese	67,000	60,044	90%
3	Projekte film, artistike, bl.drejta tv, f.p.pavarur	422,000	273,139	65%
4	Organizma Nderkombetar	93,500	64,213	69%
5	Shërbime nga të tretë	268,850	234,318	87%
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	38,000	37,930	100%
7	Shpenzime të tjera operative	71,700	71,537	99.8%
8	Mirembajtje rrjeti digjital.dhe te tjera	255,000	232,902	91%
9	Investime	60,000	107,246	179%
Totali pa kestin e kredise		2,403,255	2,189,288	91%
10	Shpenzime këste e interesa kredie	324,800		
TOTALI		2,728,055	2,189,288	80%

Shpenzimet e RTSH-së gjatë vitit 2023 janë realizuar në nivelin 91%, pa përfshirë detyrimin për kredinë që është likujduar nga Ministria e Financave.

Struktura e shpenzimeve paraqitet në mënyrë grafike:



Shpenzimet për Paga, si dhe Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore është realizuar 98% dhe përbën 50.6% të shpenzimeve të RTSH-së gjatë periudhës, krahasuar me 45% që zinin në vitin 2022, rritje kjo për shkak të efektit të ndryshimit të pagave të RTSH sipas Vendimit Nr.34, datë 07.12.2022, të Këshillit Drejtues, hyrë në fuqi në Janar 2023. Bazuar në strukturën aktuale në fuqi numri faktik është 1039 vënde pune, Numri mesatar mujor i punonjësve gjatë vitit 2023 është 982 punonjës.

***Zëri Materiale** në total për 60,044 mijë lekë, përfshin shpenzimet për blerjen e materialeve kryesore teknike, materiale ndihmëse, dhe lëndë djegëse (karburant). Niveli i shpenzimeve për materiale është 90% në krahasim me planifikimin e vitit 2023.

***Zëri i projekteve Filmike dhe Artistike & Fondi i prodhimit të pavarur**, përfshin:

a) Të gjitha shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit evente sportive është realizuar në vlerën 95,058 mijë lekë.

b) Shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit, filma e dokumentare, në vlerën 37,982 mijë lekë.

c) Projekte filmike e Artistike, dhe shpenzime për to, si edhe marrje pajisjesh me qira për projekte, realizuar në vlerën 140,100 mijë lekë.

d) Fondi i prodhimit të pavarur planifikuar në vlerën 22,000 mijë lekë, nuk është shpenzuar gjatë vitit 2023.

***Zëri i Organizmave Ndërkombëtare** përfshin të gjitha shpenzimet që RTSH kryen ndaj organizmave ndërkombëtare realizuar në masën 69%, si Eutelsat e Ses Astra për shërbimin satelitor në vlerën 20,812 mijë lekë, si edhe kuota e pjesëmarrjes paguar për EBU, por edhe pagesat për AFP, Kosova Press, etj për 43,402 mijë lekë.

***Zëri i Shërbimeve nga të tretë** përfshin shpenzimet për shërbime të një natyre të përgjithshme që kryhen nga të tretët për funksionimin e përditshëm të veprimtarisë së RTSH, si shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzimet telefonike, shpenzimet për ruajtjen e sigurisë fizike të objekteve të RTSH, qira të ambienteve, mirëmbajtje si dhe shpenzime të tjera.

Realizimi i këtij zëri është në nivelin 87%, dhe në mënyrë analitike paraqitet:

-Shpenzimet për energji elektrike 105,958 mijë lekë, ujë në vlerën 3,151 mijë lekë.

-Shërbimi i ruajtjes fizike në vlerën 23,277 mijë lekë.

-Shpenzimet për qira për pronarët e truallit ku janë ndërtuar kullat e transmetimit gjatë procesit të digjitalizimit, kontrata për përdorimin e linjave elektrike për stacionet Dvb-t2, prej 18,988 mijë lekë.

Telefoni e shpenzime postare në vlerën 2,006 mijë lekë.

Shpenzimet e internetit dhe fibrave optike në vlerën 18,388 mijë lekë.

Siguracione në vlerën 17,219 mijë lekë.

Pagesa e frekuencave në AKEP në vlerën 13,304 mijëlekë.

Shpenzime për mirëmbajtje automjetesh në vlerën 4,842 mijë lekë.

Shpenzime të ndryshme e komisione në vlerën 27,288 mijë lekë.

***Zëri i shpenzimeve Udhëtime e dieta** është realizuar pothuajse në masën 100%, dhe në vlerë prej 37,930 mijë lekë. Rreth 30 % e përbëjnë shpenzimet në Njësinë Tematike dhe të Lajmeve, për vetë natyrën e kësaj Njësie. 8% e shpenzimeve janë në Njësinë Teknike për regjistrimin dhe transmetimin e aktiviteteve sportive, politike e artistike, si edhe për riparimet e defektet që ndodhin në stacionet rtv e furnizimin me karburant të gjeneratorëve në stacionet radiotelevizive. Rreth 57 % e shpenzimeve janë në Drejtorinë e Përgjithshme, përfshirë Departamentin e Prodhimit, 5 % në Njësinë e Programeve, Qendrat vendore Audiovizive për realizimin e programeve.

***Zëri i shpenzimeve të tjera Operative** është realizuar pothuajse në nivelin 100%. Në këtë zë të planifikuar për 71,700 mijë lekë, dhe realizuar për 71,537 mijë lekë janë përfshirë shpenzimet për, Honorare, Taksa e tatime, dhe Shpenzime për pritje e përcjellje.

***Zëri i shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit të digjitalizimit (mirembajtje e sistemit të transmetimit DVB-T2, OTT, Playout, Head-end satelitor etj.),** është realizuar në masën 91%. Për mirëmbajtjen e rrjetit të digjitalizimit në vlerën prej 206,778 mijë lekë, dhe për mirëmbajtjet e tjera në vlerën 26,124 mijë lekë.

***Zëri i shpenzimeve për investime,** realizuar në vlerën 107,246 mijë lekë, konsiston kryesisht në blerje për pajisje teknike, led ëall, servera, e liçensa. Tejkalimi në këtë zë me 79% është pasojë e detyrimit të RTSH për të paguar investime të paparashikuara në këtë vit. Sqarojmë se në zbatim të një vendimi gjyqësor Radio Televizioni Shqiptar është detyruar gjatë vitit 2023 të përmbushë


një kontratë investimi, që në vitin 2021 ishte parashikuar me fonde buxhetore, dhe u ndërpre në atë vit.

**Zëri i shpenzimeve të kësteve dhe interesave të kredisë nuk është realizuar* si rezultat i mungesës së të ardhurave, pamundësisë financiare të RTSH-së për përballimin e këtij shpenzimi, relatuar në të gjitha shkresat dërguar në Ministrinë e Financave.

C.Krahasimi i Shpenzimeve të RTSH gjatë tre viteve të fundit

Emertimi	Realizimi Viti 2021	Realizimi Viti 2022	Realizimi Viti 2023
Paga,shpërblime ,sig.shoqëror	915,597	885,685	1,107,959
Materiale,lëndë djegëse	61,000	55,245	60,044
Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav. etj	315,684	324,467	261,539
Organizma Ndërkombëtarë	86,161	88,890	64,213
Shërbime nga të tretë	264,959	252,156	234,318
Shpenzime udhëtimi e dieta	61,127	40,409	49,530
Shpenzime të tjera operative	66,576	58,489	71,537
Investime dhe mirëmb. rrjeti digj.	287,982	273,186	340,147
Shpenz.këste e interesa kredie			
TOTALI	2,059,086	1,978,527	2,189,288

Paraqitja grafike e shpenzimeve gjatë tre viteve të fundit:



Gjatë vitit 2023 krahasuar me periudhat paraardhëse ka një rritje pothuajse të gjithë zërat e shpenzimeve, por që janë të planifikuara gjatë këtij viti. Rritjen kryesore e ka zëri i pagave me një rritje të konsiderueshme prej afër 222,274 mijë lekë. E paparashikuar siç theksuam më lart është pjesërisht rritja në zërin e investimeve,

NJËSIA E PROGRAMEVE

Mbështetur në nenin 24, pika “dh” të Statutit të RTSH-së, po ju përcjellim raportin vjetor të punës së Njesisë së Programeve për periudhën 1 janar 2023– 31 dhjetor 2023:

- Kanali **RTSH1-HD**, si kanal gjeneralist i rrjetit të Radio Televizionit Shqiptar, vijon misionin e tij për t’i ofruar audiencës së gjerë një strukturë programore me përmbajtje të pasur, bazuar në standardet e larta editoriale, duke ofruar informacion korrekt dhe utilitar, pa harruar dhe fokusin drejt edukimit dhe argëtimit të publikut.
- Kanali **RTSH 2** ka vijuar me programet që u dedikohen kryesisht minoriteteve në Shqipëri, si dhe grupeve të marginalizuara të shoqërisë, gërshetuar këto me programe ditore utilitare e informuese.
- Kanali **RTSH 3** ka vazhduar linjën editoriale me transmetime ekskluzive shqiptare kushtuar bashkatdhetarëve dhe të rinjve.

Redaksia e Kanalit RTSH 2 ka vijuar punën me organizimin dhe programimin e transmetimeve për dy kanale televizive RTSH 2 dhe RTSH 3.

- Kanali **RTSH FËMIJË** është impenjuar për të pasuruar strukturën e kanalit me programe të reja argëtuese për fëmijë dhe ka nisur punën për prodhimin e sezonit të ri të emisionit “Luaj me mua”.
- Kanali **RTSH SHKOLLË** ka vijuar transmetimin e kurrikulës mësimore, duke pasuruar skaletën ditore me dokumentarë e filma dedikuar fëmijëve e të rinjve.

Redaksia e Kanalit RTSH Fëmijë ka vijuar punën me organizimin dhe programimin e transmetimeve për dy kanale televizive RTSH Fëmijë dhe RTSH Shkollë.

- Kanalet **RTSH FILM** dhe **RTSH SHQIP** janë konceptuar si dy kanale të cilat i dedikohen tërësisht publikut të apasionuar pas filmit dhe kinemasë së huaj dhe asaj shqiptare duke synuar për t’u kthyer në dritaren kryesore të kinematografisë.
- Për Kanalin **RTSH MUZIKË** programacioni është pasuruar më prurje të reja, si koncertet e regjistruara në vend, ashtu edhe me koncerte të huaja me të drejta transmetimi.
- Kanali **RTSH SATELIT** dhe **RTSH PLUS**, ka vijuar me programet arkivore me karakter edukues, informues dhe sidomos programet arkiv që ngjallin nostalgjinë e shikuesit besnik të RTSH-së.

Në vazhdimësi, gjeni ju lutem raportet e detajuara të strukturave të Njesisë së Programeve të punuara nga Kryeredaktorët, Redaktorët Përgjegjës të kanaleve dhe Përgjegjës të Sektorëve.

RAPORT PUNE PËR VITIN 2023 KANALI RTSH 1 HD

Struktura programore e RTSH 1 HD përgjatë vitit 2023: Periudha Janar-Korrik 2023

Nga e hëna në të premte:

06:00 - “Mirëmëngjes Shqipëri”, emisioni i mëngjesit, në 3 orë transmetim të drejtpërdrejtë, me rubrika dinamike, lajmet më të fundit nga vendi dhe bota, shtypin e ditës, motin, trafikun rrugor, ekonominë e kulturën. Nën drejtimin e Matilda Mcini dhe Florian Agalliu.

11:00 – “Si në familje”, emisioni i mesditës, i cili informon konsumatorin në lidhje me produktet e jetës së përditshme. Informacione dhe kuriozitete për çdo detaj që na rrethon në përditshmërinë tonë. Përgjigjja për të gjitha dilemat dhe për të gjithë familjen. Nën drejtimin e Blerina Shehu.

16:35 - “Ditë pas dite”, emisioni i përditshëm informativ dhe argëtues, ku në sallonin e Fjodora Fjorës çdo ditë do takohemi me personazhe të përhershëm dhe të ftuar nga të gjitha fushat.

Çdo të hënë:

20:35 – “Pa censurë”, emisioni i përjavshëm me intervista ekskluzive, çdo të hënë nga Elona Meço. Në një botë ku gjithçka po ndryshon me shpejtësi, duhen pyetjet e duhura, për të marrë përgjigjet e duhura. Për të kuptuar, ne duhet të dimë çfarë po ndodh. Si ndikojnë në jetën tonë vendimet e politikës, të drejtësisë, të pushtetit? Çfarë duhet të besojmë?

22:00 – “Rubrika Sportive”, emisioni me analiza të detajuara mbi Kampionatin Kombëtar të Futbollit. Specialistë të futbollit dhe të ftuar, diskutojnë dhe debatojnë për ecurinë e nivelit më të lartë të futbollit shqiptar.

Çdo të martë dhe të premte:

21:00 – “Publikisht”, emisioni i cili i dedikohet ngjarjeve kryesore të aktualitetit, personazheve me ndikim në publik, zyrtarëve e politikanëve që përgjigjen për problematikat shqiptare. Nën drejtimin e Blerta Tafani.

Çdo dy të mërkura në muaj:

18:00 – “Autor”, emisioni që përmes gjurmëve që lanë njerëzit e gjallë, të cilët e bënë Shqipërinë, na sjell profile, intervista dhe rrëfime me personalitete dhe për personalitete të shquar të letrave dhe botës akademike shqiptare.

Çdo të enjte:

18:00 – “Në tempull”, emisioni kulturor, dedikuar trashëgimisë kulturore shqiptare dhe personazheve që kanë kontribuar në pasurimin e saj. Nën drejtimin e intervistave nga Anisa Ymeri, emisioni ka nisur transmetimin e tij 8 shtator 2022.

Çdo të shtunë:

13:15 – “Hapësirë e blertë”, cikël reportazhesh në të cilin trajtohen tema të zhvillimit bujqësor e blegtoral dhe përcillen tek teleshikuesit emocionet e udhëtimeve nëpër Shqipëri. Puna që bëjnë specialistët, fermerët dhe biologët, për të zhvilluar blegtorinë, për të menaxhuar parqet natyrore, si dhe për të ruajtur vlerat e specieve endemike shqiptare. Nën drejtimin e Marash Mirashi.

16:35 – “Auditor arsimit”, emisioni në të cilin trajtohen tema të ndryshme mbi arsimin në vend me problematikat e tij, por edhe përcillen informacione të dobishme për të gjithë studentët. Nën drejtimin e Edlira Birko.

19:00 – “ShëndetSI”, emisioni i përjavshëm kushtuar mirëqenies fizike dhe mendore. Këshilla dhe përvoja jetësore nga të ftuar specialë, si dhe rubrika praktike. Nën drejtimin e Erjona Shehu.

23:00 – “Bibliotekë”, emisioni kulturor kushtuar librit. Bashkëbisedime në studio me autorë e përkthyes. Nën drejtimin e Arta Marku.

21:00 – “Ti duhet ta dish”, quiz shoë nga patenta e njohur ndërkombëtare “Armoza Formats”. Ekskluzivisht për publikun shqiptar, një quiz i bazuar tërësisht në postimet e konkurrentëve në rrjetet sociale. Nën drejtimin e Ardit Roshit. Më datën 2 mars 2023, quiz shoë ndryshon ditën e transmetimit dhe kalon çdo të enjte, ora 21:00.

Çdo të diel:

10:20 – “Luaj me mua”, emisioni për fëmijë me të ftuar nga profesione të ndryshme, të cilët vijnë të rrëfehen përpara fëmijëve me sekretet e profesionit të tyre. Përralla e lojra të shumta, për të gjithë familjen. Nën drejtimin Bledi Strakoshës.

20:35 – “Kosherja”, spektakli i cili ka nisur rrugëtimin në ekranin e RTSH, më 19 mars 2023, vjen çdo të diel, në orën 20:35, për të mbërthyer pranë ekranit familjet shqiptare plot të qeshura e argëtim. Ashtu siç një koshere gumëzhin, mbledh bletët në zgjoin e saj, në të cilën ato edhe prodhojnë mjaltin, ashtu edhe ky shoë ka mbledhur aktorët më në zë të momentit, figura të reja, si dhe personalitete të afirmuar të skenës dhe televizionit. Një shoë i konceptuar si një program kabaret. Një familje e madhe artistësh, ku secili pjesëtar ofron standardet më të larta profesionale, humor dhe argëtim.

Çdo të shtunë dhe të diel:

18:30 – “Më prit në fundjavë” një emision nga Ermal Peçi me panele me tema të ndryshme sociale e kulturore, intervista ekskluzive me të ftuar VIP nga arti, kultura, sporti e politika. Emisioni ka nisur transmetimin e tij më 11 mars 2023, për të qenë në familjet tuaja, çdo të shtunë dhe të diel, në RTSH 1, në orën 18:30.

Transmetime spotive në fashë-orare sipas kalendarit:

“Formula 1”, drejtpërdrejtë kualifikueset dhe garat e Formula 1, në sezonin e 73-të të Kampionatit Botëror të Automobilizmit.

“Liga e Kampionëve”, ndeshjet më të mira të Kampionatit të Ligës së Kampionëve (Champions League), me emision të dedikuar, prag ndeshje (ora 20:20) dhe post ndeshje (ora 22:50) çdo të mërkurë. Eventi përcillet në emisionet prag dhe post ndeshje, me të ftuar, specialistë e analistë të fushës. Nën drejtimin e Sabina Mete.

“Edicioni Informativ”, lajme.

Emisione Prodhime të RTSH 1 HD, janar – korrik 2023

Emision: Mirëmëngjes Shqipëri;

Emision: Si në familje;

Emision: Ditë pas dite;

Emision: ShëndetSI;

Emision: Bibliotekë;

Emision: Në tempull;

Emision: Zëri i popullit;

Quiz Shoë: Ti duhet ta dish;

Emision: Më prit në fundjavë;

Spektakël: Kosherja;

Periudha shtator-dhjetor 2023

Nga e hëna në të premte:

06:00 - “Mirëmëngjesi Shqipëri”, program i cili nisi në sezonin e ri televiziv, nën moderimin e Ermal Qorit dhe Valbona Mhillit. Për rreth tre orë transmetimi direkt, programi përcjell një larmishmëri zhvillimesh përfshirë tema aktuale, me personazhet më në zë, rubrika dinamike, horoskop, quiz, batuta, lajmet më të fundit dhe intervista me të ftuar në studio, e jashtë saj. Gjithçka ju duhet për ta nisur mëngjesin plot energji. “Mirëmëngjesi Shqipëri” transmetohet nga e hëna në të premte, ora 06:00, në RTSH 1 HD.

12:30 - “Stacioni Rozë”, vjen me lajmet me të fundit të botës së shoëbizit shqiptar dhe atë të huaj. Çfarë po ndodh mes VIP-ave tanë? Ndarje, rrëfime, suksese, probleme mes yjeve, e shumë të tjera. Filmata më të pëlqyer, video të ditës dhe rikthimi pas në kohë me këngët e viteve '90.

13:20 - “Jetë Shqiptare”, synon të sjellë informacion të verifikuar dhe analizë thelbësore mbi ngjarjet më të rëndësishme të ditës. Në kohën kur informacioni përhapet rrufeshëm dhe ndryshimet ndodhin me shpejtësi, ky program vjen si një burim i besueshëm për spektatorët që kërkojnë të informohen, zbavitën, kuptojnë dhe të vlerësojnë botën që i rrethon.

16:35 - “Ekspres”, vjen çdo ditë për t’iu përcjellë teleshikuesve një këndvështrim të plotë për të gjitha ngjarjet aktuale të ditës. 25 minuta për të shtuar me argumente, fakte, por edhe me këndvështrime në mënyrë sa më të plotë një moment të rëndësishëm të ditës. Nuk do të mungojnë as lidhjet e drejtpërdrejta në varësi të ngjarjeve konkrete.

17:05 - “Pasditja ime”, Një emision i përditshëm social-kulturor i konceptuar që të prekë të gjitha grupmoshat, i cili do të shoqërojë pasditet tuaja. Nën moderimin e Gerta Gixharit, “Pasditja ime” do të trajtojë tema që nxisin debat, me pjesëmarrjen e të ftuarve në studio.

18:30 - “Zona 30”, ju lë takim çdo ditë, nga e hëna në të premte, për të diskutuar të rejat më të fundit nga merkato, futbollit ndërkombëtar, video të ndryshme për të qeshur, momente gazmore, kronika me statistika interesante, kuriozitet, “pa koment”, lidhje në Skype me personazhe, por edhe të ftuar në studio.

Të hënë, të martë, të enjte dhe të premte:

21:00 - “3D” me Alban Dudushin, një program i dedikuar aktualitetit ku trajtohen “dritëhijet, debatet dhe dilemat” mbi çështjet që prekin dhe shqetësojnë publikun shqiptar brenda dhe jashtë vendit. Përmes gazetarëve dhe analistëve të ftuar në panel, 3D do të përcjellë mesazhe të forta nga Shqipëria dhe përtej saj.

Çdo të hënë:

00:05 - “Mjaftueshëm” një podcast nga Tiri Gjoci dhe Enkelejd Caca, ku nën shoqërinë e tingujve të kitarës do të informoheni rreth kulturës së përgjithshme, artit, historisë dhe shkencës. Bashkë me të ftuarit, do t’ju përcjellin rehatinë e kafenesë me pak ngjyra humoristike, ndërkohë që diskutohet rreth universit dhe informacioneve që ju kanë munguar deri tani.

22:30 - “Rubrika Sportive”, Analizë e detajuar mbi kampionatin kombëtar të futbollit. Specialistë të futbollit dhe të ftuar diskutojnë dhe debatojnë për ecurinë e nivelit më të lartë të futbollit shqiptar

Çdo të martë:

23:00 “Artes”, një emision mbi aktualitetin kulturor dhe artin shqiptar në të gjitha dimensionet e tij. Falë bashkëbisedimeve, debatit, diskutimit dhe analizave të ndryshme në studio, do të zbuloni më tepër rreth dritëhijeve dhe problematikave që shoqërojnë artin dhe kulturën.

Çdo të mërkurë:

19:00 - “Dritëhijet e personaliteteve historike”, një emision i ideuar nga historiani i njohur, Prof. Paskal Milo. Përmes bashkëbisedimeve me studiues dhe historianë, mësoni më tepër rreth dokumenteve arkivore të cilat në masën e tyre më të madhe kanë qenë të panjohura deri tani, të cilat do të ndriçojnë aspekte të jetës dhe veprimtarisë së personazheve që i përkasin historisë shqiptare.

23:05 - “Rapshtet”, Radio Televizioni Shqiptar dhe Radio Tirana sjellin një podcast në format hip-hopi. Big Basta pret të ftuar të fushave të ndryshme të shoqërisë shqiptare. Biseda të ngrohta dhe mjaft të sinqerta do të shoqërohen me anë të këngëve të përzgjedhura nga vetë të ftuarit. Ata do të rrëfejnë kujtime, sjellin argumente dhe do të nxisin debate. Në përfundim, si qershi mbi tortë, një 8 vargësh surprizë, i frymëzuar nga biseda dhe rrëfimi i të ftuarve, shoqëruar me instrumentale.

Çdo të enjte:

19:00 - “Mes dy botëve”, një program risi nëpërmjet të cilit do t’i bëhet analizë psikologjike çdo personazhi dhe falë përgjigjeve shumë të sinqerta përballë Helidonit, penelatat do fillojnë të marrin formë. Intervista të jashtëzakonshme me personazhe të spikatur të cilët i takojnë dy botëve të ndryshme. E në përfundim të bashkëbisedimit, falë rrëfimit të sinqertë, personazhet do të shohin veten e tyre të pikturuar nga Helidon Haliti.

23:05 “Të qeshim seriozisht”, RTSH dhe Radio Tirana vijnë me një podcast nga Renada Caci përmes të cilit do “Të qeshim seriozisht”. 60 minuta ku politikanët, biznesmenët, drejtuesit e një institucioni dhe analistët “zhvishen” nga kostumi i përditshëm dhe rehatohen. Një format ku s’do të mungojnë bisedat e sinqerta dhe batutat me qëllimin e vetëm, për të njohur ndryshe ata që jemi mësuar t’i shohim gjithmonë seriozë.

Çdo të premte:

15:00 “Bibliotekë”, në një emision kulturor nga Arta Marku, ku do të endeni në botën e leximit për t’u argëtuar, pasuruar dhe për të jetuar. Bashkëbisedime me autorë dhe përkthyes, çdo të premte në orën 15:00, në RTSH 1.

20:35 “Pa censurë”, në një botë ku gjithçka po ndryshon me shpejtësi, duhen pyetjet e duhura, për të marrë përgjigjet e duhura. Për të kuptuar, duhet të dimë çfarë po ndodh rreth nesh. Si ndikojnë vendimet e politikës, të drejtësisë e pushtetit te ne? Të gjitha përgjigjet i gjeni në “Pa Censurë”, çdo të premte me Elona Meçon.

23:05 “Të Çmendur”, podcast inovativ dhe provokues nga Kastro Zizo për njerëzit “jashtë kornizave”. Një hapësirë e veçantë e krijuar për ata që kanë thyer tabutë shoqërore, të cilët kanë vendosur të dalin nga kutia e shoqërisë tradicionale. Me një vëmendje të veçantë ndaj individëve të ndryshëm dhe mënyrës së tyre të jetuarit, ky podcast nxit ndryshimin e perceptimeve dhe mendimeve mbi atë që quhet "normale".

Dy të premte në muaj:

19:00 “Autor”, një emision nga Ben Andoni, i cili na sjell profile, intervista e rrëfime me personalitete të shquar të letrave dhe botës akademike shqiptare.

Çdo të shtunë:

09:00 “Me Ketin”, çdo të shtunë do të argëtoheni plot 60 minuta. Një studio e mbushur me fëmijë të cilët luajnë, intervistohen dhe promovojnë talentet e tyre në fusha të ndryshme. Nuk do të mungojnë as të rriturit të cilët do të “japin intervista” të vështira përballë fëmijëve.

16:35 “Auditor Arsimi”, një emision nga Edlira Birko, në të cilin trajtohen tema të ndryshme mbi arsimin në vend me problematikat e tij, por edhe përcillen informacione të dobishme për të gjithë studentët.

18:00 “Në Tempull”, një emision kulturor nga Anisa Ymeri, dedikuar trashëgimisë kulturore shqiptare dhe personazheve që kanë kontribuar në pasurimin e saj. Çdo të shtunë, ora 18:00 vetëm në RTSH 1-HD.

19:00 “Trupi dhe Shëndeti”, programi më jetëgjatë dhe ndër më të vjetrit në vend, “Trupi dhe Shëndeti”, vjen çdo të shtunë në ekranin e RTSH 1-HD. Me tema të dedikuara mirëqenies fizike dhe mendore, çdo puntatë sjell mjekë dhe specialistë të ndryshëm për të na dhënë këshilla dhe përvoja jetësore.

20:35 “Fustanella”, një spektakël humori që harmonizon traditën me modernen. Në një skenë ku brezat e humoristëve pasojnë stafetën, “Fustanella”, sjell plot surpriza, të ftuar dhe të qeshura. Mos e humbisni, të shtunën në RTSH 1-HD!

22:40 “Kur xhirohej një film”, në 70 vite histori, mijëra metra pelikule kinematografike kanë shoqëruar ditët tona më të zymta, e çastet tona më të lumtura. Filmat shqiptar i kemi parë të gjithë, por asnjë nga ne nuk di se ç’ndodhte pas kamerës kur xhirohej një film. Programi transmetohej të shtunave në orën 21:00 dhe më pas kaloi të shtunave në orën 22:40.

Çdo të diel:

00:10 “Të gjithë jemi Tironsa”, podcast 60 minuta dedikuar kryeqytetit të gjithë shqiptarëve, Tiranës. Bashkë në valët e Radio Tirana dhe RTSH çdo javë për të diskutuar mbi problematikat, historinë e kryeqytetit, por dhe për mjaft elemente të tjera të cilat do të zbulohen përmes intervistave me të ftuarit tiranas autoktonë. Zbulojmë përmes tyre prizme të ndryshme nga jeta në Tiranë dhe kontributin e gjithsecilit për zhvillimin e kryeqytetit tonë.

13:30 “E diela jonë”, programi dinamik i së dielës nën moderimin e Ermal Peçit, nga ora 13:30 në ekranin e RTSH-së. Çdo të diel do të ndiqni personazhe, debate, muzikë, lojëra telefonike, ngjarje sportive, rrëfime plot emocione, e histori suksesi. Figurat më të përfollura publike përballen me Ermalin nëpërmjet rrëfimeve e tingujve muzikorë nga banda e programit. 'E diela jonë' i jep vëmendje edhe ngjarjeve të javës, jetës sociale e sportive.

18:00 “ParaFest”, argëtim, nostalgji dhe promovim i Festivalit të Këngës, në formën e një shfaqje lojërash dhe pyetjesh “pikante”. Një spektakël, i shoqëruar gjithë mbrëmjen nga banda muzikore, ku do të luhen disa nga këngët hit të këtij festivali, të cilat kanë përbërë oguret dhe themelet e tij.

21:00 “Një natë sa një jetë”, spektakli i të dielave, i cili rikthen një copëz historie të RTSH-së. Çdo mbrëmje e së dielës i dedikohet një artisti, emri të madh të muzikës shqiptare, që ka bërë dhe bën historinë e muzikës. Bashkë me të ftuarit në studio bisedojmë për detaje interesante nga jeta e tyre dhe këndojmë këngë të artistëve të mëdhenj. Një natë sa një jetë, çdo të diel, ora 21:00.

23:00 “ADN”, një emision që ka në qendër artin, natyrën dhe demokracinë. Zbuloni më tepër për ngjarjet kulturore që shënjuan hapësirën publike dhe një reflektim se si po sillemi me natyrën. ADN nga Ilir Yzeiri, çdo të diel.

Transmetime sportive në fashë-orare sipas kalendarit:

“Formula 1”, drejtpërdrejtë kualifikueset dhe garat e Formula 1, në sezonin e 73-të të Kampionatit Botëror të Automobilizmit.

“Liga e Kampionëve”, ndeshjet më të mira të Kampionatit të Ligës së Kampionëve (Champions League), me emision të dedikuar, prag ndeshje (ora 20:20) dhe post ndeshje (ora 22:50) çdo të mërkurë. Eventi përcillet në emisionet prag dhe post ndeshje, me të ftuar, specialistë e analistë të fushës. Nën drejtimin e Sabina Mete.

“Edicioni Informativ”, lajme.

Çfarë ka ofruar RTSH 1 HD përgjatë vitit 2023?

Përpos emisioneve të strukturës, të cilat janë transmetuar përgjatë javëve nga e hëna në të diel, RTSH 1 HD ka ofruar për të gjithë teleshikuesit:

Emisione

- **Cikël emisionesh “Netët e Klipit Shqiptar”**, një event unikal dedikuar krijuesve dhe artistëve- Festivali “Netët e Klipit Shqiptar u rikthye në vitin e 20-të të realizimit të tij me emisione të dedikuara. Në këto puntata speciale në “Netët e klipit shqiptar” me moderatorët Drita Ziri dhe Françeska Rustem, ndoqë, prezantimet e videoklipeve që hynë në garën e konkurrimit, paskuintat e festivalit dhe kujtimet e personazheve specialë. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 1, 5, 8, 12, 15, 19, 22, 26 maj 2023, ora 18:00.
- **“PostFest”**- Në përfundim të magjisë së Festivalit të Këngës në Radio Televizionin Shqiptar dhe në përfundim të emisionit pati një puntatë speciale “PostFest”. Nën moderimin e Arjola Shehut dhe dy paneleve me të ftuar, u diskutua gjithçka mbi “Fest 62”. Zbuluan cilat ishin problematikat, risitë që solli, e deri te forma si u përcoll te publiku. Kjo puntatë speciale u transmetua në RTSH 1-HD, në orën 18:00 më 24 dhjetor 2023.

Festivale

- **“Sanremo 73”** - Pas 4 mbrëmjeve emocionuese, mbushur me nostalgji, humor dhe mesazhe të rëndësishme, vjen finalja e shumëpritur! 28 artistë, në garë për Luanin e Sanremos. Prezantojnë: Amadeus, Gianni Morandi dhe Chiara Ferragni. Të ftuar specialë: Gino Paoli, Ornella Vanoni, Luisa Ranieri, Depeche Mode dhe një mesazh nga presidenti ukrainas Volodymyr Zelenski. Nën komentin e Andri Xhahut dhe Blerina Shehut. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 11 shkurt 2023, ora 20:45.
- **“Netët e Klipit Shqiptar, Spektakli”** - Muzika dhe Arti bashkojnë në një natë Gala më të mirët! Drejtpërdrejtë nga Ulqini, vjen Festivali i Videoklipit Shqiptar, nën moderimin e Ermal Peçit, Drita Zirit dhe Françeska Rustem. Protagonistët e videoklipeve, personazhe të Shoëbiz-it dhe personalitete të fushave të ndryshme, bëhen bashkë në një nga ngjarjet më të mëdha të aktiviteteve kulturore dhe artistike në të gjitha trevat shqipfolëse. Tapet i

kuq, takime mes krijuesish, performanca të fuqishme dhe emocione të vlerësimit nga juria, do të jenë kryefjala e mbrëmjes. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 27 maj 2023, ora 20:35.

- **“Eurovision 2023”** - Eurovision 2023, erdhi në tre net magjike ekskluzivisht në Radio Televizionin Shqiptar! 37 yje botërore, shkëlqyen në Arenën e Liverpool-it, për të festuar 67-vjetorin e ngjarjes më të madhe muzikore evropiane. Mes tyre edhe ylli shqiptar, Albina dhe Familja Kelmendi! Në koment: Andri Xhahu. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 9, 11, dhe 13 maj 2023, ora 21:00.
- **“Tëinkle Tëinkle Festival 2023”** - Festivali “Tëinkle tëinkle 2023” çeli siparin e edicionit të tij të dytë! 30 krijime të reja nga kompozitorë, poetë, orkestrues e producentë të mirënjohur, erdhën në fluturim si një buqetë shumëngjyrëshe. Talentet e së ardhmes në një skenë të vetme, për t’i kënduar ëndrrave fëmimore e dëshirave të adoleshentëve. Më shumë muzikë, më shumë gëzim në zemrat tona. Producent dhe drejtues artistik: Elvis Peçi. Nata e tretë, transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 17 qershor 2023, ora 10:20.
- **“Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës 2023”** – Në Kalanë e Gjirokastrës mbledhen thesaret e trashëgimisë kulturore të të gjithë Shqipërisë. Epika dhe lirizmi i këngëve e valleve shqiptare, bashkohen me kostumografinë mahnitëse në këtë festival emblemantik. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 qershor, 1 dhe 2 korrik 2023, ora 20:35.
- **“Festivali i fëmijëve në Shkodër”**- Radio Televizioni Shqiptar sjell drejtpërdrejt nga Shkodra, natën finale të Festivalit Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë, i cili prej krijimit të tij në maj të vitit 1963, nuk i ka munguar asnjë vit fëmijëve, duke sjellë krijimet më të mira të autorëve më me emër të muzikës e teksteve të këngëve, si dhe duke zbuluar talente që kanë shkëlqyer në skenat muzikore brenda e jashtë vendit. Skena e teatrit Migjeni mirëpret interpretimin e artistëve të vegjël me 20 këngët pjesëmarrëse në edicionin e 61-të të Festivalit më historik të këngës shqiptare për fëmijë. Transmetuar në RTSH 1 HD më 6 korrik 2023, ora 20:35.
- **“Junior Fest Albania 2023”** - Skena e Junior Fest Albania 2023 mirëpriti artistët e vegjël nga e gjithë Shqipëria. Të vegjlit në moshë, por me talente e zëra të jashtëzakonshëm garuan në një skenë të ngritur posaçërisht për ta në zemër të Tiranës, te Piramida. “Junior Fest Albania 2023” priti në skenë 16-të fëmijë nga Shqipëria dhe Kosova, të gjithë në garë për të fituar një biletë për "Junior Eurovision Song Contest 2023". Transmetimi premierë ndodhi në RTSH 1 HD, më datë 22 shtator, ora 20:35.
- **“Festivali i këngës në Kosovë”- FINALE-** Organizuar për herë të parë në Kosovë Festivali i Këngës “Fest 2023” u transmetua drejtpërdrejt në RTSH 1- HD. Një shumëllojshmëri artistësh të cilët vinin nga zhanre të ndryshme të botës së muzikës dhuruan emocione të forta në atë mbrëmje magjike të natës finale, transmetuar, më 28 tetor 2023, ora 21:00.
- **“Junior Eurovision Song Contest 2023”- FINALE-** Drejtpërdrejt nga Nice e Francës, 16 artistë të vegjël nga vende e kultura të ndryshme bëhen bashkë për të shijuar aventurën

mahnitëse në festën më të madhe muzikore të kontinentit “Junior Eurovision 2023”. Spektaklit magjik dhe zërave të mrekullueshëm u bashkohet Shqipëria, me “Bota ime” të Viola Gjyzelit! U transmetua më 26 nëntor 2023, në orën 16:00 në RTSH 1 HD.

- **“Festivali i 62-të i Këngës në RTSH”**- Festivali i 62-të i Këngës në Radio Televizionin Shqiptar, solli në natën e parë dhe të dytë 31 këngë të cilat publiku i dëgjoi për herë të parë! Emra të njohur të muzikës dhe këngëtarë të rinj. Të ftuar dhe shumë surpriza. Ndërsa, nata e tretë erdhi e gjitha si një mbremje nostalgji ku u sollën për publikun këngë të cilat kanë lënë gjurmë. Në natën finale, nuk munguan surprizat dhe të ftuarit specialë, të cilët e bënë më magjike atmosferën. Në përfundim, ishte juria ajo që vendosi për çmimet dhe publiku i cili vendosi për këngën përfaqësuese të Shqipërisë në “Eurovision Song Contest 2024”. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 19-20-21-22 dhjetor 2023, ora 21:00.

Koncerte

- **“Koncerti i madh i Vjenës”** - Urimi më elegant për Vitin e Ri 2023, troket nën frymën e shpresës, miqësisë dhe paqes. Orkestra Filarmonike e Vjenës, për të 65-tin vit radhazi vjen me një koncert mahnitës, ndjekur nga miliona teleshikues në mbarë botën, ekskluzivisht për Radio Televizionin Shqiptar. Nën bagetën e Franz Eëlsler-Möst, me një program gazmor dhe optimist dhe në komentin e Mjeshtrit Zhani Ciko. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 1 janar 2023, ora 11:15.
- **“Duke pritur Verdin”** - Radio Televizioni Shqiptar ju uron gëzuar me galanë festive nga Orkestra e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit. Një udhëtim në kryeveprat e Verdit, Donixetit, Puçinit, Rosinit dhe Ofenbahut. Le t’i trokasim gotat, për një vit të hareshëm, me ariet më të bukura në botë dhe artistët më të mirë të skenës operistike shqiptare. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 1 janar 2023, ora 20:30.
- **“Zare”** - Radio Televizioni Shqiptar ju fton në një shfaqje të pazakontë! Nga Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, vjen “Zare”, historia e dashurisë së dy të rinjve, me energjinë e valles dhe harmoninë e tingujve. Nën drejtimin artistik të Sokol Marsit, tingujt e muzikës së Edmond Xhanit dhe koreografi të Andrea Kokerit. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 2 janar 2023, ora 20:30.
- **“Së bashku për paqen”** - Koncert madhështor i 300 artistëve nga bandat ushtarake të SHBA-ve, Britanisë së Madhe, Italisë, Kosovës, Greqisë, Francës, Maqedonisë së Veriut, Kroacisë, Sllovenisë dhe Shqipërisë, dedikuar 110-vjetorit të Forcave të Armatosura. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 3 janar 2023, ora 14:25.
- **“Apocalyptic”** - Ata janë shpërthyes, të pazakontë në stil dhe interpretim, gjithnjë në sfidë me veten! Nga Helsinki, në zemër të Tiranës, në një koncert elektrizues, vjen kuarteti elektrik “Apocalyptic”! I ftuar special: Eugent Bushpepa. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 4 janar 2023, ora 23:20.
- **“Za Fest”** - Radio Televizioni Shqiptar dhe Vlashent Sata sjellin edicionin e gjashtë të “Za Fest”, festivalit që bën bashkë zanat dhe legjendat! Nga oborret e shtëpive tradicionale

shkodrane, deri tek Kalaja e Rozafës, vijnë me artin e tyre: Elina Duni, Arben Bajraktaraj, Vlashent Sata, Jericho, Linda Rukaj, Las Migas, Cristiana Verardo, Lylit, Jeton Neziraj, dhe Erenik Beqiri. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 19 shkurt 2023, ora 20:35.

- **“Messa da Requiem”** - Radio Televizioni Shqiptar ju fton në një shfaqje të pazakontë! Nga Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, vjen “Zare”, historia e dashurisë së dy të rinjve, me energjinë e valles dhe harmoninë e tingujve. Nën drejtimin artistik të Sokol Marsit, tingujt e muzikës së Edmond Xhanit dhe koreografi të Andrea Kokerit. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 26 shkurt 2023, ora 23:05.
- **“Not’te da Oscar”** - Një ndër prodhimet më të mira të vitit nga Orkestra e Teatrit Kombëtar të Operas Baltetit. Një udhëtim i jashtëzakonshëm nëpër kryeveprat e kinemasë, që e gjejnë prijësin tek kompozitori i madh John Ëilliams. Nën drejtimin e Giovanni Pompeo. Solist në violinë: Ettore Pellegrino. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 27 mars 2023, ora 21:05.
- **“Rrno për me tregue”** - Kosova 15 vjet Pavarësi! 25 vjet nga Epopeja e UÇK-së. Një koncert gala që evokon ndjenjën e lavdisë, krenarisë dhe lirisë. Nën interpretimin e shkëlqyer të artistëve: Elsa Lila, Gjon’s tears, Jericho, Rona Nishliu, Florent Abrashi, Kori Siperantum, e shumë interpretime të tjera emocionuese. Dirigjent: Valton Beqiri. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 22 prill 2023, ora 20:40.
- **“Stina Koncertore 2022-2023”** - Orkestra Simfonike e Radio Televizionit Shqiptar, Nder i Kombit, sjell për publikun koncerte, me vepra të autorëve, dirigjentëve dhe solistëve të mirënjohur të muzikës. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, të mërkurave të vitit 2023, ora 23:05. Në rast se ditën e mërkurë kishte ndeshje, transmetimi shtyhej për në orën 00:05.
- **“Një natë ëndrrash”** - Radio Televizioni Shqiptar dhe Orkestra Simfonike e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, në bashkëpunim me Orkestrën Simfonike të Forcave të Armatosura, ju ftojnë në një botë ëndrrash! “Romeo e Giulietta”, kryeveprat e Çajkovskit, Rosinit e Ofenbahut, vijnë mjeshtërisht nga zërat e papërsëritshëm të sopranos lirike italiane, Ripalta Bufo dhe mezzo-sopranos, Vikena Kamenica. Nën bagetën e Sandor Gyudi. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 28 maj 2023, ora 23:05.
- **“Një jetë nga jeta ime”** - Koncert recital i kompozitorit Flamur Shehu, Mjeshtër i Madh! Krijimtaria që depërtoi thellë në zemrat e publikut shqiptar. 500 këngë të fondit të artë të muzikës, përcjellë nga vargjet e shumë poetëve, kënduar nga këngëtarët më të njohur shqiptarë, të skalitura në kujtesën e publikut. Me pjesëmarrjen e: Irma Libohova, Mefarete Laze, Liljana Kondakçi, Ermira Babaliu, Era Rusi, Evi Reçi e shumë artistë të tjerë të muzikës shqiptare. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 31 maj 2023, ora 20:35.
- **“Goc’ Tirone”** - Krijimtaria më e mirë ndër vite dhe perlat e muzikës tradicionale, në një festë të vërtetë të muzikës popullore shqiptare nga zëri i papërsëritshëm i Artjola Toskës! Me pjesëmarrjen e: Sinan Hoxha, Bruno, Kori i fëmijëve të shkollës “Servete Maçi” dhe Ansambli “Arian Plaku”. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 11 qershor 2023, ora 20:35.

- **“Orkestra e Forcave të Armatosura”** - Radio Televizioni Shqiptar ju fton në një koncert mbresëlënës. Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura dhe dy solistë virtuozë të dy gjeneratave të ndryshme: Laura Llozi në violin dhe Pascal Gallet në piano! Në program: vepra të Nicolo Paganinit dhe një premierë botërore e Aleksandër Peçit! Nën dirigjimin e Elda Laros dhe Harlen Nikollit...një mbrëmje që na çon në dimensione të thella krijuese. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, më 14 qershor 2023, ora 23:05.
- **“Albanian Pop Rock, In Memoriam”**- Vjen sërish në Radio Televizionin Shqiptar nën drejtimin e Kozeta Kurtit! Nderimi i 15 artistëve, të cilët i përkasin përjetësisë. Përjetoni plot emocione nga miqtë dhe të afërmit e tyre. Të ftuar, Aleksandër Gjoka, Redon Makashi, Anxhela Peristeri, Adhurim Demiri, Era Rusi, Ervin Bushati, Gjergj Kaçinari, Gerta Mahmutaj, Land Kademi dhe Denisa Gjezo. Gjithashtu dhe artistë të rinj. Transmetuar në RTSH 1 HD, më 21 tetor, ora 21:00.
- **“Adhurim Demiri and Friends”**- Rikthehet pas shumë vitesh me një koncert recital Adhurim Demiri. Ai dhe miqtë e tij do t’ju shoqërojë mbrëmjen e të shtunës në RTSH 1-HD. Pjesëmarrës emra të njohur të muzikës si Elton Deda, Redon Makashi, Aleksandër Gjoka, Renis Gjoka dhe Eneda Tarifa. Të ftuar special Einar Nelku, Hektor Duri, Arjan Gjici, Bledar Sejko, Ergys Myftari dhe Sokol Shehu. Transmetuar në RTSH 1 HD, më 11 nëntor 2023, ora 21:00.
- **“Opereta Karnavalet”**- Rikthimi i “Karnavaleve të Korçës” në skenën e TKOB pas 45 vjetësh në një atmosferë festive. Inva Mula vjen këtë herë në rolin e regjisores së kësaj vepre si një homazh për krijuesit, kompozitorin Avni Mula dhe libretistin Luigj Gurakuqi, dy figura shumë të rëndësishme në historinë e muzikës shqiptare. Aty gërshetohet bukur linja e dashurisë, humori i hollë i personazheve, mënyra e të jetuarit elegante korçare, të cilat kanë lënë gjurmë të rëndësishme në kujtesën e kulturës artistike dhe sociale të shoqërisë sonë. Transmetuar në RTSH 1 HD më 22 nëntor 2023, ora 20:35.
- **“Tumankuqe”**- Bazuar në origjinalitetin e këngëve, valleve e kostumeve të krahinës së Çamërisë vjen muzikali "Tumankuqe" me origjinalitetin dhe trashëgiminë e këngës dhe valles çame . Artistëve të AKVP i bashkohen edhe Enkelejda dhe Hysni Alushi si dhe Altin Malo. Një pasuri artistike e kulturore e cila korr duartrokitje në çdo skenë. Transmetuar në RTSH 1 HD më 28 nëntor 2023, ora 15:00.
- **“Marsela këndon Faber”** - Këngëtarja Marsela Çibukaj në një koncert dedikuar artistit italian Fabrizio De Andre. Një koncert ndryshe ashtu sikurse poezia dhe muzika e kantautorit poetit De Andre, e cila depërton thellë në shpirtin e kujtudo që e dëgjon. Përqafuar nga melankolia , reagim nga revolta dhe përkëdhelur nga dashuria. Këngët më të bukura të De Andre-së, në zemër të Tiranës, nga zëri unik i Marsela Çibukaj. Transmetuar në RTSH 1 HD, më 6 dhjetor 2023, ora 20:35.
- **“Anna Pirozzi live në Tiranë me Orkestrën e TKOB”**- Një nga sopranot dramatike më të suksesshme italiane, Anna Pirozzi, fama e së cilës kapërcen çdo kufi rajoni, vjen me vokalin e saj brilant me ariet më të bukura verdiane, në skenën e TKOB-së. I cilësuar si një

event unik për jetën artistike shqiptare, kjo mbrëmje do të përcjellë emocione të veçanta për publikun shqiptar e të huaj! Interpretin Orkestra e TKOB-së, dirigjent, Jacopo Sipari di Pescasseroli. Transmetuar në RTSH 1 HD, më 30 dhjetor 2023, 20:50.

Cikël dokumentarësh

- **“Dosjet e Hapura”** - Një cikël dokumentar mbi pistat dhe hipotezat nën dritën e drejtësisë. Transmetuar premierë në RTSH 1 HD, 12 episode, çdo të hënë, ora 21:05, më 10, 17, 24 prill, 1, 15, 22, 29 maj dhe 5, 12, 19, 26 qershor 2023.
- **“Kam lindur Kuqezi”** – "Kam lindur kuqezi", një cikël telereportazhesh që sjell historitë personale dhe familjare të djemve të kombëtares sonë të futbollit, e cila synon finalët e evropianit "Euro 2024". Transmetimi premierë në RTSH 1 HD, çdo të diel, ora 20:35.

Dokumentarë

- **“Gjurmëve të Hasan Prishtinës”** – Në 110 vjetorin e Pavarësisë, përmendorja e Hasan Prishtinës mbërriti edhe në Vlorë. Një këndvështrim i ri mbi rrugëtimin e ideologut të Pavarësisë, sjell fakte të pandriçura, si mungesa në ngritjen e flamurit, nxitimi për ta shpallur mëvetësinë në Shkup e deri tek vrasja në Selanik. Dokumentari u transmetua premierë në RTSH 1 HD, më 7 janar 2023, ora 17:55.
- **“Vasha e Vlorës”** - Ajo është emblema e pashpallur e qytetit bregdetar. Statuja e asaj që është njohur si vajza aulonase, u zhduk nga muzeu gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe sot ruhen vetëm dy foto nga ajo vepër historike. Dokumentari u transmetua premierë në RTSH 1 HD, më 9 janar 2023, ora 22:05.
- **“Tano Banushi, aktori simbol”** - Agron Menzhelxhiu, mjeku dhe kirurgu i njohur, pasioni dhe përkushtimi i të cilit, janë sot shembull! Një rrëfim rrënqethës nëpërmjet filmimeve arkivore të shfaqura për herë të parë në ekran, dëshmi të pacientëve të shumtë të shëruar nga duart e tij, intervistave me kolegë, dhe personaliteteve të huaj të cilët e njohën dhe punuan me të. Dokumentari u transmetua premierë në RTSH 1 HD, më 20 shkurt 2023, ora 18:00.
- **“Rikard”** – Për herë të parë në ekran, RTSH1 shfaq dokumentarin "Rikard", me regji nga Mevlan Shanaj. Rrëfime ekskluzive nga të afërm, miq dhe artistë. Dokumentari u transmetua premierë në RTSH 1 HD, më 1 prill 2023, ora 20:35.
- **“Flamurtari një shekull!”** - Historia 100-vjeçare e klubit legjendë të futbollit, “Flamurtari” i Vlorës. Foto, pamje filmike dhe intervista të shumta, të asaj rruge të gjatë dhe të mbushur me lavdi, veçmas në vitet '80 - '91, kur futbollit shqiptar njohu majat kombëtare dhe ndërkombëtare. Një dokumentar nga Defrim Methasani. Dokumentari u transmetua premierë në RTSH 1 HD, më 24 prill 2023, ora 18:00.
- **“Heroi i fjalës së lirë, Fadil Kokomani”** - Portreti i Fadil Kokomanit, gazetarit të Radio Tiranës në vitet '60, vjen për herë të parë i rrefyer pas 44 vitesh nga pushkatimi i tij, nga familjarë, miq dhe ish-kolegë. Fadil Kokomani u pushkatua nga regjimi komunist, sepse

guxoi të mbronte fjalën e lirë dhe aspiratën për një Shqipëri demokratike, duke luftuar deri në ditën e fundit të jetës së tij, me një betejë epike kundër një kohe të errët. Sot e kësaj dite, eshtrat e tij nuk janë gjetur. Dokumentari u transmetua premierë në RTSH 1 HD, më 24 maj 2023, ora 18:00.

- **“Vullneti të jep famën, modestia madhështinë”** - Një udhëtim në jetën dhe veprën e albanologut Kolec Topalli. Një homazh në 5-vjetorin e ndarjes së tij nga jeta. Një fëmijë që provoi vitet e internimit, një mësues që sherbeu në pesë rrethe të vendit. Një studiues i gjuhës, nga bashkëpunëtori shkencor, deri tek akademiku dhe gjithmonë njeriu i thjeshtë dhe modest. Vlerësuar si vazhdues i veprës së Çabejt, Demirajt etj. Një dokumentar nga Ëngjëll Ndocaj. Dokumentari u transmetua premierë në RTSH 1 HD, më 24 maj 2023, ora 23:05.
- **“Dy kampionët”** - Dokumentar kushtuar ikonave të sportit, bashkshorteve Marieta dhe Kushtrim Zaçe, ish kampionë dhe rekordmenë në atletikë dhe basketboll. Dokumentari është një rikthim në vitet e sportit dhe të jetës së Marietës, ish atlete dhe rekordmene në kërcim së larti, ish pedagoge, deputete, drejtuese e sportit, etj, por dhe një homazh për ish basketbollistin e talentuar Kushtrim Zaçe që prej 12 vitesh na mungon. Dokumentari u transmetua premierë në RTSH 1 HD, më 29 qershor 2023, ora 14:50.
- **“Një jetë me drejtësi, për drejtësinë dhe në emër të drejtësisë”** – Dokumentar i realizuar nga gazetari Anxhelo Xhaçka, mbi jetën dhe veprimtarinë e Prof. Aleks Luarasi, një nga figurat më të spikatura në fushën e jurisprudencës, si pedagog dhe studiues, përfaqësues i Shqipërisë në Komisionin e Venecias dhe krijues i Universitetit të parë privat shqiptar. Transmetuar në RTSH 1 HD, ora 17:55, 23 korrik, 2023.
- **“Strategu i Futbollit Shqiptar, Ilias Ceco”**- Dokumentar kushtuar ish-futbollistit dhe drejtuesit të suksesshëm Ilias Çeço, Mjeshtër i Madh. Transmetuar në RTSH 1 HD më 22 gusht, ora 18:00.
- **“Një penel që s'di të ndalet”**- Filmi dokumentar është frymëzuar nga jeta shumë e veçantë e një qytetari vlonjat. Që nga rinia e tij, ka qënë shofer, me duart e tij ka ndërtuar një "oaz" qetësie në bregun shkëmbor në hyrje të Radhimës por sot, në moshën 81-vjeçare është edhe një piktor me një krijimtari të veçantë. Rahmi Dervishaj është "historia e një dashurie për jetën që vazhdon, ashtu si dhe peneli i tij që s'di të ndalet". Transmetuar në RTSH 1 HD më 28 gusht, ora 20:30.
- **“Drejt Euro 2024”**- Përjetoni emocionet e sfidës që drithëroi çdo shqiptar. Të pathënat, historitë dhe faktet që i paraprinë barazimit të Pragës dhe ëndrrës së kualifikimit. Personazhet që e përjetuan nga afër, vijnë 24 orë para takimit të kthimit në Tiranë në zogjtë shtegtarë të futbollit shqiptar dhe emocionet e ndeshjes Çeki-Shqipëri. Transmetuar në RTSH 1 HD, më 11 tetor 2023, ora 21:00.
- **“Fatosi mes nesh”**- Fatos Sela, një prej figurave të shquara të artit tonë skenik dhe atij kinematografik. Një film-dokumentar kushtuar jetës dhe karrierës së tij në RTSH, Teatrin

e Fierit dhe Teatrin Popullor në Tiranë. Transmetuar në RTSH 1 HD, më 14 tetor 2023, ora 13:20.

- **“Ju flet Agron Çobani”** - Një jetë dedikuar gazetarisë, e mbushur me veprimtari dhe emocione, figura e dritësuar e Agron Çobanit vjen përmes një dokumentari me copëza rrëfimesh, kujtimesh dhe momentesh shënjuese nga jeta e tij. Nën regjinë dhe skenarin e regjisores Zhejniva Garo, dokumentari "Ju flet Agron Çobani". Transmetuar në RTSH 1 HD, më 17 tetor 2023, ora 21:00.
- **“Rrugëtim me skenën operistike shqiptare”** - Historia e institucionit që nxiti dhe frymëzoi kompozitorët tanë më të mirë, për të sjellë në skenë operën shqiptare, vjen në ekran nëpërmjet pamjeve, bisedave dhe analizës, në një rrugëtim përgjatë dekadave nga krijimi i saj, deri në ditët tona. Vepra muzikore dinjitoze, të cilat ngjiten në skenë krijuesit dhe interpretuesit tanë më të mirë. Një model frymëzimi që shërben si nxitje për të rikthyer te artdashësit e skenës operistike krijime të reja në këtë gjini muzikore. Transmetuar në RTSH 1 HD, më 26 tetor 2023, ora 15:00.
- **“85 vjetori i Radio Tirana”**- Një minutazh special dedikuar atyre që bënë historinë e Radio Tiranës nga viti i largët 1938 dhe deri sot. Si ishte, si është dhe si do të jetë Radio Tirana? Transmetuar në RTSH 1 HD, ora 15:00, datë 30 nëntor 2023.
- **“Thesare të kulturës shqiptare në Suedi”**- Shoqata e Shkrimtareve dhe Artisteve Shqiptare "Papa Klementi XI - Albani" në Suedi bën bilancin e arritjeve në letërsi. Mbi 200 vepra të botuara në poezi dhe prozë, 14 vëllime të periodikut "Thesare shqiptare në Suedi" të botuara në shqip dhe suedisht, 10-ra veprimtari në Shqipëri, Kosovë e më gjerë, marrëveshje me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, janë vërtetë një arritje që rrallë e gjen në diasporë, çka u pasqyrua në Kuvendin e tyre IV zgjedhor të zhvilluar në Malmo. Transmetuar në RTSH 1 HD më 29 dhjetor 2023, ora 18:30.

Seriale

- **“Dy jetë”** - Ekskluzivisht në Radio Televizionin Shqiptar, premierë absolute prodhimi më i ri spanjoll i vitit 2021, “Dy jetë”. Një serial nga RTVE, Bambu dhe Studio Canal. Një rrëfim i jashtëzakonshëm, i shtrirë në dy kohë. Dy jetë të ndryshme, që i bashkon historia dhe gjaku. Dy gra të jashtëzakonshme, në dy epoka paralele, të vendosura për të ndryshuar fatin e tyre me çdo kusht! Premiera u transmetua më 16 Janar 2023. Seriali transmetohet nga e hëna në të premte në RTSH 1, ora 19:00.
- **“Një shtëpi e stërmadhe”** - Seriali amerikan komik më i dashur i të gjitha kohërave vjen ekskluzivisht në Radio Televizionin Shqiptar. Ngjarjet e përditshme të një familjeje të zakonshme me pjestarë të jashtëzakonshëm. Me situata komike e plot të papritura, ata të gjithë bashkë përpiqen të ndërtojnë një jetë në një shtëpi që sa vjen e bëhet më e madhe! Premiera u transmetua më 24 Janar 2023. Seriali transmetohet në RTSH 1 çdo të martë, të enjte dhe të premte, ora 20:30.
- **“Bujtina e Okos”** - Një serial i animuar për fëmijë, në qendër të së cilit është Oko, një vajzë aktive 12-vjeçare. Pasi prindërit e saj ndërrojnë jetë papritur në një aksident tragjik

me makinë, Oko fillon të jetojë me gjyshen e saj, e cila drejton një bujtinë tradicionale japoneze. Ajo takon një djalë fantazmë të quajtur Uribo, i cili e bind atë të ndihmojë gjyshen e saj dhe të bëhet trashëgimtare e bujtinës. Me ndihmën e fantazmave miqësore, Oko zgjidh problemet e vështira të bujtinës dhe u sjell buzëqeshje mysafirëve me mikpritjen e saj. Ajo do të përpiqet të bëhet menaxherja më e mirë e ardhshme ndonjëherë! Seriali u transmetua në RTSH 1 nga e hëna në të premte, prej datës 6 shkurt 2023, ora 10:45.

- **“Ben Ten i Ri”** - Ben Ten, djaloshi 10-vjeçar nga qyteti i Belvudit, së bashku me kushëririn e tij Guen dhe gjyshin Maks, nisen për një udhëtim fantastik, me ndihmën e orës Omnitrix. Shumë shpejt ai do të mund të shndërrohet në krijesa të ndryshme aliene, duke u kthyer në një superhero, në ndihmë të njerëzve. Seriali transmetohet prej datës 5 qershor 2023, çdo të hënë dhe të premte, në RTSH 1, ora 18:00.
- **“Qenushi Kale”** - Radio Televizioni Shqiptar sjell për fëmijët dhe gjithë familjen aventurat e “agjentit” më të ri të policisë së Flensburgut, qenushi Kale! I adoptuar nga Pia, shefja e policisë së qytetit, nën asistencën e Hanno-s dhe Merle-s, Kale do të jetë një ndihmë e madhe në zgjidhjen e problemeve të policisë dhe familjes. Seriali transmetohet prej datës 5 qershor 2023, çdo të hënë dhe të premte, në RTSH 1, ora 18:15.

Evente speciale

- **“Miss Shqipëria 2023- Spektakli”**- Radio Televizioni Shqiptar solli ekskluzivisht një mbrëmje që e tejkaloi një konkurs të thjeshtë bukurie. Një event spektakolar në zemer të Tiranës, ku 25 vajza konkurruan për titullin më prestigjioz të bukurisë në Shqipëri! Nën moderimin e Hygerta Sakos, përveç 25 bukurosheve të këtij viti, u ngjiten në skenë edhe artistë të jashtëzakonshëm, të cilët ofruan një mbrëmje për të mos u harruar. Ndërsa juria profesioniste e përbërë nga figura të fushave të ndryshme, votoi për Mbretëreshën e këtij viti. Eventu u transmetua në RTSH 1 më 8 korrik 2023, ora 20:30.
- **“The Miss Globe 2023 - Spektakli”** – Nata finale e njërit prej eventeve më të rëndësishme të bukurisë botërore u transmetua drejtpërdrejt në RTSH 1. 56 konkurrentet e MISS GLOBE përmyllën me sukses turet promovuese në Shqipëri. Në natën finale, pati shumë surpriza dhe plot emocione ku u shpall Mbretëresha e Globit. Kjo natë finale u transmetua më 17 nëntor 2023, ora 20:40.
- **“Look of the year”**– Një nga top eventet botërore për modele dhe stilistë, vjen si një produksion televiziv ekskluziv nga RTSH. Nga Sanremo i Italisë dhe pikërisht nga teatri mitik “Ariston”, arena e mijëra artistëve të dashur për publikun tonë dhe jo vetëm. Transmetuar në RTSH 1 HD, ora 11:35, më 31 dhjetor 2023.
- **“Fustanella Shoë”** - Radio Televizioni Shqiptar erdhi në natën e ndërrimit të viteve me programin e madh të Vitit të Ri. “Fustanella Shoë” dhuroi një mbrëmje të paharrueshme natën e ndërrimit të viteve. Humor, muzikë dhe shumë të ftuar specialë, sollën festë, traditë dhe të qeshura në çdo familje shqiptare. Nën drejtimin e Ervis Saliasit dhe Evi Reçit, ky program special u transmetua premierë në RTSH 1 HD, më 31 dhjetor 2023, ora 20:35.

- **“Gëzuar”** - Radio Televizioni Shqiptar solli natën e ndërrimit të viteve një tjetër program special “Gëzuar”. Le të trokasim gotën me ata që janë larguar, por që nuk kanë mundur të ikin. Me ata që si çdo vit, do të ulen në tryezat tona së bashku me ne në natën e ndërrimit të viteve. Transmetuar në RTSH 1 HD, më 31 dhjetor 2023, ora 22:00.

Evente sportive

Liga e Kampionëve në RTSH 1 HD dhe RTSH Sport

Ndeshjet më të mira të kampionatit të Ligës së Kampionëve (Champions League), po përcillen prej datës 17 gusht 2022, live në ekranin e RTSH 1 HD dhe RTSH Sport, me emision të dedikuar, prag ndeshje dhe post ndeshje. Këto evente, të cilat kanë një audiencë të lartë televizive, përcillen në emisionet prag dhe post ndeshje, me të ftuar, specialistë e analistë të fushës.

1. **Borussia Dortmund – Chelsea**, më 15 shkurt 2023, ora 20:50;
2. **Inter – Porto**, më 22 shkurt 2023, ora 20:50;
3. **Bayren- Paris**, më 08 mars 2023, ora 20:50
4. **Real Madrid-Liverpool**, më 15 mars 2023, ora 20:50
5. **Milan-Napoli**, më 12 prill 2023, ora 20:50
6. **Bayern-Manchester City**, më 19 prill 2023, ora 20:50
7. **Milan-Inter**, më 10 maj 2023, ora 20:50
8. **Manchester City-Real Madrid**, më 17 maj 2023, ora 20:50
9. **Manchester City-Inter**, më 09 qershor 2023, ora 20:50
10. **UEFA SuperCup 2023 –Manchester City-Sevilla**, më 16 gusht 2023, ora 21:00
11. **Braga-Panathinaikos**, më 23 gusht 2023, ora 21:00
12. **PSV-Rangers**, më 30 gusht 2023, ora 21:00
13. **Bayern-Man. United**, më 20 shtator 2023, ora 21:00
14. **Dortmund-Milan**, më 04 tetor 2023, ora 21:00
15. **Paris-Milan**, më 25 tetor 2023, ora 21:00
16. **Salzburg-Inter**, më 08 nëntor 2023, ora 21:00
17. **Real Madrid-Napoli**, më 29 nëntor 2023, ora 21:00
18. **Neëcastle-Milan**, më 13 dhjetor 2023, ora 21:00

FORMULA 1

Formula 1 në RTSH 1 HD dhe RTSH Sport

Garat kualifikuese të Formula 1, në sezonin e 73-të të Kampionatit Botëror të Automobilizmit, janë përcjellë live në RTSH 1 HD. 10 skuadra dhe 20 pilotë, në kërkim të kurorës së Max Verstappen-it.

RTSH 1 HD ka transmetuar live:

1. **Gara GP Bahrain**, më 5 mars 2023, ora 15:50;
2. **Saudi Arabian Grand Prix**, më 19 mars, ora 18:00
3. **Australian Grand Prix**, më 2 prill, ora 07:00
4. **Azerbaijan Grand Prix**, më 30 prill, ora 13:00
5. **Miami Grand Prix**, më 7 maj, ora 21:30
6. **Monaco Grand Prix**, më 28 maj, ora 15:00
7. **Spanish Grand Prix**, më 4 qershor, ora 15:00
8. **Canadian Grand Prix**, më 18 qershor, ora 21:00
9. **Austrian Grand Prix**, më 2 korrik, ora 15:00
10. **British Grand Prix**, më 9 korrik, ora 16:00
11. **Hungarian Grand Prix**, më 23 korrik, ora 15:00
12. **Belgian Grand Prix**, më 30 korrik, ora 15:00
13. **Dutch Grand Prix**, më 27 gusht, ora 15:00
14. **Italian Grand Prix**, më 3 shtator, ora 15:00
15. **Singapore Grand Prix**, më 17 shtator, ora 14:00
16. **Japanese Grand Prix**, më 24 shtator, ora 07:00
17. **Qatar Grand Prix**, më 8 tetor, ora 16:00
18. **United States Grand Prix**, më 22 tetor, ora 21:00
19. **Mexico City Grand Prix**, më 29 tetor, ora 21:00
20. **São Paulo Grand Prix**, më 5 nëntor, ora 18:00
21. **Las Vegas Grand Prix**, më 18 nëntor, ora 07:00
22. **Abu Dhabi Grand Prix**, më 26 nëntor, ora 14:00

Lidhje direkte

- **“Sulltan Novruzit”**- Me rastin e festës zyrtare tradicionale të Sulltan Novruzit, më 22 mars 2023, ora 11:00.
- **“Pashkët Katolike 2023 – Ngjallja e Zotit Jezu Krisht”** - Drejtpërdrejt nga “Katedralja e Shën Palit”, në Tiranë, nën udhëheqjen e Arqipeshkvit, Imzot Arjan Dodaj, Mesha e Vigjiljes së Pashkëve Katolike. Paqja me ju! Lidhja direkte u realizua më 8 prill 2023, ora 22:00.
- **“Pashkët Katolike 2023 – Urbi et Orbi”** - Përshëndetja e Papës drejtpërsëdrejti nga Vatikani, me anë të së cilës Papa jep mesazhin e Pashkëve dhe bekimin tij, për paqen e të gjithë popujve, në gjuhë të ndryshme të botës. Lidhja direkte u realizua më 9 prill 2023, ora 11:55.

- **“Pashkët Ortodokse 2023 – Shërbesa e Ngjalljes”** - Drejtpërdrejt nga Kisha Ortodokse " Ngjallja e Krishtit", shërbesa e mbrëmjes së Pashkës, duke vijuar me shërbesën tradicionale të Ngjalljes. Kremtimi Paskal dhe Liturgjia Hyjnore. Lidhja direkte u realizua më 15 prill 2023, ora 23:00.
- **“Falja e Namazit të Fiter Bajramit”** - Drejtpërdrejt nga Sheshi “Skënderbej”, falja e Namazit të Bajramit. Gëzuar Fitër Bajramin të gjithë besimtarëve myslimanë! Lidhja direkte u realizua më 21 prill 2023, ora 06:00.
- **“Falja e Kurban Bajramit”**- Drejtpërdrejt nga sheshi “Skënderbej” falja e Namazit të Kurban Bajramit, më 28 qershor 2023, ora 05:30.
- **“Ceremonia e Festës së Malit të Tomorit”** – Drejtpërdrejtë nga ceremonia e Festës së Malit të Tomorit, transmetuar në RTSH 1 HD më 22 gusht, ora 11:00.
- **“Ceremonia e fjalimit së ish-Presidentit Amerikan, Bill Clinton”** -Drejtpërdrejt nga “Bulevardi Dëshmorët e Kombit”, përballë kryeministrit, ish-Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Clinton ka mbajtur fjalimin e tij historik para qytetarëve në Tiranë në vizitën e tij të parë në Shqipëri. Kjo ngjarje u transmetua në RTSH 1 HD, më 3 korrik 2023, ora 19:00.
- **“Festa e Ashures”** - Drejtpërdrejt në RTSH 1 HD, kremtimi i ceremonisë së Ashures, transmetuar më 9 gusht 2023, ora 11:00.
- **“Edi Rama në asamblenë e përgjithshme të OKB-së”**- Drejtpërdrejt nga mbledhja e këshillit të sigurimit në OKB, nga ku Shqipëria ka drejtuar seancën për Ukrainën në Këshillin e Sigurimit në OKB, i pranishëm ka qenë edhe Presidenti Volodymyr Zelensky. Transmetuar më 20 shtator 2023, ora 08:36.
- **“Samiti i Liderëve të Procesit të Berlinit 2023”** - Samiti i Liderëve të Procesit të Berlinit 2023, u zhvillua për herë të parë jashtë kufijve të BE-së, me pjesëmarrjen e 6 kryeministrave të rajonit, si dhe përfaqësuesve të nivelit të lartë dhe organizmave ndërkombëtare të mbi 25 vendeve, mes të cilëve Kancelari i Gjermanisë Olaf Scholz, Presidentja e Komisionit Europian, Ursula von der Leyen, Presidenti i Këshillit Europian Charles Michel, si edhe një sërë kryeministrash të vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Pjesëmarrësit në Samit u pritën nga Kryeministri Edi Rama në një ceremoni të posaçme në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” e më pas vijuan në mjediset e COD. Kjo ngjarje u transmetua drejtpërdrejt në RTSH 1 HD, më 16 tetor 2023, ora 11:05.
- **“Nënshkrimi i marrëveshjes ekonomike mes Ramës dhe Makronit”**- RTSH 1 HD transmetoi drejtpërdrejtë nga Kryeministria, më 17 tetor ora 10:40, momentin kur u nënshkrua marrëveshja ekonomike dhe bashkëpunimi mes dy vendeve nga kryeministri Edi Rama dhe presidenti Emmanuel Macron.
- **“Mesha e Krishtlindjes Katolike”**- Drejtpërdrejt kremtimi i festës tradicionale të besimit “Lindja e Zotit Jezu Krisht”, ceremoni e cila organizohet dhe celebrhet në Kishën Katedrale të Shën Palit, nën udhëheqjen e Arqipeshkvit Imzot Arjan Dodaj, më 24 dhjetor ora 23:00.

- **“Mesha e Krishtlindjes Orthodoxe”** –Kisha Orthodoxe Autoqefale e Shqipërisë kremton festën e madhe të Krishtlindjes, e kremtja e Paqes dhe e Dashurisë hyjnore për Shpëtimin e të gjithë njerëzimit. Radio Televizioni Shqiptar sjell drejtpërdrejt shërbesën kremtuese të Liturgjisë Hyjnore të Krishtlindjes dhe mesazhin kremtues të Kryepeshkopit Anastas, më 25 dhjetor, ora 08:00.
- **“Urbi et Orbi”**- Drejtpërdrejt ceremonia e përshëndetjes së Papës, drejtuar të gjithë popujve të botës, “Urbi et Orbi”, nën komentin e Z. Ferdinand Ndocaj, më 25 dhjetor, ora 12:00.
- **“Ndërrimi i viteve në RTSH 1 HD”** - Radio Televizioni Shqiptar ju uron “Gëzuar 2024”! Përcjellim minutat e para të Vitit të Ri, drejtpërdrejt nga Sheshi “Skënderbej”, më 31 dhjetor, ora 23:55.

Objektivat dhe vizioni ynë për vitin 2024:

Kanali RTSH 1 HD në sezonin e ri televiziv do të ofrojë një programacion të larmishëm, me sasi dhe cilësi të lartë programesh.

Një detyrë e rëndësishme dhe mision në vetvete i RTSH 1-HD do të jetë të prodhojë program për të gjitha moshat dhe për të gjitha kategoritë.

Ajo që ky kanal televiziv do të ketë në fokus, është gara “kokë më kokë” me konkurrentët.

Fashat e orarit do të jenë gjithashtu një pike kyçe, pasi audiencia duhet të jetë e qartë për orarin kur transmetohet filmi, apo emisioni i preferuar.

Një ndër objektivat është të kemi program dedikuar adoleshentëve, të cilët përbëjnë një pjesë të madhe të audiencës.

Do të vazhdojmë të jemi konkurrent me kanalet e tjera gjeneraliste, veçanërisht në prime time.

RTSH 1 konkurren në “Prime Time” me emisionin politik 3D, teksa e mërkura i mbetet “Champions League”. Në ditët kur nuk ka Champions, orari i “Prime Time” do të ketë fokusin në filmat premierë.

Fundjava do të vijojë edhe këtë sezon me “Fustanellën” dhe “Kur xhirohej një film” të shtunën si dhe “Një natë sa një jetë” të dielën.

Nuk përfundon me kaq. Ajo çfarë duhet të arrihet edhe më shumë në këtë sezon të ri, është bashkëpunimi me online-in, ëeb-in dhe rrjetet sociale.

Duhet që programet të jenë të gjitha të pasqyruara në rrjet në kohë reale, pasi vetëm kështu do të mund të jemi në garën e vërtetë të klikimeve.

Gjithashtu, në RTSH 1 HD, do të ketë më tepër seriale për fëmijë dhe të rritur dhe filma premierë. Këtu vlen për t’u theksuar fakti që transmetimi i tyre do të përzgjidhet me kujdes për të qenë sa më korrekt me audiencën dhe fashën orare e cila kufizon transmetimin e materialeve të papërshtatshme.

Viti 2024, do të jetë një vit kryesor dhe thelbësor sa i përket programacionit të RTSH 1 HD.

Theksojmë dhe një herë se me gjithë ndryshimet që u bënë dhe pasqyruan në sezonin e kaluar, ky sezon i ri premtan për cilësi, risi dhe spektakle të reja.

Synimi ynë është të kemi programe premierë në transmetim në çdo periudhë të vitit, pa bërë “pushim”.

Objektivi kryesor është që më 1 shtator të gjitha programet do të jenë në transmetim.

RAPORT PUNE PËR VITIN 2023 KANALI RTSH 2

Kanali RTSH 2 përgjatë vitit 2023 ka pasur në vëmendje dhe prioritet fokusin që ka të përcaktuar kanali RTSH 2.

Prioritet i këtij kanali është për ta forcuar sa më shumë fokusin e tij, e për të qenë sa më në shërbim të grupeve e audiencës që përfaqëson RTSH 2, e jo vetëm.

Duke u nisur nga ecuria e emisioneve të cilat kanë startuar në janar të vitit 2023, e deri në fundin e sezonit në qershor 2023, reagimet kanë qenë pozitive nisur nga fakti që shumë grupe janë ndjerë të përfaqësuar. Sidomos religjionet dhe pakicat kombëtare.

Pakicat kombëtare kanë qenë të angazhuar drejtpërdrejtë në realizimin jo vetëm në prezantimin e lajmeve në gjuhët përkatëse, por edhe në transmetimin e reportazheve dhe dokumentarëve që kanë ardhur si rezultat i bashkëpunimeve të institucioneve, shoqatave dhe RTSH 2.

Aktivitet të shumtë janë përcjellë nga kanalet lokale të Shkodrës, Kukësit, Korçës dhe Gjirokastrës me kronika dhe me lidhje direkte. Gjithashtu të ftuar të fushave të ndryshme të cilët kanë qenë burim informimi për audiencën.

Në sezonin e ri shtator-dhjetor 2023 janë bërë ndryshime në strukturën e tij programore. Tashmë RTSH 2 e ka kthyer vëmendjen drejt rretheve dhe qyteteve të Shqipërisë ku çdo ditë nga e hëna në të diel janë tri edicione lajmesh si dhe reportazhe të ardhura nga qendrat lokale të Shkodrës, Gjirokastrës, Korçës dhe Kukësit.

Struktura programore e RTSH 2 HD përgjatë vitit 2023:

Emisionet:

Emisioni “Transkulturë”

Emision i sezonit nëntor – dhjetor 2023

Autore Mimoza Ahmeti

Një emision për transkulturën në Shqipëri, si një metodë që ndihmon si të shohësh te tjetri për më shumë njohje dhe përjasje. Megjithëse vendi ynë ka një përbërje popullore pak a shumë homogjene për nga gjuha, ndryshimet e saj historike, sociale janë kaq të ndryshëm sa që mund të themi se ende ka shumë hapësirë për të marrë përvojë nga pjesë të ndryshme të vendit në aksionin historik, social linguistic, të zonave të ndarjes së pjesëve, që jetojnë brenda dhe përtej kufijve. Debat dhe ide për kulturën tonë, për të rritur lidhjet e saj të brendshme dhe të jashtme, për të rritur

informacionin, etikën e perceptimit si dhe kapacitetin e realizmit të mundësive organizative e produktive të të gjitha potencialeve në shtresa të shoqërisë.

Çdo të enjte ora 21:30

Emisioni “Art dhe Art”

Emision i sezonit janar 2023 – qershor 2023

Çdo të premte ora 21:00.

tetor 2023- dhjetor 2023 Ora 21:30

Autor Z.Abaz Hado dhe gazetarë Tana Kalemaj.

Emisioni ka pasur në fokus artin pamor në vendin tonë. Promovimin e artistëve të rinj si nga vendi ashtu edhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Promovim të punimeve të piktorëve më në zë të momentit. Intervista dhe ekspozita nga më të ndryshmet, të huaj të cilët kanë hapur ekspozita apo dhe kanë pasur projekte të përbashkëta me të rinj dhe profesionistë të artit figurativ. Janë promovuar performanca të ndryshme, vepra murale apo dhe arkitekturë urbane.

Emisioni “Artes”

Emision i sezonit janar 2023 – qershor 2023

Autore: Elsa Demo.

Ky emision trajton tema nga fusha të ndryshme të artit, duke e ngritur bisedën me të ftuar e specialistë në nivel kritik. Një emision i trajtuar me një këndvështrim të veçantë dhe me sy kritik nga ana e autores Elsa Demo, gjë e cila e bën emisionin të këtës dhe një audiencë elitare. Emisioni trajton tema interesante dhe probleme nga më të ndryshmet të cilat shqetësojnë komunitetin artistik, komunitet i cili ka gjetur një dritare ku i jep zë shqetësimeve apo dhe punëve të tyre. Pjesë e emisionit kanë qënë dhe panele nga Kosova, Maqedonia e Veriut, por dhe të huaj të cilët kanë punuar projekte në Shqipëri.

Çdo të mërkurë ora 21:00-22:00.

Emisioni “Flasim për ekonominë”

Emision i sezonit janar 2023 - qershor 2023

Autor i emisionit gazetari Bardhi Sejdarasi.

Një emision me në fokus problematikat e ekonomisë shqiptare. Duke shqyrtuar çdo javë aktualitetin, problematikat e momentit dhe vendimet e ndryshme të marra në lidhje me problematikat apo vështirësitë e familjeve shqiptare. Diskutime me një panel të gjerë me ekspertë të fushës.

Është një emision radio/televiziv. Në televizion transmetohej çdo të enjte ora 19:45

Emisioni “Rrënjët e ushqimit tënd”

Emision i sezonit janar 2023 – qershor 2023

Autor z.Sokrat Jani. Emision në shërbim të fermerit, tepër i dobishëm në informimin, këshillimin si të fermerëve ashtu dhe të publikut i cili informohet për shumë çka në lidhje me ato që

konsumojmë dhe se si dhe kur është më e shëndetshme të konsumohet. Agronomi në përgjigje të fermerëve. Emision me telefonata ku jepen këshilla të drejtpërdrejta për publikun. Çdo javë është nga një specialist i temës që do të trajtohet. Çdo të premte në orën 17.00-18.00 drejtpërdrejt.

Emisioni ‘ADN’

Emision i sezonit janar 2023 - korrik 2023

Një emision ku trajtohen tre tema të ndryshme që kanë lidhje me artin, demokracinë dhe natyrën. Të ftuar personalitete të fushës nën drejtimin e autorit të emisionit z. Ilir Yzeirit. Një emision i cili rikthehet herë pas here figurave të ndryshme, figura që kanë kontribuar në formimin e shtetit Shqiptar apo dhe kanë pasurkontribute në zhvillimin dhe integrimin e shoqërisë. Historianë, personalitete dhe akademikë të ndryshëm me të cilët është diskutuar për tema nga më të ndryshmet e më të larmishmet.

Çdo të enjte ora 21:00 – 22:20

“Lajmet në gjuhën e pakicave”

janar – dhjetor 2023

Janë 8 minoritete duke ju përgjigjur kështu pothuaj të gjitha minoriteteve.

Lajmet në gjuhën e pakicave

Lajmet në gjuhën e pakicave transmetohen çdo ditë, nga e hëna në të premte, ora 18:30-19:10

Lajmet në gjuhën Greke 18:30-18:35

Lajmet në gjuhën Maqedonase 18:35-18:40

Lajmet në gjuhën Malazeze 18:40-18:45

Lajmet në gjuhën Bullgare 18:45-18:50

Lajmet në gjuhën Arumune 18:50-18:55

Lajmet në gjuhën Rome 18:55-19:00

Lajme në gjuhën Serbe 19:00- 19:05

Lajmet në gjuhën Boshnjake 19:05:19:10

“Lajmet në gjuhën e shenjave”

Janar – dhjetor 2023

Pjesë e RTSH2 janë dhe lajmet në gjuhën e shenjave për personat që nuk flasin dhe dëgjojnë.

Çdo të Diel në orën 20:00 - përmbledhja javore.

Lajmet shkurt

Janar – shtator 2023

Lajmet shkurt në shqip janë në 3 orare të ditës, nga e hëna në të dielë.

Oraret: 14:00 (10 minuta),17:00 (15 minuta),23:30 (15 minuta).

Të Shtunë dhe të Diel: 08:30, 14:00 , 17:00 dhe në 23:30

Edicion informativ “360 gradë” (30 minuta)

Tre edicione informative në oratet 12:00-12:30 , 17:00 – 17:30, 21:00 – 21:30

shtator – dhjetor 2023

Lajmet “ Zëri i Amerikës”

Janar – dhjetor 2023

Ora 18.00-18.30 nga e hëna në të dielë drejtpërdrejt.

Zëri i Amerikës, Ditari që sjell lajmet më të fundit nga bota, korrespondencat nga rajoni, intervista dhe analiza me tema nga më të larmishmet.

Reportazhe

Shtator – dhjetor 2023

Reportazhe në lidhje me personazhe dhe aktivitete të ndryshme të ndodhura në qytete të shqipërisë.

Çdo ditë nga e hëna në të dielë ora 17:00 – 17:30

Pjesa tjetër e programit është mbuluar me dokumentarë, filma artistikë, koncerte, reportazhe teatër etj....Një vend të rëndësishëm zënë dhe dokumentarët e huaj dhe të vendit, prodhime të RTSH deri në muajin tetor 2023 muaj në të cilin u hap kanali RTSH dokumentarë dhe dokumentarët e huaj dhe shqiptar kaluan në këtë kanal. Aktualisht RTSH2 transmeton një pjesë dokumentarësh që kanë të qendër qytetet e Shqipërisë duke qenë se fokusi është drejt tyre.

Muzikë, duke respektuar të gjitha pakicat. Janë transmetuar me orar të barabartë muzike për të gjitha pakicat kombëtare. Janar – dhjetor 2023

Janë pasqyruar ceremoni të ndryshme fetare, festa në malin e Tomorit, ceremoni të ditëve të Pashkëve, të Krishtlindjes për të dyja religjionet, si ajo katolike apo dhe ajo ortodokse, ritet e komunitetit mysliman sidomos gjatë periudhës së Ramazanit.

Në vëmendje kanë qenë dhe problematikat apo dhe historitë e suksesit të personave me aftësi të kufizuar. Deri në shtator 2023.

Filma, koncerte recitale të huaj dhe shqiptarë. Janar – dhjetor 2023

Janë transmetuar ndeshje të ndryshme futbollit, volejbollit apo çiklizëm. Transmetime drejtpërdrejt dhe të regjistruara. Evente të deleguara nga kolegët e kanalit RTSH sport , janar – dhjetor 2023.

Objektivat dhe fokusi

Të ndiqet dhe të pasurohet tashmë fokusi i ri i kanalit RTSH 2.

Të ketë prodhim, emisione ditore , reportazhe apo dhe dokumentarë që kanë lidhje me histori suksesi apo dhe trajtim të problematikave në rrethe.

Sa më shumë emisione argëtuese për moshë dhe kategori të ndryshme, sidomos për rininë.

Filma ose seriale.

Lajmet në gjuhën e shenjave çdo ditë.

Të ketë një strukturë programore më të pasur. Është e rëndësishme që kanali të ketë pikat kyçe të ditës. Duhet të jenë minimalisht 2 ose 3 emisione ditore, gjithmonë duke pasurparasysh fokusin e kanali.

RAPORT PUNE PËR VITIN 2023 KANALI RTSH 3

Kanali RTSH3 ka qënë një kanal i dedikuar tërësisht bashkatdhetarëve tanë kudo që ndodhen. Politikat integruese të shqiptarëve, ruajtja e traditave, lidhja me vendin dhe me aktualitetin kanë vijuar të qëndrojnë si pjesë e një qëllimi që i shërben një publiku më të gjerë ndër shqiptarët kudo në botë me emisione të dedikuara. Mund të përmendim emisionin “Ura” një emision ditor rreth 90 minuta, duke u lidhur me bashkatdhetarët nëpër botë të cilët kanë pasurnjë dritare për të ndarë arritjet e tyre apo dhe aktivitetet e ndryshme që zhvilloheshin prej tyre. Ky emision ka qënë në transmetim deri në prill të 2022 dhe ka rifilluar përsëri në nëntor të 2023.

Struktura programore RTSH3 janar 2023 – dhjetor 2023

Emisionet

Emisioni URA

Pjesë e sezonit nëntor - dhjetor 2023

Autor Artur Bejzade , gazetar Vladimir Thano

Emision me kohëzgjatje 90 minuta. Të hënë , të mërkurë, të premte ora 21:00 – 22:30

URA i dedikohet tërësisht shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit. Zhvillimeve të fundit si në aspektin e politikës së integritimit të shqiptarëve, traditave, koncerteve apo dhe festave kombëtare të festuara në vendet ku jetojnë , kanë vijuar të qëndrojnë si pjesë e një qëllimi që i shërben një publiku me të gjerë ndër shqiptarët kudo në botë.

RTSH 3 ka qënë pranë shqipëtarëve me prodhime të ndryshme të RTSH siç mund të jenë reportazhe, dokumentarë emisione, filma.

Reportazhe nga Diaspora

Reportazhe, dokumentarë për individë e personalitete nga e gjithë hapësira e diasporës shqiptar.

Psikologji të ndryshme e kanë bërë interesant perceptimin e këtyre reportazheve, dokumentarëve, të cilët kanë pasurnë fokus faktet mbi të cilat është bërë i suksesshëm personazhi për të cilin janë realizuar dhe ngjarjet, mbi të cilat përshkruhet rrugëtimi i shqiptarëve në diasporë.

Gjithashtu kanali RTSH3 gjatë gjithë vitit i është përgjigjur nevojave të kanalit RTSH sport duke krijuar hapsira për transmetimin e ndeshjeve të futbollit, basketbollit apo dhe volejbollit.

Në vëmendje të kanalit gjithashtu kanë qënë dhe data të caktuara historike apo dhe ditëlindje të figurave historike që kanë pasurnjë kontribut në integritimin dhe përfaqësimin e shqiptarëve nëper botë dhe jo vetëm.

Objektivat dhe fokusi

Të shtohen emisione të tjera që i dedikohen diasporës si në problematikë, në aktivitete, histori suksesi. Gjithashtu dhe në ndarje grupmoshash, duke nisur nga fëmijët e deri tek brezi I tretë.

RAPORT PUNE PËR VITIN 2023 KANALIRTSH MUZIKË

RTSH MUZIKË është një kanal i konsoliduar tashmë dhe njihet në tregun mediatik dhe atë të rrethit të artistëve shqiptarë. Tashmë artistë të njohur dhe të rinj me aktivitetet e tyre muzikore dëshirojnë të jenë pjesë e programacionit të kanalit tonë pasi kanë krijuar besimin për cilësinë dhe korrektësinë nga ana jonë. Ajo që na bën të veçantë në tregun e ashpër të kanaleve simotra është shumëllojshmëria e gjinive muzikore që në transmetojmë sipas fashave orare të mirë përcaktuara. Aty e gjen veten fëmija 3 vjeç dhe i moshuari mbi 90 vjeç. Aty e gjejnë veten ata që adhurojnë folklorin dhe ata që duan muzikën bashkëkohore. Gjithçka që tingëllon bukur dhe ëmbël mund të shijohet në RTSH Muzikë. Së bashku për muzikën.....

Struktura programore, 1 janar – 31 dhjetor 2023

Nga e hëna në të premte:

07:00 – 09:00 “Rreze”, Orët e para të mëngjesit fillojnë me ritmet e videoklipeve më të fundit por dhe ato nostalgjike të cilat përfshihen në një hark kohor prej 120 minutash, në programin RREZE, i cili pretendohet që t’i japi publikut një impuls pozitiv për të filluar përditshmërinë e tyre me nota optimiste.

09:00-10:30 “Folk-on”, Muzika folk dhe qytetare shqiptare vjen si promovuese e vlerave të muzikës së popullit tonë me përzgjedhjen më të mirë nga kanali “RTSH Muzikë”. Folk-On titullohet rubrika e cila përfshin muzikën folklorike në orët e paradites e më së shumti në fundjavë ku e gjithë familja është së bashku dhe shijohet më mirë ky zhanër i muzikës sonë. Një hapësirë të konsiderueshme ka pasur muzika folklorike në programacion dhe është një nga prioritetet e kanalit tonë. Koncertet dhe festivalet folklorike kanë qenë pjesë e arkivit të RTSH-së por gjatë viteve të fundit ky arkiv është pasuruar me shumë aktivitete të reja.

10:30-12:00 – “Mikrofon”, Mikrofon është minutazhi ku sjellim në kanalin RTSH Muzikë koncertet më të mira të realizuara në vend dhe në skenat botërore nga artistë apo grupe. I kushtohet vëmendje dhe artistëve të rinj të cilët mund të promovohen në këtë ekran. Pretendojmë të jemi në këtë orar, duke menduar se shikueshmëria e publikut është më e lartë.

12 :00 -13:00 “Geo Music” Geo Music, i dedikohet këngëve të cilat vijnë nga vende të ndryshme të globit. Në këtë minutazh transmetohen këngë të shkëputura nga koncerte apo në formën e videoklipit për të sjellë këtë atmosferë dhe për tu njohur me kulturën dhe artin i cili vjen mes notash muzikore. Psh.: minutazh me këngë tipike franceze, braziliane, turke, italiane, etj.,

13:00-13:45 “Europe in Concert” është një rubrikë e përditshme në kanalin tonë në serinë e Europe in Concert. prodhim i DË. Në këto koncerte vijnë këngëtarë solistë dhe grupet më të mirë të

Europës në koncerte apo turne. Koncertet pasqyrohen dhe me një përshkrim të shkurtër i cili ka në fokus jetën dhe veprimtarinë e personazhit të radhës.

13:45-14:55” Koncert” Koncerte të artistëve të ndryshëm me kenge dhe numra të ndryshëm muzikore transmetohen në këtë orar për të bërë shoqëri publikut në kudo që na ndjek.

14:55-17:00 “Happy Hours” është minutazhi ku transmetohen klipet më të mira muzikore të reja por dhe të dekadave të mëparshme. Rrymat e ndryshme muzikore në këtë orar i japin të tjera energji të gjithë teleshikuesve të cilët na ndjekin gjatë këtij minutazhi special.

17:00-18:00 “ Tra-la –la” Festivale dhe muzikë për fëmijë-Fëmijët janë teleshikuesit më simpatikë të kanalit tone dhe i japim shumë rëndësi muzikës që i përket grup moshës nga 3 deri në 14 vjeç. Festalet Mbarëkombëtare të Këngës për Fëmijë Shkodër janë përzgjedhur në arkivin tonë por duke përfshirë dhe aktivitete të tjera të rëndësishme të këngës dhe muzikës për fëmijë si: Junior Eurovision Song Contest , Zecchino D’oro, Colors of the World etj, etj,. Videoklipe të këngëve shqiptare dhe të huaja për fëmijë janë pjesë e programacionit tonë të përditshëm.

18:00- 19:30 “ Mikrofon”- Mikrofon është minutazhi ku do të sjellim në kanal RTSH Muzikë koncertet më të mira të realizuara në vend dhe në skenat botërore nga artistë apo grupe. Do t’i kushtohet vëmendje dhe artistëve të rinj të cilët mund të promovohen në këtë ekran. Pretendojmë të jemi në këtë orar, duke menduar se shikueshmëria e publikut është më e lartë.

19:30-20:30 “Sanremo”- Festivali emblematik Sanremo si një nga festalet më të parapëlqyer të shqiptarëve vjen me këngët dhe interpretimet më të mira sipas kategorive në ekranin tonë. I cilësuar si festivali më jetëgjatë në Europë ai gjen hapësirë të dedikuar në programacionin tonë.

20:30-22:00 “ Partiturë”- Muzika klasike është padiskutim një vlerë e paçmuar e historisë së muzikës botërore. Jemi përpjekur vazhdimisht që kjo gjini e muzikës të jetë pjesë e programacionit të RTSH Muzikë. Në këtë gjini muzikore përfshihet aktiviteti i Orkestrës Simfonike të RTSH-së i cili është i pranishëm siç ka qenë gjatë këtyre viteve, për të sjellë në ekran edhe vlerat e këtij aseti të rëndësishëm të Institucionit tonë. I japim rëndësinë e duhur muzikës dhe partiturave të autoreve klasikë dhe bashkëkohore për të shpalosur edhe më shumë vlerat e kësaj gjinie. Njëkohësisht edukojmë edhe publikun me këtë muzikë shumëshekullore.

Koncert Festiv”- “Koncert Gala” –Kjo fashë orari përfshin të gjitha koncertet të cilat në qendër kanë një repertor të gëzueshëm dhe të zgjedhur i cili vjen si rrjedhojë e regjistrimeve televizive që RTSH ka realizuar ndër vite por dhe produksionet më të mira të huaja.

23:30 -24:30 Jazz Night- Muzika jazz vjen si një ndërveprim muzikor dhe si një rrymë e cila përfaqëson një pjesë të mirë të repertorit muzikor në botë. Kjo rubrike ka si qëllim të promovojë muzikën xhaz tek të gjithë dashamirësit dhe amatorët e kësaj gjinie muzikore.

Çdo të hënë:

20:30 – “Partiture” është program i cili sjell në ekran emrat dhe veprat më të spikatura të muzikës klasike shqiptare dhe asaj botërore, të interpretuara nga Orkestra Simfonike e RTSH-së si dhe Orkestra të mirënjohura botërore. Ky program vlen jo vetëm për argëtimin por edhe edukimin e publikut artdashës me këtë gjini muzikore. Me faqosjen e re të kanalit RTSH muzikë, programi “Partiturë” do të pasurohet edhe me informacione për kompozitorë, instrumentistë, dirigjentë dhe orkestra të mirënjohura shqiptare dhe të huaja.

Çdo të hënë dhe të enjte

19:00 “Gold Music- Flashback”, transmetohet 2 herë në javë në orën 21:00 dhe do të sjellë për më shumë se 150 minuta këngë të viteve ‘70, ‘80, ‘90 etj, duke sjellë në vëmendjen dhe kujtesën e publikut këngë të rrymave të ndryshme të këtyre viteve si Rock, Pop, Hip-Hop etj. Playlista do të përditësohet herë pas here dhe në varësi të arkivit që kemi në dispozicion.

Çdo të martë:

21:00 – “En- pointe”, Është program, i cili i dedikohet gjinisë së baletit. Minutazhi i dedikuar këtij zhanri do të pasqyrohet me veprat më të mira klasike dhe ato moderne nga teatrot dhe trupat më të famshme të botës. Në këtë program jemi përqendruar edhe tek shfaqjet e trupës sonë të baletit në TKOB.

Çdo të mërkurë:

21:00 – “Koncert Gala”, Koncertet e ndryshme gala të cilat vijnë si bashkëprodhime të RTSH-së dhe institucioneve të tjera artistike e kulturore në vend zënë hapësirën e duhur në programacionin tonë duke përcjellë emocione dhe vlerat e interpretimit të artstëve të njohur brenda dhe jashtë vendit.

Çdo të mërkurë:

23:00-“Camerale”

Me këtë program sjellim pranë publikut muzikën e dhomës, me formacione të vogla si duo, trio, kuartete etj... si dhe interpretime solistike. Ky program ka si qëllim të pasqyrojë jetën artistike muzikore të instrumentistëve shqiptarë por edhe atyre të huaj. Programi “Camerale” sjell atmosferën e muzikës së dhomës në ekranin e RTSH Muzikë.

Çdo të enjte:

21:00 – “Aria”, Gjinia e Operas ka hapësirën e saj në këtë kanal. Të gjitha veprat e autorëve më të mëdhenj botërorë shfaqen duke krijuar kështu një ndërthurje dhe me gjinitë e tjera të zhanrit klasik të cilat kanë hapësirën e tyre gjatë javës. Në këtë fashë orari ka interpretime të ndryshme nga solistët më në zë dhe nga trupat e teatrove më të famshëm të botës.

Çdo të premte;

21:00 “ Koncert festiv” Atmosferë festive në minutazhin e të premtës mbrëma ku përfshihen koncerte të cilat sjellin hare dhe gëzim tek publiku për ta nisur bukur fundjavën . Koncerte të cilat krijojnë harmoni edhe në ambientet familjare dhe shoqërore.

Çdo të martë dhe të premtë;

23:00 “DJ-Muzikë elektronike” Mbrëmjet e vona kanë nevojë për adrenalinen që transmeton muzika e DJ-ve më të mirë botërore e përcjellë në festivalet e muzikës elektronike. Ritmi dhe atmosfera që perfshin kedo gjen vend në transmetimet e RTSH Muzikë.

Çdo të shtunë dhe të diel:

20:30-“ Koncert” Kënga e bukur shqiptare në ekranin tonë gjatë fundjavës për të bërë bashkë këdo në Shqipëri dhe jashtë saj. Bashkëprodhimet e RTSH-së vijnë në këtë fashë orari me dëshirën e mirë për të sjellë vlerat e artit tonë muzikor.

Programacioni gjatë ditës së shtunë dhe të dielë në kanalin RTSH Muzikë përqëndrohet kryesisht nën tingujt popullore duke mbledhur bashkë të gjithë familjen shqiptare.

Skaletë ditore

07:00-09:00 Rreze

09:00-10:30 Muzikë popullore / folklorike

10:30-12:00 Koncert Recital

12:00-13:00 Muzikë nga vende të ndryshme të botës

13:00-14:00 Dokumentarë muzikore

14:00-15:00 Koncert

15:00-17:00 Muzikë nga vende të ndryshme të botës

17:00-18:00 Koncerte apo Festivale për fëmijë nga vendi dhe bota

18:00-19:00 Festival – RTSH / Sanremo/Eurosong

19:00-20:00 Koncert Recital

20:00-22:00 Spektakël/Festivale/Koncerte me artistë të ndryshëm

22:00-00:00 Partiturë (Muzikë klasike)/ Festivale Jazz

Shënim: Si një kanal me playlistë oraret nuk janë gjithmonë fikse pasi edhe minutazhi i një aktiviteti të caktuar ndryshon.

Muaji janar 2023

Dita e parë e Vitit të Ri na gjeti në transmetim direkt me Koncertit e madh të Filarmonisë së Vjenës i cili prej shumë vitesh është kthyer në një rit të bukur muzikor, duke uruar me nota e tinguj për një vit të gëzueshëm. Menaxhimi për një transmetim dhe koment dinjitoz ishte detyra jonë e pare për vitin 2023.

Pas kësaj ka vijuar puna për koncertet e radhës të Stinës Koncertore 2022-2023 të Orkestrës Sinfonike të RTSH-së dhe Kameratës së kësaj orkestre. Provat, asistimi në regjistrim dhe në studiot e montazhit dhe përcjellja për në transmetim është puna rutinë e stafit tonë.

Disa nga aktivitetet e reregjistruara gjatë muajve të shkuar kanë përfunduar procesin e post produksionit në muajin janar kjo si rrjedhojë e vonesave të postproduksionit të audios I cili vjen nga palët jashtë institucionit tonë.

Më date 10 janar kemi asistuar në regjistrimin e koncertit me Kolonat zanore më të mira të kinemasë botërore “Notte da Oscar”.

Më date 14 janar kemi asistuar në regjistrimin e koncertit të TKOB-së, “Klasikët në Opera”.

Më date 15 janar kemi asistuar ne regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së. Dirigjent Oleg Arapi, solist Georgi Anishenko.

Më datë 21 janar kemi asistuar në regjistrimin e koncertit të TKOB-së , **Një natë ëndrrash” me soliste soprano Ripalta Bufo , mezzo-soprano Vikena Kamenica.**

Më datë 28 janar kemi asistuar në regjistrimin e koncertit të TKOB-së , **“Violonçeli Misterioz”.** **Dirigjent** Adriano Martinolli D’Arcy, dhe violonçelisti Petar Pejčić .

Edhe gjatë muajit janar puna e përditshme ka qenë e përqendruar tek përditshmëria duke përpiluar skaletën ditore, epg-në dhe hapjen e aseteve për aktivitetet muzikore.

Muaji shkurt 2023

Me datë 4 shkurt kemi asistuar në regjistrimin e koncertit të TKOB-së , “Antikiteti Modern” . Orkestra Simfonike TKOB-së, Dirigjent: Marc Moncusi, Koreografë: Enada Hoxha, Gerd Vaso. Solistë lirikë: Shiela Piergli, Matias Xheli

7 deri më 11 shkurt u transmetua drejtpërdrejt ,për 5 net me radhë I Festivali i Këngës italiane - Sanremo 2023. Staf i ynë është përkujdesur për një transmetim me parametra cilësorë si dhe komentim korrekt. Pas kësaj kemi asistuar në studion e postproduksionit duke përgatitur material të grupuara të cilat janë pjesë e programacionit tonë dhe e RTSH 1 HD.

Me date 6 shkurt kemi asistuar në koncertin e OSRTSH-së Dirigjent Aurélien Azan Zielinski, solistë Pierre Fouchenneret dhe Theo Fouchenneret.

Koncertet e Kameratës dhe Orkestrës Sinfoniketë RTSH-së përsëri kanë qenë dhe janë pjesë e axhendës së punës sonë duke theksuar se gjatë këtyre viteve cilësia e tyre është përmirësuar. Kemi parasysh këtu që nga mënyra se si bëhen promot për këto koncerte, audio, regjia televizive, postproduksioni etj. Theksojmë se ka akoma për të bërë në lidhje me vlerat që ka ky asset i institucionit tonë.

Në datën 14 shkurt kemi asistuar në regjistrimin e shfaqjes “ O dolci Baci” .**Orkestra simfonike TKOB-së ,dirigjent Vakhtang Gabidzashvili.Solistët lirikë të TKOB-së dheKonservatorit të Salernos**

Në datën 16 shkurt kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të AKVP-së “ Shqipëria ime”.

Në datën 17 shkurt kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së , dirigjente Deniola Kuraja, solist Olivier Doise.

Në datën 25 shkurt kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e operetës “ Karnavalet e Korçës”.

Në datën 28 shkurt kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit recital të këngëtares Artiola Toska “ Goc’ tirone”.

Edhe gjatë muajit shkurt, puna e përditshme ka qenë e përqendruar tek përditshmëria duke përpiluar skaletën ditore, epg-në dhe hapjen e aseteve për aktivitetet muzikore.

Muaji mars 2023

Gjatë muajit mars kemi asistuar në regjistrimin dhe postproduksionin e koncerteve të Orkestrës Sinfonike të RTSH . Këto koncerte janë tashmë në server dhe të asetuara.

Me datë 1 mars kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSFA-se .Dirigjentë Harlen Nikolli &Elda Laro.Solistë Pascal Gallet (piano),Laura Llozi (violinë)

Me datë 10 mars kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së me Dirigjent Aurelian Azan Zielinski, solist Aurelien Pascal (violonçel).

Me datë 13 mars kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e baletit Muzg me koreografi të Eno Peçit.

Me datë 17 mars kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të AKVP-së “ Shpirti I Labërisë” kushtuar Haxhi Dalipit.

Në datat 29,30 dhe 31 mars kemi asistuar në Festivalin e Këngës për fëmijë Tëinkle Tëinkle Festival edicioni i dytë. Një festival i cili u menaxhua dhe u koordinua gjatë regjistrimit televiziv dhe më pas në postproduksion nga kanali ynë.

Me shumë profesionalizëm jemi kujdesur që gjithçka të ishte në parametra profesionalë.

Programacioni ynë edhe gjatë muajit mars ka qenë i mbushur me materiale të reja të cilat kanë ardhur në gjinitë e ndryshme të artit muzikor. Një vëmendje të madhe ka pasur edhe grup moshë e fëmijëve dhe e të rinjve.

Puna jonë shkon përtej kanalit tonë pasi si pjesë e detyrave tona zë vend edhe bashkëpunimi me kanalin gjeneralist RTSH 1HD duke sugjeruar aktivitetet më të rëndësishme muzikore.

Muaji prill 2023

Edhe gjatë muajit prill ka vijuar puna për koncertet e radhës të Stinës Koncertore 2022-2023 të Orkestrës Sinfonike të RTSH-së dhe Kameratës së kësaj orkestre. Provat, asistimi në regjistrim dhe në studiot e montazhit dhe përcjellja për në transmetim është puna rutinë e stafit tonë.

Disa nga aktivitetet e regjistruara gjatë muajve të shkuar kanë përfunduar procesin e post produksionit në muajin prill kjo si rrjedhojë e vonesave të postproduksionit të audios i cili vjen nga palët jashtë institucionit tonë.

Në datën 2 prill kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së me dirigjent Aurelien Azan Zielinski, solist Aurelien Sabouret (violonçel).

Në datën 4 prill kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të TKOB-së , “Carmina Borana”.

Në datën 7 prill kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së me dirigjent Aurelien Azan Zielinski, solistë Jean Baptiste Haye (harpë), Calogero Palermo (klarinetë).

Në datën 8 prill kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të TKOB-së , Quattro Pezzi Sacri- Giuseppe Verdi.

Në datën 12 prill kemi asistuar në provat dhe regjistrimin baletit “Giselle”, shfaqje e sjellë si produksion i TKOB-së.

Në datën 14 prill kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit recital të Kastriot Tushës me rastin e 60-vjetorit të lindjes së tij.

Në datat 18 dhe 19 prill kemi asistuar dhe regjistruar dy gjysmë finalet e Art Fest , Festivali që zhvillohet për të promovuar talentet e shkollave të mesme të Tiranës.

Më datë 25 prill kemi asistuar në regjistrimin e koncertit përkujtimor për artistin Tonin Guraziu.

Më datë 25 dhe 26 prill kemi asistuar përkatësisht në provat dhe regjistrimin e operës “Samson et Dalila”.

Në datën 28 prill kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së me dirigjent Bujar Llapaj-soliste Irina Zahharenkova (piano).

Ne datën 30 prill kemi asistuar në regjistrimin e koncertit “Na mblodhi Tirona”.

Edhe gjatë muajit prill puna ka qenë e përqendruar tek përditshmëria duke përpiluar skaletën ditore, epg-në dhe hapjen e aseteve për aktivitetet muzikore.

Muaji maj 2023

Në datën 1 maj kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit tribut të kompozitorit Flamur Shehu “ Një jetë nga jeta ime”.

Në datën 4 maj kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit “ Maestro Troket Folk “ të këngëtarit Armaldo Kllogjeri.

Më datë 8 maj kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e natës finale të Aulona Interfolk Festival 2023 zhvilluar në qytetin e Vlorës.

Më datë 9 maj kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e operas solemne “Skënderbeu” (premirë) nga Vasil Tole.

Në datat 9, 11 dhe 13 maj u zhvillua edicioni I 67-të i Eurosong 2023. Stafi ynë është përkujdesur për një transmetim direkt me parametra cilësorë si dhe komentin korrekt të kësaj ngjarjeje. Pas kësaj kemi asistuar në studion e postproduksionit duke përgatitur materiale të grupuara të cilat do të jenë pjesë e programacionit tonë dhe e RTSH 1 HD.

Më datë 15 maj kemi asistuar në prova dhe regjistrim për koncertin “ Albanian Pop Rock-In memoriam”.

Më datë 18 maj kemi asistuar në prova dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së. Dirigjent Daniel Geiss, Solist Alexis Descharmes.

Në datën 28 maj kemi asistuar në regjistrimin e finales së Art Fest , Festivali që zhvillohet për të promovuar talentet e shkollave të mesme të Tiranës.

Në datën 30 maj kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e baletit “ Don Kishoti” produksion i TKOB-së.

Këto koncerte kanë kaluar në post-produksion dhe tashmë janë në server.

Edhe në muajin maj detyrat ditore si skaleta, epg dhe hapja e aseteve ne Etere janë të pranishme tek stafi ynë.

Muaji qershor 2023

Qershori solli shumë aktivitete muzikore në agjendën e kanalit ku gjithçka u menaxhua më së miri nga ne.

Më datë 4 qershor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të TKOB-së “ Anna Pirozzi live në Tiranë”!

Më datë 5 qershor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të TKOB-së me muzikë të krijuar nga Ennio Morricone.

Më datë 7 qershor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të Marsela Çibukaj “ Marsela këndon Faber”.

Më datë 8 qershor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSFA dirigjentë Eno Koço , Harlen Nikolli , L.Qazimi, solistë Frederic Laroque (violinë) Aurelien Sabouret (violonçel).

Më datë 10 qershor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të TKOB-së “ Don’t Cry For me Argentina” .

Më datë 13 qershor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të AKVP-së “ Rituali i jetës”.

Më datë 13 qershor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së dirigjent Doron Salomon, soliste Deborah Nemtanu (violinë).

Me datë 27 qershor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e operas “Aida”, si pjesë e produksionit të TKOB-së.

Më datë 30 qershor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së dirigjent Jetmir Barbullushi, Solist Marin Gjollma (piano).

Nga datat 24 qershor-1 korrik kemi asistuar përgjatë gjithë shfaqjeve të 8 netëve të FFKGJ 2023. Në këtë festival jemi përfshirë prej disa muajsh ku jemi njohur me gjithëka rreth organizimit , shfaqjeve, programit dhe shumë detajeve të cilat ishin shumë domethënëse për një transmetim të saktë dhe profesional. Puna u nda në disa sektorë si në qytetin e Gjirokastrës dhe në Tiranë ku në studiot e montazhit përgatitej çdo gjë për transmetimin e Festivalit.

Po ashtu për këtë ngjarje të madhe të folklorit shqiptar u përgatit edhe një dokumentar muzikor nga stafi I kanalit tonë.

Këto koncerte kanë kaluar në post-produksion dhe tashmë janë në server.

Muaji korrik 2023

Në datat 4, 5 dhe 6 korrik kemi asistuar në provat dhe transmetimin live të Festivalit të 61-të Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë Shkodër. I gjithë festivali është menaxhuar nga stafi ynë përse i përket një transmetimi dhe pasqyrimi profesional në ekranin e RTSH-së. Pas transmetimit live kemi realizuar post - produksionin e Festivalit dhe tashmë ky festival është asetuar në sistemin ETERE.

Më datë 11 korrik, kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së dirigjent Aurelien Azan Zielinski , solist Ermir Abeshi (violinë).

Më datë 19 korrik kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e Festivalit Ndërkombëtar të Valleve FIDAF 2023.

Kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e Festivalit Za Fest në Shkodër në datat 20,21 dhe 22 korrik.

Këto koncerte kanë kaluar në post-produksion dhe tashmë janë në server.

Janë hapur asete të disa koncerteve dhe aktiviteteve muzikore , janë përpiluar me kujdes skaletat ditore dhe epg-në e kanalit RTSH Muzikë.

Muaji gusht 2023

Muaji gusht ka qenë një muaj ku më së shumti kemi evidentuar materialet më të mira të arkivit në server dhe i kemi kaluar në post-produksion.

Gjatë këtij muaji kemi asistuar në procesin e post produksionit për materialet e prapambetura gjate vitit.

Përpilimi çdo ditë i skaletës ditore si dhe i epg-së.

Kemi asistuar në regjistrimin e 2 koncerteve të Festivalit Shkodra Jazz Festival 2023.

Këto koncerte tashmë janë pjesë e arkivës së RTSH-së.

Muaji shtator 2023

Muaji shtator është muaji ku rifillon sezoni artistik i cili na gjeti me angazhime të shumta në stafin tonë.

Në datën 9 shtator kemi qenë të angazhuar me regjistrimin e shfaqjes e ORATORIOS Elias nga Felix Mendelssohn.

Në datën 15 shtator kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së dirigjent Aurélien Azan Zielinski, solist Daniel Vlashi-Lukaçi (violinë).

Në datën 16 shtator kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të Ansambllit të Këngëve te Valleve Popullore “Tumankujja”.(premierë)

Në datën 21 shtator kemi asistuar në provat dhe regjistrimine baletit “UNI”

Në këtë muaj stafi ka qenë pjesë me organizimin dhe koordinimin e punës për Junior Fest Albania 2023. Në datën 22 shtator është finalizuar Junior Fest Albania 2023 ku stafi yne ka qenë prezent me angazhimin për një mbarëvajtje dhe transmetim dinjitoz.

Në datat 28 dhe 29 shtator kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e Festivalit të Rapsodëve “Trojet Tona”, organizuar nga Bashkia Kamëz.

Në datën 29 shtator kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së Dirigjent Aurélien Azan Zielinski, Soliste Anna Kravtchenko (piano)

Gjatë këtij muaji kemi përfunduar edhe procesin e post produktionit të disa koncerteve të regjistruar gjatë verës .

Muaji tetor 2023

Me date 3 tetor kemi asistuar në provat dhe në regjistrimin e koncertit simfonik premierë “Strauss & Tchaikovsky: përtej kufijve të shpirtit njerëzor.

Me datë 13 tetor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së dirigjent Ermir Krantja, Solist Lovro Pogorelich (piano).

Në datat 18 dhe 29 tetor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e 2 prej koncerteve të Festivalit pianistik Pianodrom 2023

Në datat 11, 18, 25 tetor, kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e 3 prej koncerteve në kuadër të projektit “E mërkura në xhaz”.

Në datën 19 tetor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit “Tre Tenorët 2023”

Në datat 25 dhe 26 tetor kemi asistuar përkatësisht në provat dhe regjistrimin e koncertit jubilar në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së kompozitorit Simon Gjoni.

Më datë 31 tetor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e shfaqjes në nder të artistit Besim Zekthi “Legjenda e Valles”.

Gjatë këtij muaji kanë përfunduar proceset e post-produksionit të disa koncerteve dhe tashmë janë bërë gati për transmetim.

Janë hapur asete të disa koncerteve dhe aktiviteteve muzikore , janë përpiluar me kujdes skaletat ditore dhe epg-në e kanalit RTSH Muzikë.

Muaji nëntor 2023

Në datat 1, 8, 16, 22 nëntor, kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e 4 prej koncerteve në kuadër të projektit “E mërkura në xhaz”.

Në datën 2 nëntor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit në TKOB “ In Memoriam”, në nder të kompozitorëve shqiptarë që nuk jetojnë më.

Në datën 7 nëntor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit në TKOB në kuadër të solidarizimit me viktimat dhe sulmet në Izrael “ Stabat Mater”

Në datat 10 dhe 11 nëntor kemi asistuar me stafin në qytetin e Shkodrës për të ndjekur aktivitetin e përvitshëm Festivalin “Luleborë”.

Në datën 16 nëntor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së dirigjente Clara Baget, Solist Eric-Maria Couturier (violonçel).

Në datat 18 dhe 19 nëntor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin përkatësisht të kastit A dhe kastit B të operës Attila si pjesë e produksionit të TKOB-së.

Në datën 23 nëntor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit recital “ Kthehem Prap” të Altin Gocit.

Në datën 25 nëntor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të OSRTSH-së dirigjent Gridi Kraja, soliste Jonela Golemi (flaut).

Në datën 26 nëntor jemi angazhuar për një transmetimin e drejtpërdrejtë të Junior Eurovision Song Contest 2023 i cili u zhvillua në Nicë të Francës.

Në datën 27 nëntor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të TKOB-se “ Simfonia nr 9” nga Ludvig Van Beethoven.

Në datën 29 nëntor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit të TKOB-së titulluar “Tingujt e Lirisë”

Janë hapur asete të disa koncerteve dhe aktiviteteve muzikore, janë përpiluar me kujdes skaletat ditore dhe epg-në e kanalit RTSH Muzikë.

Muaji dhjetor 2023

Muaji dhjetor është pa dyshim muaji ku sezoni artistik i shumë institucioneve por edhe i RTSH-së kulmon me shume aktivitete muzikore me fokus festat e fundvitit.

Me datë 4 dhjetor kemi asistuar në provat dhe regjistrimin e koncertit recital të Rona Nishliut & The Neë Orchestra.

Në datat 7, 13, 16, 17, 26, 27 dhjetor kemi asistuar në provat dhe regjistrimet e festivalit pianistik Pianodrom 2023.

Në datat 10 dhe 11 dhjetor kemi asistuar përkatësisht në provat dhe regjistrimet e operas Carmen duke përfshirë këtu kastin A dhe kastin B.

Në datën 24 dhjetor kemi ndjekur provat dhe kemi asistuar në regjistrimin e shfaqjes së baletit Arrëthyesi në TKOB.

Për ti ardhur në ndihmë programit muzikor PARAFEST një pjesë e stafit tonë është angazhuar për të asistuar në pregatitjen dhe përmbajtjen e këtij programi

Një pjesë e stafit tonë ka qenë pjesë e ekuipit të Festivalit të 62- të duke dhënë asistencë përgjatë muajve nëntor-dhjetor për një mbarëvajtje të këtij aktiviteti të rëndësishëm.

Sipas udhëzimeve të drejtuesve kemi asistuar në postproduksionin e netëve të FEST 62-të, të cilat janë bërë gati për ritransmetimin e tyre në ditët e para të muajit janar 2024

Gjatë këtij muaji kemi përfunduar edhe procesin e post produktionit të disa koncerteve të regjistruara më parë dhe janë bërë gati për transmetim nga kanali RTSH 1 HD.

Përpilimi i programit dhe pasqyrimi i EPG-së ka qenë puna jonë e përditshme.

Shënim: Staf i RTSH Muzikë është i angazhuar për mbarëvajtjen e një programacioni të pasur dhe cilësor, duke garantuar një program korrekt dhe gjithëpërfshirës përsa i përket artit muzikor. Ky kanal nuk është i ndërtuar thjesht si një kanal me transmetim me playlist-ë por ndërkohë menaxhon thuajse të gjitha aktivitetet muzikore që vijnë në forma bashkëprodhimi etj.

Objektivat dhe fokusi

Kanali RTSH Muzikë si një kanal i dedikuar muzikor , i rrjetit të Radio Televizionit Shqiptar, është në përpjekje të vazhduar për t'i ofruar audiencës së gjerë një strukturë programore, me përmbajtje të bazuar në standardet më të larta, duke përcjellë muzikë cilësore, larg ndërhyrjeve jo profesioniste muzikore të cilat në ditët e sotme mund ti cilësojmë si antivlera muzikore.

Nëpërmjet skaletës programore, synojmë të përfshijmë çdo target grup e të edukojmë çdo brez, përmes muzikës shqiptare dhe asaj të huaj, si një formë edukimi por edhe argëtimi.

Përshtatja me tregun është një nga sfidat më të mëdha, e cila duhet realizuar në perspektivë, duke sjellë për publikun produksionet më të mira në vend por dhe ato të huaja në mënyrë që të jemi koherentë me gjithshka ndodh në botën muzikore.

Në fokus për të qenë gjithmonë në përmirësim, kanali RTSH Muzikë është në përpjekje të vazhdueshme për

- Të krijuarbesueshmëri dhe stabilitet tek publiku;
- Të vendosur publikun gjithmonë të parin;
- Të sjellë për publikun formate të larmishme muzikore te realizuara në vend dhe jashtë;
- Të sjellë për publikun më shumë koncerte dhe aktivitete muzikore argëtuese për të gjitha grupmoshat

Gjatë muajve në vijim do të jemi të angazhuar me punën tonë të përditshme por edhe me rregjistrimet televizive të të gjitha aktiviteteve muzikore në vend duke e bërë këtë proces me profesionalizëm.Në punën tonë , përveç funksionit si kanal i dedikuar krejtësisht muzikës kemi treguar gatishmërinë për të ndihmuar dhe kanalet e tjera përsa i përket përzgjedhjes dhe nevojave të tyre në programet muzikore, veçanërisht, RTSH1HD.

RAPORT PUNE PËR VITIN 2023 KANALI RTSH FILM

Kanali RTSH FILM është konceptuar si kanal që i dedikohet tërësisht publikut të apasionuar pas filmit dhe kinemasë së huaj duke synuar për t'u kthyer në dritaren kryesore të kinematografisë.

Duke qenë i vetmi në platformën digjitale, kanal është një kanal gjeneralist filmi ndaj gjithë-përfshirja e zhanreve, metrazheve dhe formave të ndryshme të filmit apo dokumentarëve është e domosdoshme dhe e pashmangshme.

Larmia në gjini, formë dhe përmbajtje e bën këtë kanal që të ketë një target të gjerë audience duke iu afruar kështu jo vetëm të rriturve, por edhe gjithë familjes, të rinjve, adoleshentëve si dhe një publiku specifik dashamirës të filmit, serialit dhe dokumentarit të huaj. Filmi me metrazh të gjatë është në qendër të këtij kanali dhe elementi kryesor në hartimin e programacionit ditor e javor. Transmetimi dhe ritransmetimi i çdo filmi bëhet mbi filozofinë që t'i përshtatet orareve jetësore të audiencës së këtij filmi, dhe që audienca e interesuar për të, të mos e humbasë.

Duke qenë i lidhur ngushtë me kinemanë, një tjetër element i rëndësishëm dhe që nuk mund t'i mungojë këtij kanali është dhe filmi dokumentar, i cili vjen në gjitha gjinitë dhe metrazhet të cilët ndërthuren natyrshëm me programin ditor të kanalit.

Serialet televizivë janë po ashtu pjesë integrale e programacionit ditor të këtij kanali duke përmbushur kështu kërkesat gjithnjë e në rritje të shikuesit për këtë gjini filmike, aq më tepër që prodhimet e fundit, të cilat transmetohen në këtë kanal janë të një cilësie të lartë si në përmbajtje ashtu edhe në realizim. Qëllimi i RTSH FILM është që shumë shpejt të jetë kanali kryesues i afrimit të publikut me kinemanë dhe prodhimtarinë filmike (feature), filmin artistik televiziv, filmin serial artistik, filmin serial televiziv, si edhe të gjitha zhanret e tjera të prodhimit filmik, përfshirë dokumentarin historik, kulturor, hulumtues, shkencor, docufiction etj..

Me anë të programacionit të përcaktuar sipas strukturës programore, RTSH FILM synon qasjen e transmetimeve të veta në përmbushjen gjithëpërfshirëse të shijeve dhe kërkesave të publikut sie edhe rritjen e audiencës, jo vetëm të RTSH FILM, por të gjithë rrjetit të digjitalizuar të RTSH.

Programacioni në RTSH film për periudhën janar – dhjetor 2023

Programi ditor i RTSH FILM dhe RTSH SHQIP konsiston në një playlist-ë të studiuar filmash artistikë, dokumentarësh, serialesh e teatros të cilët shfaqen sipas një fashorare të paracaktuar në strukturën programore të kanaleve.

Filma artistikë në RTSH FILM

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2023, fondit të RTSH FILM i janë shtuar tituj të rinj nga paketa e filmave prodhime të “Ëarner”, dhe nga paketa e RAI-t, filma artistikë televizivë të cilët janë përkthyer dhe janë skeduar në sistemin etere, janë krijuar skedat për secilin prej tyre dhe janë përfshirë në programacionin e kanalit, kryesisht për ditët festive të dhjetorit. Premierat e tyre janë shoqëruar me spote e promovime të dedikuara jo vetëm në transmetim por dhe në rrjetet zyrtare të RTSH-së. Veç kësaj, fondi është pasuruar edhe me seriale të rinj, siç janë serialet e

suksesshëm amerikanë “Një familje e stërmadhe” dhe “Një masa si shoqe” të cilat kanë nisur ritransmetimin në RTSH FILM, pasi u transmetua në RTSH 1.

Në RTSH FILM kemi pasurçdo muaj nga 4 premiera filmash nga paketa e filmave të blerë në 2021 të cilët i kemi skeduluar në mënyrë të tillë në transmetim që të kemi çdo muaj premiera të reja, deri me ardhjen e titujve të rinj nga paketat e reja me të cilat kemi marrë të drejtat e transmetimit.

Premiera në RTSH FILM për periudhën janar - dhjetor 2023

NË MAJË TË GISHTAVE –Njëmbëdhjetë vjeçarja Angela Lerro jeton në Secondigliano dhe ka një ëndërr: të bëhet një kërcimtare klasike. Babai i saj Vincenzo, një Camorrist i lidhur me klanin Peluso, vendos të bashkohet me klanin kundërshtar. Për të shmangur hakmarrjen, e gjithë familja detyrohet të jetojë i fshehur dhe Anxhela nuk mund të ndjekë më shkollën e kërcimit. Megjithatë, Anxhela dhe nëna e saj Nunzia nuk dorëzohen dhe pasi të takojnë mësuesen e kërcimit Lorenza do të bëjnë gjithçka për t'i shpëtuar gjendjes në të cilën jetojnë.

UNË JAM MIA - Një film biografik mbi jetën e Mia Martinit, nga marrëdhënia e saj e trazuar me prindërit, përplasjet me producentët supersticioz dhe seria e të dashuruarve të trazuar që takoi gjatë rrugës. Rrëfimi nis në vitin 1989, nga qyteti i Sanremos, përmes një historie në retrospektivë deri në vitin 1970, ku përfshihen edhe disa episode fëmijërie, Po ashtu rrëfen dhe historinë e trazuar të dashurisë me fotografën milanez Andreamë të cilin mbeti e lidhur për rreth 10 vjet.

DUISBURG - LINJA E GJAKUT- Gjithçka fillon në mbrëmjen e 15 gushtit 2007. Në qytetin e Duisburgut të Gjermanisë, kur gjashtë italianë vriten nga dy vrasës. Të gjashtë janë kalabrezë, shumë të rinj. Masakra ka një ndikim të jashtëzakonshëm mediatik në të gjithë Gjermaninë: një gjë e tillë nuk kishte ndodhur kurrë në atë vend. Në Kalabri, komisar Michele Battaglia (Daniele Liotti) po kalon pushimet me familjen buzë detit. Teksa mëson për masakrën nga lajmet, i vjen një telefonatë nga shefi i policisë të Reggio Calabria-s, i cili e thirret me urgjencë në punë. Battaglia dërgohet menjëherë në Gjermani për të ndihmuar kolegun e tij Thomas Block (Benjamin Sadler) në hetim.

DUNKIRK- Fitues i tre Oskar-ve. Ushtarët aleatë nga Belgjika, Komonuelthi, Perandoria Britanike dhe Franca rrethohen nga ushtria gjermane dhe evakuohen gjatë një beteje të ashpër në Luftën e Dytë Botërore, e njohur si beteja e Dunkirk-ut, ku përshkruhet evakuimi gjatë Luftës së Dytë Botërore nga perspektiva e tokës, detit dhe ajrit me efekte speciale të jashtëzakonshme.

OCEAN'S 8 - Kur një pilot rrëzohet dhe tregon për konfliktin në botën e jashtme, Diana, një luftëtare amazoniane në stërvitje, largohet nga shtëpia për të luftuar në luftë, duke zbuluar fuqitë e saj të plota dhe fatin e vërtetë.

A NUK MË SHEH?- Me Paola Cortellesi dhe Raoul Bova. Serena është një arkitekte jashtëzakonisht e talentuar. Pas një sërë suksesesh profesionale jashtë vendit, vendosi të rikthehet për të punuar në Itali, sepse e do vendin e saj. Në kërkimin aventuresk të një pune, ajo përballet me një zgjedhje të çmendur, të shtiret si ai që të gjithë presin të jetë: një burrë... Ose kështu duket.

PËRBINDËSHAT FANTASTIKË: KRIMET E GRINDELVALDIT - Seria e dytë e sagës së famshme. Gellert Grindelwäld planifikon të ngrejë një ushtri magjistarësh për të sunduar mbi qeniet jo-magjike. I vetmi që mund ta ndalojë atë është Neēt Scamander, i cili merr përsipër të luftojë kundër Grindelwäld-it pa ditur rreziqet me të cilat do të përballet.

GRUAJA E MREKULLIVE - Kur një pilot rrëzohet dhe tregon për konfliktin në botën e jashtme, Diana, një luftëtare amazoniane në stërvitje, largohet nga shtëpia për të luftuar në luftë, duke zbuluar fuqitë e saj të plota dhe fatin e vërtetë.

SNAJPERI AMERIKAN - Film fitues i çmimit Oskar dhe i dhjetëra çmimeve kinematografike. Historia e snajperit të Marinës së Sh.B.A-ve, Chris Kyle, i cili falë saktësisë dhe mjeshtërisë së tij arrin të shpëtojë shumë jetë njerëzish gjatë luftës në Irak. Por, pasi rikthehet në shtëpi nga misionet e kryera, ai nuk arrin të heqë dorë nga tmerret që ka përjetuar, duke rrezikuar kështu të shkatërrojë përfundimisht jetën e tij dhe të familjes së tij.

RIKTHIMI I NJË GRUAJE (4 episode) –Një grua pa kujtesë endet nëpër qendër të Romës. Dy burra që nuk e njohin njëri-tjetrin pretendojnë se janë përkatësisht i biri dhe i shoqi. Por kush janë ata në të vërtetë? Virna Lisi këtë herë merr rolin e Paolës, një gruaje që ka humbur kujtesën dhe është në kërkim të identitetit dhe të shkuarës së saj. Ajo është protagoniste e filmit të ri "Rikthimi i një gruaje", katër episode të prodhuara nga Endemol Italia për Rai Fiction.

Dokumentarët në RTSH FILM

Cikli “Nata Dok”

“Nata Dok” është një takim special me dokumentarin ku të apasionuareve të dokumentarit u ofrohet një përzgjedhje e mirë menduar me prodhime ndërkombëtare nga fusha dhe zhanre të ndryshme si psh. histori, shkencë dhe teknologji, qytetërim, kulturë, biografi, politikë, etj. Ky program promovohet gjatë gjithë javës me një spot të përgjithshëm dhe për çdo titull premierë me promo të dedikuara. Çdo të enjte ora 22:30. I dedikohet një audience 13+.

Tituj të përzgjedhur për “Nata Dok” për vitin 2023

ITALIA, UDHËTIM NË BUKURI – premierë absolute për RTSH FILM. Një cikël dokumentarësh me 10 episode prodhuar nga Rai Cultura. Një eksplorim i vendeve më të bukura të Italisë përmes historisë, artit dhe trashëgimisë kulturore. Çfarë kanë trashëguar nga e shkuara

dhe si po e ruajnë italianët vlerën, traditën dhe bukurinë e vendit të tyre. Ky ciklet është shoqëruar edhe me promon e dedikuar.

LUFTËTARËT E VATERLOSË – Episodi 1 dhe 2 - Ushtria që mundi Napoleonin në Väterlo mbahet mend si një nga forcat më të mëdha patriotike britanike. Një fakt pak i njohur është se shumica e burrave nën komandën e Dukës së Uellingtonit nuk ishin aspak anglezë. Duke përdorur fakte të pabotuara më parë, historia e betejës tregohet nga perspektiva e atyre trupave - Luftëtarët e Väterlosë.

Cikli “PIKTORËT E BOTËS” - Gjatë programit të paradites dokumentarët kanë gjithashtu dhe një tjetër fashëorar të dedikuar, prej orës 10:30 deri 11:30.

Cikli “Klasikët e kinemasë” në RTSH FILM

Një nga ciklet më të veçantë në RTSH FILM është “Klasikët e kinemasë”, një takim i përjavshëm, që e njeh ose e ritakon publikun me filmat, që kanë bërë historinë e kinemasë, filma bardh e zi, filma ëestren, autor dhe klasikë hollivudian, kryesisht të viteve '40, '50, '60 dhe '70.

Tituj premierë në ciklin e klasikëve të kinemasë në RTSH FILM

RRUGËTIMI - Viti: 1971.Një aventurë e shkëlqyer në rrethinat e Australisë. Një rrugëtim mbijetese drejtuar nga një udhërrëfyes aborigjen, i cili duhet të ndahet nga tribuja e tij.

55 DITË NË PEKIN – Viti: 1963. Gjatë rebelimit të 1900-ës, marinsi amerikan, majori Matt Leëis, bashkë me konsullin britanik, Sir Arthur Robertson, organizojnë një plan bllokimi të rebelëve në gji. Ata duhet të jenë vigjilentë derisa të vijnë përforcimet e ushtrive ndërkombëtare.

BLOFI I KUGANIT - Viti: 1968. Ligjvënësi amerikan Ëalt Coogan niset për një udhëtim të shkurtër, i cili shndërrohet më pas në një odise dhune. Plani i tij për të kthyer në të dënuar, komprometohet nga policia e Manhatanit. Këtu fillon një seri përballjesh të ashpra shkaktuar edhe si pasojë e mentalitetit të ndryshëm e kulturave antagonistë të dy vendeve.

NËN VULLKAN – Viti: 1984. Ngjarjet bazohen në librin gjysmë-autobiografik të shkrimtarit anglez Malcolm Loëry. Filmi përmbledh 24 orët e fundit të jetës së Geoffrey Firmin, një alkoolist britanik, ish-konsull në një qytet të vogël meksikan të quajtur Quauhnhuac. Sfondi është Dita e të Vdekurve dhe gjithçka ndodh në vitin 1938.

METROPOLIS – Viti: 1927. Konsideruar si filmi i parë fantastiko-shkencor dhe njëkohësisht kryevepra e regjisorit të njohur gjerman. Në qytetin futurist Metropolis jeton një shoqëri utopike

ku banorët janë ndarë në dy klasa. Të pasurit bëjnë një jetë të lumtur dhe të varfrit jetojnë në nëntokë duke punuar e duke drejtuar makineritë, që mbajnë funksionimin e botës utopike mbi tokë.

MARKEZJA – viti 1997 - Shkëlqimi dhe rënia e një aktoreje të bukur. Ajo vjen nga shtresat e varfra dhe do të ngjitet në shkallët e shoqërisë duke u bërë e preferuara e Mbretit të Diellit, Luigjit të XIV.

SERIALET

Serialet zënë një vend të rëndësishëm në RTSH FILM. Kanë dy fasha orare të dedikuara përgjatë javës dhe në periudhën kohore janar – dhjetor 2023 janë transmetuar premierë në RTSH FILM këto seriale:

PARIS POLICE 1900 – Një serial original tërheqës nga CANAL+ CREATION i cili ofron një përfaqësim modern dhe të ashpër të -jo dhe aq- Belle Epoque të vendosur në rrugët e furishme të Parisit në fillim të shekullit të 20-të.

NJË MAMA SI SHOQE – Fitues i shumë çmimeve dhe një prej serialeve më të suksesshëm amerikanë, vjen premierë në RTSH FILM. Rory dhe Lorelai Gilmore arrijnë ta mbajnë mbërthyer publikun me ngjarje e histori plot të papritura, me ndarje e ribashkime dhe mbi të gjitha me forcën për t'ia dalë mbanë gjithmonë para sfidave më të vështira të jetës.

Në përfundim RTSH FILM ka program ditor të ri në 24 orë 7 ditë të javës. Për vazhdimin e sezonit televiziv Kanali RTSH FILM po përgatitet për transmetimin e serialeve dhe filmave artistikë që i janë shtuar së fundit fondit tonë filmik. RTSH FILM kujdeset që me dorëzimin e materilave, shpërndarjen për përkthim, përgatitjen e skedave për secilin titull, hapjen e asetëve në sistemin Etere Mum si dhe përgatitjen e promote dhe spoteve promovuese televizive për të gjithë platformëm si dhe në rrjetet sociale.

RAPORT PUNE PËR VITIN 2023 KANALI RTSH SHQIP

RTSH SHQIP u krijua për të qenë një kanal ikonë i prodhimit artistik shqiptarë ndër vite duke sjellë 24 orë, çdo ditë, nostalgjinë e kinemasë ndërthurur natyrshëm me prodhimet e reja të kinematografisë shqiptare, shfaqjet teatrale, serialët, dokumentarët dhe telekomeditë - të gjithë këto zhanre, prodhime ose bashkëprodhime të RTSH-së.

Qëllimi i kanalit RTSH SHQIP është jo vetëm të prezantojë prodhimet artistike shqiptare të shtrira në zhanre të ndryshme, por gjithashtu edhe të pasqyrojë realizimet më të fundit, duke e bërë këtë kanal edhe më të pasur në përmbajtje. Fokusi qëndron në synimin e prodhimeve cilësore, duke mbajtur një ekuilibër mes filmit “nostalgji” dhe atij komercial.

Kanali RTSH SHQIP e shtrin skaletën e programacionit të tij në zhanër të ndryshëm, duke mos lënë pa përmendur: rrëfimet biografike, nostalgjinë e pelikulës së vjetër, historinë, dramën familjare të viteve 70’ – 90’, veprat më të realizuara të vëna në skenën e teatrit, komedi ndër vite e shumë të tjera. Të gjitha këto vijnë çdo ditë në kanalin dedikuar prodhimeve artistike shqiptare duke sjellë një larmi tematikash. Transmetimi dhe ri-transmetimi i çdo materiali artistik zhvillohet mbi filozofinë e cila i përshtatet orareve jetësore të audiencës dhe interesit të saj për të mos i humbur.

Programacioni në RTSH SHQIP për periudhën janar – dhjetor 2023

Gjatë këtij viti RTSH SHQIP ka vijuar bashkëpunuar me skenën teatrale shqiptare. Por regjistrimet kanë qenë të pakta. Premierë përgjatë këtyre muajve janë transmetuar vepra të tjera të regjistruara më parë. Janë transmetuar “Vizita e damës plakë dhe Mbreti Lir” dhe “Gjaku i martirëve të kombit” si premiera. Për t’u përmendur vlen dhe bashkëpunimi shumë i rëndësishëm për vitin 2023 me Teatrin Kombëtar në kuadër të festivalit të Teatrit Shqiptar, “MOISIU”, ku RTSH regjistroi 4 nga shfaqjet më të suksesshme të festivalit që janë: “Shtëpia e Zoti”, “Nuse vetëm për letra”, “Shekspiri” dhe “Nyjat”. Të gjitha shfaqjet do përgatiten në post produksion për sezonin e ri televiziv të vitit 2024.

Veç teatrove, një tjetër zhanër që ka pasur disa premiera në RTSH SHQIP janë dhe prodhimet e reja kinematografie shqiptare të cilat vijnë kryesisht si bashkëprodhime me RTSH. Këtu përfshihen seriale të prodhuara nga RTSH apo bashkëprodhime për filma artistikë të cilët vijnë kryesisht të mbështetura edhe nga Qendra e Filmit apo organe të tjera të pavarura.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 janë transmetuar këto evente të përzgjedhura në RTSH SHQIP:

Seriale në RTSH SHQIP

NINA – Çdo të premte, ora 21:00, një serial komik me një kast të zgjedhur aktorësh. Në qendër është personazhi i Ninës, një vajzë beqare në kërkim të partnerit ideal. Në ndihmë për t’ia gjetur janë angazhuar të gjithë miqtë, që kanë edhe problemet e veta.

NJERËZ DHE FATE - Çdo të shtunë ora 21:00 Ritransmetim për nostalgjikët seriali kult, prodhim i RTSH i vitit 2003 me regji nga Ylli Pepo dhe skenar nga Ruzhdi Pulaha. Të papriturat që shkojnë deri në kufijtë e fatkeqësisë brenda një familjeje, shërbejnë si një skaner i gjithë shoqërisë shqiptare. Nga aventurat e rrezikshme dhe të jashtëligjshme të djalit të familjes, zhgënjimit të dy motrave të tij dhe dhimbjen vrasëse të prindërve, ngjarjet tregojnë realitetin e hidhur që fshihet pas fasadës së ndërtuar nga njerëz me pushtet.

MILLENIAM - Çdo të shtunë ora 21:00 Vrasja e një studenteje do të zbulojë shumë intriga dhe pabesi që nga e kaluara e deri në kohën kur zhvillohen ngjarjet. Një dashuri e mohuar nga fuqia e

pushtetit, një baba që pa dashje shkakton drama të parikuperueshme dhe një hakmarrje, që gërryen pak e nga pak shpirtin e vrarë të një burri.

Filma artistikë në RTSH SHQIP

DELEGACIONI – Regjia nga Bujar Alimani - Në vitin 1990, një delegacion evropian vjen në Tiranë për të monitoruar reformat e regjimit komunist. Shefi i delegacionit kërkon të takohet me një mikun e tij të vjetër, Leon, të cilin regjimi e ka dënuar si disident. Një zyrtar i lartë dërgohet me mision në burgun e largët, në mënyrë që të sjellë në kryeqytet të burgosin politik.

NJERKA - Regjia dhe skenari nga Leka Bungo - Ngjarjet zhvillohen në familjen e një prej prokurorëve më të njohur të qytetit. Pasi humbet të shoqen, ai vendos që të bashkëjetojë me avokaten e re, Adelen. Ai nuk e di se e dashura e cila është shumë më e re se ai në moshë, ka qenë në fakt e lidhur më parë me djalin e tij. Filmi nuk sjell vetëm një panoramë të një drame sociale, por edhe pangopësinë e njeriut për pushtet.

SEKS PËRRALLË DHE CELULAR– Me regji e skenar nga Genc Përmeti dhe Erion Kame - Një shkrimtar librash për fëmijë, i cili e ka të pamundur të jetojë në një shoqëri e cila funksionon larg ideve të tij romantike, pëson një amnezi të përkohshme, gjë kjo që e bën të rishikojë marrëdhënien me bashkëshorten dhe partnerët, të cilët e përdorin.

Shfaqjet teatrale premierë në RTSH SHQIP:

"MBRETI LIR" - Mbreti Lir” me regji të Jonida Beqos, është historia e dy familjeve jofunksionale, me dinamika të ndryshme, të cilat shumë prej nesh mund t’i njohin nga afër. Po çfarë e shtyn një mbret të qëndrojë përballë tre vajzave të tij dhe të pyesë se kush e do më shumë?! Çfarë e mirë mund të ndodhë kur Mbreti është i çmendur dhe budallai është i mençur?!

"GJAKU I MARTIRËVE TË KOMBIT" – Teatri me regji nga Ledian Gjeçi dhe bazuar në romanin me të njëjtin titull të shkrimtares Zana Tako, prek temën e martirizimit të kombit shqiptar gjatë diktaturës komuniste, sidomos të klerit katolik, i cili i dha kombit 38 martirë, që me qëndresën në besim dhe gjakun e tyre shkruan historinë e qëndresës shpirtërore gjatë periudhës së errët të diktaturës.

Dokumentarët në RTSH SHQIP

Gjithashtu në RTSH SHQIP prej kohësh ka nisur një takim dedikuar dokumentarit Shqip ku, çdo të martë ora 22:30 publikut i prezantohen dokumentarë profile biografike, historikë, kulturor dhe social. Prodhimet janë kryesisht të Radio Televizionit Shqiptar por edhe bashkëprodhime me emra të njohur të fushës apo shtëpi të mirënjohura prodhimi. Cikli ka zgjatur deri në 4 tetor të vitit 2023 dhe më pas u ndërpre për arsye të ndryshimit të strukturës programore të kanalit.

Disa prej dokumentarëve të transmetuar në këtë cikël janë:

KOHA DHE ARTISTI - Një cikël dokumentarësh që sjell artistë të ndryshëm dhe zhvillimin e tyre hapa pas hapi nga fazat e para të karrierës deri në arritjen e shkëlqimit që gëzojnë në ditët e sotme.

JETË E TRAZUAR - FRANÇESK RADI - Një dokumentar biografik mbi jetën e kantautorit të famshëm Françesk Radi. Udhëtimi i tij artistik dhe vështirësitë për të lënë gjurmë në historinë e muzikës shqiptare. Kujtime dhe mbresa nga miqtë dhe familjarë të tij.

KOHA E PELIKULËS - XHANFIZE KEKO - Dokumentari bëri bashkë emrat e njohur të kinemasë shqiptare për të nderuar regjisoren e njohur ikonë të filmit shqiptar, Xhanfise Keko, në dhjetëvjetorin e ikjes, në një rrëfim të udhës së saj krijuese. I konceptuar si një rrëfim i autores, mbështetur në librin e saj “Ditët e jetës sime” si dhe libri, i shkruar nga aktorët e saj të vegjël, “Teta Xhano”.

60 VJETORI I TEATRIT "PETRO MARKO"- Petro Marko u zhvillua në nëntor të vitit 2022. Një festë që përkoi dhe me restaurimin e teatrit. Shumë të ftuar dhe personalitete e nderuan eventin atë natë që zgjati deri vonë. U kujtuan shumë emra aktorësh regjisorësh, skenografësh e punonjësish që nuk janë më.

PESHKIMI- Dy dokumentarë mbi veprimtarinë e këtij profesioni të lashtë në zonat jugore të Shqipërisë, nga Ervin Lera.

Pas çdo dokumentari dedikuar një figure të shquar të kinematografisë apo skenës shqiptare kemi vendosur në transmetim filmin e atij regjisorit, aktori apo skenaristi.

Emisione:

RTSH SHQIP ende nuk ka një emision të prodhuar nga kanali, por si një kanal dedikuar kinemasë shqiptare, ka nisur që prej nëntorit ritransmetimin e emisionit “**Kur Xhirohej një film**”, një program dedikuar filmit shqiptar.

Çdo takim shoqërohet me një promo të dedikuar për emisionin dhe para çdo emisioni në RTSH SHQIP shfaqet filmi për të cilin do të flitet më pas në emision.

Në RTSH SHQIP programacioni ditor është prej orës 7:00 – 23:55. Gjatë natës ritransmetohen eventet më të mira të programit ditor.

Organizimi i punës të kanaleve RTSH SHQIP, RTSH FILM:

Përveç organizimit të programeve ditore të kanaleve, puna në redaksi ka vijuar sistematikisht me prodhimin e çdo spoti të ri që promovon filmat, serialet, dokumentarët apo teatrot, jo vetëm në RTSH FILM dhe RTSH SHQIP por edhe në kanalin kryesor të platformës RTSH 1 HD.

Gjithashtu është punuar dhe me hapjen e aseteve për çdo material të ri filmik që i është shtuar fondit, duke u arkivuar me skedën përkatëse në sistemin Etere Mum.

Programacioni ditor i të dy kanaleve hartohet në sistemin e transmetimit Etere Schedule ku skedulohen sipas skaletës të gjitha siglat, eventet, spotet promovuese dhe reklamat që përditësohen çdo ditë.

RTSH FILM kujdeset që me dorëzimin e materilave, shpërndarjen për përkthim, përgatitjen e skedave me sinopse dhe të gjithë të dhënat e nevojshme për EPG për secilin titull, hapjen e aseteve në sistemin Etere Mum si dhe përgatitjen e promote dhe spoteve promovuese televizive për të gjithë platformëm si dhe në rrjetet sociale.

Sa i përket programacionit të RTSH FILM në sezonin e ri kemi ruajtur premiera nga paketa e filmave artistikë të kompanisë EarnerBros.

Çdo të hënë premiera i kushtohet filmit evropian independent ose film autor. Kemi në program filma nga kinemaja spanjolle, italiane, franceze e gjermane si dhe filma nga regjisorë me emër.

Në bazë të kontratës me Ambasadën italiane për paketën nga RAI, ku lejohet ritransmetimi brenda 24 orëve nga premiera, do të vijojmë ritransmetimin e filmave të RAI-t pasi transmetohen në RTSH-1 duke i konsideruar si premiera për vetë kanalin e RTSH FILM.

Filmat hollivudianë do të jenë po ashtu pjesë integrale e programit ditor, duke u transmetuar në prime time, si premiera. Janë titujt e paktës më të fundit EARNER për të cilat kemi marrë të drejtat. Janë 50 tituj të rinj të zhanreve të ndryshëm, kryesisht Blockbusters të cilat do shoqërohen me pormot e dedikuara për çdo premierë si dhe promovim në rrjetet sociale dhe ëeb.

Cikli **“Klasikët e kinemasë”** do të vazhdojë çdo të mërkurë në orën 21:00 me 12 tituj krejtësisht premiera, klasikë të viteve '70 – '80-të ku përfshihen jo vetëm emra të mëdhenj regjisorësh e aktorët, por dhe zhanre të ndryshme si ëestren, dramë, histori dhe thriller.

Sa i përket **serialeve**, do të vijojmë me serialin “NJË MAMA SI SHOQE”, si dhe me transmetimin premierë të serialit “DY JETË”. Një nga prodhimet e fundit spanjolle, vlerësuar nga kritika, vjen premierë absolute në RTSH FILM, pasi u transmetua fillimisht në RTSH 1 HD.

Cikli **“Nata Dok”** me sezonin e ri televiziv nuk kemi shumë premiera por do të ritransmetojmë tituj të përzgjedhur të dokumentarëve pjesëmarrës në festivale si BelDocs. Janë tituj autori të zhanrit biografi, social, current affairs si dhe histori.

Fundjava i dedikohet tërësisht familjes dhe filmave aventurë, aksion, komedi, hiteve të kinemave dhe filmave që janë fitues të çmimeve kinematografike.

RTSH FILM transmeton 24 orë në 7 ditë të javës program të ri dhe sipas kapaciteve të fondit filmik synojmë të kemi të paktën 2 premiera në javë duke e afruar publikun me tituj të rinj e të zgjedhur dhe duke plotësuar kërkesat dhe shijet e targetit të cilit i drejtohem.

RTSH FILM kujdeset që me dorëzimin e materilave nga kompanitë e distribucionit, shpërndarjen dhe planifikimin për përkthim, përgatitjen e skedave për secilin titull, hapjen e aseteve në sistemin Etere Mum si dhe përgatitjen e promote dhe spoteve promovuese televizive për të gjithë platformëm si dhe në rrjetet sociale dhe Eëb.

RTSH SHQIP për sezonin e ri televiziv do të ketë premiera të teatrove të xhiruara gjatë sezonit të fundit të shfaqjeve teatrale të cilat kanë qenë në post producion përgjatë muajve të kaluar. Shfaqjet premierë në sezonin e ri priten të jenë: : “Shtëpia e Zoti”, “Nuse vetëm për letra”, “Shekspiri” dhe “Nyjat”.

Pas bashkëpunimeve të suksesshme me skenën teatrale të Tiranës, kemi në program ritransmetimet e shfaqjeve të suksesshme dhe të vlerësuara si dhe premierat të cilat vijnë në prime time, ora 21:00, çdo të mërkurë në një mbrëmje dedikuar terësisht **teatrit shqiptar në ekran**, një traditë e hershme e RTSH-së.

Gjithashtu në programacionin javor do të jenë dhe programi special që kemi çdo fundjavë në prime time programacioni i dedikohet **telekiomedive apo serialeve**.

Gjithashtu një takim në javë do të kemi ciklin “**Nata autor**” ku në prime time do të ketë vepra të zgjedhura të një regjisorit, aktori, kompozitori filmash, skenaristi etj. Emrat që kanë bërë historinë e kinematografisë do të kenë vendin e tyre të veçantë në programacionin javor të RTSH SHQIP.

Fondit filmik të RTSH SHQIP pritet t'i shtohen edhe filma të rinj artistikë të kinematografisë shqiptare të cilat janë bashkëprodhime me Radio Televizionin Shqiptar.

Titujt që i janë shtuar arkivës por priten ti shtohen fondit filmik (ende nuk kanë mbaruar shëtitjen nëpër festivalet e filmave) janë:

Virgjërsha Shqiptare

Love

Derë e hapur (Open Door)

2 Luanë drejt Venecias

Gjirokastra

Sahatçia

RTSH SHQIP kujdeset përgatitjen e skedave për secilin titull, hapjen e aseteve në sistemin Etere Mum si dhe përgatitjen e promoteve dhe spoteve promovuese televizive për të gjithë platformëm si dhe në rrjetet sociale dhe Eëb.

RAPORT PUNE PËR VITIN 2023 KANALI RTSH FËMIJË

Kanali RTSH Fëmijë për vitin 2023 ka pasur këto objektiva;

Objektivat për vitin 2023

1. Fuqizimi i kanalit me programe të prodhuara.
4. Blerja e serialeve dhe filma për fëmijë.

Realizimi I objektivave 2023

Gjatë vitit 2023 kanali i fëmijëve ka pasur këtë veprimtari;

Përpos strukturës bazë të kanalit që janë serialet dhe filmat e animuar kanali ka punuar për disa reportazhe dhe realizimin e një programi të përjavshëm.

Serialet dhe filmat që janë transmetuar gjatë vitit 2023 janë si më poshtë;

1.Seriale

Aventurat argëtuese

Legjenda e Borëbardhës

Breshka Hero

Këlyshët e dinozaruve

Pirati I zi

Kërcimtarët e qiellit

Përbindsha dhe piratë

Libri i natyrës

Dinofroz

Lepurushët diellorë

Kamioni Leo

Bashkë me Rozin

3.Programe për fëmijë

Rreth nesh

Roza dhe Rudi

Të mësojmë me Ogin

Reaksion

Luaj me mua

Çfarë janë sekretet

1.Luaj me mua Sezoni II- një emision nga Bledi Strakosha ku fëmijët nëpërmjet takimeve me profesionistëve marrin përgjigje për pyetje të ndryshme që ata duan të dinë.

2.Autizmi flet - në ditën e autizmit kanali i fëmijëve realizoi një promo të gjatë sensibilizuese me intervista fëmijësh të spektrit autik të cilët shpjegojnë me fjalët e tyre se çfarë është autizmi dhe si duhet të sillemi me fëmijë që kanë nevoja të veçanta.

3.Edukimi për për median dhe informimin - një reportazh në 4 shkollat e Shqipërisë, Tiranë, Durrës, Tiranë për programin EMI, një projekt i UNESCO-s dhe Institutit të Medias për implementimin e metodës së re në shkollat 9 vjeçare.

Objektivat për vitin 2024

Objektivat e kanalit të fëmijëve për 2024 janë;

- 1.Realizimi një programi të përditshëm
- 2.Realizimi i 2 programeve javore
- 3.Blerje e serialeve të ndryshme për fëmijë të grupmoshave 2- 12 vjeç.

RAPORT PUNE PËR VITIN 2023 KANALI RTSH SHKOLLË

RTSH Shkollë është një dritare ku nxënësit nëpërmjet transmetimit të leksioneve të shkollës sipas kurrikulës mësimore përveç bankave të shkollës kanë mundësi që ti ndjekin ato edhe në këtë kanal.

Leksionet e RTSH Shkollë

Klasa I

Abetare, Dituri natyre, Anglisht

Klasa II

Gjuhë shqipe, Edukim për shoqërinë, Matematikë, Dituri natyre

Klasa III

Gjuhë shqipe, Edukim për shoqërinë, Matematikë, Dituri natyre, Anglisht

Klasa IV

Dituri natyre, Gjuhë shqipe, Matematikë, Anglisht, Tik, Qytetari, Histori

Klasa V

Dituri natyre, Gjuhë shqipe, Matematikë, Anglisht, Histori, Qytetari

Klasa VI

Gjuhë shqipe, Matematikë, Histori, Shkencat e natyrës, Qytetari, Anglisht, Gjeografi

Klasa VII

Matematikë, Gjuhë shqipe, Letërsi, Anglisht, Biologji, TIK, Histori, Fizikë, Gjeografi

Klasa VIII

Fizikë, Gjeografi, Kimi, Matematikë, Gjuhë shqipe, Anglisht, Biologji, Histori, Qytetari

Klasa IX

Matematikë, Gjuhë shqipe, Fizikë, Gjeografi, Histori, Kimi, Anglisht, TIK, Qytetari

Klasa X

Matematikë, Gjuhë shqipe, Histori, Gjeografi, Letërsi, Tik

Klasa XI

Filozofi, Gjeografi, Matematikë, Gjuhë, Letërsi

Klasa XII

Gjuhë shqipe, Letërsi, Matematikë, Kimi, Fizikë,

Fashat e orareve të transmetimit

07:00-08:00 Me duar të vogla – program për fëmijë

08:00-11:00 Arsimi fillor

11:00-13:00 Arsimi nëntëvjeçar
13:00-15:30 Arsimi i mesëm
15:30-17:00 Me duar të vogla, Bulza , Klipe muzikore
17:00-22:00 Ritransmetimi i leksioneve premierë, ndarë sipas blloqeve të paradites, cikli fillor, nëntëvjeçar dhe i mesëm.

Gjuha jonë sa e mirë- konkursi i shkollave të mesme (14 episode), një bashkëpunim i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve së bashku me UNICEF dhe RTSH është transmetuar gjatë muajve Prill- Maj

Objektivat për vitin 2024

- 1.Pasurimi me emisione për të rinj me qëllim përfshirjen e tyre sa më të madhe në televizion duke gjetur kështu forma të ndryshme për t’ju afruar audiencës më të re.
- 2.Pasurimi me seriale për adoleshentë me qëllim, krijimin e një një balance midis leksioneve, programeve për të rinj dhe serialeve/argëtimit.

RAPORT PUNE PËR VITIN 2023 KANALI RTSH SATELIT / PLUS

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, kanalet televiziv RTSH Satelit/Plus kanë zhvilluar normalisht procesin e punës duke kryer detyrat e caktuara për secilin punonjës:

Hartimi i programit ditë/javor/mujor, i transmetimit

Plotësimi i guidës elektronike të programeve (EPG)

Zbardhja e programeve të përshtatshme për transmetim nga RTSH Satelit/Plus, nga arkiva dhe serverat e transmetimit

Përshtatja e programeve të reja sipas formatit teknik të vlefshëm për transmetim

Kontrollin e cilësinë së materialit e të figurës, përmbajtjen e tyre në përshtatje me kohën.

Hartimi i programit plotësues në RTSH Satelit, duke zëvendësuar materialet e huaja pa të drejta transmetimi.

Koordinimi me kanalet e tjera të rrjetit RTSH si: RTSH 1, RTSH 2 dhe RTSH Sport nga të cilat transmetojmë herë pas here materiale apo vendosim lidhje direkte për transmetim satelitor, siç janë p.sh.: lajmet, ndeshjet sportive, spektakle të ndryshme etj.

Hartimi i sinopseve të munguara për materialet e marra nga server/arkiva.

Hedhje në përmbledhësen e situacioneve për të gjitha materialet që transmetohen dhe njoftimi për to në sektorin e financës.

Heqjen e reklamave sipas rasteve në brendësi të materialeve që ritransmetohen, proces i kryer në redaksi dhe i përcjellë më tej në sektorët përkatës.

Dërgimi çdo ditë për verifikim të materialeve që programohen për transmetim, në sektorin e Transcoding & Kontrolli i Kualitetit dhe në sektorin e ËEB.

Dërgimi i programeve në sektorin e transmetimit dhe mbajtjen e lidhjeve me to për çdo ndryshim të mundshëm gjatë ditës.

KANALI RTSH PLUS – 1 Janar-15 Tetor 2023

Duke nisur nga fëmijët, RTSH Plus ka transmetuar rregullisht për ta çdo mëngjes një program 30-45 min. Materialet e marra kryesisht nga arkivi, janë filma vizatimorë, koncerte, shfaqje teatrale, apo emisione të tilla si “Me duart e vogla”, “Dadoja e pallatit tonë”, “Performfest”, “Dambaje”, “Mini Mini Shoë” etj. prodhime të RTSH, ku protagonist janë vetë fëmijët.

Për të rinjtë, janë transmetuar emisionet: “Bulza”, “Auditor arsimit”, “Art dhe art”, “Bibliotekë”, “Artes”, “Klubi i të rinjve” etj. ku nëpërmjet intervistave, reportazheve dhe informacioneve të ndryshme, trajtohen tema sociale dhe problematika të përditshme, të shoqëruara me bashkëbisedime e analiza.

Janë transmetuar spektakle si: “Master Chef Junior”, “Gjyshet milionere”, “Çfarë më ofron”, “Sot ofroj unë”, “Historia nis këtu”, “Shih programin” etj.

Por prioriteti i kanalit RTSH Plus nuk kanë qënë vetëm emisionet. Janë transmetuar rregullisht çdo ditë 3 edicione lajmesh nga 10 minuta, një edicion 30 minuta nga lidhja direkte me VOA dhe një edicion lajmesh sportive pas mesnatë.

Janë transmetuar dokumentarë që sjellin në ekran zhvillimin dhe problematikat e ekonomisë në tërësi dhe të turizmit në veçanti, nëpërmjet cikleve “Klik në 7x7”, “Albania guide”, “Albania style”, “Krahina shqiptare” etj.

Janë transmetuar portrete të individëve të ndryshëm e të martirëve të kombit, të familjeve të mëdha, material që përcjellin historinë dhe traditën tonë etj.

Po ashtu, çdo ditë nuk ka munguar reportazhi, spektakli dhe aktiviteti, seriali televiziv dhe filmi artistik. Ndërsa opera, baleti dhe shfaqja teatrale janë dhënë në ditë të caktuara, sikundër për spektaklet e humorit që kanë qënë të rezervuara ditët e fundjavës.

Janë transmetuar cikël emisionesh si: “Udhëve”, “Puna që dua”, “Qyteti i legjendave”, “Qyteti i zemrës”, “Çfarë më ofron”, “Sot ofroj unë”, “Transkulturë”, “Katalog kulturor”, “Individi dhe shoqëria”, “Art&Art”, “Kohe te tjera” etj. Njëkohësisht kemi vijuar me një cikël dokumentarësh e reportazhesh si “Qyteti im”, “Profesione që po humbasin”, “Shqipëria në fokus”, “Udhëtim me fotografinë”, “Tregomë”, “Historia e besimeve fetare” etj.

Struktura programore 1 Janar – 15 Tetor 2023

Nga e hëna në të diel:

09:00 - 9:30 “Na ishte njëherë”, emision ku fëmijët e kopshteve tregojnë vjersha dhe përralla, klasike apo moderne, të shoqëruara nga ilustrimet përkatëse.

09:30 - 10:00 “Gjuha e shpirtit”, një emision i realizuar nga psikologjia Anila Kruti, me skenar dhe regji të Neim Hoxhaj, ku fëmijë të ndryshëm, komunikojnë nëpërmjet talentit dhe aftësive të tyre të veçanta.

11:00 – 12:30 “Sot ofroj unë”, një format unik programi nga Gjergj Leka, me të ftuarit e tij specialë, zbavitje dhe performanca muzikore.

12:30 – 13:30 “Katalog kulturor”, emision televiziv me artistë nga të gjitha gjinitë artistike, të ftuar për bashkëbisedim në studio nga moderatorja Anila Bisha.

Nga e hëna në të premte:

08:20 – 9:00 “Me duart e vogla”, emision për fëmijë që na mëson se si të pikturojmë dhe të krijojmë objekte të ndryshme në kushtet e shtëpisë.

19:30 – “Auditor arsimit”, emisioninë të cilin trajtohen tema të ndryshme mbi arsimin në vend me problematikat e tij, por edhe përcillen informacione të dobishme për të gjithë studentët. Nën drejtimin e Edlira Birko, “Auditor” transmetohet në Rtsh Plus me emisione të sezonit të kaluar, Shtator 2021 – Korrik 2022.

Çdo të hënë:

18:30 – 19:30 “ShëndetSI”, emisioni i përjavshëm kushtuar mirëqenies fizike dhe mendore. Këshilla dhe përvoja jetësore nga të ftuar specialë, si dhe rubrika praktike. Nën drejtimin e Erjona Shehu, emisioni ka nisur transmetimin e tij PREMIERË më 24 shtator 2022 çdo të shtunë në Rtsh1 HD për tu ritransmetuar më pas në Rtsh Plus çdo të hënë ora 18:30.

13:30 – 14:30 “ADN”, Një emision i ri i gazetarit të njohur, Prof. Ilir Yzeirit, që ka në qendër artin, natyrën dhe demokracinë.

Çdo të hënë dhe të martë:

10:00 – 11:00 “Autor”, emisioni që përmes gjurmëve që lanë njerëzit e gjallë, të cilët e bënë Shqipërinë, **na sjell profile, intervista dhe rrëfime me personalitete dhe për personalitete të shquar të letrave dhe botës akademike shqiptare.** “Autor” transmetohet në Rtsh Plus me emisione të sezonit të kaluar, Shtator 2021 – Korrik 2022.

Nga e hëna në të enjte:

19:30 – 20:30 “Art&Art”, Cikël emisionesh kushtuar artit shqiptar, me intervista ekskluzive të piktorëve e artistëve tanë më të mirë, por edhe një interpretim profesional e kritik mbi punimet e tyre.

21:30 – 22:30 “Individi dhe Shoqëria”, problematika të shoqërisë shqiptare në fokusin e trajtimeve sociale.

Çdo të martë dhe të mërkurë:

15:30 – “Në tempull”, emisioni kulturor,dedikuar trashëgimisë kulturore shqiptare dhe personazheve që kanë kontribuar në pasurimin e saj.**Nën drejtimin e intervistave nga Anisa Ymeri**, “Në tempull” transmetohet në Rtsh Plus me emisione të sezonit të kaluar, Shtator 2021 – Korrik 2022.

Çdo të mërkurë, të enjte dhe të premte:

10:00 – 11:00 “Bibliotekë”, emisioni kulturor **kushtuar librit. Bashkëbisedime në studio me autorë e përkthyes. Nën drejtimin e Arta Marku,** “Bibliotekë” transmetohet në Rtsh Plus me emisione të sezonit të kaluar, Shtator 2021 – Korrik 2022.

Çdo të premte:

17:00 – 18:00 “Zëri i popullit”, emisioni i përjavshëm, i cili sjell një vëzhgim të vërtetë mbi përditshmërinë në Shqipëri. I vetmi program televiziv, që nuk do bëjë premtime politikanësh, por do marrë përsipër të thotë vetëm të vërtetën për çdo ngjarje, dukuri, apo personazh.

“Zëri i popullit” transmetohet në Rtsh Plus me emisione të sezonit të kaluar, Shtator 2021 – Korrik 2022.

18:30 – 19:30 “Kohë të tjera”, Emision ku personazhe të njohur diskutojnë në studion televizive rreth temave historike dhe sociale të vendit.

Çdo të shtunë dhe të diel:

10:00 – 11:00 “Transkulturë”, Një emision i ideuar nga Mimoza Ahmeti dhe Rita Petro, që trajton tema të ndryshme në lidhje me kulturën dhe realitetin shqiptar.

18:30 – 19:30 “Fletorja zyrtare”, Emision që na njeh me ligjet e publikuara në fletoren zyrtare.

22:30 – 23:00 “Pa Çensurë”, emisioni i përjavshëm me intervista ekskluzive nga **Elona Meço. Në një botë ku gjithçka po ndryshon me shpejtësi, duhen pyetjet e duhura, për të marrë përgjigjet e duhura. Për të kuptuar, ne duhet të dijmë çfarë po ndodh. Si ndikojnë në jetën tonë vendimet e politikës, të drejtësisë, të pushtetit? Çfarë duhet të besojmë?**

23:00 – 00:00 “Artes”, Emision me gazetaren Elsa Demo dhe regjisoren Sonila Basha, ku me të ftuarit në studio nëpërmjet bashkëbisedimit, debatit, diskutimit dhe analizës, trajtohen tema nga fusha të ndryshme të artit.

RTSH PLUS(DOKUMENTAR)16 Tetor-31 Dhjetor 2023, një kanal i ri që do të pasurojë programet e platformës RTSH, ka për qëllim informimin dhe edukimin e publikut, nëpërmjet zhanrit televiziv dhe artistik të programeve dhe filmave dokumentarë.

Puna e kanalit është e përqendruar në përzgjedhjen e programeve sa më të mira nga vlerësimi i realizimit, përmbajtjes dokumentareske dhe cilësisë teknike të transmetimit.

Për këtë kanal, është shumë e rëndësishme, dhe ijep vlerën e duhur sipas tematikës që ka për detyrim të programacionit të tij, transmetimi i pothuajse të gjithë dokumentarëve pavarësisht kohës kur ata janë realizuar, pasi kthen në vëmendje të publikut, kushtet social – politike dhe ekonomike të kohës kur është realizuar, por edhe zhvillimin kinematografik, televiziv dhe artistik.

Përcjellja e historisë me zë dhe figurë, i lehtëson publikut njohjen dhe mësimin e historisë, ngjarjeve të shënuara, personalitetet dhe figurat e shquara historike, artistike, kulturore, politike dhe të çdo fushe tjetër të historisë dhe përditshmërisë.

Gjithashtu, për tu vlerësuar si duhet, në mënyrë që informacioni ti shkojë publikut edhe përtej së tashmes, nëpërmjet dokumentimit të përpjekjeve për të realizuar qëllimet e të ardhmes, janë të rëndësishme dhe programet dokumentarë me përmbajtje sci-fi, hi-tech etj. të ngjashme.

Nga puna e bërë deri tani, e cila përfshin kryesisht, ndërtimin e bazës së të dhënave me programet, titujt dhe kohëzgjatjen e dokumentarëve të gatshëm për transmetim nga sistemi Etere MAM (Media Asset Management), ka një volum prej rreth 1500 tituj të gatshëm vetëm në Etere MAM. Ndërkohë, e gjithë kjo bazë të dhënash, do të konsultohet edhe me Drejtorinë e Arkivit RTSH, për të përgatitur për transmetim edhe ata tituj që nuk janë të hedhur në Etere MAM.

Nga titujt e evidentuar deri më tani, për programet dokumentar prodhime vendase, janë disa cikle, prodhime të RTSH, të cilët janë të dedikuar për, *historinë e vendit, figura dhe personalitete të shquara kombëtare, familje që kanë lënë shenjë në zhvillimin social-kulturor, politik dhe ekonomik në vend, ngjarje të shënuara nga periudha e regjimit socialist në vend, ngjarje të tjera të rëndësishme të shoqërisë dhe të vendit pas viteve '90, cikle mbi qendrat urbane dhe rurale në vend, atraksionet turistike, arkeologjike, historike dhe natyrore në vend.*

Të gjitha këto do të transmetohen sipas një rendi të paracaktuar (me miratimin tuaj), programor duke u nisur nga përmbajtja, trajtimi tekniko – regjisorial, cilësia teknike e transmetimit dhe parametrat e tjerë që të plotësojnë kushtet e transmetimit të platformave digjitale RTSH.

Titujt e përpunuar deri më tani janë pothuajse të ndarë në volum të njëjtë titujsh mes atyre shqip dhe atyre të huaj (në listën e titujve të huaj, do të shtohen edhe dokumentarët e *Deutche Ëelle*, të cilët janë të ndarë në tre kategori: kujdesi për shëndetin, *“Në formë të mirë”*; zhvillime teknologjike dhe shkencë, *“Nesër Sot”*; dhe industria e automobilit, *“Në Timon”*).

Me përfundimin e përpunimit të bazës së të dhënave me të gjithë titujt e gatshëm dhe të vlefshëm për transmetim në RTSH PLUS(DOKUMENTAR), ndarjen e tyre sipas zhanrit, kohëzgjatjes, kohës/vitit të realizimit, struktura programore e transmetimit të kanalit RTSH DOKUMENTAR, është si më poshtë:

07:00 – 10:00

Dokumentarë me përmbajtje :

Natyrë

Gjeografi

Arkitekturë

Qytetërimi

10:00 – 13:00

Dokumentarë me përmbajtje:

Traditë
Trashëgimi
Arkeologji
Kulinari

13:00 – 16:00

Dokumentarë me përmbajtje:

Agrokulturë
Blegtori
Bota e bimëve
Bota e kafshëve

16:00 – 20:00

Dokumentarë me përmbajtje:

Histori
Profile
Personalitete
Ngjarje të shënuara
Sport
Personalitete dhe figura të spikatura kombëtare dhe ndërkombëtare

20:00 – 00:00

Dokumentarë me përmbajtje:

Ngjarje dhe zhvillime historike (për data të shënuara kombëtare dhe ndërkombëtare programe dokumentar të dedikuar ngjarjes)

Histori arti

Prezantime artistike të ngjarjeve dhe personaliteteve të shënuar

Historia e botës dhe ajo kombëtare

Marrëdhëniet kombëtare me vendet fqinje

Marrëdhëniet ndërkombëtare (zhvillimet e rëndësishme që kanë ndikuar historinë diplomatike ndërkombëtare, si p.sh. traktate, konventa, dhe marrëveshje të tjera të ngjashme të rëndësishme)

00:00 – 02:00

Dokumentarë me përmbajtje:

Kujdesi për shëndetin
Zhvillime teknologjike
Prezantime artistiko-kulturore kombëtare dhe ndërkombëtare
Vepra artistike kombëtare dhe ndërkombëtare

02:00 – 07:00

Ritransmetim të programeve të transmetuar gjatë ditës.

KANALI RTSH SATELIT

RTSH Satelit është kanali kryesor satelitor i rrjetit të RTSH. Ky kanal televiziv transmeton çdo ditë një program televiziv 24 orësh. Prioriteti i tij janë shqiptarët me banim jashtë atdheut. Në fokusin e tij është informimi, edukimi dhe argëtimi.

Programet televizive që transmetohen janë në përgjithësi prodhime të RTSH.

Materialet e huaja mund të transmetohen vetëm me të drejta. Rtsh Satelit bazohet në skaletën ditore të transmetimit të kanalit RTSH 1 ku zëvendësohen materialet televizive të huaja me material shqiptar. Materialet shqiptare që ripërdoren, merren nga serveri i RTSH.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023 janë transmetuar portrete të individëve të ndryshëm, të martirëve të kombit, materiale që përcjellin historinë dhe traditën tonë.

Po ashtu, çdo ditë nuk ka munguar reportazhi dhe filmi artistik. Ndërsa opera, baleti dhe shfaqja teatrale janë dhënë në ditët e caktuara.

Janë transmetuar cikle emisionesh që kemi në përdorim si: “Auditor arsimit”, “NE”, “ADN”, “Fletorja zyrtare”, “Çfarë më ofron”, “Individi dhe shoqëria”, “Sot ofroj unë” etj. Njëkohësisht kemi transmetuar dhe cikle dokumentarësh e reportazhesh si “Dosja gri”, “Qyteti im”, “Profesione që po humbasin”, “Shqipëria në fokus”, “Udhëtim me fotografinë” etj.

Nga fondi që kemi në përdorim janë transmetuar gjithashtu spektakle, humor, telekomedi si edhe koncerte të muzikës së lehtë, simfonike dhe folk.

Janë transmetuar dokumentarë nga Kosova, Maqedonia e Mali i Zi, të cilat na njohin me jetën në trevat shqiptare, por edhe me portrete të martirëve që dhanë jetën për liri e pavarësi.

Janë transmetuar gjithashtu dokumentarë dhe reportazhe nga treva të tjera shqiptare dhe sidomos nga komunitetet shqiptare në emigracion.

Objektivat dhe fokusi

Janar – Dhjetor 2023

E rëndësishme në marrëdhënie me diasporën dhe publikun përtej kufijve, është që të pasqyrohen, identifikohen dhe të tregohen lehtësitë që bashkatdhetarët mund të gjejnë në vendlindje. Një moment shumë i rëndësishëm është edhe mësimi, promovimi dhe zhvillimi i gjuhës amtare të bashkatdhetarëve kudo që jetojnë. Shumë nisma në lidhje me aktivitetin gjuhësor, Brenda komuniteteve janë një mundësi natyrale e promovimit të gjuhës, traditave dhe kulturës mijërvjecare shqiptare. Të gjitha këto duhet dhe mund të kenë hapësirën e vet të dedikuar në rrjetin e digjitalizuar të RTSH nëpërmjet RTSH SATELIT dhe kjo është edhe një avantazh për pasurimin e arkivës së RTSH. Unifikimi i abetares dhe programit bazë arsimor të sistemit parashkollor dhe atij elementar janë ngjarje historike kombëtare, të cilat duhet të zënë vend të rëndësishëm në arkiva, jo vetëm si data por mbi të gjitha si ngjarje të shënuara historike. Nismat dhe politikat qeveritare, pavarësisht orientimit politik, janë një dokument i rëndësishëm social-

kulturor dhe politik në antologjinë e një kombi. Këto moment janë një temë/subjekt me rëndësi historike dhe kombëtare, të cilat kanë nevojën për tu promovuar dhe zhvilluar, dhe media audiovizive është mjeti më i përshtatshëm për këtë.

RAPORT PUNE PËR VITIN 2023 SEKTORI I PËRKTHIMIT

Sektori i përkthimit si një nga sektorët më të përgjegjshëm e të qëndrueshëm ka vijuar punën normalisht për vitin 2023 duke përbushur me korrektesë e përgjegjshmëri detyrat e ngarkuara. Kontributi dhe përvoja e punonjësve në këtë sektor është për t'u konsideruar, duke qenë siguri në rezultatin e tyre.

Janë përkthyer dhe përgatitur për transmetim :

- Filmat : - 100 metri
 - Largohu nga unë
 - Në majë të gishtave
 - Rikthimi i një gruaje – 4 seri
 - Tani e kam radhën unë
 - Dafne
 - Duisburg
 - Astar is born
 - Ocean 8
 - Game night
 - Gruaja e mrekullive
 - Unë jam Mia
 - A nuk më sheh?
 - Meg
 - Nata e lojës
 - Dunkirk
 - Bukuri kolaterale
 - Filmi i Legove
 - Stuhi gjeomagnetike
 - Historia e delfinit 2
 - Nëse më le, nuk është e drejtë
 - Skuadra e gangsterave
 - Zemerboja
 - Fundi i Romanovëve
 - Shefa të tmerrshëm 2
 - Agjentë sekretë

- Modeli i flokëve
- Majku magjik
- Pasojat 3
- Graviteti
- Ngritja e një Perandorie
- The golden compass
- Gruaja e astronautit
- Truproja - Bodyguard
- The notebook
- Njeriu i ujit
- Batman Superman, fillimi i drejtësisë
- Mësuesja
- Hang over
- Dy ligjet
- Diamante gjaku
- Kazablanka
- Njeriu prej celiku
- Maksi i cmendur
- Shpërthimi i virusit
- Mbreti Artur, legjenda e shpatës
- Bishat fantastike
- Zoti i unazave
- Stenli Kubrik
- Shtatë gra
- Border
- Bar Xhuzepe
- Martohu me mua
- Herri Potter dhe guri i magjistarit
- Të gjitha ditët e jetës time

Janë përkthyer, redaktuar e subtitruar dokumentarët :

- Rrethimi im
 - Shpëtimi i Madonës
 - Inkheart
 - Felini i pavdekshëm
- Eshtë redaktuar e titruar Seriali “ Gilmore girls “, 140 seri.
 - Eshtë përkthyer, redaktuar e titruar Seriali “ Fuller house”, Nje shtepi e stermodhe.
 - Intervistë për Fjodora Fjorën (Sanremo 2023),

- Përkthim të intervistave me artistë të ndryshëm për emisionin e pasdites, artistë të ftuar edhe nga orkestra e RTSH-s etj.

NJËSIA E EMISIONEVE TEMATIKE DHE LAJMEVE

Analiza e punës së Njesisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve ndahet në dy sezone televizive: janar – korrik dhe shtator – dhjetor. Ndarja me sezone është jo vetëm si pasojë e ndryshimit të drejtuesve të televizionit dhe vetë njësisë, por edhe si pasojë e emisioneve që ndryshuan nga sezoni i parë në atë të dytin.

Lajmet, emisionet dhe reportazhet në RTSH1-HD gjatë vitit 2023 pasqyruan ngjarjet më të rëndësishme nga vendi, rajoni, bota, kultura dhe sporti duke ofruar saktësi, panashmëri dhe gjithëpërfshirje. Në rastet të vecanta, kur ngjarjet ishin të një rëndësie kombëtare apo ndërkombëtare, transmetimet direkte informatike ndërprejnë edhe programacionin e RTSH1. Emisionet tematike trajtuan temat me interes publik në fushat e politikës, arsimit apo ekonomisë. Edhe reportazhet dhe specialet trajtuan përditshmërinë, historinë, kulturën dhe vecanërisht turizmin.

Kanali **RTSH 24** një televizion informativ, transmeton edicione lajmesh 24 orë në 24 për përçimin e lajmit në mënyrë të shpejtë, të saktë dhe të pavarur përmes transmetimeve direkte të ngjarjeve brenda apo jashtë Shqipërisë dhe thellimin e tyre në studio përmes bisedave, analizave dhe intervistave. RTSH24 gjatë vitit 2023 pati një programacion të larmishëm për shkak të ngjarjeve të shumta që dominuan vitin që lamë pas si zgjedhjet lokale, samitet e rëndësishme, ngjarjet e rëndësishme sportive si eliminatorët e EURO2024, ngjarje këto që u shoqëruan me raportime maratonë të drejtpërdrejta si edhe me të ftuar e biseda të shumta në studio.

Kanali **RTSH Sport** është kanal tematik sportiv që synon të promovojë shumëllojshmërinë e aktiviteteve sportive me rëndësi kombëtare dhe të transmetojë evente sportive kombëtare dhe botërore, duke nisur nga kompeticionet europiane deri te kampionatet botërore, olimpiadat dhe programe të blerë me të gjithë të drejtat nga RTSH. Ky kanal është i fokusuar në realizimin dhe transmetimin e lajmeve sportive ditore, transmetime direkte, emisione të ndryshme informativë, analiza, të ftuar, dokumentarë dhe reportazhe sportive nga vendi dhe bota. Gjatë 2023erdhi me shumë ekskluzivitetedhe transmetime të drejtpërdrejta të ngjarjeve kryesore sportive. Lajmet ishin të larmishme nga të gjitha llojet dhe disiplinat sportive.

Kanali **RTSH Kuvend** i dedikohet zhvillimeve parlamentare në Shqipëri duke transmetuar në lidhje direkte seancat plenare, duke pasqyruar debatet dhe punimet e ndryshme të komisioneve parlamentare

Radio Tirana Internacional transmeton në shtatë gjuhë të huaja: anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, turqisht, greqisht dhe serbisht. Ky kanal synon transmetimin e informacioneve për Shqipërinë për një audiencë dhe publik të huaj përmes emisioneve informative dhe programeve të veçanta. Radio Tirana International ka edhe faqen e internetit ku pasqyrohen lajmet e ditës në 7 gjuhë të ndryshme.

Redaksia e lajmeve në Radio Tirana 1 ka qenë gjatë vitit 2023 ka qenë tepër e ngarkuar në ndjekje të zhvillimeve që përbëjnë interes për dëgjuesit, në vend rajon dhe botë. Volumi i punës dhe angazhimi i stafit kanë qenë edhe më intensive pas miratimit të strukturës së re, ku lajmet dhe flashet informative ishin cdo një orë.

Në vazhdimësi, gjeni ju lutem raportet e detajuara të strukturave të Njësisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve të punuara nga Kryeredaktorët, Redaktorët Përgjegjës të kanaleve dhe Përgjegjësit e Sektorëve.

Lajmet në RTSH1

Informacioni vjen në RTSH në edicionet e lajmeve dhe Revistën televizive, çdo ditë në RTSH 1 përmes gjashtë edicioneve ndërkohë që një kanal i dedikuar, RTSH 24 i kushtohet për gjatë gjithë ditës aktualitetit me lajme, lidhje direkte, të ftuar në studio, analizë dhe ekspertizë për ngjarjet e që ndodhin në vend, rajon dhe botë. Në RTSH1 janë 6 edicione lajmesh në oraret:

Ora 08 00 – 15 minuta lajme

Ora 10 00 – 15 minuta lajme

Ora 13 00 – 15 minuta lajme

Ora 16 00 – 25 minuta lajme

Ora 20 00 – 25 minuta lajme – Revista Televizive

Ora 22 30 – 25 minuta lajme

(Gjatë sezonit të parë të 2023, edicionet e orës 08 00 transmetoheshin vec në fundjavë)

Cdo të hënë edicioni i Lajmeve të fundit është në orën 00 00, ndërsa për shkak të programacionit ka ndryshime minutazhi dhe orari edhe në disa edicione të tjera të Lajmeve përgjatë javës. Të mërkurat e Champions League edicioni i orës 20 00 është vetëm 15 minuta, ndërsa edicioni i orës 22 300 zhvendoset në orën 23 00. Ndërkohë ditën e shtunë lajmet e orës 22 30 janë vetëm 10 minuta, ndërsa të dielën edicioni i orës 16 00 është vetëm 15 minuta. Në edicionet e Lajmeve janë future lidhje direkte ku raportohen ngjarjet më të fundit nga vendi.

Lajmet në RTSH1 janë fokusuar tek publiku, duke nxjerrë në plan të parë qytetarin me problematikat, shqetësimet, por edhe arritjet dhe sukseset e tij. Edicionet e lajmeve janë pasuruar me lajme të larmishme nga të gjitha fushat duke ofruar saktësi, paanshmëri dhe gjithpërfshirje. Janë shtuar kronikat falë edhe minutazhit të reduktuar (90 sekonda maksimumi), lidhjet dhe raportimet e drejtpërdrejta nga terreni, kronikat kanë zëra qytetarësh, zyrtarësh e ekspertësh ndërsa shoqërohen edhe me stand up apo dhe grafika për të qenë sa më të përceptueshëm nga audienca. Raportimet nga rrethet janë pjesë e përditshme e lajmeve ndërsa në edicione nuk mungojnë asnjëherë lajmet nga rajoni, bota, sporti dhe kultura. Lajmet gjatë sezonit veror u dominuan nga promovimi i turizmit dhe numri i lartë i turistëve që vizituan Shqipërinë.

Lajmet në edicionet e Lajmeve në RTSH1 gjatë 2023 u dominuan kryesisht nga ngjarjet e rëndësishme të politikës si zgjedhjet lokale të majit të cilat u mbuluan drejtpërsëdrejti në RTSH24, si edhe protestat e vazhdueshme të opozitës. Ndërkohë edhe përsëritja e zgjedhjeve në bashkitë Rrogozhinë dhe Kukës u transmetuan drejtpërsëdrejt në RTSH24 dhe lidhje direkte pati edhe në edicionet e Lajmeve të RTSH1.

Gjatë vjeshtës kryesimi i Këshillit të Sigurimit nga Shqipëria mori një vëmendje ndërkombëtare pas përplasjes me Rusinë për luftën në Ukrainë. Ky aktivitet për shkak të rëndësisë u transmetua direkt edhe në RTSH1 si edicion i jashtëzakonshëm jashtë edicioneve të Lajmeve (20 shtator 2023).

Po ashtu vëmendje e vecantë iu kushtua edhe samitit të Berlinit që u mbajt në 16 tetor të 2023 në Tiranë, ku për herë të parë liderët e vendeve të BE-së u mbledhën në një vend që nuk është anëtar i Unionit. Nisur nga rëndësia e samitit që ktheu Tiranën në qendër të Europës, deklaratat dhe konferencat përmbyllëse të këtij eventit u transmetuan direkt në RTSH1.

Për herë të parë Tiranën në 2023 e vizitoi një president francez, Macron dhe në këtë rast edhe RTSH1 pasqyroi drejtpërsëdrejti konferencën dhe deklaratat e tij në takimet me krerët e shtetit shqiptar (17 tetor 2023).

Ndërkohë edhe ndeshja Partizani-Roma, në gusht 2023 nisur interesi i lartë, u pasqyrua gjerësisht në valët e RTSH1.

Gjatë vitit 2023 u rrit edhe numri i reportazheve dhe specialeve ku përvec redaksisë së reportazheve, edhe gazetarët e terrenit u angazhuan në përgatitjet e specialeve apo intervistave të gjata me interes publik.

Rajoni dhe bota u pasqyruan gjërësisht në edicionet e lajmeve dhe u shoqëruan edhe me lidhje direkte si në rastin e ngjarjes në Banjskë të Kosovës ku mbeti i vrarë një polici i forcave të Kosovës. Lajmet nga jashtë Tirane janë pjesë e pandarë e edicioneve dhe zënë një vend të rëndësishëm. Gazetarët në rrethe raportojnë në RTSH1 dhe RTSH24 për cdo lajm të fundit dhe zhvillime të rëndësishme.

Rëndësi iu dha edhe gjuhës shqipe duke larguar fjalët e huaja dhe gabimet ortografike por edhe duke promovuar aktivitetet në mbrojtje të drejtshkrimit shqip.

Është rritur bashkëpunimi me faqen e internetit përmes integritit të gazetarëve të online në grupet e shkëmbimit të informacionit, ku gazetarët dërgojnë të dhënat e para të lajmeve por edhe video të shkurtra.

Objektivat për 2024

- Sfida madhore mbetet afrimi i publikut të ri me lajmet duke i bërë ata pjesë të edicioneve
- Prandaj cdo javë pjesë e kronikave do të jenë histori frymëzuese të të rinjve
- Do shtohen zërat e publikut në edicione lajmesh
- Më shumë zëra të specialistëve për të shpjeguar reformat dhe ligjet e reja
- Ruajtja e paanësisë duke i dhënë zë secilës palë
- Ruajtja e besueshmërisë duke u fokusuar tek vërtetësia e lajmit dhe burimet e sigurta

EMISIONET

Gjatë sezonit të parë të vitit 2023 (janar-korrik) Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve realizoi 3 emisione që janë pjesë e strukturës:

Titulli: Rubrika Sportive

Gazetar: Hygerta Sako

Skenografia: Studio RTSH

Kohëzgjatja: 90 minuta

Frekuenca: Çdo të hënë, ora 22:00

Transmetimi: RTSH 1

Pershkrim

Emisioni më jetëgjatë sportiv në Shqipëri. Kronika, intervista, analiza, debate dhe komente mbi Superligën Shqiptare dhe gjithë ngjarjet më të rëndësishme të sportit shqiptar brenda një jave.

Emisioni trajton në brendësi problematikën, jep informacion, por edhe edukon.

Titulli: “Auditor Arsimi”

Gazetar: Edlira Birko

Skenografia: Emisioni u regjistrua ne terren, permes studiove te improvizuara në ambientet arsimore dhe akademike, shkolla dhe universitete, dhe u finalizua ne post – produksion.

Kohezgjatja: 80 Minuta.

Frekuenca: Çdo të shtunë, ora 16:35

Transmetimi: RTSH 1

Pershkrim

“Auditor Arsimi” është programi që i kushtohet të gjithë problematikave të arsimit, për të gjithë ciklet, nga arsimi i ulët tek ai pasuniversitar. “Auditor Arsimi” sjell në ekran zerin e mesuesve, prindërve dhe nxenesve për shqetësimet që lidhen me shkollën, cilësinë e mesimdhënisë dhe gjithçka që rrethon institucionet arsimore, kryesisht ato publike, Shqipëri. Gjate viteve të fundit, arsimi ka qenë një ndër çështjet që ka ngjallur debat të gjatë publik, dhe “Auditor Arsimi” nuk ka mundur të përçellet e tij, përmes debatit dhe pluralizmit të zerave, mesues, pëdagogë, nxenes e studente, si edhe eksperte e aktore që lidhen me berjen e politikave arsimore.

Titulli: Hapesire e Blerte

Gazetar: Marash Mirashi

Skenografia: Emisioni u regjistrua ne terren dhe u finalizua ne post – produksion.

Kohezgjatja: 30 Minuta.

Frekuenca: I përjavshëm

Transmetimi: RTSH 1

Pershkrim

Emisioni i kushtohet kryesisht problematikes se fshatit, bujqesise apo blegtorise, duke sjelle ne ekran shqetesimin e tyre, problematiken e fermerit shqiptar, por edhe promovimin e vlerave. Përçelja e sa me shume traditave lokale dhe promovimi i produkteve bujqesore te fshatrave apo zonave te ndryshme ne vend, synon te zhvendose sa me shume fokusin tek prodhimi dhe jo tek prodhuesit.

Po ashtu u transmetua edhe emisioni që është pjesë e paketës Champions.

Titulli: Studio Champions

Gazetar:

Skenografia: Studio RTSH

Kohezgjatja: 50 minuta

Frekuenca: Emisioni transmetohet ditët e mërkura kur ka Champions League.

Transmetimi: RTSH 1

Pershkrim

Emisioni i zakonshëm që shoqëron UEFA Champions League, kompeticionit më të madh evropian të futbollit për klube, ekskluziviteti i RTSH. Emisioni shtrihet në periudhën prag dhe post ndeshjeve që transmeton RTSH. Gjithçka nis në orën 20.00 ku analizohet dhe diskutohet për gjithë ndeshjet e mbrëmjes, pastaj fokusohet në sfidën e përzgjedhur të transmetohet në RTSH 1. Në drejtimin e gazetares Sabina Mete dhe në prezencën e Kastriot Caushit, Alban Tafaj dhe Arbër Abilalij vjen tek publiku një emision profesional për të mos humbur asgjë nga Champions League. Ndeshja transmetohet duke nisur nga ora 20.55 dhe pas ndeshjes, emisioni Studio Champions rikthehet me analizën për atë që ka ndodhur, jo vetëm në ndeshjen e transmetuar, por edhe në stadiumet e tjerë.

Ndërkohë u realizuan edhe emisionet e aktualitetit përmes projekteve si më poshtë:

Titulli: Publikisht

Gazetar: Blerta Tafani

Skenografia: Studio, RTSH

Kohezgjatja: 90 Minuta

Frekuenca: Çdo të martë dhe të premte

Transmetimi: RTSH 1

Pershkrim

Emisioni “Publikisht”, trajtoi çështjet kryesore të aktualitetit në Shqipëri. Situata politike, me të gjitha detajet e saj të trajtimit, ekonomia dhe ndikimi i saj në jetën sociale, ngjarjet që shënjojnë jetën publike, vendimet e rëndësishme të qeverisë, parlamentit, apo institucioneve të tjera, lajme me ndikim tek njerëzit etj, ishin substance e këtij emisioni. Duke u përpjekur për ruajtjen e balancave politike, informimin nëpërmjet disa burimeve, e duke përfshirë në emision, të gjitha grupet e interesit, për çështje të ndryshme, një alternativë e besuar të mendimit publik në vend.

Titulli: Pa Censurë

Gazetar: Elona Meço

Skenografia: Emisioni rregjistrohet në terren

Kohezgjatja: 30 Minuta

Frekuenca: Çdo të hënë, ora 20:35

Transmetimi: RTSH 1

Përshkrim

Emisioni “Pa Censurë” synon që, përmes intervistave hard talk me personazhe të ndryshëm të informojë dhe të bëjë analizë mbi ngjarje me rëndësi politike dhe të aktualitetit që kanë ndikim direkt në jetën e njerëzve. Me të ftuar që dominojnë jetën politikë dhe me pyetjet e duhura, një bisedë 25-30 minuta, publiku informohet për vendimet që merr qeveria dhe opozita, si janë marrë këto vendime, kujt dhe për çfarë shërbejnë ato. Lufta kundër korrupsionit, integrimi i Shqipërisë në BE, përplasjet brenda opozitës, gjendja ekonomike dhe ndikimi në buxhetet familjare kanë qenë disa nga temat më të diskutuara në emisionin “Pa Censurë”.

Titulli: ADN

Gazetar: Ilir Yzeiri

Skenografia: Studio, RTSH

Kohezgjatja: 90 Minuta

Frekuenca: Çdo të enjte

Transmetimi: RTSH 2

Përshkrim

Në këtë emision të përjavshëm që u shfaq në RTSH 2, RTSH- satelit dhe Radio Tirana 2, 95.8mhz, ditën e enjte në orën 21:00 tregohet aktualiteti shoqëror, kulturor, politik e ambiental në një formë tjetër: me anë të personazheve të spikatur nga bota akademike e artistike në kulturë, shkencë, arsim, politikë, sport etj., brenda e jashtë vendit. Në media mungonte paraqitja e Shqipërisë dinjitoze të cilën e përfaqësojnë sidomos personalitetet më të shquara të të gjitha fushave që gjenden brenda e jashtë vendit në Shkencë, Art, Kulturë, Sport, mungonte ligjërimi ityre. Këta personalitete, tregojnë jo vetëm vitalitetin e shqiptarëve, por japin mendime se si mund të projektohet e ardhmja e demokracisë shqiptare.

Titulli: Ndërtesat e Pushtetit

Gazetar: Nolian Lole

Skenografia: Studio, RTSH

Kohezgjatja: 60 Minuta

Frekuenca: Çdo dy javë, të hënën ora 21:00

Transmetimi: RTSH 1

Përshkrim

Një cikël dokumentarësh edukativë, historikë por edhe me plot kuriozitete mbi ndërtesat kryesore të qytetit dhe shtetit. Historitë e tyre të njohura dhe të panjohura, kush i ndërtoi dhe për çfarë i përdorën? Një ndërthurje mes arkitekturës, historisë dhe filozofisë. Prej më të rinjve e deri te moshat me të vjetra mund t'a ndjekin çdo episod. Shumë prej ndërtesave njihen me funksionet që kanë aktualisht apo me institucionet që mbajnë sot brenda, por pak i njohin për qëllimet që u ndërtuan apo për çfarë shërbyen. Përmes tregimit të historisë së ndërtimit të secilës godinë simbol, që nga ideimi e projektimi, shndërrimi dhe për çfarë shërben sot, sillet edhe historia e zhvillimit në dekada të Tiranës.

Titulli: Dosje të Hapura

Një herë në dy javë në RTSH 1, në orën 21:00

Përshkrim

Sezoni i dytë i ciklit mjaft të ndjekur të dokumentarëve investigative mbi vrasjet pa autor në Shqipëri. Qëllimi nuk është zbulimi i autorëve, kjo nuk është detyrë e gazetarisë, por sjellja për publikun e ngjarjeve të mbuluara nga pluhuri i kohës. Nëpërmjet intervistave me dëshmitarë, profesionistë dhe jo vetëm, sillet para publikut një ngjarje të cilën drejtësia ka dështuar t'a zbardhë. Interesi është i kujtudo të kuptojë në rradhë të parë se çfarë ka ndodhur dhe pistat e mundshme ku është hetuar. Emrat e personazheve të famshëm apo jo, janë pak të rëndësishëm, e përbashkëta është se nuk kanë autor.

Titulli: Autor

Gazetar: Ben Andoni

Skenografia: Emisioni realizohet në shtëpitë e të intervistuarve

Kohezgjatja: 30-45 minuta

Frekuenca: Një herë në dy javë (Dita e Enjte)

Transmetimi: RTSH 1

Pershkrimi

Emisioni “Autor” është në ekranin e RTSH 1 prej pesë vitesh dhe tashmë numëron në galerinë e vet mbi 100 personazhe të fushave të ndryshme. Objekti ka mbetur risjellja në ekranin e operatorit më të madh publik të vendit e personazheve të njohura, veçanërisht me autorësi botimesh, krijimesh, drejtimesh dhe organizimesh, që kanë lënë gjurmë në historinë e Shqipërisë në fusha të ndryshme. Synimi i “Autor” por edhe fasha ku shkon në hulumtimin e vet emisioni ka qenë përcjellja e personazheve shumë të njohura për jetën e vendit, që sot janë në moshën e tretë, e të cilët me kontributin e tyre kanë lënë shenja dhe gjurmë jo thjesht në fushat respektive por edhe me përvojën e tyre. E veçanta është se një pjesë e tyre kanë vazhduar dhe realisht bëjnë punë edhe në moshën e tretë dhe synimi i tyre mbetet që eksperiencën por edhe parametrat e lartë moral-profesionalë t’i përcjellin dhe për brezat më të rinj, apo për kolegët që mbajnë peshat në zhvillimet e sotme të vendit. Për fat të keq, një pjesë e tyre pothuaj as nuk njihen nga brezat e të rinjve të sotëm dhe jo vetëm.

Titulli: Flasim për Ekonominë

Gazetar: Bardhi Sejdarasi

Skenografia: Studio, RTSH

Kohezgjatja: 60 Minuta

Frekuenca: Çdo javë

Transmetimi: Radio Tirana dhe RTSH 2

Përshkrim

Programi “Flasim për ekonominë”, për vitin 2023, ishte një vijim logjik dhe tematik i programit të njëjtë, të zhvilluar në 4 muajt e fundit të vitit 2022. Në fokus janë zhvillimet më të fundit në fushën e ekonomisë, specifikisht lidhur me treguesit më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të vendit. Studiues dhe të ftuar të tjerë, të njohur në të gjitha fushat, që lidhen me ekonominë dhe tregun etj., analizojnë dhe debatojnë lidhur me problematikat e ndryshme që do të trajtohen. Risia e provuar në ciklin e parë të emisioneve, që ka të bëjë me lidhjet e drejtpërdrejta dhe përfshirjen në debat të dëgjuesve të Radio Tiranës, gjithashtu, në emisionet e reja, do të vijojë me lidhje të drejtpërdrejta telefonike, me qytetarë nga rrethet e ndryshme të vendit, sipas specifikimeve të emisionit të rradhës, që do të prezantojnë shqetësimet e tyre apo bëjnë pyetje për ekspertët e ftuar në studio.

Ndërkohë gjatë sezonit të dytë Shtator-Dhjetor, Njësia vijoi me realizimin e 2 emisioneve të strukturës:

Titulli: Rubrika Sportive

Gazetar: Hygerta Sako

Skenografia: Studio RTSH

Kohezgjatja: 90 minuta

Frekuenca: Çdo të hënë, ora 22:00

Emisioni vijoi transmetimi cdo të hënë por në orarin e ri 22: 30.

Titulli: AuditorArsimi

Gazetar:Edlira Birko

Skenografia: Emisioni u regjistrua ne terren, permes studiove te improvizuara në ambientet arsimore dhe akademike, shkolla dhe universitete, dhe u finalizua ne post – produksion.

Kohezgjatja: 80 Minuta.

Frekuenca:Çdo të shtunë, ora 16:35

Transmetimi: RTSH 1

Ndërsa emisioni “Hapësirë e Blertë” nuk u konfirmua nga drejtuesit e televizionit.

Titulli: Studio Champions

Gazetar: Sabina Mete

Skenografia: Studio RTSH

Kohezgjatja: 35 + 35 minuta

Frekuenca: Emisioni transmetohet ditët e mërkura kur ka Champions League.

Transmetimi: RTSH 1

Emisioni ndahet në dy pjesë, para dhe pas ndeshjes.

Ndërkohë projektet që u ri konfirmuan edhe sezonin e dytë shtator-dhjetor 2023 ishin:

Titulli: Pa Censurë

Gazetar: Elona Meço

Skenografia: Emisioni rregjistrohet në terren

Kohezgjatja: 30 Minuta

Frekuenca:Çdo të premte, ora 20:35

Transmetimi: RTSH 1

(Emisioni në sezonin e dytë u transmetua cdo të premte)

Titulli: ADN

Gazetar: Ilir Yzeiri

Skenografia:Studio,RTSH

Kohezgjatja: 90 Minuta

Frekuenca:Çdo të dielë ora 23 00 (ndryshim orari)

Transmetimi: RTSH 1 (ndryshim kanali)

(Emisioni kaloi në RTSH1, në ditën e diel në orën 23 00)

Titulli: Autor

Gazetar: Ben Andoni

Skenografia: Emisioni realizohet në shtëpitë e të intervistuarve
Kohëzgjatja: 30-45 minuta
Frekuenca: Një herë në dy javë (Dita e premte)
Transmetimi: RTSH 1

(Emisioni transmetohet cdo dy të premte në orën 19 00 në RTSH 1)

Ndërkohë në sezonin Shtator-Dhjetor u realizuan dy projekte të reja:

Titulli: Ekspres

Gazetar: Nolian Jole
Skenografia: Studio, RTSH
Kohëzgjatja: 25 Minuta
Frekuenca: Nga e hënë në të premte ora 16 35
Transmetimi: RTSH 1

Përshkrim:

Ekspres, vjen çdo ditë për t'iu përcjellë teleshikuesve një këndvështrim të plotë për të gjitha ngjarjet aktuale të ditës. 25 minuta për të shteruar me argumente, fakte, por edhe me këndvështrime në mënyrë sa më të plotë një moment të rëndësishëm të ditës. Nuk do të mungojnë as lidhjet e drejtpërdrejta në varësi të ngjarjeve konkrete.

Titulli: Bar Tribuna

Gazetar: Ervin Nikolla
Skenografia: Studio, RTSH
Kohëzgjatja: 90 minuta
Frekuenca: Cdo të martë e premte Ora 17 30
Transmetimi: RTSH Sport

Përshkrim:

Ky emision përcjell golat e 5 kampionateve kryesorë të Futbollit në Evropë:
Serie A (Itali)
La Liga (Spanjë)
Premier League (Angli)
Bundesliga (Gjermani)
Ligue 1 (Francë)

Emisioni realizohet brenda një ambienti të ngjashëm me një bar ku mblidhen tifozët dhe diskutojnë për ndeshjet. Tavolina kryesore qëndron përballë një ekrani të madh. Në këtë rast janë tre mikpritës, tre specialistë futbollit të ftuar dhe një specialist gjykimi.

REDAKSIA E LAJMEVE RADIO TIRANA 1

Viti 2023 në Redaksinë e Lajmeve në Radio Tirana ka qenë tepër i ngarkuar në ndjekje të zhvillimeve që përbëjnë interes për dëgjuesit , në vend rajon dhe botë . Volumi i punës dhe angazhimi i stafit kanë qenë edhe më intensive pas miratimit të strukturës së re , ku në fillim të ishëm cdo një orë në transmetim me edicione dhe flash-e informative . Redaksia e radios ka qenë në transmetim nga ora 07.00 deri në orën 00.00 për të përcjellë tek dëgjuesit gjithcka ndodh në kohë reale. Gazetarët kanë kryer lidhje të drejtpërdrejta nga ngjarjet më të rëndësishme dhe redaktorët në redaksi kanë transmetuar për dëgjuesit lajme të reja në cdo flash informativ.

Viti 2023 nisi me një lajm të mirë që ishte vendimi për rritjen e pagave të administratës dhe rritjen e masës së pagës minimale . Më pas vijoi me fushatën zgjedhore dhe procesin e zgjedhjeve vendore . Redaksia e lajmeve e mbuloi këtë proces me transmetim maratonë që në nisje të tij dhe deri në daljen e rezultateve në të gjitha bashkitë e vendit . Gjatë këtij transmetimi u kryen më shumë se 100 lidhje të drejtpërdrejta telefonike me gazetarët në të gjithë vendin .

Zhvillimet e vrullshme brenda tre fraksioneve të Partisë Demokratike janë ndjekur në vazhdimësi nga gazetarët. Një vend të vecante në edicionet zunë sulmet kibernetike të Iranit ndaj Shqipërisë si dhe thirrja e takimit në Këshillin e Sigurimit ku u diskutua për këtë çështje .

Të shumëpritura dhe me shumë interes për dëgjuesin kanë qenë çështjet e ndjekura nga Struktura e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Seancat e politikanëve të lartë Arben Ahmetaj, Lefter Koka e Klodian Zoto për inceneratorët, Fatmir Mediu për Gërdecin , 21 janari si edhe kryebashkiakët Qerim Ismailaj, Fatos Tushe, Lefter Alla , Safet Gjici , Vangjush Dako janë pasqyruar hap pas hapi ne edicionet tona informative . Çështja Cez Dia , ajo e pronave të ushtrisë dhe çështja Partizani ku po hetohet ish kyrministri Sali Berisha dhe dhëndëri i tij Jamambër Malltezi janë ndjekur nga gazetarët e radios seancë pas séance. Po ashtu çështja Beleri që në arrestimin e tij dhe deri te reagimet edhe jashtë vendit janë transmetuar për dëgjuesit në cdo zhvillim të ri që ka patur.

Integrimi i vendit në Bashkimin Europian, të gjitha takimet e zhvilluara brenda dhe jashtë vendit dhe kulmimi i tyre me zhvillimin e Samitit të Berlinit në Tiranë me vizitën e Presidentit Macron janë ndjekur nga gazetarët tanë me lidhje të drejtpërdrejta dhe kronika të dedikuara .

Turizmi shënoi suksesin e tij me 10 milion vizitorë këtë vit dhe në lajmët e radios janë transmetuar cdo shkrim të mediave të huaja që i ishte dedikuar Shqipërisë turistike. Turistja me e vecantë e këtij sezoni ishte kryeministrja italiane Meloni.

Zhvillimet në Kosovë kanë qenë prezente në çdo edicion informative në Radio Tirana që nga vendimi për liberalizimin e vizave, të takimet e njëpasnjëshme të dialogut Kosovë - Serbi dhe deri të sulmi në Banjskë dhe reagimet e shkaktuara pas tij.

Frontet e luftës, viktimat, zhvillimet, tentativat për armëpushime në Izrael- Hamas dhe Rusi Ukrainë janë pasqyruar çdo orë në lajmet e Radio Tiranës.

Një vend të vecantë në edicione kanë zënë kronikat për ndryshimet që kanë ndodhur në Radio Televizionin Shqiptar, programet e reja, marrëveshjet e nënshkruara dhe vizioni për zhvillimin e institucionit janë transmetuar në vazhdimësi në Radio Tirana.

Intervistat *temat* e trajtuara nga gazetarët e radios që kryesisht janë transmetuar gjatë fundjavave kanë patur të bëjnë me problemet shëndetësore, ato të mungesës së fuqisë punëtore, emigracionin punësimin etj.

Të gjitha këto zhvillime janë përmbledhur në fund të vitit në një prodhim mbi 60 minuta dhe janë transmetuar në ditën e fundit të vitit 2023.

Prej 1 shtatorit në radio kanë nisur flashet informative çdo një orë, përveç fashave të përcaktuara të edicioneve të lajmeve (12 00, 15 00, 20 00, 22 00).

Flashet nuk bëhen vetëm kur jepen emisionet:

3D nga Alban Dudushi, “Pa kufij” çdo të enjte në orën 16 30 – 17 30 (emision në bashkëpunim me radion e Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut”).

Kanali RTSH24

Në Kanalin RTSH 24 gjatë vitit që lamë pas, u punua me transmetime live që në nisje të 2023. Protestat e opozitës që shoqëruan vendin deri në zgjedhjet e 14 majit. Deri në zgjedhje sidomos gjatë fushatës u desh të ruhet me kujdes minutazhi i cili u shkel nga kanale të tjera sidomos prej programeve argëtuese që nuk e dinin se llogariteshin në minutazhin e partive kur ftonin kandidatë dhe prandaj RTSH 24 rekuperoi me kohë televizionin të gjitha problemet që pati televizioni. Kjo ndodhi duke përsëritur në disa raste mitingjet elektorale apo duke ftuar në studio eksponentë të partive të ndryshme që kishin mungesa në monitorimin e KQZ. Një incident i fundit u sqarua me AMA-n pasi kishin llogaritur edhe në kronika retrospektive sinkrona të përdorur prej arkivit si fushatë elektorale. Në fund rezultuam të paanshëm në mbulimin e zgjedhjeve. Zgjedhjet në 14 maj u mbuluan dhe transmetuan live për të dytën herë në RTSH 24 duke e lënë të lirë për programacionin RTSH 1. Në studio nga mëngjesi i 14 majit e deri në 17 maj në mbrëmje u këmbyen kryesisht Noljan Lole, Blerta Tafani, Matilda Mcini por edhe Eda Elbasani dhe Arjeta

Cuka paraditet e 15-16 Majit. Kishim lidhje me cdo rreth live me gazetarë ne Terren, megjithëse fillimisht në mëngjesin e 14 majit nuk dihej nëse do dilnim live dhe nga ku sepse ishin të paqarta marrëdhëniet me një firmë telefonike prej kontratës që kishte skaduar. Gjithsesi në fund cdo lidhje u realizua. Nga ana tjetër nuk munguan të ftuarit e larmishëm në studio.

Në pjesën e dytë të vitit u mbuluan zgjedhjet e përsëritura në Kukës dhe Rrogozhinë, por edhe ngjarje si Festivali Folklorik me gazetarë dhe të ftuar në Gjirokastrë.

Ardhja e ekipit të ri drejtues dha një impuls tjetër në mënyrën e realizimit të gjërave por edhe shkrirja e drejtimit mes lajmeve të RTSH 1 dhe punës së RTSH 24 bëri që të kishim më shumë lidhje dhe transmetime direkte në RTSH 24. U shtuan gjithashtu edicionet informative në fundjavë. Nëse deri atëherë kishim dy edicione të shtunave dhe të dielave, pas gushtit gjithcka u barazua, me 4 edicione informative në ditë.

Gjithcka u finalizua me netët e festivalit kur në RTSH 24 për herë të parë pati një transmetim paralel maratonë të dedikuar pa asnjë problem dhe me cilësi. Ndërkohë që nuk kanë munguar transmetimet maratonë për protesta, kongrese, vizita apo ngjarje të atypëratyshme dhe të organizuara pasi ndodhën.

Nata e ndërrimit të viteve shënoi gjithashtu risi pasi kishim transmetim live me studio dhe me sheshet ne Tiranë e rrethe.

Objektivat për 2024

Shtimi i ngarkesës shton edhe nevojën e vazhdueshme që kanali ka për pavarësi, ekonomike, njerëzore dhe infrastrukturore. Duke nisur nga studio fillimisht që duhet liruar sa herë ka nevojë RTSH 1 për lajmet, RTSH 2 për lajmet, gjuha e shenjave, moti, tashmë edhe RTSH Sport me një edicion të shtuar. Programacioni i RTSH24 nuk është i fiksuar pasi gjithcka është në varësi të ngjarjeve të ditës. Këtë vit synojmë që përmes një studio të pavarur lajmesh, ti japi më shumë pavarësi RTSH24 dhe të pasurojmë më shumë transmetimet.

RTSH KUVEND

(Përgatitur nga redaktore Edlira Roqi)

- RTSH Kuvend është kanali që u krijua me kërkesë të Kuvendit të Shqipërisë në bazë të Rezolutës dt.20.06.2020 ku shprehimisht thuhet: “Të sigurohet infrastruktura e nevojshme teknike dhe burimet njerëzore për funksionimin e kanalit të dedikuar RTSH Kuvend, me qëllim transmetimin e plotë të veprimtarisë parlamentare, pasurimin e programacionit me dokumentarë, realizimin e intervistave me deputetë dhe pasqyrimin e aktiviteteve të javës

së gjelbër. Gjithashtu, ritransmetimi i seancave plenare dhe i mbledhjeve të komisioneve parlamentare të realizohet në fashën e orareve që është e përshtatshme për audiencën e synuar. do të ketë në vëmendje veprimtarinë parlamentare, revokimin e momenteve më të rëndësishme me impakt publik të Parlamentit Shqiptar

ndër vite. Transmeton drejtpërdrejt seancat plenare të Kuvendit dhe punën e komisioneve parlamentare”

Qëllimi dhe objektivat e realizuara për RTSH Kuvend në vitin 2023:

*Informimi i publikut për gjithçka ndodh në Kuvendin e Shqipërisë,

*Koordinimi me ekipin e prodhimit për sigurimin e pajisjeve dhe teknologjisë së nevojshme për transmetimet direkte dhe të regjistruara

*Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së transmetimeve dhe prodhimeve të tjera për të siguruar një përvojë të shkëlqyer për audiencën tonë.

*Përzgjedhja dhe redaktimi i materialeve të rëndësishme për të garantuar objektivitetin dhe kualitetin e transmetimeve tona

*Komunikimi dhe bashkëpunimi i ngushtë me Kuvendin dhe institucionet tjera për sigurimin e informacionit të saktë dhe të freskët.
Lidhja me gazetarët dhe korrespondentët e tjerë parlamentarë për takime, intervista dhe raportime të veçanta.

Koordinimi i veprimtarisë së kanalit me departamentet tjera të organizatës dhe ndarja e informacionit relevante për secilin departament.

Mendimi i ekspertëve për të kuptuar më mirë ligjet e miratuara.

Shfrytëzimi i lidhjeve me radiotelevizionet e rajonit dhe më gjerë për mbulim të plotë të veprimtarisë të parlamentarëve shqiptarë në aktivitete të rëndësishme.

Veprimtaria e punës të RTSH Kuvend:

Në të përditshmen e tij, RTSH Kuvend është i angazhuar në kryerjen e detyrave si më poshtë:

- Kontrolli i përditshëm i programit ditor si dhe monitorimi i materialeve të caktuara për transmetim, pasi ka komisione që zhvillohen në të njëjtën orë.
- Koordinimi i punës ditore .
- Bashkëpunimi i përditshëm me Njësinë e Lajmeve

- Mbledhje e përditshme me stafin
- Sigurimi i materialeve për transmetim sipas parametrave të caktuar nga Sektori i Transcoding
- Zbardhje e materialeve sa herë lind nevoja

Menaxhim i aseteve media ETERE

- Përgjegjësesi gjatë transmetimit të seancave parlamentare (drejtpërdrejt) dhe komisioneve parlamentare(drejtpërdrejt)
- Montimi i seancave dhe komisioneve parlamentare dhe i përgatit për ritransmetim
- Përzgjedh fjalimet më të rëndësishme të parlamentarëve dhe montimi me specialistët e gjuhës së shenjave.

Programi nuk mund të bëhet më parë, pasi komisionet vendosen brenda ditës nga Kuvendi dhe ndryshon disa herë si p.sh; Anullim mbledhje komisioni, seance të jashtëzakonshme etj.

Në objektivat tanë , nëse do të kemi personel të mjaftueshëm, do të ishte përgatitja e emisioneve me temat mbi parlamentarizmin, një edicion lajmesh si dhe përmbledhje javore e

*Stafi i Kryetares të Kuvendit, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit dhe Zyra e Shtypit kanë qenë ndihmues në çdo moment dhe kanë monitoruar rigorizisht transmetimet tona.

Zyra e OSBE-së në Tiranë ka qenë e gatshme për ndihmë në trajnime personeli ne TV evropiane.

Gjatë vitit 2023 janë transmetuar:

Seanca plenare: 51 të transmetuara.

Janë transmetuar rreth 1300 komisione live.

Objektivat për 2024

Gjatë 2024 do të përpiqemi të realizojmë transmetimet e emisioneve të dedikuara me intervista nga deputetë e ligjvënës për të shpjeguar më mirë për publikun vendmimarjen e parlamentit.

RADIO TIRANA INTERNACIONAL

Viti 2023 ka qënë një vit i vrullshem përse i përket zhvillimeve në vendin tonë në të gjitha fushat: politike, ekonomike, kulturore dhe sportive.

Te tilla ishin:

-Shqipëria rimerr për herë të dytë Presidencën e Këshillit të Sigurimit në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

-Shqipëria mbajti zgjedhjet vendore në 14 Maj 2023

-NëSamiti i Procesit të Berlinit pati nje pasqyrim maratone nga te gjitha seksionet e gjuheve,

- Hapja e **Kolegjit të Evropës në Tiranë**, kampusi i parë jashtë BE-së.

-Samiti III i Diasporës. U pasqyruan lajme mbi panelet e veçanta te diskutimit si: Diaspora dhe politika e jashtme; Inovacioni dhe Ekselencia; Dinamikat e Turizmit të Shqipërisë; Agroturizmi si instrumenti më i fuqishëm i zhvillimit rural, etj.

Shqipëria përfundoi me sukses procesin screening, duke shënuar një moment historik të rëndësishëm në procesin e integritimit evropian.

U nënshkruan tre marrëveshje të Berlinit për lëvizjen e lirë, dhe tashmë kanë hyrë në fuqi. Gjithashtu, ka hyrë në fuqi edhe marrëveshja për uljen e tarifave të roaming ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.

-Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë;

-Shqipëria doli nga lista gri e pastrimit të parave, në të cilën kishte hyrë në Shkurt të vitit 2020.

-Festivali Folklorik Kombëtar në Gjirokastrë, Edicioni i 10-të u mbajt për 8 ditë rresht dhe gjeti pasqyrim jo vetëm në faqen e Eëb-it por edhe në emisionet radiofonike(lajmet ditore, rubrika Folklori shqiptar dhe Muzika Popullore)

-Komisionit Evropian publikon progres raportin për Shqipërinë

-Shqipëria anëtarësohet në **Bordin Ekzekutiv të UNESCO-s**

-Lumi Vjosa u shpall Park Kombëtar

-Piramida me një dimension të rilindur.

- “**South Outdoor Festival**”, promovon turizmin dhe traditën.

-Shqipëria perfaqesohet ne Eurovision

-Edicioni i dytë i **Javes Kulturore Nderkombetare(JKN)** nisi në Maj -30 Nëntor 2023.

- **Festivali Folklorik Kombëtar,“Kala Festival”,UNUM, Ricky Martin** ne Tirane

- **Tirana,Qyteti European i Sportit** (aktivitetet) -**Atletja shqiptare Luiza Gega** rekord të ri kombëtar në “Semi Marathon” që u mbajt në Lille të Francës.

- **Në turneun ndërkombëtar “Muhamet Malo”**, Shqipëria rrembeu pesë medalje të arta

-**Luiza Gega** siguroi medaljen e artë në Lojërat Evropiane Ekipore që u zhvilluan në Poloni, kampione e Ballkanit dhe fiton të drejtën për të qenë pjesë e Lojërave Olimpikë Paris 2024. Në Serbi, Gega ka fituar garën e 3 mijë metrave me pengesa duke merituar medaljen e artë në Kampionatin Ballkanik.

Shqipëria arriti të kualifikohet në Euro 2024 për herë të dytë në historinë e vendit, pas barazimit 1-1 ndaj Moldavisë në Stadionul Zimbru (Chişinău), takim ky i vlefshëm për grupin E.

Festivali i 62 i Këngës në Radio Televizion u pasqyrua për tre ditë i shoqëruar me informacion për këngët dhe këngëtarët pjesmarres etj..

NE ËEB

Gazetarët/ përkthyes të RTI kanë punuar edhe në faqen e Ëeb-it. Kanë ndjekur zhvillimet ditore dhe i kanë postuar sipas rubrikave përkatëse të secilit seksion të gjuhës, duke mbuluar zhvillimet politike, ekonomike, kulturore, sportive, turizëm, profil dhe nga rajoni. Burimet e informacionit janë rtsh.al, ATSH dhe institucionet shtetërore. Seksioni Anglishtes poston në Ëeb edhe të Shtunë e të Diel.Gjithë Redaksia poston edhe ditët e festave.

Lajmet e postuara kanë qënë korrekte, me burim të konfirmuar dhe më të zgjeruara se lajmet që jepen në audio. Në postimet në Ëeb janë përfshire edhe intervistat e kryera, dhe rubrikat që transmetohen në audio.

Disa nga treguesit kryesorë të punës:

Cilësia e punës- Janë shfaqur aftësi të mira hulumtuese, duke pasqyruar lajme të balancuara dhe etike duke treguar kujdes në krijimin dhe redaktimin e lajmeve si dhe në paraqitjen e burimeve të informacionit.

Lajmet kanë qënë gjithmonë në përputhje me parimet e tij si: lajme te cilat kanë patur ndikim në audiencën e huaj të secilit seksion gjuhe, jo vetëm në Shqipëri por dhe jashtë saj(si p.sh lajme që lidhen me komunitetin Italian që jeton në Shqipëri, me minoritetin serb e grek) lajme në kohë reale të pasqyruara me objektivitet.

Produktiviteti dhe efikasiteti –Janë postuar lajme në kohë reale në faqen e Ëeb-it, duke realizuar detyrat brenda afatit. Seksioni i Anglishtes ka qënë i angazhuar me faqen e Ëeb-it edhe të Shtunave e të Dielave. Janë përdorur burimet e informacionit, mjetet dhe teknologjinë në mënyrë efektive. Në jo pak raste ka patur edhe angazhime intensive si interpret në Radio-Televizion.

Zhvillimi profesional- Janë ndjekur trajnime për ngritjen e aftësive profesionale dhe cilësisë të punës, që garantojnë avancim të mëtejshëm në punë.

Një nga ndryshimet e para vitin e kaluar dhe që rezultoi i suksesshëm, ishte futja e rubrikave te reja si: **Guida Turistike, Folklori Shqiptar, Kulinaria Shqiptare, Shqipëria në 30 minuta, Udhetim nëpër historinë e Shqipërisë dhe Kalendari Ditor Historik.** Ky rikonfigurim i rubrikave solli larmishmëri në programet e RTI.

Teknologjia dhe Inovacioni:

RTI u integrua në rrjetet sociale të RTSH (facebook) për shpërndarjen e produktit ditor dhe promovimin e punës së saj.

Komentet dhe Mirënjohjet:

Ka patur reagime dhe vlerësime nga dëgjuesit tanë tradicional jo vetëm në rrjetet sociale por edhe nëpërmjet e-maileve dhe letrave. Seksioni i Anglishtes ka një rritje të dëgjueshmërisë nga klubet Indiane të dëgjimit, e shprehur kjo në e-maile dhe letra.

Seksioni Gjermanishtes-komunikim i vazhdueshëm me dëgjuesin tradicional (shprehur në dy rubrika javore-Posta e Redaksisë dhe Ju përgjigjemi pyetjeve të dëgjuesëve, paqyryar dhe në faqen e Eeb-it)

RTSH Sport

RTSH Sport është kanali sportiv i paktetës digjitale të transmetuesit publik. Një kanal për të gjithë sportdashësit, që sjell për ta shumëllojshmëri sportesh, nga vendi dhe Bota, me një trajtim të specializuar, me informacione dhe emisione.

RTSH Sport si kanal tematik i platformës digjitale të transmetuesit publik synon të arrijë nivelet më të larta të shërbimit ndaj audiences, për të zbatuar vlerat themelore të shërbimit publik:

- Gjithëpërfshirja – për të arritur të gjithë, kudo.
- Besueshmëria – për të qenë një prodhues lajmesh e programesh i besueshëm.
- Përsosmëria – të veprojnë me integritet dhe profesionalizëm.
- Diversiteti – për të pasur një qasje pluraliste.
- Llogaridhënia - për të dëgjuar audiencën dhe për t'u angazhuar në debat kuptimplotë.
- Inovacioni – për të qenë një forcë lëvizëse për risi dhe krijimtari.
- Paanshmëria –për të ofruar informim objektiv, të plotë dhe të padiferencuar, jashtë çdo ndikimi ideologjik, politik, social, fetar, financiar, kulturor.

Struktura programore e RTSH SPORT është e fokusuar në ngjarjet sportive të drejtpërdrejta dhe për këtë arsye programi ditor pëson ndryshime në varësi të kalendarëve të ndryshëm të ngjarjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shpërndarja e strukturës programore gjatë 2023 ka qenë:

20 % edicionet informative

10% emisionet tematike

25% ngjarjeve të drejtpërdrejta sportive nga vendi

45% ngjarje të drejtpërdrejta sportive nga bota

Gjatë vitit 2023, RTSH Sport jo vetëm ka realizuar emisionet dhe transmetimet e planifikuara, por ka arritur me sukses të zgjerojë gamën e programeve.

Lajmet dhe informacioni

RTSH Sport vazhdon të transmetojë pesë edicione lajmesh sportive në ditë, në një kohëzgjatje 30 minutash dhe duke i shërbyer edhe kanalit RTSH 24. Lajmet përgatiten dhe transmetohen çdo ditë të javës. Edicionet informative sportive përveç aktualitetit kanë ofruar një gjeografi të gjerë mbulimi, duke përdorur edhe rrjetin e korrespondentëve në gjithë Shqipërinë dhe duke sjellë në ekran edhe shumë qytete që gjejnë shumë pak pasqyrim në mediat e tjera, për sa i përket ngjarjeve sportive. Edhe gama e sporteve ka qenë e gjerë, sepse edicionet e lajmeve në RTSH Sport kanë pasqyruar përveç sporteve elitare edhe disiplina të reja sportive. Lajmet e RTSH Sport vazhdojnë të jenë burim informacioni edhe për mediat e tjera, duke qenë se edhe gjatë kësaj periudhe ka patur lajme ekskluzive. Në mungesë të një studioje të sportit, çdo ditë, redaksia e lajmeve të RTSH Sport po përgatit dhe transmeton një edicion lajmesh me spiker në 14.30 për kanal RTSH 24, ku gazetarët jo vetëm përgatisin lajmet, por edhe dalin në transmetim si moderatorë.

Rubrika Sportive

Gjatë vitit 2023 ka qenë në transmetim çdo ditë të hëne në Drejtuar nga Hygerta Sako dhe me praninë e Shkëlqim Muçës, Fatmir Menerit, Elton Marinin, Gerd Haxhiut dhe specialistit të rasteve të diskutueshme Klajdi Kola, emisioni më jetë-gjatë sportiv në ekran mbetet i vetmi që analizon çdo skuadër dhe çdo kronikë me profesionalizëm, duke patur edhe përfaqësues nga të gjitha klubet që mund të kenë herë pas here zërin e tyre në emision. Analiza e Shkëlqim Muçës dhe verdikti i Klajdi Kolës për rastet e diskutueshme në Kategorinë Superiore përdoren gjithmonë edhe si burim për mediat e tjera sportive (portale dhe gazeta), të cilat evidentojnë dhe citojnë si emisionin ashtu edhe kanal televiziv që transmetohet. Rubrika Sportive ka qenë prezente në stadium edhe me lidhje direkte dhe protagonistë pas ndeshjeve të rëndësishme.

Champions League

Gjatë vitit 2023 RTSH Sport ka përgatitur dhe realizuar emisionin “Studio Champions”, është transmetuar finalja e sezonit 2022-23, Superkupës së Evropës 2023 dhe emisionet prag dhe post si edhe revistën javore të Ligës së Kampioneve. Sezoni 2022-23 nisi në shkurt të 2023 dhe përfundoi në qershor, u transmetuan 9 ndeshje deri në finale Po ashtu erdhën të pasqyruara edhe dy ndeshjet e play-offit të Champions League për sezonin 2023-24, edhe këto të shoqëruara me emisione post dhe prag. Gjithashtu data 20 shtator shënoi edhe nisjen e sezonit të ri të ndeshjeve të fazës së grupeve, ku në RTSh u transmetua ndeshja Bajern-Mançester Junajtid. Çdo të shtunë në orën 19.30 në RTSH Sport transmetohet Revista Javore e Champions League e cila përkthehet, redaktohet dhe vihet në transmetim nga redaksia e RTSH Sport, në këtë periudhë janë përgatitur 4 revista javore, të cilat zgjasin 25 minuta secila.

“Bar Tribuna”

Me një takim dy herë në javë, emisioni i dedikuar futbollit evropian vjen në RTSH Sport cdo të martë dhe të mërkurë. Emisioni i së martës, i cili zgjatë 90 minuta është i rezervuar për golat dhe

analizën e sfidave më të rëndësishme të fundjavës futbollistike evropiane. Emisioni i së premtes, i cili zgjat 60 minuta, është i rezervuar për atë që ka rezervuar mesjave, takimet e kupave kombëtare apo ato evropiane, por edhe një analizë të asaj që pritet të ndodhë në fushat evropiane gjatë fundjavës.

Abbisnet Superiore

Gjatë vitit 2023, në periudhën janar-maj, RTSH Sport ka transmetuar dhe prodhuar ndeshje të Kategorisë Superiore të futbollit, pjesë e sezonit 2022-23. Gjatë kësaj periudhe janë transmetuar në total 15 ndeshje, ndër më të mirat e zhvilluar janë pas jave në kampionat, por gjithashtu duke pasur parasysh edhe një shpërndarje të madhe gjeografike të skuadrave të përfshura, për të përmbushur një nga kriteret më të rëndësishme të transmetuesit publik, atë të gjithëpërfshirjes. Ndeshjet janë shoqëruar edhe me lidhje direkte para dhe pas ndeshjes, me intervista por edhe me analizë në studio ose gjatë edicionit të lajmeve.

Kategoria e Parë

Edhe në vitin 2023, Kategoria e Parë e futbollit, ka pasur dritaren e saj të përjavshme të transmetimeve në RTSH Sport. Gjatë periudhës janar-maj 2023 janë transmetuar 13 ndeshje të kësaj kategorie, pjesë e sezonit 2022-2023 futbollistik, deri në finalen për të përcaktuar ekipin kampion. Nuk kanë munguar edhe ndeshjet play-off e play-out për të përcaktuar fatin e skuadrave në këtë nivel të piramidës së futbollit shqiptar.

Kategoria e Dytë

Në vitin 2023 një pasqyrë të gjerë ka gjetur edhe transmetimi i ndeshjeve të Kategorisë së Dytë të futbollit, nivelit të tretë të piramidës së futbollit shqiptar. Gjatë kësaj periudhe janë transmetuar shtatë ndeshje deri në finalen për të përcaktuar kampionen e kësaj kategorie.

Kupa e Shqipërisë në Futboll, U17 dhe U19

Muaji qershor pa në RTSH sport edhe transmetimin e fazëve finale të dy kompeticioneve të organizuara në Shqipëri për futbollin e moshave, finalet e Kupave të Shqipërisë për U17 dhe U19.

Ekipe Kombëtare të Moshave

Gjatë vitit 2023 FSHF ka organizuar në Shqipëri një seri ndeshjesh miqësore për ekipet kombëtare të moshave, U15, U17, U19, U21. Ekipet kombëtare të futbollit U15 dhe U17 kanë zhvilluar 4 miqësore të luajtura me Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën janë zhvilluar në stadiumet “Arena Kombëtare” dhe “Elbasan Arena”. Ekipi U17 ka pasqyruar në RTSH edhe në miqësoret ndaj Italisë, Turqisë dhe Bosnje-Hercegovinës, gjatë muajit shkurt. Ekipi kombëtar U19 ka qenë i përfshirë në ndeshjet e saj kualifikuese për evropian e kategorisë, me takimet e zhvilluara në Shqipëri dhe të gjitha të transmetuar në RTSH Sport. Gjithashtu gjatë Qershorit ka luajtur ndeshjen miqësore edhe ekipi kombëtar U21, në një ndeshje miqësore në “Elbasan Arena”, ndaj Bullgarisë,

ndërsa në shtator ka nisur edhe fushatën e saj të kualifikuese për kamponatin evropian U21 të vitit 2025 me ndeshjen ndaj Malit të Zi, të transmetuar në RTSH Sport.

Kupa e Botës FIFA Femra

Nga 20 korriku deri më 20 gusht në RTSH Sport u transmetuan të 64 ndeshjet e edicionit të nëntë të kampionatit botëror të futbollit të femrave. Një transmetim i gjerë në RTSH Sport, me deri katër ndeshje në ditë, për një total prej 8 orësh duke zënë një pjesë të gjerë të transmetimeve. Të gjitha ndeshjet e këtij kompeticioni u komentuan nga gazetarët e redaksisë.

UEFA Nations League Femra

Muaji shtator shënoi edhe nisjen e edicionit të parë të Ligës së Kombeve të UEFA-s. RTSh ka të drejtën e transmetimit të të gjitha ndeshjeve të Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe kombëtarja luajti 6 ndeshje, Shqipëri-Hungari dhe Irlandë e Veriut-Shqipëri, Irlandë-Shqipëri dhe Shqipëri-Irlandë si edhe Shqipëri-Irlandë e Veriut dhe Hungari-Shqipëri

EURO 2023 U19 Femra

Gjatë vitit 2023 një pasqyrë të gjerë kanë pasur edhe aktivitet e moshave të futbollit të femrave. Në bashkëpunim me FSHF-n janë organizuar në Shqipëri ndeshjet e dy grupeve kualifikuese për evropianin e vitit 2023 dhe 6 ndeshje janë transmetuar gjithashtu ekskluzivisht edhe në RTSH Sport, duke konfirmuar rolin e saj edukues dhe gjithëpërfshirës në transmetimet sportive.

Kampionati evropiane të futbollit U21

Në qershor-korrik UEFA organizoi kampionatin evropian të moshave, U21 për meshkuj. Në RTSH u transmetuan ndeshjem më të mira të fazës së grupeve dhe të gjitha takimet e fazës me eliminim, me një total prej 20 ndeshjesh të transmetuar gjatë këtij aktiviteti.

Kupa e Botës U20

Në Argjentinë u zhvillua edicioni i radhës i Kupës së Botës për 20 vjeçarë. RTSH transmetojë të gjitha ndeshjet e këtij kompeticioni i cili gjatë qershorit zhvilloi fazën finale të tij, me cerekfinalet, gjysmëfinalet dhe me aktin përmbyllës. Ndeshje u transmetuan ekskluzivisht për Shqipërinë në RTSH.

Kupa e Botës U17

Në Indonezi u zhvillua edicioni i radhës i Kupës së Botës për 17 vjeçarë. RTSH transmeto të gjitha ndeshjet e këtij kompeticioni. Ndeshje u transmetuan ekskluzivisht për Shqipërinë në RTSH.

EURO U17, U19

Gjatë vitit 2023 u zhvilluan në periudha të ndryshme edhe kampionatet evropiane të 17 dhe 19 vjeçarëve, si për meshkuj ashtu edhe për femra. Në RTSH këto aktivitet erdhën të pasqyruara me ndeshjet më të rëndësishme të fazës së grupeve dhe më të gjitha takimet e fazës me eliminim, ato gjysmëfinale dhe finale për të shfaqur në RTSh Sport të gjitha emocionet e talenteve të së ardhmes të futbollit evropian.

Kampionati Evropian Futsal U19

Nga 3-10 shtator në Poreç të Kroacisë u zhvillua kampionati evropian i futsalës për 19-vjeçarët. RTSh transmetoi nga 2 ndeshje në ditë nga ky kompeticion, për një total prej 20 orësh.

Futsal EURO 2023 Femra

Gjatë muajit mars u zhvillua faza finale në kampionatit evropian të femrave në futsal. 2 ndeshjet gjysmëfinale dhe finalja u transmetuan ekskluzivisht dhe drejtpërdrejt në RTSH Sport.

Futsal – Kampionati Shqiptar 2023

Në prill u zhvillua dhe u transmetua në RTSH Sport edhe ndeshja finale e edicionit 2023 të kampionatit shqiptar të futsalës me pjesëmarrjen e ekipeve të Tiranës dhe Flamurtarit.

Kampionati Botëror i Çiklizmit

Edicioni inaugurues i kampionateve botërore të çiklizmit. 12 disiplina të ndryshme, për herë të parë të përmbledhura në një aktivitet, njohin kampionet e botës për vitin 2023. Nga 5 deri në 13 gusht një pasqyrim i gjerë, deri në 4 orë në ditë i këtij botërori, një risi në kalendarin sportiv të transmetimeve

Basketboll – Kampionati Kombëtar

Edhe gjatë vitit 2023 vazhdoi bashkëpunimi i RTSH me Federatën Shqiptare të Basketbollit. Gjithcka për këtë vit nisi në muajin janar, me transmetimin e dy finaleve të Kupës së Shqipërisë si për meshkuj ashtu edhe për femra. Më pas, në muajin prill, nisi edhe faza finale e kampionateve të sezonit 2022-23, si për meshkuj ashtu edhe për femra. Nga kjo fazë në RTSH u transmetuan ndeshjet më tërheqëse të fazës gjysmëfinale dhe e gjithë serie e ndeshjeve finale që kulmuan në muajin maj me takime spektakolare dhe emocionuese. Bashkëpunimi vazhdoi në shtator, me nisjen e sezonit të ri 2023-24 të basketbollit, fillimisht me finalët e Kupës së Federatës, të transmetuara në RTSH, si për femra ashtu edhe për meshkuj dhe më pas me ndeshjet e sezonit të rregullt të kampionateve deri në mesin e muajit dhjetor.

Basketboll-Kombëtarja

Viti 2023 pa në RTSH edhe pasqyrimin e ndeshjeve të ekipit kombëtar të basketbollit, i angazhuar gjatë kësaj periudhe në ndeshjet kualifikuese për kampionatin evropian të vitit 2025. Ishin tre

ndeshje të luajtura nga Shqipëria në këtë periudhë, ato ndaj Turqisë, Rumanisë dhe Sllovakisë, të gjitha të transmetuara në RTSH Sport.

Volejbolli

Kupa e Federatës, Kupa e Shqipërisë, Kampionati Kombëtar, Kupat Evropiane dhe Liga “Gjergj Kastrioti”, në volejbolli, femra dhe meshkuj, gjatë gjetur një pasqyrim të gjerë në ekranin e RTSH, si për sezonin 2022-23, me fazën finale të këtyre kompeticioneve, por edhe me një angazhim më të madh gjatë sezonin 2023-24, ku në RTSH Sport janë transmetuar edhe deri në katër ndeshje në javë volejbolli.

FIFA The Best 2022

Në muajin shkurt u zhvillua në Londër edhe edicioni 2022 i çmimeve të organizuara ngë FIFA, për të vlerësuar më të mirët e një viti futbollistik, si në futbollin e meshkujve ashtu edhe në atë të femrave. Lojtarët, trajnerët dhe formacioni më i mirë i një viti më parë u zhvilluan në një mbrëmje gala e cila erdhi drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht edhe në RTSH Sport.

Albanian Open- Aereonautikë

Edicioni 2023 i Albanian Open në Aereonautikë u zhvillua edhe këtë vit në bregdetin e Vlorës nga 11 deri më 13 maj dhe me një transmetim maratonë, deri në 5 orë për ditë, erdhi ekskluzivisht edhe në RTSH Sport.

Turneu "Muhamet Malo"

Muaji maj solli në RTSH edhe aktivitetin e përvitshëm të sportit të mundjes, të lirë dhe greko-romake, Turneun ‘Muhamet Malo’. Një turne ndërkombëtar i mundjes për të rinj dhe të rritur i cili u pasqyrua me një transmetim maratonë edhe në ekranin e RTSH Sport.

Triathlon

Aktiviteti “Tiranathlon” i sportit të triathlonit, ku përfshihen noti, çiklizmi dhe atletika, u transmetua në RTSH Sport me një transmetim maratonë, ku një pjesë e rëndësishme të tij ishin edhe intervistat para dhe pas garës.

Lojërat Evropiane 2023

Në Korrik u zhvillua në Poloni dhe u transmetuan ekskluzivisht për Shqipërinë në RTSH, edicioni i tretë i lojërave evropiane. I organizuar si një mini-olimpiadë me vetëm shtetet e kontinentit evropian, ngjarja është pasqyruar në RTSH Sport me një transmetim prej 6 orësh në ditë, për 13 ditë me rradhë, duke dhënë drejtpërdrejt edhe emocionet e medaljeve të arta të fituara nga delegacioni shqiptar.

Kampionati Evropian Universitar i Futbollit

RTSH gjatë muajit qershor ishte edhe partner mediatik i zhvillimit në Shqipëri të Kampionatit Evropian Universitar të Futbollit, për meshkuj e femra. Për më shumë se një javë, ndeshjet e këtij kompeticioni u transmetuan përditë në RTSH Sport, së bashku me ceremonitë e hapjes dhe mbylljes së kësaj ngjarje.

Ciklizëm-Xhiro e Shqipërisë

Pesë etapat e garës më të rëndësishme të çiklizmit në Shqipëri erdhën të pasqyruara edhe në RTSH Sport me një përmbledhje të përditshme prej 30 minutash të fazave më të rëndësishme të cdo etape.

Çiklizëm

Kampionati Botëror i Çiklizmit u transmetua gjatë muajit gusht në RTSH Sport. Për herë të parë, disiplina të ndryshme të çiklizmit ishin të përmbledhura në një botëror 14 ditor, ku u pasqyruan garat e çiklizmit në pistë, çiklizmit në rrugë dhe garat e mountain-bike.

Kampionati Botëror i Sporteve Ujore

Gjatë muajit Korrik, në Japoni, u zhvillua edicioni i plotë i sporteve ujore. Hedhje nga trampolina, not artistik, vaterpolo dhe sigurisht garat e notit gjetën hapësirën e tyre në RTSH Sport. Nga 14 deri më 31 korrik, deri në 4 orë transmetim në ditë me garat e këtij botërori u pasqyruan në RTSH Sport me komentën e gazetarëve të redaksisë.

Lojërat Mesdhetare të Plazhit

Nga 9 deri më 16 shtator në Heraklion të Greqisë u zhvillua edicioni i tretë i lojërave mesdhetare të plazhit, ku RTSH Sport transmetojë të paktën dy orë në ditë nga kjo ngjarje sportive.

Turneu Ndërkombëtar i Boksit dhe Kikboksit

RTSH Sport gjatë muajit Gusht ka transmetuar turneun ndërkombëtar i Boksit dhe Kikboksit “Nata e Kampionëve”. Përafërsisht 1 orë transmetim me ndeshje në boks olimpik dhe atë profesionist.

Automotive Fair Albania

Nga 26-29 tetor në Tiranë u zhvillua edicioni i dytë i panairit të makinave. Një aktivitet i menduar për të promovuar zhvillimin e sporteve automobilistike në Shqipëri dhe ku u zhvilluan një serë garash në rrugët e Tiranës. Aktivitet ky që u pasqyrua edhe në RTSH me një transmetim deri në 4 orë në ditë.

Bilardo / Laçi Open

Federata Shqiptare Bilardos & Snookerit organizuan "STEKA E ARTË 2023", Laçi Open. Eventu do të zhvillohet në stadiumin portativ 1000 vendesh, i instaluar në Qendër, pranë Pallatit të Kulturës, Laç. Ngjarje e cila u transmetua në RTSH me një mbulim prej 6 orësh.

KOKSH / Më të mirët 2023

Në muajin dhjetor u transmetua në RTSH Sport edhe mbrëmja Gala e ndarës së çmimeve të mrë të mirëve të vitit në të gjitha sportet organizuar nga Komiteti Olimpik Shqiptar. Me një transmetim prej 2 orësh, më të mirët e vendit morën vlerësimin e tyre

Formula 1

22 Gara nga marsi në nëntor, të shoqëruar me kualifikueset por edhe me gjatë gara sprint, ishin pjesë e sezonit 2023 të Formula 1, të gjitha këto të transmetuara në RTSH për një total që i kalon të 80 orët mbulim në ekranin e RTSH 1 dhe RTSH Sport.

Përmbledhjet e kampionateve Evropiane

Në muajin shtator në RTSH ka nisur transmetimi i përmbledhjeve të gjashtë kampionateve më të rëndësishme të kontinentit evropian. Një mbulim prej 6 orësh në javë, me një takim të përjavshëm, kanë sjellë në RTSH Sport të gjitha emocionet e futbollit të rëndësishëm.

Radio Tirana

Në Radio Tirana, RTSH Sport organizon dhe transmeton dy emisione të përjavshme sportive që kanë vijuar transmetimin edhe në tre mujorin e fundit.

Emisioni “Nga njëra ndeshje në tjetrën” që transmeton emocionet e golave në Kategorinë Superiore dhe të Parë të futbollit ka qënë në transmetim 4 herë gjatë kësaj periudhe në një fashë orari prej 3 orësh. Mbetet emisioni i vetëm sportiv në tregun mediatik që jep golat në kohë reale dhe është nga emisionet më të ndjekura. I vetmi ndryshim është që emisioni “Nga njëra ndeshje në tjetrën”, duke qënë se shpërndahej në disa ditë, e kemi kaluar për transmetim në Radio Tirana 2.

RTSH Sport/Ëeb

Gjatë kësaj periudhe, edhe ËebFaqe e internetit e RTSH Sport ka qënë e plotë dhe me informacione në kohë reale. Gjithë transmetimet dhe emisionet e RTSH Sport, gjithmonë pasqyrohen edhe në faqen tonë elektronike nëpërmjet informacioneve. Redaktori i faqes është në punë ndërkohë kur prodhojmë emisionet sportive, duke qënë burimi i parë i lajmit. Nuk mungojnë edhe lajmet ekskluzive në faqen e internetit të RTSH Sport, të cilat hidhen në kohë reale edhe në faqen e instagramit RTSHSPORT.al

Objektivat për 2024

Gjatë vitit 2024 RTSH sport synon të bëjë dy edicione me lajme në orarer 14 30 dhe 19 00 që do të transmetohet direkt. Shkak për mungesën e edicioneve me speaker ka qënë mungesa e një studio

të dedikuar për RTSH Sport. Po ashtu RTSH Sport do të synojë të transmetojë evente sportive ekskluzive nga të gjitha disiplinat sportive. Do të synojmë të shtojmë emisionet që do të fokusohen jo vetëm tek futbollit por edhe tek sportet e tjera.

Departamenti i Teknikës TV.

Informacioni që po percjellim më poshtë, bën një përmbledhje të veprimtarisë së Njesisë Teknikë për periudhën Janar-Dhjetor 2023 si dhe planet për të ardhmen e afert.

Gjatë kësaj periudhe, Njesia Teknikë, ka qenë e fokusuar në shfrytëzimin e kapaciteteve të studiove të prodhimit, përmirësimit të infrastruktures së tyre teknike dhe mbajtjen në gatishmëri të aparaturave të prodhimit të emisioneve sipas kërkesave të Njësive të tjera dhe Drejtorisë së Prodhimit. Informacionin e mëposhtëm do të japim të grupuar sipas departamenteve dhe sektoreve pjesë përbërëse të Njesisë Teknikë.

Viti 2023 ka qenë vit i ngarkuar dhe intensiv në instalimet e pajisjeve teknike në studiot e RTSH. Çdo sektor është angazhuar për të përbushur të gjithë detyrat e caktuara nga Njesia Teknikë dhe rregullorja e brendshme e institucionit.

Ky Departament ka qenë pjesëmarrës në procedurat e tenderave duke përgatitur specifikime Teknikë, dokumenta standarte tenderi, pjesëmarrje në KVO dhe akte kolaudimi mallrash.

Spektori i profilaksisë, ka kryer një sërë detyrash, të cilat i kanë shërbyer garantimit të transmetimit, regjistrimit, montazheve dhe studiove levizëse brenda kushteve teknike, instalimi i aparaturave të reja si dhe mirëmbajtja e pajisjeve.

Spektori teknik i transmetim-regjistrimit ka realizuar të gjitha transmetimet direkte dhe regjistrimet në të gjitha studiot e Televizionit.

Përgjegjësi i sektorit ka organizuar dhe shpërndarë punën në bashkërendim me përgjegjësit teknik të turneve duke vënë në shfrytëzim optimal punën teknike. Kjo në bashkëpunim edhe me sektoret e tjerë të Njësive të struktura të RTSH.

Përgjegjësit e turneve kanë zbatuar me përpikëri orarin dhe kanë vënë në shfrytëzim aparaturën teknike duke kontrolluar të gjithë parametrat teknike përpara dhe gjatë realizimit të emisioneve të ndryshme.

Gjatë këtij viti janë realizuar me sukses:

- Festivali Europian i këngës EUROSONG për të rritur e fëmijë

- Zgjedhjet Vendore të Republikës së Shqipërisë transmetime maratone
- Festivali i 62-të i RTSH
- Emisione të shumta ne studiot e TV si transmetime direkte apo rregjistrime.
- Si dhe shume evente të tjera, prodhime apo jo të RTSH, te cilat kanë pasur angazhimin maksimal të ketij departamenti.

Teknikët e figurës, zërit, playout dhe titra jane perpjekur dhe kanë mbuluar me punë cilesore të gjitha studiot e TV.

Teknikët e Studios nr.2 kanë mbuluar transmetimet e edicionve të lajmeve për kanalet RTSH 1, RTSH 2 dhe RTSH 24 si dhe disa emisione të Prime time.

Tekniket e Studios nr.1 kane bere te mundur realizimin e emisioneve:

Si ne Familje

Publikisht

Zeri i Popullit

Mirëmëngjes Shqiperi

Jetë Shqiptare

Pasditja ime

Stacioni roze

3D

Ekspres

Zona 30

Rubrika Sportive

Artes

Bibliotekë

Autor

Me Ketin

Auditor Arsimi

Në Tempull

Trupi dhe Shëndeti

Fustanella

Kur Xhirohej një Film

Para Fest

ADN

Një Natyrë sa një jetë

Pa censurë

E diela Jonë

Dritëhijet e personaliteteve Historikë

Emisionet e zhanrit Podcast

Emsioni URA

Pamjaftueshmeria e kapaciteteve Storage ka qenë një problematike që ka sjellë vështiresi në organizimin e punes të teknikeve në 6 mujorin e parë të vitit 2023. Një tjetër mungesë që ka kufizuar mundësitë e kualitetit të transmetimeve live në disa kanale ka qenë mungesa e pajisjeve video dhe audio pa të cilat ka qene e pamundur përpunimi i sinjaleve direkte për transmetim.

Problem konstant mbetet koha e pamjaftueshme e kontrollit të disa emisioneve javore, kryesisht të fundjaves, të cilët vijnë në këtë sektor, në më pak se 24 ore, deri edhe 4 apo 5 orë nga orari i percaktuar për transmetim.

Spektori teknik RTSH Sport ka realizuar gjatë vitit 2018 transmetimin live të shumë eventeve sportive ku me kryesoret jane:

Uefa Champions League

Formula 1

Botërori U17

Botërori i Ciklizmit

Botërori i Peshëngritjes

Kombëtarja e futbollit U21

Kombëtarja e futbollit U19

Kombëtarja e futbollit U17

Kombëtarja e Femrave

Kombëtarja e Basketbollit

Kombëtarja e Voljebollit

Kampionati Kombëtar i basketbollit

Kampionati Kombëtar i Volejbollit

Liga Gjergj Kastrioti

Komapionati Kombëtar Futsal

Eventet e Boksierëve Shqiptarë nëpër Botë

Ne kete sektor kane dale veshtiresi ne realizimin e detyrave per shkak te mungeses se infrastruktures teknike per te komentuar eventet sportive ne rastet kur ka pasur me shume se nje te tille live ne te njejten kohe, por qe ne bashkepunim me sektoret e tjere te Njesise jane zgjidhur. Nga Njesitë e tjera të struktures së RTSH, shumë shpesh hasim pengesa dhe gjendemi në situata të vështira për shkak të ndryshimit të programeve te regjistrimit pa njoftim praparak.

Departamenti i Platformes Tokesore dhe Satelitore.

Analiza e punës për vitin 2023 do të bëhet mbi veprimtaritë e zhvillimit të kapaciteteve teknike të Platformës dhe në funksionalitetin operacional të saj.

Stafi i transmetimit të platformës ka përbushur detyrat për transmetim të pandërprerë në 24 orë në 365 ditë të vitit për të gjithë kanalet e platformës. Procesi i funksionimit të punës gjatë këtij viti ka qenë transmetimi i përditshëm i programeve të drejtëpërdrejta të prodhuara në studiot e RTSH-së sipas kërkesave të programit dhe riprodhimi i programeve me anë të playlistave. Emisione dhe evente të drejtëpërdrejta kanë transmetuar gjatë gjithë vitit kanalet RTSH 2, RTSH 3, RTSH Plus, RTSH Kuvend, RTSH Muzikë, RTSH Agro dhe RTSH 24.

Theksojmë se gjatë këtij viti intesiteti i transmetimit të drejtëpërdrejtë ka qenë i lartë në kanalet RTSH Kuvend dhe RTSH 24.

Në kanalën RTSH Kuvend përveç seancave parlamentare janë transmetuar edhe aktivitetet e komisioneve të kuvendit drejtëpërdrejtë për çdo mbledhje të tyre. Transmetimet në këtë kanal kanë kërkuar impenjim të shtuar të stafit teknik në transmetim dhe shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve teknike. RTSH Kuvend përveç transmetimeve të drejtëpërdrejta, transmeton edhe ritransmetimin e seancave dhe komisioneve të kuvendit gjatë gjithë javës sipas programit të kanalit.

Problematika kryesore për kanalet RTSH 24 dhe RTSH Kuvend është mungesa e stafit teknik të dedikuar për këto kanale. Mbulimi i punës për këto kanale me stafin teknik të platformës është shpeshherë i pamundur për shkak të kërkesave specifike që kanë këto dy kanale. Kjo mungesë i

ekspozon këto dy kanale ndaj problemeve organizative pasi të dy kanalet duan staf në të njëjtën kohë dhe me profil pune të ndryshëm nga ai i teknikut të transmetimit të platformës.

Spektori i Transkoding dhe kontrollit të kualitetit

Spektori i transcoding ka punuar për përmbushjen e detyrave të përcaktuara nga përshkrimi i punës së Njësisë Teknike.

- Kontrolli i programeve ditore për çdo kanal
- Bashkangjitja e metadatave me materialet video në sistemin MAM për me shumë se 20,000 asete
- Kontrolli i kualitetit video dhe audio për asetet e reja në MAM
- Përshtatjen (konvertimin) e materialeve video në parametrat e përcaktuara për transmetim.
- Bashkangjitjen e titrave për filmat

Ky sektor përveç detyrave të përditshme të kontrollit të programeve që janë për transmetim është impenjuar në mënyre aktive në funksionimin e sistemit MAM. Çdo material i kaluar në këtë sistem ka nevojë për ingest dhe konfirmimin e kualitetit. Aktualisht numri i aseteve të përpunuara nga ky sektor i kalon 29500. Problem konstant mbetet koha e pamjaftueshme e kontrollit për disa programe të cilët vijnë për kontroll vetëm pak orë para orarit të planifikuar për transmetim.

Mungesa e stafit bëhet më e evidente me shtimin e punës në sistemin MAM. Ky sektor ka nevojë urgjente për plotësimin e vendit vakant në strukturë.

Problematika të ndryshme në Departament:

Konstatohet vazhdimisht që gjatë transmetimeve të drejtpërdrejta në kanale të ndryshme të platformës mungojnë redaktorët e programeve duke bërë që të krijohet konfuzion në stafin teknik dhe për pasojë rritet mundësia për gabime në transmetim.

Objektivat

Optimizimi dhe mirëmbajtja e sistemeve ekzistuese për të mbështetur kërkesat e prodhimit. Zhvillim dhe instalime të tjera sipas planifikimeve të Njësisë Teknike.

Risqet:

Risqet që identifikohen janë:

Mungesë stafi për kanalet RTSH 24 dhe RTSH Kuvend që rrezikon deshtimin e transmetimve për këto dy kanale.

Mos realizimi i blerjeve të vogla dhe investimeve të planifikuara sjellin pengesa dhe kufizim të realizimit të objektivave.

Departamenti i Teknikes Radio

Departamenti Teknik i Radios në Njësinë Teknike prodhon dhe transmeton emisione dhe materiale për 7 kanalet e radios, si : Radio Tirana 1, Radio Tirana 2, Radio Tirana 3 , Radio Tirana Internacional, Radio Tirana Klasik, Radio Tirana Jazz dhe Radio Tirana Fëmijë.

Transmetojnë në FM këto kanale: Radio Tirana 1, Radio Tirana 2 dhe Radio Tirana Klasik.

Kanali i parë Radio Tirana 1 transmeton në të gjithë territorin e Shqipërisë , kurse kanali i dytë Radio Tirana 2 në zonën Tiranë, Durrës dhe në Juglindje dhe Radio Tirana Klasik transmeton në zonën Tiranë dhe Durrës .

Shpresojmë që edhe sinjali i transmetimit për këto dy kanalet të shtrihet në të gjithë Shqipërinë.Kurse të gjitha kanalet e radios transmetojnë në DVB-T2 , DVB-S2 , Live Stream në TuneIn Live, OnlineRadio My tuner, etj .


Stuktura e departamentit ka një personel teknik prej 24 personash të cilët janë të ndarë në sektor të ndryshëm si sektor të transmetimit dhe sektor të regjistrim – montazhi .

Në studiot e transmetimit kujdesemi për mbarëvajtjen e transmetimeve të emisioneve sipas programit ditor të sjellë nga Njësia e Programeve .



Mbas 10 vitesh u vu në funksion Studio Regjistrim 1 e cila mori jetë me një format të ri Radio-Televiziv PodCast, duke bërë të mundur realizimin e regjistrimit audioviziv si dhe Postproduksioni Audio-Video

- Kemi bërë të mundur realizimin e emisioneve të reja radio televizive në studion regjistrim 8.
- Kemi bërë rivitalizimin e studiove të Radios si Studiot e Transmetimit , Regjistrimit , Studion e Podcastit, Studion e Orkestrës nga ana e regjisë në të gjitha studiot në mënyrë uniforme.
- Ndricim (spote).
Jemi duke punuar për rivitalizim të sallës së orkestrës duke e sjell atë në identitet.



Disa nga punët e kryera gjatë vitit

1. Kemi montuar studion e re të regjistrimeve në studion 8 duke bërë të mundur realizimin e emisioneve të reja radio televizive.
2. U vu në funksion Studio Regjistrim 1 e cila mori jetë me një format të ri Radio-Televiziv PodCast, duke bërë të mundur realizimin e regjistrimit audioviziv si dhe postproduksioni Audio-Video.
3. Kemi bërë rivitalizimin në të gjitha studiot e Radios në mënyrë uniforme si Studiot e Transmetimit, Regjistrimit, Studion e Podcastit, Studion e Orkestrës
4. Në të gjitha studiot u hoqën materialet për jashtë përdorimit dhe u pastruan studiot
5. U shtruan linjat në studion e orkestrës për komunikimin dixhital të sinjaleve midis regjisë dhe stagebox-it në sallë.
6. U montuan pajisjet në studion e orkestrës si monitorët audio, kartat e mikserit etj.
7. Kemi sistemuar kabllimin në të gjitha studiot , aty ku ka pasë nevojë është vendosur i ri.
8. U montua sistemi audio për eventin e 85 vjetorit të Radios.
9. Kemi realizuar dhe kemi zbatuar të gjitha oraret e lidhjeve direkte, dhe të gjitha lidhjeve që kemi realizuar nga burime të jashtme ashtu dhe të brëndëshme si :
 - Lidhjet për festat e Pashkëve Ortodokse dhe Katolike
 - Lidhjet për festën e Kurban Bajramit etj
 - Lidhja e sinjalit të RTSH 1 për transmetimin e “Xhunior Fest “
 - Lidhjet për Festivali i 62 i Këngës në RTSH 1 me Radio Tirana 1
 - Lidhjet për Festivali i 62 i Këngës në RTSH 24 “Këndi i Radio Tiranës“ me Radio Tirana 2
 - Lidhjet për Festivalin e Sanremos me Radio Tirana

Jemi kujdesur për transmetimin e pandërprerë të të gjitha kanaleve të Radios si për cilësinë e transmetimit ashtu dhe për cilësinë e regjistrimeve .

Invenstimi në pajisje të reja si në studiot e transmetimit ashtu dhe në studiot e regjistrimit është i domosdoshëm për cilësinë e transmetimit ashtu edhe për personelin teknik .

Sektori Transmetimeve Satelitore dhe te Levishme.

SEKTORI SATELITOR

Sektori i Transmetimeve Satelitore ka realizuar me rregull e vazhdueshmëri transmetimet e kanaleve Satelitore S2 të RTSH .

Transmetimi i RTSH në Satelit është kryer në përgjithësi mirë me cilësi shumë të mirë dhe nuk kemi pasur probleme me këtë transmetim.

Parametrat e transmetimit janë me kualitet të kënaqshëm

Çdo muaj është kryer profilaktikë në amplifikatorin e RTSH – SAT.

Çdo ditë kryhet kontrolli visual e fizik i punës (ventilimi , temperaturë , fuqia, reflektimi siguria mekanike) dhe ndërhyhet në rast nevojë duke stabilizuar parametrat.

Të dhënat e transmetuesit satelitor, monitorohen çdo ditë dhe dokumentohen në fletoren përkatëse. Gjithashtu nga Sektori Satelitor janë realizuar shumë marrje sinjali satelitor.

- Në vitin 2023 janë kryer rreth **1050** marrje sinjalesh që transmetohen në kanalet e ndryshme të RTSH

Ndër më të rëndësishmit po përmendim:

Është realizuar me sukses marrja e sinjalit dhe transmetimi i Formula 1.

Është realizuar me sukses marrja e sinjalit dhe transmetimi i Moto Gp .

Është realizuar me sukses marrja e ndeshjeve dhe transmetimi i Kampionatit vendas .

Është realizuar me sukses marrja e UEL MAGAZINË me të gjithë 15 seritë e saj

Janë marrë sinjalet e ndeshjeve të ekipit Kombëtar të Futbollit si brenda ashtu edhe jashtë vendit sëbashku me emisionet shoqëruese .

Janë marrë sinjalet e ndeshjeve të Kampionatit Kombëtar të Futbollit Shqiptar kategoria e parë.

Janë marrë sinjalet nga veprimtaritë politike, qeveritare, kombëtare e ndërkombëtare.

Janë marrë sinjalet dhe transmetimet e inagurimeve të ndryshme.

Janë marrë sinjalet e vizitave të personaliteteve të ndryshme që kanë vizituar vendin tonë.

Vlen të theksohet se të gjitha sinjalet e planifikuara dhe të paplanifikuara janë marrë të gjithë pa asnjë dështim dhe me cilësi të mirë.

Në shumicën e rasteve këto sinjale kanë qenë të dubluara .

Edhe personeli i stacionit Fllakë çdo ditë kryen marrjet sipas programit.

Dokumentacioni teknik i përditshëm në sektorin satelitor mbahet në rregull, është i përditësuar dhe i firmosur nga dorëzuesi dhe marrësi. Dokumentohen vlerat dhe punimet e përditëshme.

Personeli ka kryer detyrat e veta funksionale si në mbajtjen në kontroll të transmetimit dhe parametrave të tij ashtu dhe në realizimin e marrjeve të ndryshme .

Gjatë ditëve të javës sektori satelitor kryen edhe detyren e koordinatorit me sektorët e tjerë.

Gjithashtu kryen përherë kolaudimin e sinjalit me studion gjatë transmetimeve të ndryshme

Janë kryer punime profilaktike në antenat dhe amplifikatorët e FUNA.

Janë kryer çdo një muaj profilaktikë në paisjet e FUNA
Janë kryer punime profilaktike në të gjitha antenat e satelitit.

SEKTORI RADIORELE

Gjatë vitit 2023, sektori radiorele dhe fibra optike ka realizuar detyrat e veta
Gjatë këtij viti sektori ka realizuar të gjitha transmetimet direkte të kërkuara nga departamentet
e ndryshme te :

Aktiviteteve të Kryeministrit (në kryeministri dhe në institucione te tjera)

Aktiviteteve të Qeverisë

Aktiviteteve të Parlamentit

Aktiviteteve të Kryesisë Kuvendit të Shqipërisë

Aktiviteteve të Presidencës

Aktiviteteve Sportive (Basketboll, futboll, etj) .

Aktiviteteve fetare

Ndeshjet ndërkombëtare të futbollit

Janë realizuar disa transmetime të protestave të opozitës.

Sidomos në boulevard dhe selitë e partive të tyre

Është realizuar me sukses transmetimi i festivalit të këngës në RTSH .

Në pergjithësi transmetimet janë kryer me fibra optike dhe Rele .

Këto transmetime janë realizuar me sukses nga personeli i këtij sektori

Gjatë vitit 2023 Sektori I R.Releve kanë realizuar **680** transmetime

STUDIOT LEVIZËSE

Sektori i Autobuzave ka kryer normalisht detyrat e veta të rregjistrimit të eventeve të ndryshme
duke plotësuar pothuaj 100% kërkesat dhe nevojat e RTSH

Studiot lëvizëse HD1, HD 2 dhe HD 3 kanë realizuar rregjistrimet dhe transmetimet direkt :

Aktiviteteve të Kryeministrit

Aktiviteteve të Qeverisë

Aktiviteteve të Parlamentit

Aktiviteteve të Kryesisë Kuvendit të Shqipërisë

Aktiviteteve të Presidencës

Aktiviteteve te përbashketa të qeverive të Shqipërisë e Kosovës

Aktiviteteve Artistike Koncertore të Orkestrës Simfonike RTSH dhe cdo koncert tjetër sipas kërkesave të Drejtorisë së Prodhimit.

Aktiviteteve Artistike Teatrorë

Aktiviteteve Sportive (Basketboll, futboll, etj)

Aktiviteteve fetare

Personeli i studiove lëvizëse frekuenton rregullisht dhe shpesh herë ka punuar me orë të zgjatura duke kryer rregullisht detyrat funksionale si dhe ka kryer rregullisht profilaktikë të mjeteve në dispozicion.

Është kryer shpërndarja e punës në mënyrë të ekuilibruar në të tre studiot.

Kualifikimi i këtij personeli është i mjaftueshëm dhe i përgjigjet relativisht kënaqshëm detyrave të transmetimit.

Gjatë vitit 2023 Studiot Levizese kanë realizuar **760** Regjistrime dhe Transmetime direkt.

Studio SNG

Gjatë vitit 2023 SNG ka punuar si Regji e pavarur në shumë raste .

Në menyrë të vecantë ka punuar si regji për aktivitetet e kryeministrit dhe qeverisë.

Ka punuar si regji e pavarur edhe në disa raste për evenimente artistike dhe sportive sidomos kur studiot e tjera kanë qenë të angazhuara .

Të gjitha regjistrimet i ka kryer me kualitet .

Ka punuar si UPLINK në rastet e transmetimeve ndërkombëtare.

Personeli kryen me rregullsi detyrat e veta funksionale.

Ka frekuentim të rregullt në punë.

Vlen të theksohet gadishmëria e këtij personeli në çdo orë e çdo kohë.

Gjatë vitit 2023 SNG ka realizuar **276** transmetime .

Spektori i Qendrës së Kontrollit dhe Operimit të Rrjetit

1. Përmbledhje

Aktualisht në Sektorin e Qendrës së Operimit dhe Kontrollit të Rrjetit punohet në 2 nënsektorë: *Qendra e Kontrollit dhe NOC (Qendra Operacionale e Rrjetit)*. Qendra e Kontrollit kryen kontroll periodik të serviseve RTSH dhe raporton problemet për platformat: DVB-T2, DVB-S2 dhe FM (Dajt). NOC kryen monitorimin të vazhdueshëm të rrjetit DVB-T2. Bën raportimin e problematikave në lidhje me problemet e shfaqura në rrjetin DVB-T2, në transmetimin e serviseve

në çdo platformë, si dhe merr pjesë në zgjidhjen e tyre. Transmetimi në platformat ËEB dhe OTT është ndërprerë në vitin 2022 dhe nuk ka patur çfarë të monitorohet/raportohet për to, por në momentin që do rikthehet transmetimi, do vijojë puna normalisht nga sektori dhe për monitorimin e tyre.

Monitorimi kryhet nga sistemet: R&S BC NETSTATE System Monitor, RTM (Real Time Monitoring), Intermapper, AVHE100 (për Enkodimin dhe Multipleksimin), SmartPSS, Siae - Netëork Management System, R&S Prismon. Operatorët NOC përgjigjen dhe ndaj ankesave të shikuesve në numrin e kontaktit për problemet me kanalet e RTSH dhe lokale në DVB-T2.

Në këtë sektor punohet çdo ditë nga ora 07:00 deri në 00:00. Puna është e organizuar me turne. Gjatë kësaj periudhe, janë verifikuar problematikat dhe janë marrë ankesat si më poshtë:

1. Janë hapur 535 problematika për probleme me transmetuesit dhe sistemin e transmetimit DVB-T2.
2. Janë hapur 593 problematika për probleme me transmetimin e serviseve në platformat DVB-T2, ËEB, OTT dhe FM.
3. Janë marrë rreth 278 telefonata përgjatë vitit 2023, ku kryesonin ankesat për serviset e RTSH dhe informacion.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 është integruar pjesërisht sistemi i kondicionimit/ventilimit në sistemin e monitorimit Intermapper.

Në vazhdim gjeni një analizë të rezultateve të këtyre monitorimeve.

2. Stacionet e transmetimit

Aktualisht në territorin e Shqipërisë, funksionojnë 59 *stacione transmetimi* (secila prej të cilave transmeton në MUX-1 serviset RTSH dhe në MUX-2 serviset lokale), gjendja transmetuese e të cilave monitorohet me anë të sistemit R&S BC NETSTATE System Monitor. Ky është sistemi kryesor që paraqet gjendjen transmetuese të rrjetit. Të gjitha sistemet e tjera specifikojnë parametrat nën të cilat këta transmetues funksionojnë.


2.1. Tipet e problemeve në transmetues

Problemet në transmetues janë të ndryshme dhe janë kategorizuar si më poshtë:

- Off Air (Stacioni i fikur)
- Service Failed (Stacioni i ndezur, por nuk ka transmetim në MUX)
- Monitoring (Problem monitorimi, por nuk afekton transmetimin)


- Ëarning (Ka një problem teknik, por nuk ka ndërprerë transmetimin e MUX)
- Link (Problem në komunikimin e stacioneve me njëri tjetrin me anë të radio-linqeve)
- Gjenerator (Difekt në funksionimin e gjeneratorit, i cili afekton ose jo transmetuesin)
- UPS (Difekt në funksionimin e UPS, i cili afekton ose jo transmetuesin)
- Temperature (Temperaturë e lartë ose e ulët, i cili afekton ose jo transmetuesin)

Në Grafikon 2.1 janë paraqitur tipet e problemeve në transmetuesa. Këtu janë përfshirë të gjitha tipet e problemeve, edhe ato që janë paralajmëruese dhe ato probleme që kanë shkaktuar ndërprerjen e transmetimit. Bazuar në raportimet e problematikave për 2023, problemet kryesore në stacione kanë qenë *Ëarning* (80%), të cilat nuk kanë afektuar funksionimin e transmetuesit.



Grafiku 2. 1. Tipet e problemeve në transmetuesa - Total

Në Grafikon 2.2 janë paraqitur tipet e problemeve në transmetuesa që kanë ndikuar në transmetim dhe për pasojë dhe në disponueshmëri. Në problemet që kanë ndikuar në punën e transmetuesëve, kryesisht kanë qenë problemet e shkaktuara nga *Radio-Linqet* (38%).



Grafiku 2. 2. Tipet e problemeve në transmetuesaqë kanë ndikuar në disponueshmëri

2.2. Disponueshmëria e secilit stacion gjatë vitit 2023


Në Grafikon 2.3 paraqitet disponueshmëria mesatare e secilit stacion gjatë vitit 2023 (duke marrë parasysh vetëm problemet kritike që kanë afektuar funksionimin e transmetuesëve).

Vihet re se stacionet me disponueshmëri më të ulët kanë qenë: *Ksamili, Shën Vasili dhe Dobrenji*. Këto stacione janë afektuar kryesisht nga problemet e “Service Failed” “Off Air” dhe “Link”, siç është specifikuar dhe në paragrafin 2.1.


Në Grafikon 2.4 paraqitet disponueshmëria mesatare e stacioneve për çdo muaj gjatë vitit 2023 (duke marrë parasysh vetëm problemet kritike që kanë afektuar funksionimin e transmtuesëve).

Vihet re se muaji me disponueshmëri më të ulët kanë qenë: *Mars (99.83%) dhe Nëntor (99.83%)*. Gjithsesi disponueshmëria ka qenë çdo muaj mbi kriterin minimal që është: 99.8%.

Disponueshmëria mesatare e stacioneve për vitin 2023 ka qenë **99.91%**




Grafiku 2. 3. Disponueshmëria e Stacioneve (%)



Grafiku 2. 4. Disponueshmëria e transmetimit sipas muajve


2.3. Kontrollët e mirëmbajtjes

Në grafikun e mëposhtëm tregohet totali i kontrolleve periodike dhe urgjente të mirëmbajtjes për secilin stacion përgjatë vitit 2023.



Grafiku 2. 5. Kontrollat e mirëmbajtjes për çdo stacion

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten numri i kontrolleve të mirëmbajtjes (periodike dhe urgjente) për çdo muaj gjatë vitit 2023.



Grafiku 2. 6. Kontrollat e mirëmbajtjes për çdo muaj

Kontrollet urgjente janë kryer në rast defekti të transmetuesëve, ndërsa kontrollet periodike sipas grafikut të suportit çdo muaj në çdo stacion. Gjatë vitit 2023 janë kryer gjithsej 731 kontrolle periodike dhe 69 kontrolle urgjente.


Nga grafikët vihet re se:

- Kontrollat janë kryer periodikisht çdo muaj në çdo stacion.
- Mesatarisht janë kryer 65 kontrolle mirëmbajtje çdo muaj.
- Muaji me më shumë kontrolle: Nëntor.
- Në stacionet e transmetimit, nuk ka asnjë stacion me diferencë të konsiderueshme të numrit të kontrolleve të mirëmbajtjes.

2.4. Problemet në MUX-1 dhe MUX-2

MUX-1 në të gjitha allotmentet (përveç Tiranës) transmeton paketën RTSH, ndërsa MUX-2 transmeton kanalet lokale për secilin allotment.

Sipas raportimeve të bëra nga NOC, problemet e transmetuesëve kanë qenë me shpërndarje 50% - 50% në mux-e. Pra, shpërndarja e problemeve në transmetuesë ka qenë e barabartë dhe nuk është ndikuar nga stream-i që kanë transmetuar.



Grafiku 2. 2. Afektimi i MUX-1 dhe MUX-2 nga problemet në stacione

2.5. Puna e stacioneve me gjenerator

Përgjatë vitit 2023 janë mbajtur me korrektësi raporte në lidhje me nivelin e naftës dhe punimin e gjeneratorit në stacione. Monitorimi kryhet me anë të sistemit Real Time Monitoring dhe Intermapper. Shumica e stacioneve kanë gjeneratorin të monitorueshëm, por një pjesë e stacioneve nuk e kanë patur monitorimin aktiv gjatë gjithë vitit 2023.

Stacione të cilat, akoma, nuk kanë monitorim të gjeneratorit:

1. PETRESHI
2. DAJTI
3. ZVËRNECI

Stacione të kanë dy gjenerator, dhe kanë në monitorim vetëm njërin prej tyre:

1. TARABOSH
2. MIDË
3. GLLAVË

4. ÇERVENAKË
5. FUSHË DAJT
6. SOPOT
7. LLOGARA

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet koha e punimit me gjenerator përgjatë gjithë vitit. Vihet re se stacionet që kanë punuar më shumë me gjenerator gjatë vitit janë: Shashica (28 % të vitit), Llogara (24.45 % të vitit) dhe Lurthi (10.72 % të vitit).

Mesatarisht një stacion ka punuar me gjenerator 4.06% të kohës përgjatë vitit 2023, ose 353.8 orë gjatë vitit. Kjo statistikë është realizuar në bazë të monitorimit, duke marrë parasysh stacionet e sipërpërmendura që nuk kanë akoma gjenerator të monitorueshëm, që prej prill-it 2023. Verifikimi për punë e këtyre stacioneve është bërë duke marrë raportim të vazhdueshëm nga teknikët e stacionit ose përgjegjësit përkatës.



Grafiku 3. 1. Koha e punimit me gjenerator (%) për çdo stacion

3. Ankesat nga Shikuesit


Aktualisht telefonatat nuk regjistrohen, përgjigjet në telefon gjatë orarit të punës operatori NOC, i cili pasi merr informacion për tipin e ankesës dhe zonës nga ankoher shikuesi, e udhëzon apo i jep informacion për zgjidhjen e ankesës. Çdo ankesë mbahet shënim nga operatori e kategorizuar, e komentuar mbi komunikimin që ndodhi gjatë telefonatës dhe

drejtimi që iu dha problemit. Në rastet kur operatori nuk ka informacionin e duhur për t'i dhënë zgjidhje ankesës, njofton përgjegjësën e turnit.

3.1. Tipet e ankesave

Shumica e ankesave vijnë për *mungesë të kanaleve RTSH* apo mungesë totale kanalesh. Shikuesit kërkojnë udhëzime nga të drejtojnë antenën, frekuencat e kërimit manual, informacion se ku mund të blejnë dekoder/telekomandë, etj. Ankesat kategorizohen si më poshtë.

- Problematika me serviset RTSH (problem me një apo disa kanale RTSH në platformat në të cilat transmetohet: DVB-T2, FM, ËEB, OTT, DVB-S2).
- Problematika me serviset lokale (të cilat transmetohen nga MUX-2 i stacioneve transmetuese).
- Ankesa për kanale që nuk transmetohen nga RTSH (kryesisht ankesat vijnë për kanalet Klan dhe Top Channel).
- Informacion (në lidhje me çmimin e dekoderave, udhëzime për instalimin, informacion mbi programacionin etj.).
- Probleme me transmetuesin (Transmetuesi nga drejton antenën qytetari ka probleme teknike).
- Pika të vdekura (zona ku nuk kemi akoma mbulim me transmetimin DVB-T2).
- Në lidhje me Njësitë/Departamentet e tjera (Kërkojnë kontakt me punonjës të RTSH-së që nuk janë pjesë e njësisë teknike, p.sh: gazetarë, burimet njerëzore etj.).
- Telefonata të humbura (shumica prej të cilave ka qenë gjatë natës, kur nuk ka operator në turn).




Grafiku 4. 2. Tipet e Ankesave nga shikuesit

3.2. Ankesat sipas Allotmenteve

Kryesojnë ankesat nga Allotmenti i Tiranës (i cili sipas ndarjes së rrjetit përfshin qarkun e Tiranës dhe Durrësit). Ndiqet nga allotmenti i Elbasanit. Telefonatat më të shumta kanë ardhur për probleme me serviset RTSH dhe informacion.

Ilustrimi grafik është paraqitur në Grafikon 4.3.



Grafiku 4. 3. Ankesat sipas allotmenteve

4. Transmetimi i paketës RTSH

Aktualisht RTSH transmeton në 3 platforma (DVB-T2, DVB-S2, FM). Në këto platforma transmetohet paketa RTSH si dhe disa kanale lokale.

Gjatë vitit 2023 janë monitoruar nga teknikët e turnit, vetëm platformat: DVB-T2, DVB-S2, FM. Monitorimi është kryer nga teknikët e turnit, dhe verifikimet e mëtejshme janë kryer nga operatorët NOC.

Është vënë re se disponueshmëria ka qenë shumë e lartë ~99.99% në DVB-T2, në DVB-S2 afektimi i transmetimit kur kushtet e motit kanë qenë të këqija ka qenë gjithmonë prezent, në FM transmetimi ka qenë gjithashtu me disponueshmëri të lartë dhe pa probleme.

Problem gjatë këtij viti ka qenë mungesa e përkohshme, por shumë e shpeshtë e EPG-së në DVB-T2 dhe DVB-S2. Ky problem është raportuar vazhdimisht te IT.

5. Objektivat për vitin 2024

Për NOC (Qendrën Operacionale):

- Të miratohet në mënyrë zyrtare një procedurë për tipet e problemet dhe raportimin e tyre për çdo rast.
- Të trajtohen punonjësit, që të jenë të aftë jo vetëm për raportim të problemeve, por dhe për pjesëmarrje në zgjidhjen e tyre.
- Të punohet për një sistem të ri monitorimi ku të integrohen të dhënat e monitorimeve, për monitorim më efikas.
- Të punohet për eliminimin të monitorimit “manual”.
- Të shtohet monitorimi i platformës DVB-S2 në multivieëer.
- Raportimet e shtuara gjatë këtij viti, të vijojnë të jenë të rregullta.
- Të ketë raportim më të shpejtë.

Për Qendrën e Kontrollit dhe monitorimin e serviseve:

- Të vendoset në zyrë ekranet Multivieëer, për monitorim më efektiv të serviseve.
- Të mundësohet gjenerimi i logeve automatike dhe identifikimi automatik i problemeve (Duke përdorur Probe-t).
- Të mundësohet monitorimi me anë të probeve edhe i transmetimit DVB-T2 dhe FM në gjithë territorin e Shqipërisë.
- Të trajtohen punonjësit për t’iu përgjigjur ankesave të shikuesve.
- Të ketë raportim më të shpejtë.

Spektori Elektrik

Ne sektorin elektrik procesi i punës ka vazhduar normalisht me 3 turne , sistemi elektrik në godinën e Radio Televizionit nuk ka patur difekte në rrjet.

Cdo muaj është bërë kontrolli i burimeve alternative të energjisë si UPS dhe motor gjeneratori i vendosur në RTSH i cili është ndezur periodikisht për të kontrolluar automatikën si dhe gadishmërinë në rast mungese energjie nga rrjeti.

Dy UPS me fuqi 120 kVA, të vendosur në sallën e Head End, kanë sinjalizuar për mbarim të kohës së garancisë të baterive, është e nevojshme të bëhet zëvendësimi i baterive.

Është mbajtur në monitorim dhe sistemi i ftohjes në sallën e Head End-it, pasi në gjëndje pune aktualisht janë dy kondicionerë dhe dy të tjerë janë me difekt ,pas kërkesës tonë është në proces prokurimi.

U punua tek Studio Nr.4, për montimin e LedËall të ri për emisionin ,(Ti duhet ta dish).

Gjatë cdo muaji behet kontrolli dhe zëvendësimi i ndriçimit të korridoreve dhe zyrave ku kanë patur probleme me ndriçimin në godinat e TV dhe Radios .

Gjatë muajit Shkurt u realizua rregullimi dhe zëvendësimi i pjesëve me difekt tek sistemi i ftohjes në sallën e Head End-it, nga firma fituese .Pas këtyre ndërhyrjeve, procesi i sistemit ftohës, vazhdon punën brenda parametrave teknik .

Ne muajin Shkurt u punua për ndërrimin e transformatorit në stacionin Lurth, Rrëshen sipas marrëveshjes me kompaninë ONE Albania për kalimin e pikës së lidhje me energji elektrike nga kompania Plus Netëork tek ONE Albania, si dhe furnizuar me energji elektrike stacionin DVB-T2 .

Muajin Mars u bë ndërrimi i sistemit të ndricimit ne sallën e orkestres me ndricim LED 120Ë , duke përmirësuar shkallën e ndricimit si dhe duke ulur konsumin energjisë pasi ndricimi egzistues ishte me llampa Halogjen 350 Ë .

Gjatë muajit Prill u bë kontroll në stacionet transmetuese Gllavë dhe Zvërnec për sigurimin e rrjetit elektrik shpërndarës në godinë si dhe matjen e rezistencës së tokëzimit .

Mbajtja në monitorim e sallës serverave Head End ,ku janë të instaluar dy UPS me fuqi 120 kVA, pasi kanë sinjalizuar për mbarim të kohës së garancisë të baterive, është e nevojshme të bëhet zëvendësimi i baterive.

Gjate muajit Maj u përgatitën materialet elektrike për ngritjen e pikave të transmetimit gjatë procesit zgjedhor Maj 2023, si dhe ngritja e gatishmërise për datat 14 dhe 15 Maj.

Ne muajin Qershor u punua në zyrën e Drejtorit të përgjithshëm për instalimet e reja dhe montimin e TV.

Gjate mujit Shtator u bë demontimi i linjave elektrike që furnizonin skenografitë e vendosura tek Studio nr.1.

Nga sektori elektrik u bë demontimi i VideoËall- eve, te cilat u spostuan nga punonjesit e studiove per ruajtje ne nje ambient tek TV .

Për realizimin e Junior Fest tek piramida u dha suport teknik për vendosjen e LedËall-eve.

Në studion nr.3 të Montazhit të Radios, u kryen instalime të reja me furnizim nga UPS. Gjithashtu u vendos ndricim i ri .

Tek zyra e Përgjegjësit transmetimit, u bënë instalime të reja me furnizim nga UPS, pasi tek kjo zyre do vendosej “Programacioni”.

U përgatit baza materiale elektrike për instalimet e reja që do të vendosen tek Studio nr.1.

Pas heqjes së ndricuesve dhe paisjeve ngritse nga ana e Sektorit të ndricimit , më datë 27.09.2023 filluam montimin e linjave dhe prizave të cilat do shërbejnë për furnizimin e ri me energji elektrike me linje nga UPS për ndricimin e ri të Studio Nr.1

Gjate muajit Tetor u puna per furnizimin me energji elektrike te skenografise se re 360° , montim Videoëall dhe ndricimit teknik ne Studion Nr.1

Gjate muajit Nentor duke qene se Radio kishte pervjetorin u puna ne sistemimin e ndricimit te studiove te transmetimit te Radiove dhe te mjediseve te Montazhit .

U punua me ndricimin e koridoreve te godines se Radios duke zevendesuar ndricimin aktual me ndricues LED, duke përmirësuar efincencen e energjise elektrike.

Gjate muajit Dhjetor u moren masa per gatishmerine gjate diteve te Festivalit .

U punua tek Kamerale Nr.1 ne te cilen do filloje emisionin e Procesit Sportiv .

Departamenti Stacioneve Transmetuese Tokesore

Një nga drejtimet e rëndësishme për vitin 2023 ka qenë inspektimi i pikave për mbulimin me sinjal DVB-T2 në gjithë territorin e Shqipërisë.

Në zbatim të detyrës së caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, për rritjen e zonës së mbulimit me sinjal DVB –T2, me qëllim arritjen e nivelit 90 % të popullsisë së Shqipërisë, Grupi i Punës të Njësisë Teknike, ka kryer vizita inspektuese në disa pika në të gjithë vendin bazuar kjo në një plan paraprak.

Keshtu janë realizuar inspektimet në pikat sa më poshte:

- Në Muajin Janar janë inspektuar Pikat: Himare, Terbac, Mavrore, Borsh.
 - Në muajin Shkurt janë inspektuar pikat: Shengjergj, Baldushk, Sarisalltik, Suke-Dajc.
- Rezultatet e këtyre inspektimeve janë dorëzuar në formë raporte në Drejtorinë Përgjithshme të RTSH.

Mbetet për të realizuar vizitat inspektuese edhe në pikat e tjera të mbetura me qëllim hartimin e një strategjie për mbulimin me sinjal TV të gjithë territorit të vendit, sic e kërkon ligji.

Gjatë vitit 2023 janë kryer punimet për mirëmbajtjen e sistemit të transmetimeve FM si më poshtë :

- Në muajin Janar u riparua Transmetuesi FM i radio Tiranës Programi i Pare në pikën Transmetuese Ishem.
- Në muajin Mars është ndërruar një transmetues FM i Radio Tiranës Programi i Pare pasi nuk kishte fuqi në dalje.
- Është realizuar kryerja e shërbimit për riparimin dhe ndërimin e fiderit të antenës FM në Stacionin Midë në muajin Qershor 2023.
- Është realizuar ndërimi i dekoderit DVB-T2 dhe rikonfigurimi i RDS në transmetuesin FM në Lurth në muajin Mars.
- Me datë 16 Nëntor u bë ndërimi i transmetuesit FM 500 Ë i Radio Tiranës programi Pare, në Stacionin Asim Zeneli pasi ekzistuesi ishte pa fuqi në dalje.
- Me datë 21 Nëntor 2023 është ndërruar transmetuesi FM i radio Korçes në Stacionin Pepellash pasi ekzistuesi nuk kishte fuqi në dalje.

Po kështu janë realizuar edhe disa inspektime për të shqyrtuar ankesat e qytetarëve të ardhura në drejtim të RTSH. Përkatesisht janë kryer shqyrtimi i ankesave të mëposhtme:

- Nga një banor i fshatit Tragjas, i cili ankohej për mungesë sinjali TV DVB-T2 në këtë fshat në orë të caktuara të ditës. Mbas realizimit të matjeve në disa pika të fshatit dhe nga drejtime të ndryshme u arrit në përfundim se sinjali në këtë fshat sigurohej në

menyre te pandrerpere nga stacioni Llogora dhe u keshillua ankimuesi qe te siguronte sinjal nga ky stacion.

- Nga nje banues ne zonen e Plazhit Durres i cili ankohej per ikje te sinjalit nga Pika Transmetuese PSV Durres. Duke qene se kjo ankese ishte e drejte u moren masa qe ne bashkëpunim me firmen “Rohde&Schëarz” te behej nderrimi i fuqive te transmetuesave te kësaj pike me ate te Pikes Transmetuese Arapaj respektivisht 50 ë me 500 Ë rms. Me kete zgjidhje ky problem nuk ekziston me.
- Nga nje banor i Njesise Administrative Stebleve (por edhe nga Bashkia Librazhd) , i cili ankohej per mungese sinjali kryesisht ne fshatin Stebleve. Pas inspektimit te gjithë njesise administrative u përcaktuan pikat e mundshme te transmetimit si dhe u hartua relacioni per Drejtorin e Pergjithshem per zgjidhjen e këtij problemi.

Nga personeli inxhiniero-teknik i këtij departamenti janë kryer detyrat e mëposhtme:

- Është mbajtur në kontroll gjendja e transmetimit TV dhe FM në gjithë territorin e vendit.
- Është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me Qendrën e Monitorimit dhe Kontrollit të Rrjetit me qëllim mbylljen e ticketave të hapura nga kjo e fundit lidhur me problemet e shfaqura në transmetim
- Janë mbajtur në kontroll dhe janë ruajtur të dhënat e gjëndjes së karburantit në 59 Stacionet Transmetuese.
- Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me punonjësit e OSHEE për ndërprerjet, riparimet dhe difektet e linjave që furnizojnë stacionet tona.
- Është bërë komunikimi i përditshëm me kujdestarët e stacioneve transmetuese për ndërprerjet e ndodhura të energjisë dhe sinjalit TV e FM.
- Është mbajtur komunikim i pandërprerë me teknikët e turneve në stacionet transmetuese (Midë, Tarabosh, Petresh, Çervenakë, Llogara- Zvërnec, Dajt, Gllavë, Sopot, Mile, Qafë Prush, Fllakë) për gjendjen e transmetimit si dhe nevoja të përditshme të stacionit dhe personelit.
- Është bërë hartimi i grafikëve të punës së punonjësve për stacionet (Tarabosh, Midë, Homesh, Qafë Prush, Dajt, FM Dajt, Petresh, Çervenakë, Gllavë, Sopot, Mile, Fllakë, Llogara dhe Zvërnec) si dhe Sektorit Mirëmbajtje Antena dhe Logjistikë për periudhën, si dhe është raportuar tek Drejtuesi i Njesisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Krahas kësaj një drejtim i tjetër i punës së Departamentit të Stacioneve Transmetuese Tokësore ka qenë edhe ndjekja e problemeve të transmetimit sic janë :

- Sigurimi i karburantit për gjeneratorët e stacioneve transmetueseë
- Sigurimi i energjisë elektrike në keto stacione.
- Si dhe ruajtja e stacioneve dhe evidentimi i problemeve në strukturën e tyre.

Për sigurimin e furnizimit të energjisë në stacionet tona kemi pasur një bashkëpunim të ngushtë me Sektorin Elektrik si dhe me OSHEE për identifikimin e defekteve dhe eliminimin e tyre në një kohë sa më të shkurtër.

Furnizimin e stacioneve me karburant e kemi kryer bazuar në informacionin që marrim nga sistemi i monitorimit për gjendjen në depozitë. Në çdo rast sistemi i monitorimit është konfiguruar që të raportojë gjendje alarmi kur në depozitë ka një minimum prej 300 litrash karburant, sasi kjo e mjaftueshme për të punuar gjeneratori deri në furnizimin e saj.

Ruajtja e stacioneve bazohet tek sistemi i kamerave por edhe nga monitorimi i përditshëm nga kujdestarët e tyre dhe raportimi i këtyre të fundit tek përgjegjësi i qarkut.

DEPARTAMENTI PRODHIMIT

Departamenti i Prodhimit është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme në RTSH dhe qëllimi i veprimtarisë së Departamentit të Prodhimit është realizimi artistik i programeve informuese, edukuese dhe argëtuese të RTSH-së, si edhe prodhimi i të gjitha materialeve video, audio, foto, skenografi, ndriçim etj... Ky departament mund të realizojë edhe prodhimin e programeve dhe spoteve të ndryshme audio dhe audiovizive, si edhe materialeve të tjera reklamuese, të porositura nga kompani, organizata, apo subjekte të tjera, me qëllim të përfitimit të të ardhurave financiare, apo materiale nga ana e RTSH-së. Të gjitha subjektet krijuese dhe realizuese koordinohen nëpërmjet një rrjedhe të punës (Ëorkfloë) të krijuar për mirë funksionimin e këtij departamenti. Njësia e Programeve, Njësia e Programeve Tematike dhe Lajmeve, paraqesin kërkesat e tyre për studiot e regjistrimit, regjisorë, montazh, studiot lëvizëse, transport dhe të tjera kërkesa pranë Departamentit të Prodhimit për të gjitha prodhimet në strukturën e tyre programore.

Departamenti Prodhimit ka një strukturë të ndërtuar më së miri në sektorët përkatës për të realizuar nevojat që ka institucioni. Departamenti është i përbërë nga:

- Drejtori i Drejtorisë
- Koordinatore Ekzekutive
- Sektori i Regjisë dhe Koordinimit
- Sektori i Kameramanëve
- Sektori i Operatorëve

- Drejtor Fotografie
- Sektori i Studiove
- Sektori i Montazhit
- Sektori i Montazh-Audios

Përgjatë vitit 2023 RTSH dhe Stafi i Departamentit të Prodhimit ka realizuar prodhimet në tabelën si më poshtë:

Emisione në studio	1500
Reportazhe	6
Dokumentarë Artistikë	5
Koncerte të RTSH, TKOB dhe Shfaqjet teatrale	165
Aktivitete Sportive	133
Aktivitetet e Presidentit	27
Seanca Plenare	40
Eventet e Kryeministrit	175
Zgjedhjet Lokale 2023	20 ditë

Përgjatë periudhës 2023 puna e Departamenti i Prodhimit, kanë qënë si më poshtë.

1. Rikonceptimi i Imazhit të RTSH me të gjitha elementët e Brand.
2. Rikonceptimi i Studiove të RTSH.
3. Krijimi i një strategjie të re në mënyrën e të punuarit në lidhje me stafin dhe zbatimit të hierarkisë profesionale.
4. Krijimi i Ëorkfloë për mirë funksionimin e Departamentit të Prodhimit.

Koordinatorë Ekzekutive

Puna e koordinatorë ekzekutive konsiston në planin javor të regjistrimeve, koordinimin e tyre në studio dhe në terren si dhe menaxhimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me pproçesin e punës në Departamentit të Prodhimit.

Koordinatorë Ekzekutive ka qënë përgjegjëse për koordinimin e të gjitha pproçeseve për plotësimin e kushteve të nevojshme të financimit, të infrastrukturës dhe teknologjisë, të pjesëmarrjes së njerëzve, etj., për të bërë të mundur realizimin me sukses të prodhimit të programeve. Janë zbatuar të gjitha kërkesat për regjistrimin e programeve nga Njësia e Programeve në RTSH, Njësia e Lajmeve dhe Programeve Tematike, Orkestra RTSH, Drejtoria e Marketingut.

Janë përgatitur të gjithë dokumentacionet në lidhje me, raportet mujore, honorare, kërkesa të ndryshme, listë prezencat si dhe të gjitha dokumentacionet në lidhje me procedurat për shërbimet e Institucionit nga palë të treta.

Në lidhje me punën e përgjithshme të Sektorëve

Spektori Regjisë dhe Koordinimit

Spektori i Regjisë dhe Koordinimit në Departamentin e Prodhimit ndjek të gjitha hallkat e prodhimit që kanë patur si qëllim prodhimin dhe finalizimin e një produkti sa më cilësor. Një nga sektorët më të rëndësishëm ka patur një përmiresim të dukshëm duke ju dhënë regjisorëve rëndësinë e duhur.

Spektori Kamerave

Spektori i Kamerave është një nga hallkat kryesore nga i cili vjen burimi i çdo materiali audioviziv. Kamera është objekti më i rëndësishëm në një televizion, pa të cilin nuk ka asnjë prodhim. Çdo material audioviziv merr formën bazë në momentin e ndezjes së kameras.

Spektori i Operatorëve

Spektori i Operatorëve luan rol kryesor nga i cili vjen burimi i çdo materiali audioviziv për sa i përket terrenit, realizimeve të Aktiviteteve me Regji Lëvizëse si edhe Aktiviteteve Sportive. Kamera është objekti më i rëndësishëm në një televizion, pa të cilin nuk ka prodhim.

Spektori i Studiove

Spektori i Studiove është kujdesur në çdo kohë për të gjitha hallkat e krijimit të një studio e cila është gati për regjistrim nga ana e rekuizitave dhe proceseve artistike. Bashkëpunimi ka qënë i drejtëpërdrejtë me Koordinatorin Ekzekutiv dhe Drejtorin e Prodhimit. Në këtë sektor ka patur një përmiresim të ndjeshëm në mënyrën se si realizohen proceset e prodhimit.

Spektori i Montazhit

Spektori i montazhit si një nga hallkat kryesore të zinxhirit të prodhimit, përgjatë vitit 2021 ka pasur një rëndësi të veçantë, ky sektor duke bërë pjesë të rinj të talentuar ku përkushtimi dhe pasioni ka qënë maksimal ka ndikuar ndjeshëm në përmiresimin e cilësisë së imazhit në RTSH.

Spektori Montazh Audio

Audio si një nga elementët shumë të rëndësishëm në realizimin e një produkti televiziv është një sektor i krijuar me ristrukturimin e Departamentit të Prodhimit.

Ky sektor është kujdesur për cilësinë e zërit për të gjitha realizimet dhe programet në RTSH, koncerte dhe shumë evente të mëdha të realizuar përgjatë vitit.

Analiza e Sektorëve në Departamentin e Prodhimit

Raport pune vjetor Janar - Dhjetor 2023 , Sektori Regji Koordinim

Gjatë vitit 2023 , kjo strukturë ka funksionuar me 18 regjisorë, 3 prej të cilëve pranë Njesisë së Lajmeve, 3 regjisorë në kanalin e sportit , 5 regjisorë në gjininë e shoët artistik, filmit dokumentar, spoteve dhe pjesa tjetër në emisionet në studio. Regjisorët në Njësinë e lajmeve mbulojnë edicionet e lajmeve, komisionet parlamentare dhe seancat e Kuvendit të Shqipërisë. Për të gjithë regjisorët që në fillim të vitit, pasi vlerësua edhe një herë aftësitë dhe kontributet e tyre në të kaluarën, i vendosëm nëpër programet e ndryshme në studio dhe jashtë saj. Po kështu, u veprua edhe me regjisorët e sportit pasi ky kanal shtoi numrin emisioneve në studio dhe aktivitet jashtë studios si; futboll, lojrat me dorë etj. Duke qenë se gama e emisioneve sipas gjinive të ndryshme si shoë artistik, teatri, filmi dokumentar, erdhi duke u rritur, u pa e nevojshme që të shikohej edhe më me kujdes se ku regjisorët mund të jepnin më shumë produktivitetin e tyre.

Në lidhje me ndarjen e punës në sektorin e regjisorëve me programet që ata realizojnë është bërë duke patur parasysh dhe një lloj “autospecializimi” të tyre, kuptohet që ka të bëjë me prirjet e përvojën e tyre gjatë viteve në televizion . Gjithashtu edhe regjisorët e rinj që kanë ardhur këtë vit në sektorin tonë jemi përpjekur të jenë me përvojë artistike për të rritur cilësinë e programeve.

Konstatoj me kënaqësi se sektori ka qenë eficient, duke realizuar në kohe dhe me cilësi të gjithë programet , pjesë e structures programore.

Disa nga objektivat të realizuara nga Sektori Regjisë dhe Koordinimit janë:

Detyra jonë kryesor ka qenë ofrimi i një larmie të gjerë programesh për publikun pa harruar misionin kryesor - informim, edukim, argëtim.

Rinovimi i studiove dhe ndryshimi i skenografive të emisioneve gjatë sezonit shtator-dhjetor bëri që të gjitha programet tona të ofronin një imazh dhe cilësi më të mirë të figures, për të qenë sa më konkurrues në tregun mediatic.

Disa nga programet të realizuara në studio tona:

Emisioni Mirmëngjes Shqipëri - regjisor Pirro Ngjeliu.



“Mirëmëngjes Shqipëri” sjell pranë publikut ngjarjet dhe tematikat më argëtuese të përditshmërisë tonë, duke e bërë publikun nga shtëpia pjesë integrale të emisionit. Emisioni është i ndërtuar me rubrika të ndryshme, një pjesë e të cilave e bën interaktiv publikun nëpërmjet rrjeteve sociale; muzikë, diskutime mbi çështje sociale, kalendar, këshilla, të ftuar të fushave të ndryshme, gjithçka në një këndvështrim pozitiv e çlodhës, për ta filluar ditën me energji të mira.

E hënë-e premte, ora 06:00



Emisioni Pasditja ime – regjisore Sara Jaupaj

“Pasditja ime” një emision i përditshëm social-kulturor i konceptuar që të prekë të gjitha grupmoshat, i cili do të shoqërojë pasditet tuaja. Nën moderimin e Gerta Gixharit, “Pasditja ime” do të trajtojë tema që nxisin debat, me pjesëmarrjen e të ftuarëve në studio.

E hënë, e premte, ora 17:05



Emisioni Artes - regjisore Sonila Basha

“Artes” ka për qëllim të nxisë kritikën në vend, një dimension i munguar për të mos thënë i harruar. Përfitimet konkrete janë më shumë morale sesa materiale, pasi qëllimi i këtyre lloj programeve është të rrisin vetëdijen për kulturën, artin dhe të nxisin konkurrencën e shëndetshme.

E martë, ora 23:00

Emisioni E diela jone - regjisor Armand Vllahu



E diel, ora 13:30

Çdo të diel do të ndiqni personazhe, debate, muzikë, lojëra telefonike, ngjarje sportive, rrëfime plot emocione, e histori suksezi.



Emisioni 3D –regjisor Lulzim Sula

Emisioni 3D ka një “hard talk” elegant, me gjuhë të pastër, të qartë dhe pa qëllime komerciale, por me qëllim utilitar.

Emisioni Me Ketin- regjisor Besian Kozma



E shtunë, ora 09:00

Një studio e mbushur me fëmijë të cilët luajnë, intervistohen dhe promovojnë talentet e tyre në fusha të ndryshme

Auditor Arsimi regjisor Besian Kozma

E shtunë, ora 16:35



Një emision nga Edlira Birko, në të cilin trajtohen tema të ndryshme mbi arsimin në vend me problematikat e tij, por edhe përcillen informacione të dobishme për të gjithë studentët.

Dritëhijet e personaliteteve historike regjisor Lulëzim Sula

Çdo të mërkurë, ora 19:00



Një emision i ideuar nga historiani i njohur, Prof. Paskal Milo.

Jetë Shqiptare regjisor Besian Kozma

E hënë- e Premte, ora 13:20

“Jetë Shqiptare” synon të sjellë informacion të verifikuar dhe analizë thelbësore mbi ngjarjet më të rëndësishme të ditës

“Jetë Shqiptare” synon të sjellë informacion të verifikuar dhe analizë thelbësore mbi ngjarjet më të rëndësishme të ditës



“Jetë Shqiptare” synon të sjellë informacion të verifikuar dhe analizë thelbësore mbi ngjarjet më të rëndësishme të ditës

Ekspres regjisor Ilir Drini



E hënë e premte, ora 16:35

Ekspres, vjen çdo ditë për t’iu përcjellë teleshikuesve një këndvështrim të plotë për të gjitha ngjarjet aktuale të ditës. 25 minuta për të shteruar me argumente, fakte, por edhe me këndvështrime në mënyrë sa më të plotë një moment të rëndësishëm të ditës. Nuk do të mungojnë as lidhjet e drejtpërdrejta në varësi të ngjarjeve konkrete.

Zona 30 regjisor Mirdit Çupi

E hënë- e premte, ora 18:30



Zona 30’, diskutime me të rejtat më të fundit nga futbollit ndërkombëtar, video të ndryshme për të qeshur, momente gazmore, kronika me statistika interesante, kuriozitete.

Rubrika sportive regjisor Ermal Beci



E hënë, ora 22:30

Analizë e detajuar mbi kampionatin kombëtar të futbollit. Specialistë të futbollit dhe të ftuar diskutojnë dhe debatojnë për ecurinë e nivelit më të lartë të futbollit shqiptar.

AND regjisor Mirdit Çupi

E diel, ora 23:00



ADN, një emision që ka në qendër artin, natyrën dhe demokracinë. Zbuloni më tepër për ngjarjet kulturore që shënjuan hapësirën publike dhe një reflektim se si po sillemi me natyrën. ADN nga Ilir Yzeiri, çdo të diel.

Trupi dhe shëndeti regjisor Vasilika Londo

Eshtunë, ora 19:00



Programi më jetëgjatë dhe ndër më të vjetrit në vend, “Trupi dhe Shëndeti”, vjen çdo të shtunë në ekranin e RTSH 1-HD.

Gjithashtu regjisorët janë të ngarkuar dhe me emisionet e kanalit Rtsh2 Rtsh3, Rtsh muzike, Rtsh sport pra me gjithë kanalet e platformës tonë dixhitale.

Orkestra Simfonike e RTSH-së ka patur një vit me aktivitet shumë të ngjeshur si gjatë Stinës Koncertore ashtu edhe jashtë saj, regjisor Ervin Kotori.



Gjithashtu gjatë vitit 2023 vijojnë regjistrimet për koncerte të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit që kemi me TKOB ku mund të përmendim një seri koncertesh me artistët e rinj të cilësuar si “Artistët e së Ardhmes”. Opera- Cavalleria Rusticana, opera “Carmen”

Regjisor Petri Bozo

Disa nga objektivat për vitin pasardhës

Impenjimi maksimal duke paraqitur projekte e tyre artistike përveç detyrave të sektorit.

E rëndësishme është marrja e brezit të ri krijues të cilët mund të japin ide më inovative duke u përshtatur më shumë me kohën dhe teknologjinë, gjë e cila të pasqyrohet në rritjen e cilësisë së programeve.

Mundësia e trajnimit të punonjësve në fusha specifike (sporti, shoë artistik etj..)

Bashkëpunimi regjisorëve dhe autorëve për të sjellë një produkt sa më cilësor artistik.

Bashkëpunimi i sektorit të regjisë dhe koordinimit me sektorët e tjerë të Departamentit të Prodhimit për të realizuar produkte të një cilësie të lartë për ekranin.

Sektori Kameramanëve (Plani vjetor per vitin Janar2023-Dhjetor 2023)

Sektori i Kamerave është një nga hallkat kryesore nga i cili vjen burimi i çdo materiali audioviziv. Kamera është objekti më i rëndësishëm në një televizion, pa të cilin nuk ka asnjë prodhim. Çdo material audioviziv merr formën bazë në momentin e ndezjes së kameras.

Sektori i kameramanëve është i përbërë në total prej 27 të punësuar. Emisione në studio,sport(ndeshje futboll,basketbolli,volejbolli),evente (koncerte,recitale) këto janë disa nga punët e kryera nga sektori i kameramanëve.

Gjatë viti 2023 jemi përkushtuar që të realizojmë çdo program dhe emision të programuar sipas planit të përcaktuar. Cilësia në xhirim, ka dhënë produktivitet në finalizimin e një produkti televiziv. Gjatë vitit 2023 për të gjithë emisionet, është bërë shpërndarja e mëposhtme:

1. “Mirëmëngjes Shqipëri”	205 Emisione
2. “Shendet Si”	24 Emisione
3. “Dite pas dite”	205 Emisione
4. “Bibliotekë”	40 Emisione
5. “Si ne familje”	157 Emisione
6. “Publikisht”	59 Emisione
7. “Evente qeveritare KM,Presidenti”	88 Evente
8. “Koncerte”	116 Koncerte,Spektakle
9. “Emisioni ADN”	41 Emisione
10. “Evente sportive futboll, volejboll,basketboll”	86 Evente Sportive
11. “Emisioni Artes”	48 Emisioni
12. “Rubrik Sportive	54 Emisione
13. Seanca Parlamentare	42 Seanca
14. Auditor arsimi	26 Emisione
15. Teatro	7 Shfaqje Teatrale
16. Emisioni Quiz	8 Puntata
17. Më prit ne fundjave	46 Emisione
18. 2A Kosherja	14 Puntata
19. Festivali Gjirokastres	10 Dite
20. Junior Fest	2
21. Zona 30	70 Emisione
22. Stacioni Roze	70 Emisione
23. Jete Shqiptare	70 Emisione
24. Para Fest	14 Emisione
25. Dritehijet e personaliteteve historic	15 Emisione
26. E diela jone	21 Emisione
27. Shqiperia inteligjente	6 Emisione
28. Nje nate sa nje jete	11 Emisione
29. Me ketin	8 Emisione
30. Emisioni 3D	32 Emisione
31. Trupi dhe shendeti	7 Emisione
32. Kur xhirohej nje film	8 Emisione

33. Fustanella	7 Puntata
34. Festivali fundvitit	8 Dite
35. Programi vitit te ri”	2 Puntata
36. Edicionet Informative çdo dite	

Shumëllojshmëria e punëve të kryera nga ky sektor kërkonte edhe një ndarje specifike. Kategorizim jo vetëm të punës por edhe të kameramanëve. Sporti ose xhirimi i eventeve sportive kërkon një specializim të veçantë përse i përket kameramanëve. dinamika e punës, shumëllojshmëria e planeve si dhe reflekse të cilat krijohen dhe fitohen me kalimin e kohës janë disa nga veçoritë që duhet të zotëroj një kameraman i këtij profili.

Çdo punë ka specifikat e veta prandaj edhe kategoritë janë specifike për punën që kryet. Kameramanët e studios kanë specifika të tjera.

Rezultati final i punës tone është të dalim në trasmetim në orarin e caktuar nga programacioni, kjo kërkon përkushtim jo vetëm nga ana jonë por edhe nga sektorët e tjerë që marrin pjesë në prodhimin e çdo eventit. Tekniku i figurës është pjesë shumë e rëndësishme ashtu si edhe tekniku i pultit. Figura është ajo që shofim por nevoja për të digjuar është e nevojshme, prandaj edhe fonia(audio) është hallkë themelore e këtij zinxhiri pune.

Përpara se të dalë në trasmetim çdo event si emisionet në studio, koncertet, festivalet etj, kërkojnë një punë kolosale edhe në letër. Pjesë vitale e emisionit është dekori dhe ndriçimi, kjo nuk do të bëhej e mundur pa skenografët dhe teknikat e ndriçimit. Normalisht kjo kërkon edhe mirëmbajtje e cila kryet nga punetoret e studios. Teknologjia e përdorur e bën punën më të lehtë për të gjitha palët.

Organizatorët, gazetarët redaktotër si dhe asistentet janë ajo pjesë thelbësore që përgatisin eventin para se të dalë në trasmetim. Temat që do trajtohen kronikat që do të regjistrohen të ftuarit janë vetem një pjesë e punës së tyre.

Emëruesi i përbashkët i të gjithë këtyre sektorëve është regjisorin.

- VIII. Bazuar në kërkesë e Drejtorisë së Integrimit European, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media” plotësimin të formularëve online për vlerësimin e nevojave për trajnim në kuadër të forcimit të kapaciteteve të integrimit evropian për periudhën 2024-2025, nga Sektori i Marrdhënieve Ligjore i është dërguar plotësimi i formularëve anëtarët përfaqësues të institucionit të RTSH Kapitullin 10 “Transformimi Digjital dhe Media” dhe janë plotësuar formularët online për vlerësimin e nevojave për trajnim në kuadër të forcimit të kapaciteteve të integrimit evropian për periudhën 2024-2025.
- IX. Bazuar në detyrimin e RTSH për shqyrtimin e ankesave nga Bordi i Shqyrtimit të Ankesave pranë RTSH, nga Sektori i Marrdhënieve Ligjore janë trajtuar të gjitha ankesat me objekte të përcaktuar në ankesë, në drejtim të institucionit të RTSH-së, brënda afatit 7 ditor nga momenti i mbërritjes së ankesës në RTSH drejtuar Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- X. Sektori i Marrdhënieve Ligjore ka ndërmarrë të gjithë procedurën ligjore dhe ka finalizuar marrëveshje me Sportelin Unikt të Adminsitrimin të së Drejtës së Autorit për vitin 2023, me objekt “ Dhënie në mënyrë të pakufizuar përdorimi, nga SUADA në favor të përdoruesit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, për shfrytëzimin dhe komunikimin në publik të veprave me të drejta autorit të mbrojtura dhe të administruara nga ligji nr.35/2016 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij” , kundrejt shpërblimit të përcaktuar në këtë kontratë/autorizim.
- XI. Sektori i Marrdhënieve ligjore ka marrë pjesë në takime të zhvilluara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive për ndryshimet në ligjin nr.97/2016 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- XII. Me anë të Urdhërit nr.738 prot, datë 04.03.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm, specialistja e Sektorit të Marrdhënieve Ligjore ushtron kompetencat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit për RTSH-n, dhe ndjek çdo kërkesë për informacion apo dokumentacion që përfshin këtë fushë. Për periudhën objekt relacioni, ka pasur gjithsej 6 (gjashtë) kërkesa për informacion, të cilat i janë deleguar drejtorive përkatëse përgjegjëse për informacionin e kërkuar dhe brënda afatit ligjor të përcaktuar nga ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” është dërguar kthim përgjigje sipas formatit të specifikuar (postë/postë elektronike).
- XIII. Nga Sektori i Marrdhënieve Ligjore janë lidhur kontrata me objekt “për vendosjen e ATM” me subjektet “Raiffeisen Bank”, “Union Bank” dhe “Tirana Bank”.
- XIV. Nga Sektori i Marrdhënieve Ligjore është trajtuar dhe ndjekur e gjithë procedura për realizimin e koncerteve të Orkestrës Simfonike të RTSH-së, me Teatrin e Operas dhe Baletit apo dhe me Qendrën e Katedrales Ortodokse dhe janë finalizuar kontratat respektive për marrjen me qira të ambjenteve, për realizimin e koncerteve nga Orkestra Simfonike e RTSH-së.
- XV. Është trajtuar rasti i komunikimit me Këshillin e Ministrave për caktimin e strukturës përgjegjëse që do të ushtronte përgjegjësinë e autoritetit kontraktor në kontratën me kompaninë fituese të garës “Rohde & Schëars për financimin, projektimin, furnizimin, instalimin, trajnimin dhe transferimin e rrjetit DVB-T2 për Republikën e Shqipërisë.

- XVI. Janë hartuar Urdhëra për ngritjen e grupeve të punës, grupeve të xhirimit dhe dërgimin e personelit me shërbim, sipas natyrës dhe objektit të përcaktuar në kërkesat e drejtorive përkatëse në RTSH.
- XVII. Sipas njoftimeve nga zyrat përmbartimore gjyqësore private janë kryer njoftime në drejtoritë përkatëse dhe janë nxjerrë urdhëra për heqjen apo vendosjen e masës së sekuestros mbi pagën e punëmarrësit.
- XVIII. Janë realizuar korrespondenca me institucionet shtetërore dhe subjekte private.

PROCESET GJYQËSORE

Spektori i Marrdhënieve Ligjore sa i takon çështjeve gjyqësore ka përgatitur Deklarata Mbrojtje sipas kërkesë-padive të palëve paditëse, të cilët i janë drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke mbledhur prova dhe dokumentacion në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, si dhe duke hartuar qëndrime përfundimtare sipas secilës fazë të proceseve gjyqësore. Për këtë periudhë për specialistët e Sektorit të Marrdhënieve Ligjore janë ndjekur proceset gjyqësore si më poshtë:

A. Procese gjyqësore me vendime në favor të palës paditëse , RTSH/ pala e paditur:

1. Paditësi, Ilirjan Cuku, i Paditur, RTSH, me objekt : “Dëmshpërblim Page”. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka vendosur pranimin e padisë së palës paditëse, z. Ilirjan Cuku. RTSH është në pritje të vendimit të zbardhur, në mënyrë që të vijojë me procedurën e ankimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Paditës, Arto 2018, i Paditur, RTSH, Objekti “Shfuqëzim e Akteve Administrative” çështja është duke u shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës të Parë Tiranë.
3. Paditësi, z.Genc Gjika, i Paditur, RTSH, objekti: “Dëmshpërblim Page”. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka vendosur pranimin e padisë së palës paditëse, z.Genci Gjika. RTSH ka ndjekur procedurën e ankimit kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës të Parë në favor të paditësit, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Paditësi, Kleart Duraj, i Paditur, RTSH, objekti: “Dëmshpërblim Page”. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka vendosur pranimin e padisë së palës paditëse, z.Kleart Duraj. RTSH ka ndjekur procedurën e ankimit kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë në favor të paditësit, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
5. Paditës, Donika Leka, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka vendosur pranimin e padisë së palës paditëse, z.Donika Leka. RTSH ka ndjekur procedurën e ankimit kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë në favor të paditësit, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
6. Paditëse, Behije Dyrmyshi, i Paditur , RTSH , Objekti : “Dëmshpërblim Page”. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka vendosur pranimin e padisë

së palës paditëse, z. Behije Dyrmyshi. RTSH është në pritje të vendimit të zbardhur, në mënyrë që të vijojë me procedurën e ankimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

7. Paditës, Sokol Gjoshi, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. Çështja është fituar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. RTSH ka ndjekur procedurën e ankimit kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë në favor të paditësit, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
8. Paditëse, Mirela Oktrova, i Paditur, RTSH, Objekti “Shfuqëzim vendimi, Dëmshpërblim page”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.977, datë 13.03.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë së palës paditëse. Ndërsa Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në datë 14.09.2023 ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, dhe më datë 04.10.2023 ka vendosur pranimin e kërkesë padisë së palës paditëse, znj. Mirela Oktrova. RTSH është në pritje të vendimit të zbardhur, në mënyrë që të vijojë me procedurën e Rekursit në Gjykatën e Lartë Tiranë.
9. Paditës, z. Bardhyl Domi, i paditur, RTSH, për çështjen me objekt: “Dëmshpërblim si pasojë e aksidentit të ndodhur në Stacionin Fllakë. Paditësi ka fituar në Gjykatën e Shkallës së Parë Kavajë gjithsej shumë prej 36.361.270 (tridhjetë e gjashtëmilion e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, ku shumë prej 10.284.602 (dhjetëmilion e dyqind e njëzet e katërmijë e gjashtëqind e dymijë) lekë është ekzekutuar nga përbarimi, duke përfshirë shpenzimet gjyqësore dhe përbarimore, çështja është ankimuar nga RTSH në Gjykatën e Apelit Durrës në lidhje me detyrimet që i ngarkohen RTSH me Vendimin nr.297, datë 17.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në vlerën prej 6.106.440 lekë, dëmin biologjik në vlerë 11.877.415 lekë, dëmin moral në vlerë 5.938.707.5 lekë, dëmin ekzistencial në vlerë 5.938.707.5 lekë, dhe shpenzime fizioterapie në vlerë prej 6.500.000 lekë, në total vlerë prej 36.361.270 lekë, RTSH sipas vendimit të mësipërm është debitorë në shumë prej 26.076.668 (njëzet e gjashtëmilion e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.
10. Paditës, Shoqëria “Mc Netëorking”, i Paditur Komisioni i Prokurimit Publik dhe RTSH, çështja me objekt: “Shfuqëzim akti administrative”. Çështja është duke u gjykuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
11. Paditës, RTSH, i Paditur, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Objekti: “Pavlefshëminë absolute të aktit administrativ”. Çështja është duke u gjykuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

B. Proçese gjyqësore të pushuara në Gjykatën e Shkallës së Parë :

1. Paditëse, z. Artur Bejzade , i Paditur, RTSH , Objekti: “Dëmshpërblim Page”, çështja është pushuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Paditëse, z. Asllan Merlika, i Paditur, RTSH dhe Agjensia e Trajtimit të Pronave, Objekti: “ Njohjen e së drejtës së pronësis dhe kompesimin fizik ose financiar të

subjektit Asllan Merlika dhe të trashëgimtarëve”, çështja është pushuar në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

C. Proçese gjyqësore për të cilët është depozituar Deklarata Mbrojtëse dhe priten zhvillimet e seancës së parë ose janë në proçes gjykimi.

1. Padiësia, znj. Uljana Marku është në proçes gjyqësor me palën e paditur, RTSH me objekt “Dëmshpërblim në shumën 400.000 (katërqind mijë) lekë dhe kamat vonesat ligjore, si pasojë e aksidentit të ndodhur shtetasit, z. Bardhyl Domi në stacionin Fllakë”. Çështja është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Padiës, z. Besim Meta, i Paditur RTSH, Objekti: “Diskriminim financiar dhe zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës”. Është dorëzuar Deklarata e Mbrojtjes. Çështja është duke u gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Padiës, z.Redjan Mulla, i Paditur RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. Është dorëzuar Deklarata e Mbrojtjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes gjyqësore.
4. Padiëse, znj. Ana Mihali, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. Është dorëzuar Deklarata e Mbrojtjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe jemi në pritje të fletë thirrjes për shqyrtimin e çështjes gjyqësore.
5. Padiëse, znj. Fiona Hajdëri, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. Është dorëzuar Deklarata e Mbrojtjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe jemi në pritje të fletë thirrjes për shqyrtimin e çështjes gjyqësore.
6. Padiëse, z. Pëllumb Troçi, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. Është dorëzuar Deklarata e Mbrojtjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe jemi në pritje të fletë thirrjes për shqyrtimin e çështjes gjyqësore.
7. Padiëse, z.Klevis Sulioti, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. Është dorëzuar Deklarata e Mbrojtjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe jemi në pritje të fletë thirrjes për shqyrtimin e çështjes gjyqësore.
8. Padiëse, znj. Anila Magjistari, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
9. Padiës, z. Arian Xhani, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
10. Padiëse, znj. Brisela Mehmetallari, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

11. Paditëse, znj. Devis Xhaja, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
12. Paditëse, z. Ogert Peza, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
13. Paditëse, znj. Blerina Hamzollari, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
14. Paditëse, z. Adriatik Braçe, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
15. Paditëse, znj. Tatjana Shele, i Paditur, RTSH, Objekti: “Përmbushje detyrimi dhe kamat vonesa ligjore”. RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
16. Paditëse, znj. Gerald Gjorgjini, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
17. Paditëse, z. Dritan Mile, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
18. Paditëse, z. Elton Kadisi, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
19. Paditëse, z. Pluton Vasi, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
20. Paditëse, z. Tahir Gjoci, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
21. Paditëse, z. Ditmir Krasniqi, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
22. Paditëse, z. Gerti Selenica, i Paditur, RTSH, Objekti: “Dëmshpërblim Page” . RTSH ka dorëzuar Deklaratën e Mbrojtjes dhe jemi në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
23. Paditëse znj. Metila Dylgjeri, i paditur, Radio Televizioni Shqiptar, Objekti: “Dëmshpërblim Page”. Çështja është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
24. Paditëse, Jona Karapinjalli, I Paditur, RTSH, Objekti: “Kundërshtim Vendimi”. Çështja është duke u gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

SEKTORI I PROKURIMEVE

Sektori i Planifikimit dhe Prokurimeve gjatë vitit 2023, specialistët që ushtrojnë detyrën pranë këtij sektori kanë kryer procedurat si më poshtë:

1. Procedura e Prokurimit-Blerje me vlerë të vogël.

- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje inverter dhe bateri inverteri për studion lëvizëse SNG.”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 24.02.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje Inverter dhe bateri inverteri për studion e re lëvizëse për kanalin RTSH-24”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 25.08.2023
- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje Letër A4 për nevoja të RTSH-së”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 07.06.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje bordi COFDM Demodulimi për linkun portabël “ELBER”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 03.10.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje kabëll ½ dhe 7/8”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 31.03.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale dhe pajisje per Sektorin e Transmetimeve Satelitore dhe të Lëvizshme” e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 31.01.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale elektrike të studios lëvizëse HD1”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës.
- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje printer kartash me chip për nevojat e RTSH-se”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 16.05.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Furnizim – Vendosje Kondicioner 60 TBU katërfaqës tavanor”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 20.09.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit “Blerje me vlerë të vogël” me objekt: “Furnizim vendosje Bordi Oscilatorit lokal (LO_PM) për riparimin e linkut dixhital "ELBER" CPM-R”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës.
- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës.
- Është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Rinovimi i licencës së programit Antiransomëare, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 30.08.2023.

2. Procedura e Prokurimit-Tender i Hapur dhe Tender i hapur i thjeshtuar.

- Është realizuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Blerje pjesë dhe materiale për pajisje kompjuterike për nevoja të RTSH”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 15.05.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Blerje Mikser Video Portabel për nevojat e RTSH-së”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 04.12.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Rinovimi i liçencës së programit Antiransomëare”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 30.08.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me objekt: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 15.05.2023
- Është realizuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me objekt: “Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me Fibër Optike”, e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 12.05.2023

3. Blerje me vlerë nën 100.000 lekë.

Gjatë viti 2023 janë realizuar dhe procedura blerje nën vlerën 100.000 lekë si më poshtë:

- "Blerje kafe për nevoja të RTSH"
- "F.V dyer metalike 90x205 dhe 120x205"
- "Prodhim logo pleksiglas me gravurë"
- F.V Dritare duralumini dopio xham”
- Blerje kufje profesionale
- Blerje materiale Kondesator
- F.V Strukturë mbajtëse për televizorë
- Kërkesë për bluza të stampuara me logon e RTSH-së

4. Blerje emergjente

- Është realizuar procedura e prokurimit “Blerje emergjente” me objekt: “Riparim i fibrës Dark ” në datë 06.09.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit “Blerje emergjente” me objekt: “Kërkesë emergjente për blerje tonerash ” në datë 30.10.2023.
- Është realizuar procedura e prokurimit “Blerje emergjente” me objekt: “Blerje bateri gjeneratori” në datë 30.08.2023.

5. Procedura “Blerje Bileta udhëtimi me avion-Sistemi Dinamik”

- Janë zhvilluar 83 (tetëdhjetë e tre) procedura blerje bileta udhëtimi me avion - Sistemi Dinamik. Procedurat janë zhilluar duke ndjekur me përpikmëri Udhëzimin Nr.3 datë **18.06.2021**“Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin e tyre me mjete elektronike”.

6. Procedura e realizimit –Skenografi

- Është realizuar procedura Skenografi me objekt: “ Para fest” e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratave më datë 05.10.2023, datë 06.10.2023 dhe datë 03.11.2023.
- Është realizuar procedura Skenografi me objekt: “ Skenografi multifunkionale te Studio nr.1 e RTSH-së” e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës së shërbimit më datë 20.09.2023.
- Është realizuar procedura Skenografi me objekt: “ Sistemimi i tubave në funksion të skenografisë multifunkionale të Studio nr.1” e cila është konkluduar me nënshkrimin e kontratës më datë 18.10.2023.

7. Procedura të anuluar

Gjatë viti 2023 edhe pse ishin parashikuar disa prokurime procedurë e hapur e thjeshtuar, këto prokurime nuk u realizuan dhe u anuluan për sa më poshtë:

- U anulua procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Punime për zgjerimin e hapsirave të brendshme në studion televizive Nr. 3 të RTSH-së”, pasi Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.
- U anulua procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Punime për rigjallërimin e sallës së orkestrës simfonike të Rtsh-së”, pasi referuar Germës C neni 98 të ligjit Nr.162, të datës 23.12.2021 për Prokurimin Publik ku citohet se autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme.
- U anulua procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Për Sigurimin e Pajisjeve Audio për Rigjallërimin e Sallës së Orkestrës Simfonike të Rtsh-së” , pasi referuar Germës C neni 98 të ligjit Nr.162, të datës 23.12.2021 për Prokurimin Publik ku citohet se autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme.

SEKTORI GIS DHE ADMINISTRIMI I PRONAVE

Sektori GIS dhe Administrimit të Pronave është krijuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.19, datë 05.06.2018 më strukturë përbërëse 1-Përgjegjës Sektori, 1-Specialist, 1-Inxhinjer Topograf. Me Vendimit nr.09, datë 15.3.2022 të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Sektori GIS dhe Administrimi të Pronave kaloi si pjesë e strukturës organike të Drejtorisë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH-së duke u reduktuar në strukturë organike me 1-Përgjegjës

Sektori dhe 1-Specialist, ashtu sic dhe funksionon sot. Misioni i Sektorit GIS dhe Administrimit të Pronave është paisja me dokumentacionin e pronësisë të të gjitha pronave, që janë nën administrimin e Radio Televizionit Shqiptar. Ai ndjek të gjitha etapat e procesit të regjistrimit të pasurive publike në administrim të tij, nëpërmjet shërbimve kadastrale të ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës në platformën e-albania. Sektori GIS dhe Administrimit të Pronave, ka për detyrë, të sigurojë materialet hartografike, (fragmente hartash etj) dhe, çdo të dhënë tjetër që është e nevojshme, në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, që shërben, për regjistrimin e pasurive publike në administrimin tonë. Gjatë periudhës objekt raportimi Sektori GIS pranë Drejtorisë Juridike ka vijuar punën për regjistrimin e pronave të RTSH-së në zbatim të Ligjit nr.97, datë 04.03.2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Statutit të RTSH-së, kryesisht të pasurive si më poshtë :

1. Ka vazhduar korespondencën shkresore me ASHK Vlorë për pronën Stacion DVB T2 , Shashice Rradhime dhe Radio -Stacioni Zvërnec që nga muaji shkurt 2023 e deri sot me kërkesa të përsëritura për bashkëpunim dhe në pritje të përgjigjës për mbylljen e regjistrimit të këtyre pasurive publike. Për cdo korespondencë është vënë në dijeni dhe ASHK –Drejtoria e Përgjithshme për marrje masash për mosveprime nga ASHK-të vendore.
2. Ka vazhduar korespondencën shkresore me Bashkinë Përmet për të shprehur dakortësinë e saj në lidhje me sipërfaqet në të cilat janë ndërtuar Stacioni DBVB T2 në NB Opërmet dhe Stacioni DVB T2,Çarshove Përmet, si rezultat i gabimit të regjistrimit nga ASHK Përmet.
3. Ka vazhduar korespondencat shkresore me ASHK Gjirokastrë për rregjistrimin e pronës Radio Stacion Gjirokastrë, Përsëritës Radio Televiziv Golem , Përsëritës Radio Televiziv- Fushë Bardhë që nga muaji shkurt 2023 e deri sot me kërkesa të përsëritura për rregjistrimit të këtyre pasurive publike. Deri me sot për Radio Stacion Gjirokastrë, Drejtoria Vendore e ASHK-Gjirokastrë është shprehur se kjo pasuri nuk është në pronësinë tonë ndërsa për dy pasuritë e tjera nuk na ka kthyer asnjë përgjigje për vazhdimin e procedurave të regjistrimit. Për çdo korespondencë është vënë në dijeni dhe ASHK –Drejtoria e Përgjithshme për marrje masash për mosveprime nga ASHK-të vendore.
4. Si në muajin shkurt dhe në korrik janë kryer kërkesa të përsëritura drejtuar ASHK Sarandë lidhur me regjistrimin e S.T DVB-T2 Shën Vasil, S.T. DVB-T2, Ksamil dhe, Përsëritësit Radio-Televiziv Konispol Sarandë dhe deri më sot nuk ka asnjë reagim për vazhdimësinë e procesit të regjistrimit të këtyre pasurive publike, edhe pse për këto korespondenca është bërë me dije dhe ASHK –Drejtoria e Përgjithshme.
5. Për pasuritë publike Radio Stacionin Mile (DVB T2)/Sarandë, Ish Radio Stacionin Cukë (DVB T2)/Sarandë dhe Radio Stacioni Sopot, Rrethi Delvinë për të cilat disponojmë Vërtetim Hipotekor i jemi drejtuar ASHK Drejtoria Vendore Sarandë në lidhje me rifreskimin e dokumentacionit të pronësisë. (Certifikatë Pronësie, Kartelë e pasurisë dhe Hartë Kadastrale). ASHK Drejtoria Vendore Sarandë nuk vijon me regjistrimin e e pasurisë publike Radio Stacionin Mile (DVB T2)/Sarandë pasi sipas

kësaj drejtorie pasuria jonë krijon mbivendosje 100% me ish pronarët e kësaj sipërfaqe. Ky pretendim i ASHK-Sarandë do të verifikohet nëpërmjet dokumentacionit teknik-Plan Rilevimi. Edhe për pasurinë Radio Stacioni Sopot, Rrethi Delvinë, me hartimin e dokumentacionit teknik –Plan Rilevimi do të vijohen procedurat.

6. Në lidhje me pronën Stacion DVB T2, Llogara/Vlorë, nga korrespondecja jemi informuar se për momentin nuk do të kemi rifreskim të dokumentit të pronësisë për shkak të mosfutjes së zonë në sistemin e ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
7. Në lidhje për pronën Radio Stacion Qaf Prush, Rrethi Has kemi kërkuar rifreskim të dokumentit të pronësisë por për shkak të mungesës së dokumentacionit teknik –Plan Rilevimi nuk kemi vazhduar më tej korrespondecën.
8. Për pasurinë publike Qendra Vendore Audiovizive –Korcë në kemi paraqitur kërkesë për regjistrim pasurie e cila u përmbyll me pajisjen me dokument pronësie.
9. Për pasurinë publike për QVA-Radio Shkodra pas kthimit të përgjigjes nga ASHK-Drejtoria Vendore Shkodër për plotësim dokumentacioni nga ana jonë kjo korrespondecë nuk ka vijuar me tej për moskonfirmim të fletës së inventarit nga Drejtoria Ekonomike për shkak të mospërputhshmërisë së sipërfaqes të pasqyruar.
10. Për rregjistrimin e pasurisë Radio Stacionin Kuc/Shkodër, kemi kryer aplikimin për ofrimin e shërbimit kadastral dhe procedurat nuk kanë vijuar pasi nga ASHK-Drejtoria Vendore Shkodër nuk na mundëson kryerjen e aplikimit AVo për këtë kërkesë.
11. Me shkresën nr.828 prot, dt, 11.04.2023, i jemi drejtuar Drejtuar Policisë Rrugore/Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit lidhur me marrjen e masave për lirim dhe dorëzimin e pronës pasuri publike Ish-Parkun e Automjeteve, pronë kjo në administrimin e RTSH, sipas dokumentacionit të pronësisë.
12. Për pasurinë Stacion DVB T2, Mabe –Dragush dhe Stacion DVB T2- Balldren, Lezhë i jemi drejtuar ASHK-Drejtoria Vendore Lezhë për regjistrimin e pasurisë dhe nga ana e tyre është kërkuar referenca ligjore dhe dokumentacioni teknik-plan rilevimi.
13. Ka vazhduar korrespondecja shkresore me ASHK –Drejtoria Vendore Përmet për pasurinë Përsëritës në Borockë, por edhe pse kemi kryer aplikimin për ofrimin e shërbimit kadastral dhe nga ana e kësaj drejtorie nuk ka asnjë reagim nuk na mundëson kryerjen e aplikimit AVo për këtë kërkesë. Nga ana jonë është vënë në dijeni dhe ASHK –Drejtoria e Përgjithshme për marrje masash për mosveprime nga ASHK-ja vendore.
14. Ka vazhduar korrespondecja shkresore me kërkesa të përsëritura me ASHK –Drejtoria Vendore Mirditë për regjistrim pronë të Stacioneve DVBT2 Lurth/Sheshaj dhe Kodër Rrëshen /Gëzhiq, por nga ana e saj kjo drejtori nuk ka vepruar për shkak se këto sipërfaqe në të cilat janë ndërtuar Stacioni DBVB T2 janë rregjistruar në emër të Bashkisë Mirditë. Së fundmi i jemi drejtuar Bashkisë Mirditë për shprehjen e dakortësisë së saj për heqjen dorë nga këto sipërfaqe për të hapur rrugë procesit të regjistrimit.
15. Për pasuritë publike Stacion DVB-T2 Leskovik dhe Përsëritësit Radio-Televiziv Rehovë, Kolonjë kemi kryer aplikimin për regjistrimin e këtyre pasurive pranë ASHK-Drejtoria Vendore, Kolonjë dhe pas korrespondecës së fundit kemi vijuar me ngarkimin online të dokumentacionit të pronësisë. Jemi në pritje të mbylljes së procesit të regjistrimit.

16. Për pasuritë publike Stacionet DVB-T2, Bogove –Therapel dhe Çorovodë Skrapar kemi aplikuar pranë ASHK-Drejtoria Vendore, Skrapar, por nuk ka përfunduar si proces, për arsye të mungesës së planit të rilevimit, sipas formatit të përcaktuar në VKM-në 782/2020.
17. Për pasurinë publike Stacionin DVB-T2 në Tushemisht, Pogradec kemi aplikuar pranë ASHK-Drejtoria Vendore, Pogradec por nuk ka përfunduar si proces sepse, nuk pranojnë fletën e inventarit të cilën ja kemi nisur dhe sqaruar modelin për të disatën herë. Së fundmi i kemi drejtuar ASHK–Drejtoria e Përgjithshme për marrje masash për mosveprime, zvarritje nga ASHK-ja vendore.
18. Për pasurinë publike Stacion DVB-T2 në Mbreshtan, Berat, kemi aplikuar pranë ASHK-Drejtoria Vendore, por nuk ka përfunduar si proces, për arsye të mungesës së planit të rilevimit, sipas formatit të përcaktuar në VKM-në 782/2020.
19. Për institucionale të RTSH kemi aplikuar pranë ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug” për kartelë pasurie dhe hartë treguese për pasurinë publike e RTSH-Selia Tiranë, dokumentacion ky i cili u mor me sukses.
20. Me shkresën nr.1771/1 prot, datë, 23.08.2023, “Kthim Përgjigje Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Tiranë, Sektorit të Menaxhimit” kemi informuar Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në lidhje me pasuritë publike që ne i kemi në administrimin tonë si Radio Stacion Dajt(Majë e Malit) si dhe Stacioni Fushë Dajt.
21. Me shkresën me nr.2259/1 prot, datë, 20.10.2023 si dhe shkresa me nr.2259/3 prot, datë, 13.12.2023 “Kthim përgjigje Vodafon Albania Sh. A” kemi sqaruar se RTSH është e vetmja pronare e ligjshme e Stacionit të Sopotit, ku është vendosur edhe antena celulare e Kompanisë “Vodafone Albania” sh.a, për të cilën është lidhur kontrata e qirasë me nr.prot 2640, datë 16.10.2002 (rinovuar në vazhdimësi). Pronësia mbi këtë pronë vërtetohet nga Vërtetimi Hipotekor nr.67, datë 24.09.2004 i ZRPP-së Sarandë dhe i përket zonës kadastrale 2396, ndaj çdo veprim apo mosveprim i palëve të treta që çenojnë gëzimin e qetë të kësaj prone gjatë periudhës së qirasë, është i paligjshëm dhe garantohet nga ana jonë ashtu si dhe deri tani.

Pavarësisht realizimeve të deritanishme dhe profesionalizmit të treguar, për Sektorin mbetet prioritet, pajisja me Çertifikata Pronësie i pronave që administrohen nga RTSH-ja, duke interpretuar dhe zbatuar në mënyrë rigorozë kuadrin ligjor rregullator në menaxhimin e problemeve juridike të paraqitura nga ASHK-të, me qëllim, paisjen e çdo pronë me çertifikatë pronësie.

Për realizimin e këtij objektivi dy janë problematikat që duhet të marrin zgjidhje.

- Mungesa e planeve të rilevimit
- Mungesa e bashkëpunimit me ASHK-të vendore, mosmarrja parasysh e Udhëzimit nr.4 , datë 18.12.2003 e dalë nga ish Zyra Qendrore e Pasurive të Paluajtëshme mbi mënyrën e regjistrimit të pasurive publike në administrim të RTSH-së.

Drejtoria Juridike ka parashikuar që për vitin 2024 e në vazhdim nevojat për trajnim për të gjithë punonjësit e Drejtorisë Juridike, Sektin e Marrdhënieve Ligjore, Sektorin e Planifikimit

dhe Prokurorit Publik dhe Sektorin GIS dhe Administrimit të Pronave me qëllim që stafi i vet të përditësohet në çdo kohë me zhvillimet në fusha të ndryshme, të avancojë në karrierë, si dhe të risi zhvillimin personal dhe profesional.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Rekrutimet, punësimet, lëvizjet e punonjësve dhe ndryshimet në strukturën analitike.

Për periudhën Janar- Dhjetor Struktura Organizative e RTSH-së nuk ka pësuar ndryshime.

Lidhur me plotësimin e vendeve të lira në strukturë, janë përgatitur dhe shpallur gjithsej **158 njoftime** për shpallje vendi vakant.

Pas shpalljes së njoftimeve për vendet vakante, janë mbledhur të gjitha aplikimet e dorëzuara, duke u shqyrtuar dhe klasifikuar sipas emërtesave të vendeve vakante.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të grumbulluar, janë kualifikuar për t'u paraqitur në konkurs vetëm ata kandidatë të cilët plotësonin kriteret e shpallura në publikimin në faqen zyrtare të UEB

Nëpërmjet postës elektronike, janë njoftuar të gjithë kandidatët kualifikues si dhe komisioni i vleresimit, për datën dhe orën e zhvillimit të konkursit.

Janë zhvilluar gjithsej **155 konkurse**.

Në strukturën analitike janë bërë këto lëvizje:

Janë marrë në punë 155 punonjës.

Janë larguar 142 punonjës.

Për të gjitha lëvizjet janë zbardhur 267 vendime si më poshtë:

- 154 vendime emërimi
- 38 vendime lëvizje në detyrë
- 19 vendime komandim në detyrë
- 14 vendime për zëvendësim leje lindje
- 3 vendime zëvendësim në detyrë
- 110 vendime largim nga puna si më poshtë:
 - 35 vendime zgjidhje marrëdhënie pune me procedurë.
 - 69 vendime zgjidhje marrëdhënie pune me dëshirë nga punëmarrësi.
 - 6 vendime zgjidhje marrëdhënie pune me braktisje vend pune.
- 24 dalje në pension pleqërie.
- 2 lirim nga detyra.
- 4 shfuqizim vendim komandimi.

Janë hartuar 206 kontrata pune për punonjësit sipas vendimeve përkatëse të marrjes në punë.

Të gjitha vendimet e emërimeve / lëvizjet në detyrë / daljet në pension / zgjidhje marrdhënie pune, janë pasqyruar në mënyrë të rregullt:

- Në Strukturën Analitike duke bërë rakordimet përkatëse me Drejtorinë Ekonomike
- Janë bërë regjistrimet e lëvizjeve në regjistrat themeltar.
- Janë bërë ndryshimet në librezat e punës.
- Një kopje e vendimeve janë vendosur në dosjen personale të punonjësit.

Për punonjësit e rinj janë marrë masat e nevojshme për t'i prezantuar me mjedisin e punës, strukturën sipas pozicionit të punës, përshkrimin e punës, pajisjen me kartën e aksesit dhe e-mail-in zyrtar të punës, janë shtuar kontaktet e herëpashërëshme, në mënyrë që t'ju bëhej gjithëcka prezent, apo për t'i ndihmuar në zgjidhjen e çdo problemi të dalë në punë e sipër, sa herë që kjo gjë ka qenë e nevojshme.

Për punonjësit e larguar nga puna si dhe rastet e daljes në pension pleqërie, pas dorëzimit të punës janë bërë:

- Plotësimet e librezave të punës.
- Tërheqja e dosjes personale të punonjësit të larguar me kërkesë të punonjësit.
- Plotësimi i Regjistrat Themeltar.
- Komunikimi dhe rakordimi me Drejtorinë Ekonomike për vitet e punës, si dhe për nxjerrjen e pagave në vite, për punonjësit të cilët kanë dalë në pension pleqërie gjatë kësaj periudhe.

❖ **Masa disiplinore**

Si pasojë e kontrolleve fizike të ushtruara dhe verifikimeve të bëra herë pas here nëpërmjet sistemit të hyrje-daljeve në institucion me qëllim përmirësimin e frekuentimit sa më të mirë të punës, si dhe forcimin e disiplinës në punë apo pas informacioneve për thyerje të etikës apo rregullave të punës dhe propozimeve për masë, të ardhura nga drejtues të ndryshëm në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, janë zhvilluar 71 takime për bisedime me punonjës të institucionit si dhe janë mbajtur procesverbalet përkatëse, të cilat janë vlerësuar me 58 masa disiplinore dhe 12 pushim procedurë disiplinore.

Gjithsej janë dhënë **86 masa disiplinore** ndaj punonjësve, për shkelje të disiplinës dhe thyerje të rregullave në punë.

❖ **Ndihma financiare**

Në zbatim të Vendimit nr. 36 të Këshillit Drejtues të RTSH, datë 16.05.2007, i ndryshuar me Vendimin nr. 6, datë 15.02.2019, "Për ndihmën financiare të punonjësve të RTSH-së", në varësi të shkresave të ardhura nga drejtoritë përkatëse, për rastet e fatkeqësisë në familje të punonjësve të institucionit ose për rastet e ndërhyrjeve të ndryshme mjekësore që kanë kryer, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka ndjekur procedurën për dhenien e ndihmes financiare rast pas rasti.

Gjithsej janë dhënë **47 ndihma financiare**: 29 ndihma financiare për rast vdekje në familje, 18 ndihma financiare për rast ndërhyrje kirurgjikale.

❖ **Verifikimi i listëprezencave dhe orëve shtesë dhe vjetërsia e punonjësve.**

Në fillim të çdo muaji, Sektori i Burimeve Njerëzore ka mbledhur dhe verifikuar listëprezencat mujore të muajit paraardhës të sjella nga të gjithë Drejtuesit e Njësive, Departamenteve, Drejtorive dhe Sektorëve, Orkestrës Simfonike, Qëndrave Vendore Audiovizive duke bërë rakordimet përkatëse me shkresat e nxjerra nga kjo drejtori (Vendime emërimi, largimi nga puna, pensione, leje të zakonshme, verifikimin e turneve dhe vështirësive të tyre si dhe raportet mjekësore). Pas rakordimeve dhe verifikimeve të kryera, një kopje e këtyre listeprezencave është dërguar në Drejtorinë Ekonomike që të bëhet përlogaritja e pagave mujore.

Referuar VKM nr. 568/2021, në Sektorin e Burimeve Njerëzore janë paraqitur nga Njësitë, Drejtoritë dhe Qëndrat Vendore, informacionet për pagesat e orëve shtesë për punonjësit të cilët kanë punuar ditët e shtuna, të diela ose ditë feste, dhe që nuk kanë patur mundësi për t'i zëvendësuar ato me ditë pushimi gjatë 2 muajve. Pasi është kryer verifikimi dhe rakordimi me listëprezencat, si dhe pas konfirmimit nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, shkresat përkatëse janë dorëzuar në Sektorin e Pagave për kompensimin e këtyre orëve.

Janë kryer verifikimet për ndryshimet në vjetërsi të punonjësve të Njësive Teknike, Njësive së Programeve, Njësive së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, Orkestrës Simfonike, Drejtorisë së Arkivit, Departamentit të Prodhimit, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme, e më pas ky ndryshim është reflektuar në zbardhjen e shkresave përkatëse për Drejtorinë Ekonomike

❖ **Lejet vjetore**

Një ngarkesë të madhe të punës gjatë kësaj periudhe ka zënë edhe verifikimi dhe regjistrimi në Regjistrin e Lejeve, i lejeve vjetore të punonjësve, miratuar më parë nga Përgjegjësit e Sektorëve

ose Drejtorët e Drejtorive/Departamenteve/Njësive, dhe Drejtori i Përgjithshëm, të përcjella pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, të cilat janë regjistruar në Regjistrin e Lejeve.

❖ **Shkresa, kërkesa, informacione.**

Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur informacione dhe kthim përgjigje sipas kërkesave të ndryshme të ardhura në sektor si:

- Vërtetime pune dhe page për punonjësit e institucionit, **rreth 90 vërtetime**.
- Kthim përgjigje Drejtorisë Juridike lidhur me informacion dhe dokumentacion për procedurat e marrdhënieve të punës për proceset gjyqësore ku RTSH-ja është palë e thirrur.
- Bashkëpunimi me të gjitha strukturat e RTSH-së për përpilimin e kritereve të reja të marrjes në punë të punonjësve.
- Pas miratimit të Vendimit nr. 34 të KD datë 07.12.2022, si dhe pas zbardhjes së vendimeve në muajin Dhjetor 2022 për Orkestrën Simfonike, gjatë muajit Janar 2023 u lidhën gjithësej 69 kontrata pune, me të gjithë punonjësit e Orkestrës
- Janë kryer verifikime të librezave të punës për ndryshimet në vjetërsi të rreth 280 punonjësve të RTSH-së e më pas ky ndryshim është reflektuar në zbardhjen e shkresave përkatëse për Drejtorinë Ekonomike.
- Kthim përgjigje ankesa të ndryshme lidhur me akte të nxjerra nga DBNJ
- Kthim përgjigje kërkesave për vendosje aktesh ose dokumentacioni në dispozicion.
- Janë përgatitur shkresa me lëndë “Kërkesë për Informacion”, që ju janë drejtuar Drejtorëve të Drejtorive ose Njësive, për vlerësimin e performancës në punë të punonjësve të rinj, të cilët kanë mbushur kohën e provës 3 mujore.

- Përgatitja për PBA (Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026) në Zbatim të Urdhërit nr 1805, datë 23.08.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.
- Inventarizimi i asetëve të zyrës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe rakordimi me fletët e inventarit të Drejtorisë së Ekonomisë.
- Planifikimin dhe nevojat për kancelari për vitin 2024 për sektorin e BNJ.
- Urdhra për dalje në punë, për vlerësimin vjetor të punonjësve dhe njoftimet gjithë strukturave.
- Relacione mujore mbi konkurset e zhvilluara dhe ecurinë e tyre.
- Raporte ditore/javore dhe periodike mbi punën e bërë dhe plane pune për këtë sektor.

❖ Detyra të tjera të kryera gjatë kësaj periudhe:

- Referuar shkresës nr. 134 prot datë 10.01.2023 me Lëndë “Programi i Angazhimit të Auditim Përputhshmërie” të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, për fillimin e Auditit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore për periudhën 01.01.2020 deri më 30.11.2022, Sektori i Burimeve Njerëzore u angazhua dhe përgatiti gjithë dokumentacionin e kërkuar për periudhën që do të auditohej, 1 Janar 2020 deri në 31 Dhjetor 2022, i cili ju dorëzua më pas Drejtorisë së Auditit. Në vijim të shkresës me nr. 134/2 prot datë 13.03.2023 me lëndë “Projekt – Raport Auditimi të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, për periudhën Janar 2020 – dhjetor 2022”, DBNJ përgatiti Objeksionet për këtë Projekt - Raport, duke rishikuar dhe duke studiuar për disa ditë materialet të cilat ishin shfrytëzuar për auditim nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.
- Në zbatim të Kontratës me Kompaninë e sigurimit Sicred, pas marrjes në dorëzim të kartave të sigurimit nga kjo kompani, Sektori i Burimeve Njerëzore ka bërë shpërndarjen e tyre, në të gjitha Njësitë, Drejtoritë, dhe Qëndrat Vendore.
- Raporti vjetor për subjektet deklaruese për ILDKPI dhe njoftimet për subjektet deklaruese.
- Shpërndarja e kartave të aksesit të sjella nga drejtorja e TI gjatë javës dhe verifikimi i listavë të tërheqjes së kartave të aksesit nga punonjësit .
- Në zbatim të urdhrit nr. 5, datë 06.01.2023 “Për vlerësimin e punës për punonjësit e RTSH-së”, pas dorëzimit të performancave vjetore të punonjësve nga Njësitë, Drejtoritë dhe Qëndrat Vendore në Sektorin e Burimeve Njerëzore, është bërë sistemi i tyre në dosjet personale të punonjësve.
- Rakordimi me Drejtorinë e TI për punonjësit pa kartë , marrja e kartave dhe nisja e procesit të shpërndarjes së tyre.
- Përgatitja dhe dorëzimi i listës së punonjësve të cilët parashikohet të dalin në pension për 5 vitet e ardhshme, për nevoja studimi të kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm, për vitet 2023-2024-2025-2026-2027.
- Verifikimi i listë prezencave ditore të ardhura nga të gjitha njësitë/drejtoritë/sectorët lidhur me prezencën në punë të punonjësve dhe i planifikimit javor të turneve sipas grafikëve të

përcjellë pranë Sektorit të BNJ si dhe ushtrimi i kontrolleve dhe verifikime të vazhdueshme për zbatimin e orarit të punës.

- Shpërndarja e fjongove rozë në shenjë sensibilizimi dedikuar "Tetorit Rozë" dhe bashkëpunimi me Drejtorinë e Shitjes dhe Promonionit në mbështetje të grave të institucionit, me ofrimin falas të kontrollit të gjirit .
- Janë mbajtur kontakte dhe komunikime të vazhdueshme me Drejtorin e Përgjithshëm, Drejtuesit e Njësive, Drejtorët e Drejtorive, Përgjegjësat e Sektorëve si dhe çdo punonjës në lidhje me problematika të ndryshme të dala si gjatë orarit të punës, duke u përpjekur për zgjidhjen e tyre në mënyrë që të arrihet një mbarëvajtje sa më të mirë e punës.
- Përveç detyrave të mësipërme, të cilat janë kryer gjatë kësaj periudhe, Drejtoria e Burimeve Njerëzore gjatë orarit zyrtar të punës, është në dispozicion të punonjësve për komunikime verbale për problematika të ndryshme, të cilat dalin gjatë procesit të punës, ose të nevojave të punonjësve, të cilat marrin kohë të konsiderueshme nga puna jonë e përditëshme.

AKADEMIA RTSH

Me Vendim të Këshillit Drejtues në vitin 2017 u krijua për herë të parë pranë RTSH-së Drejtoria e Akademisë. **Me ndryshimet e reja strukturore, me Vendim të Këshillit Drejtues Nr.09, Datë.15.03.2022** Drejtoria e Akademisë u konceptua si Sektori i Akademisë, një strukturë e integruar në **Drejtorinë e Burimeve Njerëzore**.

Sektorin e Akademisë synon promovimin dhe mbështetjen e zhvillimit personal dhe profesional të stafit të RTSH-së në përmbushje të misionit, strategjive dhe objektivave institucionale të Radio Televizionit Shqiptar.

Analiza e vjetore e punës për vitin 2023 pasqyron veprimet dhe rezultatet e arritura deri më tani në përputhje me legjislacionin në fuqi, misionin e Sektorit të Akademisë si dhe realizimin e detyrave funksionale dhe objektivave të sektorit.

Kreu I Veprimtaria e përgjithshme e Sektorit të Akademisë

Në vijim të procesit të planifikimit strategjik të kërkesave dhe nevojave për trajnim, Sektorin e Akademisë angazhua në procesin e mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave të grumbulluara nga Pyetësi i "*Vlerësimi të nevojave për trajnim për vitin 2023*", të përcjella nga ana e Drejtorive, Strukturave dhe Departamenteve të RTSH-së dhe hartoi fushat prioritare të trajnimeve për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2023 respektivisht për:

-Sektorin Ekonomik-Administrativ;

-Sektorin e Krijimtarisë si dhe

-Sektorin e Teknikës.

Gjatë muajit korrik-gusht 2023, pas ndryshimeve në drejtim, Sektorin e Akademisë nisi procesin e rivlerësimit të kërkesave dhe nevojave për trajnime të konsideruara si më

emergjente për mbarëvajtjen e ecurisë së punës së Drejtorive, Departamenteve dhe Njësive të RTSH-së, në përputhje me fushat prioritare të tranimeve për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2023. Trajnimet janë kryer sipas kalendarëve mujor respektivë të miratuar nga ana e titullarit të institucionit.

Spektori i Akademisë, me qëllim hartimin e një politike gjithëpërfshirëse në fushën e kualifikimit dhe trajnimit të mëtejshëm të personelit të RTSH-së, ndërmori iniciativën për identifikimin dhe shfrytëzimin e potencialit të burimeve njerëzore të brendshme, si dhe ndërtoi ekipin e parë në ofrimin e trajnimeve, seminareve, leksioneve të hapura, ligjërimeve, etj.

Me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale, Spektori i Akademisë është angazhuar në kryerjen e aktiviteteve hulumtuese në përputhje me fushën e përgjegjësisë. Gjithashtu, janë propozuar nga ana e Spektorit të Akademisë për t'u ndjekur një sërë trajnimesh të ndryshme nga drejtoritë respektive të organizuara nga EBU Academy.

Spektori i Akademisë, pasi vlerësoi kërkesat e adresuara nga Departamentet dhe Drejtoritë e ndryshme brenda RTSH-së mbi nevojën e përmirësimit të njohurive të gjuhëve të huaja si dhe nisur nga rëndësia dhe domosdoshmëria që paraqet njohja e mirë e gjuhës angleze në drejtim të përmbushjes me profesionalizëm dhe rigorozitet të detyrave funksionale, por edhe të rritjes së cilësisë së produktit radio-televiziv në gjuhën angleze, ndërmori iniciativën për fillimin e kursit të gjuhës angleze, niveli B1+. Kursi kombinon mësimin aktiv me një sërë temash të gjalla të paraqitura në tetë module tematike.

Gjatë muajit nëntor 2023, Spektori i Akademisë nisi procesin e planifikimitstrategjik të mbledhjes së kërkesave dhe nevojave për trajnim të stafit të RTSH-së për vitin 2024. Aktualisht janë administruar kërkesat për trajnime për vitin 2024 të ardhura nga 10 drejtori.

Me qëllim krijimin e një tradite të mirë në ndërtimin e një partneriteti të ri midis institucionit tonë dhe spektorit të arsimit është në proces finalizimi nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me shkollën e mesme teknike "Gjergji Cango" ku synimi afatgjatë është mbështetja e RTSH-së, si një media publike me fuqi të ndjeshme në treg, për formimin e nevojshëm të nxënësve të kësaj shkolle

Në muajin dhjetor 2023, Spektori i Akademisë përgatiti dhe prezantoi Objektivat Strategjike për vitin 2024 para Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së.

Kreu II trajnimi dhe kualifikimi profesional i stafit të RTSH

2.1. Trajnimet

Trajnimet e parashikuara në kalendarët peridodikë të punës për vitin 2023 u adaptuan duke marrë në konsideratë nevojat e grupit specifik të synuar, të identifikuar në bazë të vlerësimit të kërkesave dhe fushave prioritare të trajnimeve për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2023.

- Në datat 11, 14, 19, 20, 26 Prill 2023 u zhvillua në ambientet e Radio Televizionit Shqiptar Ëorkshopi me temë “*Mekanizmi, gjuha dhe tingulli radiofonik*”. Ligjëruesi i këtij Ëorkshop-i, z. Bojken Lako, Drejtor i Departamentit Radiofonik drejtoi të gjitha sesionet duke sjellë në vëmendje për pjesëmarrësit rëndësinë dhe elementet kryesorë të gjuhës së radios si: fjala, muzika, heshtja dhe efektet e zërit në përmirësimin e komunikimit radiofonik me audjencën e synar.
- Në datat 18, 19, 20 Prill 2023 si dhe në datat 24, 25, 26 Prill 2023 ishte parashikuar të zhvillohej pranë QVA Kukës dhe QVA Gjirokastrë trajnimi me temë “*Raportimi për zgjedhjet vendore dhe Teknikat & Elementët e xhirimit*” me ligjërues z.Norel Zaimi, Gazetar në Sektorin e Reportazheve, në Njësinë e Lajmeve si dhe z. Ogert Peza, Përgjegjës i Sektorit të Operatorëve, në Departamentin e Prodhimit. Ky trajnim nuk u zhvillua për arsye objektive që kanë të bëjnë me ngarkesën e lartë profesionale të paparashikuar të departamenteve respektive.
- Sektori i Akademisë organizoi në datat 27-28 Prill 2023 trajnimin e gazetarëve me temë “*Moderimi (live) dhe gjinia e intervistës*”. Lektorët e këtij trajnimi, Dr. Entela Komnino, Gazetar në Sektorin e Politikës, pranë Njësisë së Lajmeve dhe znj. Ermenita Stafa Njuma, Kryeredaktor pranë Departamentit Radiofonik trajtuan aspektet teorike dhe praktike të moderimit dhe të gjinisë së intervistës në televizion dhe radio me qëllim përmirësimin e aftësive të gazetarëve në realizimin e produktin radio-televiziv.
- Në datat 6-7 shtator 2023 u zhvillua në ambientet e RTSHPraktikumi “*Regjistrimi dhe montimi i emisioneve radiofonike*” nga z. Redi Kristo, teknik I pranë Njësisë Teknike.
- Në datën 26 shtator 2023 u zhvillua seminari me temë “*Përdorimi korrekt i gjuhës shqipe*” në ambientet e Radio Televizionit Shqiptar. Ligjëruesit e këtij seminari ishin znj. Elona Qose, redaktor përgjegjës si dhe znj. Arta Marku, gazetar i parë krijues të cilat sollën në vëmendje për pjesëmarrësit rëndësinë e përdorimit korrekt të gjuhës shqipe në ndërtimin e lajmit dhe jo vetëm, në televizion, radio dhe ueb. Ky seminar u zhvillua në dy sesione. Në sesionin e parë, znj. Elona Qose trajtoi aspektet teorike lidhur me ndërtimin e fjalive, rregullat e përgjithshme të drejtshkrimit si dhe shenjat e pikësimit duke i konkretizuar rast pas rasti me shembuj praktikë. Kurse, në sesionin e

dytë, znj. Arta Marku trajtoi rëndësinë e shmangies së përdorimit të panevojshëm të fjalëve të huaja.

- Më 28 shtator 2023, një pjesë e stafit të RTSH ndoqën onlineëbinar për çështjet e klimës të organizuar nga ana e EBU.
- Në datën 29 shtator 2023 u zhvillua trajnimi me temë “*Menaxhimi i çrregullimit të sindromës së informacionit*” në ambientet e Radio Televizionit Shqiptar. Ligjërues i këtij trajnimi, znj. Ermenita Stafa (Njuma) solli në vëmendje për pjesëmarrësit rëndësinë e analizimit të audjencës si dhe ndikimin e saj në realizimin e produktit mediatik, fenomenin e lajmit të rremë, rolin e mediave sociale në përhapjen e këtyre lajmeve, elementët e besueshmërisë së lajmit, etj. Në këtë trajnim morën pjesë 12 persona, me pjesëmarrje nga televizioni, radio dhe ueb-i.
- Trajnim gjithëpërfshirës në ambientet e QVA-ve me fokus: “*Përgatitjen e kronikave informative të të gjithë sektorëve; Raportimi i drejtëpërdrejtë në lidhjet direkte me edicionet informative në RTSH 1 dhe RTSH 24; Përgatitjen e reportazheve dhe dokumentarëve; Moderimi i Ditareve informative dhe Emisioneve.*”
- Duke synuar zhvillimin profesional të Qendrave Vendore Audiovizuale në Shkodër, Korçë, Kukës e Gjirokastrë u konceptuan, në bashkëpunim me Njësinë e Lajmeve pranë RTSH-së, zhvillimi i Praktikumit “*Raportimi, përgatitja dhe analizimi i kronikave informative*”, si dhe Praktikumi “*Organizimi i redaksisë, ndarja e punëve dhe ndërtimi i edicionit informativ*” të cilët kanë për qëllim përmirësimin e njohurive, aftësimin në praktikë të gazetarëve dhe kryeredaktorëve të rretheve, adresimin e problematikave të ndryshme si dhe shkëmbimin e eksperiencave në fushën e raportimit, përgatitjes së kronikave informative, organizimin e punës në redaksi, ndërtimin e edicionit informativ, etj. nga dt. 09-13 tetor 2023.
- Në datat 24-25 tetor 2023 u zhvillua në ambientet e Radio Televizionit Shqiptar ëorkshopi me temë “*Ndërtimi i lajmit në ueb*” me trajner znj. Klarida Saliu, Kryeredaktor pranë RTI-së. Objektivat kryesorë të këtij ëorkshopi u përqëndruan tek përmirësimi i njohurive teorike dhe zhvillimi i aftësive të të shkruarit të lajmit në ueb. Ky ëorkshop u zhvillua në dy sesione. Në sesionin e parë u trajtuan aspektet teorike lidhur me llojet e lajmit, parimet dhe vlerat e tij, struktura e ndërtimit të lajmit përmes modelit të Piramidës së Përmbysur, Orës së Rërës apo modelit Narrativ. Sesioni i dytë u fokusua tek rëndësia e titujve të lajmeve në ueb, teknikat për të shkruar tituj interesant

dhe tërheqës si dhe tek sugjerimet dhe këshillat se si të shkruajmë një lajm të mirë. Pjesëmarrësit u angazhuan në pyetje dhe përgjigje si dhe në trajtimin e ushtrimeve praktike.

- Në datën 31 tetor 2023 në ambientet e RTSH-së u zhvillua seminari me temë “Përdorimi korrekt i gjuhës shqipe”. Ligjëruese e këtij seminari, znj. Nermin Spahiu solli në vëmendje për pjesëmarrësit rëndësinë e përdorimit korrekt të gjuhës shqipe në ndërtimin e lajmit dhe jo vetëm, në televizion, radio dhe ueb. Gjatë këtij seminari, pjesëmarrësit u përfshinë në diskutime të lira kritike dhe analitike si dhe u angazhuan me pyetje-përgjigje.

2.2. Kualifikimi i vazhdueshëm

Me qëllim edukimin në vijimësi si dhe trajnimin në mënyrë periodike të punonjësve të RTSH-së;

- Sektori i Akademisë nëpërmjet e-mailit të dt.12.01.2023, ndau me Drejtorinë e IT Thirrjen për Aplikim për Bursat #Chevening për Sigurinë Kibernetike për Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor!
- Referuar e-mailit të dt. 02.03.2023, Sektori i Akademisë i përcolli në rrugë elektronike Drejtorisë së Arkivit pranë RTSH-së Thirrjen Publike të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për të interesuarit që duan të marrin pjesë në Konferencën e VII-të Mbarëkombëtare të Arkivistikës në datat 10-11 qershor 2023.
- Referuar thirrjes publike në faqen zyrtare të Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në Shqipëri, Sektori i Akademisë ndau me kryeredaktorët e njësisë së lajmeve & radio në rrugë elektronike dt. 28.03.2023 (për gazetarët e interesuar) thirrjen për pjesëmarrje në trajnimin “Raportimi mediatik etik mbi ekstremizmin e dhunshëm, terrorizmin dhe personat e kthyer nga zonat e konfliktit” i cili do të mbahet në datat 13-14 prill 2023 pranë Hotel Mondial, Tiranë.

KREU III aktivitete të tjera

Sektori i Akademisë është angazhuar edhe në detyra të tjera dhe grupe pune të ndryshme, si:

- Sektori i Akademisë mori pjesë pjesë për herë të parë në Panairin e Punës 2023, i organizuar nga Universiteti European i Tiranës me qëllim që studentët e këtij

universiteti të kenë mundësi të njihen me tregun e punës dhe të krijojnë kontakte me subjektet pjesëmarrëse, përfshirë këtu edhe RTSH-në si dhe ta konsiderojnë këtë fundit si një mundësi për të zhvilluar praktikat e tyre profesionale, duke iu referuar edhe degës së tyre studimore;

- Ndihma për Drejtorinë e Ëeb;
- Puna me bazën e të dhënave;
- Manaxhimi i llogarisë zyrtare në X të RTSH-së;
- Pjesëmarrja në mbledhjen e COPEAM;
- Projekti i bashkëpunimit me Radion Suedeze dhe Parlamentin Evropian;
- Përvjetori i Radios;
- Etj.

DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm funksionon bazuar në Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin nr 98/2016 “Për miratimin e statutit të RTSH”, dhe në zbatim të Ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, gjithashtu, dhe në zbatim të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe në zbatim të akteve nën ligjore si dhe në zbatim të akteve nën ligjore përkatëse.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm është njësi e pavarur funksionalisht, e cila përbëhet nga tre punonjës në strukturën e saj, si më poshtë:

- | | | |
|----|--|---------|
| 1. | Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm | 1 (një) |
| 2. | Specialist i Drejtorisë Auditimi të Brendshëm | 2 (dy), |

Të certifikuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, gjithashtu janë dhe pjesë e structures në varësi të ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Në këtë analizë vjetore do të sqarojmë më në detaje mbi punën e auditimit gjatë vitit 2023 në lidhje me planin e miratuar së bashku me ndryshimet .

Gjatë vitit 2023, ishin parashikuar për t`u audituar si më poshtë:

- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm mbi auditimet e një viti më parë.
- Qendra Vendore Audiovizive Shkodër
- Drejtoria Ekonomike
- Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve

Gjatë vitit 2023, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka kryer auditimet si mëposhtë:

- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm mbi

auditimet e një viti më parë.

- Ka ndjekur zbatimin e rekomandimeve të KLSH
- Qendra Vendore Audiovizive Shkodër
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore (Parashikuar për tu kryer gjatë vitit 2022, por është përfunduar gjatë vitit 2023)

Opinion I përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësitë/drejtoritë e audituara.

Nga ana e grupit auditues referuar auditimeve të kryera sistemeve përkatëse të tyre, ka shqyrtuar dhe vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm për të cilat janë dhënë dhe rekomandimet përkatëse, lidhur me këtë themi se:

Mjedisi I Kontrollit

Duke qënë se në institucionin tonë ka patur ndryshime strukturore, rezultojnë që nuk janë aplikuar në kohë ndryshimet në rregullore, referuar ndryshimeve strukturore kështu themi se nuk janë harmonizuar dhe për ditësuar detyrat e punonjësve, përshkrimet e punës sipas strukture, në kohë. Ekzistojnë rregulla të shkruara lidhur me linjat e raportimit. Vihet re që për punonjësit janë zhvilluar pak trajnime për zhvillimin e kompetencave profesionale si dhe trajnimet mbi riskun janë të pakta. Për çdo vit është bërë dhe vlerësimi i performancës nga drejtuesit e njësisë për funksionet e varësisë së tyre.

Lidhur me sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore themi se nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikim të shkaqeve dhe përeliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Përsa I përket politikave të burimeve njerëzore që lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë janë shfaqur pak mangësi, për të cilat janë lënë rekomandimet e duhura dhe janë ndërmarrë veprime për përmirësimin e tyre.

Menaxhimi i Riskut

Për shkak të mungesës të rregullave të qarta të proceseve të punës në formë të shkruar për sistemet vec e vec si dhe për shkak se nuk ka patur të përcaktuar një procedurë për rmatjen e riskut mbi aktivitetin e kryer, për rrjedhojë nuk realizohet mënyra e identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit mbi ngjarjet që ndikojnë në punën e secilit dhe që rezikojnë realizimin e objektivave, është lënë si rekomandim hartimi i regjistrit të rriskut për cdo Drejtori/QVA, hartimi gjurmës së auditimit **për cdo sistem/fushë**.

Veprimtaritë e kontrollit

Nga angazhimet e auditimit është vënë re se në pak raste të veprimtarisë operacionale nuk janë ushtruar kontrollet e duhura përpara faktit dhe ato mbas faktit, janë gjetur mangësi për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse. Për të realizuar aktivitetet e kontrollit është kërkuar përditësimi i rregullave, procedurave, ndryshime të proceseve të punës dhe dokumentimin e tyre me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit dhe janë impementuar (ka patur përmirësime në sistemin e rekrutimeve të punonjësve, duke I reklamuar pozicionet e lira në ëeb të RTSH dhe në rrjete sociale, po kështu unë lidhje me largimet nga puna janë respektuar

afetet dhe zbatuar procedura e parashikuarnë KP, janë hequr veprimet me arkë, dhënia e shpërblimeve financiare dhe e drejta e vendimarrjes me çështje lidhur me pagën kryhet conform rregullave duke sjellë për pasojë reduktimin e risqeve.

Komunikimi

Rezulton se ka një ndarje të detyrave në mënyrë të përgjithshme jo specifike sipas funksioneve mgjt sigurohet një komunikim efektiv vertical ashtu edhe horizontal (janë dhënë rekomandime lidhur me hartimin e rregullave organizative për mënyrat dhe metodat e punës). Sigurohet shpërndarja e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin, janë hartuar rregulla për hartimin e dokumenteve. Sigurohet identifikimi, mbledhja dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm dhe brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Menaxhimit i jepen raporte mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.

Është vënë re që ka patur mangësi në komunikim shkresor të rregullt me RTSH (Drejtorinë e Përgjithshme), dhe me QVA-të për të cilat janë dhënë rekomandimet Ekzistenca e komunikimit me adresë email personal, ka qënë një mangësi në punë, por që është rregulluar.

Monitorimi

Përsa i takon monitorimit realizohen raporte të herë pasherëshme, raporte vjetore, këto të fundit nuk kanë informacion konkret në lidhje me punën e bërë, nuk shprehet për funksionimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore sipas fushave, për mënyrën e zgjidhjes së tyre, procedurat apo informacione të detajuara të punës së përditshme ndajnë lidhje me këtë është kërkuar që raportimet të jenë sa më afër realitetit dhe të qarta.

Ngasa u shprehëm më lart themi se sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon në mënyrë efektive , me mangësi të vogla, por që ka nevojë për disa përmirësime.

Referuar planit të parashikuar shprehemi se:

Institucioni jonë, është audituar nga KLSH, bazuar në programin e paraqitur të llojit “auditim përpuethshmërie” për periudhën 01.01.2020- 30.06. 2023, për rjedhje bazuar dhe në Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, I ndryshuar, neni 25, Drejtoria jonë, bazuar në parimet e komunikimit shkëmben informacionet dhe raportet e auditimit me KLSH dhe për të shmangur mbi vendosjen të auditimit, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka realizuar ndryshimin e planit të këtij viti, duke shtyrë angazhimin e Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë Juridike dhe të Prokurimeve për vitin 2024, po ashtu edhe QVA Korçë e cila u tërhoq për tu audituar gjatë vitit 2023, për arsye të ezaurimit nga KLSH dhe ndryshimeve në përbërjen e DAB, ka kaluar për auditim për vitin 2024.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në bazë të nenit 14 të ligjit 114/2015, ka hartuar planin strategjik dhe vjetor për vitin 2024-2026, të cilin e ka dërguar për miratim në Këshillin Drejtues. Ky plan është dërguar dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresë përcjellëse.

DREJTORIA E ARKIVIT

“Funksioni themelor i Drejtorisë së Arkivit është pasurimi, evidentimi, përpunimi tekniko – shkencor, ekspertiza e vlerës së ruajtjes, ruajtja, administrimi, mbrojtja, restaurimi, studimi dhe vënia në shfrytëzim e materialeve audio apo audiovizive për krijime të veprave të reja televizive dhe studimore me vlera historike të vecanta, të cilat kanë vlerë të konsiderueshme dhe përbëjnë fondin arkivor”.

Gjatë vitit 2023 Drejtoria e Arkivit ka zbatuar me korrektesë detyrat:

- Katalogimi i asetëve të materialeve audiovizive dhe materialeve bruto që krijohen në sistemin MAM Etere.
- Redaktimi i materialeve arkivore mbi bazën e një koncepti audio - viziv sipas të gjitha kërkesave klasifikuese.
- Arkivimi, redaktimi, përpunimi dhe ruajtja e të gjitha materialeve audiovizive dhe audio që regjistrohen dhe transmetohen në RTSH (programe dhe lajme). Ky proces është kryer sipas të gjitha kërkesave klasifikuese.
- Kontrolli dhe përpunimi i materialeve filmike (format shirit 16mm) në përputhje me parametrat teknikë dhe teknologjikë, si dhe përpilimi i listës së inventarit në dokument excel.
- Drejtoria e Arkivit ka qenë në gatishmëri 16 orë çdo ditë për përgatitjen dhe vënien në dispozicion të materialeve audio-vizive sipas kërkesave nga Njësia e Programeve, Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, RTSH 24, Programacioni i Radios.
- Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria e Arkivit ka punuar në kërkimin dhe përgatitjen e materialeve audio-vizive sipas kërkesave nga palët e treta (60 kërkesa), ku dhe është bërë dorëzimi i tyre në përputhje me rregulloren e Arkivit dhe tarifave të miratuara nga Këshilli Drejtues i RTSH.
- Është kryer monitorimi i asetëve në Mam – Etere nga personeli i arkivit për materialet e prodhuara nga Njësia e Programeve, Njësia e Emisioneve Tematike dhe e Lajmeve duke u bazuar në programin ditor të transmetimit në RTSH.
- Ka vazhduar puna për inventarizimin dhe sistemimin e materialeve ekzistuese dhe atyre të reja, pas marrjes së tyre në dorëzim nga njësitë e brendshme të RTSH-së si dhe nga palë të treta.
- Vazhdon puna në procesin e digjitalizimit të materialeve audiovizive dhe audio.
- Gjatë periudhës prill – qershor 2023 është punuar për zhvendosjen e materialeve arkivore të Fondit Muzikor (Fonotekë), nga ambjenti i bodrumit në ambjentin e ri të Fonotekës. Është zhvendosur tërësisht Fondi i Folur/audio dhe pjesërisht Fondi Muzikor.
- Është bërë rivitalizimi i pesë zyrave (rashinim i dyshemesë/dërrasë) në ambientin e Fondit Muzikor (Fonotekë) – Dhjetor 2023.
- Pavarësisht ngarkesave dhe periudhës së lejeve vjetore dhe mungesave për arsye shëndetësore, kemi arritur ta përballojmë me sukses detyrat e ngarkuara. Secili punonjës ka plotësuar normën mujore sipas një plani të caktuar nga drejtori i Drejtorisë.
- Drejtoria e Arkivit ka zbatuar me korrektësi rregulloren e Arkivit e cila konsiston në tërheqjen, seleksionimin, përpunimin dhe ruajtjen e të gjithë materialeve audiovizive dhe

audio që regjistrohen dhe transmetohen në RTSH; ruajtjen e informacionit, kontrollin e ambienteve arkivore dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për ruajtjen e materialeve arkivore në ambientet e Arkivit.

Sektori i Redaktimit

- Përgjatë vitit 2023 redaktorët e materialeve audio-vizive dhe redaktorët e materialeve audio kanë redaktuar në sistemin MAM Etere, 142.842 minuta materiale audio-vizive arkivore të zhanereve të ndryshëm si: emisione, filma dokumentarë, filma artistik, seriale, seriale vizatimorë, muzikorë etj. Përpunimi i këtyre materialeve është realizuar mbi bazën e një konceptimi audioviziv në përputhje me rregulloren e Arkivit sipas të gjitha kërkesave klasifikuese në mënyrë të detajuar me plane, sinkrona, intervista, inserte të vlefshme për shfrytëzim.
- Janë kontrolluar në sistemin MAM Etere 142.842 minuta materiale audio-vizive arkivore të zhanreve të ndryshëm si: emisione, filma dokumentarë, filma artistik, seriale, muzikorë, seriale vizatimorë etj.
- Janë kontrolluar në sistemin MAM Etere 20.867 minuta materiale audio-vizive bruto si edhe 4114 kronika të lajmeve ditore.
- Është monitoruar hapja e aseteve në sistemin MAM Etere duke u bazuar në programin ditor të transmetimit të kanaleve RTSH 1 HD dhe RTSH Plus. Gjatë vitit 2023 janë arkivuar në sistemin MAM Etere gjithësej 3244 materiale audio-vizive (emisione, dokumentarë, festivale, etj.), konkretisht:
 - Emisione – 1363 (1247 me video, 116 të pa bashkuara me video)
 - Dokumentare – 255 (229 me video, 26 të pa bashkuara me video)
 - Reportazhe – 43 (39 me video, 4 të pa bashkuara me video)
 - Filma – 79 (56 me video, 22 të pa bashkuara me video)
 - Seriale – 9 seriale, gjithësej 853 episode
 - Teater – 47 (38 me video, 9 të pa bashkuara me video)
 - Spektakël – 218 (191 me video, 27 të pa bashkuara me video)
 - Muzike (koncerte, festivale) – 83 (62 me video, 21 të pa bashkuara me video)
 - Spote publicitare – 541 (508 me video, 33 të pa bashkuara me video)
 - Materiale sportive – 174 (të pa bashkuara me video)
- Është bashkëpunuar me Njësinë e Programeve për materialet e digjitalizuara audio-vizive (BetaCam) për hapjen e aseteve të tyre në sistemin MAM Etere.
- Redaktorët e materialeve audio (Fonoteka) përpos planit mujor për redaktimin e materialeve audiovizive kanë punuar për kërkimin dhe vënien në shfrytëzim të materialeve audio sipas kërkesave nga Njësia e Programacionit të Radios dhe palë të treta.
- Redaktorët e materialeve audio kanë punuar në hedhjen e materialeve audio të digjitalizuara në arkivin e Radios; për mirëmbajtjen e ambienteve arkivore dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për ruajtjen e materialeve arkivore në ambientet e Arkivit.
- Gjatë periudhës shtator - tetor 2023 redaktorët e materiale audio kanë punuar në ambientin e bodrumit të Fondit Muzikor (Fonoteke) për sistemimin nëpër raftet e një

pjesë të konsiderueshme të bobinave të materialeve muzikore, të cilat ishin vendosur nëpër thasë si jo të vlefshme për fond arkivor.

Në vijim të procesit të digjitalizimit të materialeve audio në studion e Fonotekës janë digjitalizuar 53.450 minuta materialeve audio.

Sektori i Arkivimit

1. Arkivi i Lajmeve

Arkivistët e lajmeve gjatë vitit 2023 kanë redaktuar në sistemin MAM Etere, 4114 minuta kronike lajmesh si dhe 20867 minuta lajme bruto. Përpunimi i këtyre materialeve është realizuar mbi bazën e një konceptimi audioviziv në përputhje me rregulloren e Arkivit sipas të gjitha kërkesave klasifikuese në mënyrë të detajuar me plane, sinkrona, intervista, inserte të vlefshme për shfrytëzim.

Arkivistët e lajmeve gjatë vitit 2023 kanë hapur 21267 asete lajme ditore në programin MAM Etere.

Arkivistët e lajmeve gjatë vitit 2023 kanë hapur 1566 asete bruto në programin MAM Etere.

Janë eksportuar nga serverat e transmetimit në MAM Etere 1873 Lajme bruto.

Arkivistët e lajmeve kanë qenë në gatishmëri 16 orë çdo ditë për përgatitjen dhe vënien në dispozicion të materialeve audio-vizive sipas kërkesave nga Njësia e Programeve, Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, RTSH 24, si dhe palë të treta.

2. Përpunuesit e materialeve me format film 16 mm gjatë kësaj periudhe kanë realizuar këto detyra:

Janë marrë me mirëmbajtjen e materialeve arkivore të fondit; përkatësisht kanë përpunur 125993 metër linear film+pistë që i përkasin viteve 1986,1987 në zhaneret: Telerevista, Politiko Shoqëror , Ekonomik, Artistik, Art figurativ, Muzikor, Shkencor Arsim, Kulturë dhe Sport.

Kontroll dhe sistemin i vazhdueshëm i Fondit Arkivor, format film 16 mm duke ndjekur sigurinë e kushteve teknike në fond si dhe duke mbajtur evidencë ditore për temperaturën dhe lagështinë.

Mirëmbajtja dhe sistemimi rregullisht i librave dhe buletinit me film përkasisht vitet 1969 deri 1992.

Përpunuesit e materialeve me film kanë punuar në kërkimin dhe gjetjen e materialeve audio-vizive sipas kërkesave nga Njësia e Programeve, Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, RTSH 24, Programacioni i Radios, dhe për palë të treta.

3. Arkivistët e TV

Arkivistët e TV kanë punuar për përgatitjen dhe vënien në dispozicion të materialeve audio-vizive sipas kërkesave nga Njësia e Programeve, Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, RTSH 24, si dhe palë të treta.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023 arkivistët e Drejtorisë së Arkivit kanë punuar për procesin e digjitalizimit; vënien në dispozicion dhe shoqërimin e materialeve audio-vizive për tu

digjitalizuar në sektorin e Trancoding; në total 31.022 minuta materiale audio-vizive (format BetaCam).

Arkivistët e TV cdo ditë kryejnë kontrollin dhe sisteminin e vazhdueshëm të Fondit Elektronik me format Beta, Borch, Ampex, DVD, DVCam; Hard Disk duke ndjekur sigurinë e kushteve teknike në fond si dhe duke mbajtur evidencë ditore për temperaturën dhe lagështinë.

Hyrje nga palë të treta në Arkivin e TV.

Gjatë vitit 2023 arkivistët e Drejtorisë së Arkivit kanë mundësuar hyrjen e materialeve të reja audio-vizive si më poshtë:

- Bota arbërore 1 (10 episode), E. Rasha
- Bota arbërore 2 (10 episode), E. Rasha
- Filmi “Sahatçia”, Besnik Bisha
- Filmi “Rikardi”, Mevlan Shanaj
- Koncerti “Mall bulevardi”, Adhurim Demiri (dhuratë)
- Seriali i animuar “Here comes ...” sezoni 1+4
- Seriali i animuar “Here comes ...” sezoni 2+3+5
- Si dhe hyrja e kopjeve të materialeve audiovizive Arkivë Offlinen LTO: e cila shërben si kopje e sigurisë në Arkivin e RTSH-së pavarësisht se çfarë ndodh në Storage e RTSH.
- Janë arkivuar fizikisht në zyrën e Arkivit 13 kaseta LTO me nga 2 kopje secila, gjithësej 26 kaseta LTO konkretisht:
 - 20 kaseta (10 kaseta me nga 2 kopje secila) me materiale të marra nga Serveri Isilon/ Folder: Arkivi Lajme Main. Sasia 442 TB.
 - 4 kaseta LTO (2 kaseta me nga 2 kopje secila) me materiale arkivore si lajme, promo, emisione, dokumentarë etj të marra nga Transmetimi Z. Sasia 73.6 TB.
 - 2 kaseta LTO (1 kasetë me 2 kopje) me materiale të ndryshme të marra nga Transmetimi C. Sasia 16 TB.

Problematika

- Problematikë kryesore në Drejtorinë e Arkivit e në vazhdim, mbetet arkivimi i materialeve audio; dhe materialet audiovizive dhe hapja e aseteve (emisionet radiofonike; aktivitetet muzikore).

- Mungesa e burime njerëzore.

- Trajnimet profesionale të stafit të Drejtorisë së Arkivit vazhdojnë të mbeten shqetësim, pasi ndryshimi i teknologjisë është shoqëruar vetëm me një trajnim të profilit teknik për sistemin MAM Etere, por jo me element të tjerë profesionalë që kanë të bëjnë me trajtimin e të dhënave që plotësohen fushat e metadatave të ndryshme në MAM gjatë katalogimit.

Objektivat e Drejtorisë së Arkivit për vitin 2024.

- Realizimi i planit mujor.

- Shfrytëzimi i materialeve arkivore për kërkesat brenda institucionit dhe palët e treta.

- Ruajtja materialeve arkivore.

- Ruajtja pronësisë së RTSH-së, ruajtja nga keqpërdorimet dhe dalja e pa autorizuar e materialeve audiovizuale. Vendosija e rregullave strikte të hyrjes në serverat e RT & TV për parandalimin e rrjedhjes së materialeve prej tyre.
- Ruajtja fizike e materialeve audio dhe audiovizuale sipas parametrave profesionalë të EBU-së dhe plotësimi i kushteve të ruajtjes.
- Objektiv do të jetë përmbyshja e të gjitha detyrave të ngarkuara nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së si dhe bashkëpunimi me të gjithë drejtoritë e RTSH-së.
- Objektiv tjetër është përfundimi sa më shpejtë i inventarizimit të të gjithë fondeve arkivore të cilat ndodhen në Drejtorinë e Arkivit, në mënyrë që të jemi gati për procesin e digjitalizimit.
- Në kuadrin e një konkurrence mediatike, RTSH-ja armën e tij më të fortë dhe më konkurruese ka Arkivin e tij shumëvjeçar (Arkivi Radio Tiranës 85 vjeçar & Arkivi TV 54 vjeçar). Objektiv kryesor mbetet digjitalizimi i fondit arkivor. Për këtë propozojmë ngritjen e një grupi pune/ ekspertize, që të bëjë përzgjedhjen e materialeve që paraqesin interes apo vlerë arkivore pasi jo të gjitha materialet që disponojmë mund të dixhitalizohen pasi: kemi materiale që gjenden në fond në disa kopje (një nga rregullat e arkivit është që për materialet të ruhen kopje, arkat e ruajtjes, arkat e evakuimit, fondi i transmetimit, etj.), janë materiale që përsëriten mund të jenë materiale pa vlerë, ose teknikisht/ praktikisht / ideologjikisht... të tejkaluara. Kjo do të përshpejtonte procesin e dixhitalizimit dhe do të ulte kostot e tij.

RADIO

Referuar vitit 2023, programi i Radio Tirana 1, ofroi për publikun, një gamë të gjerë produkte audio, me larmishmëri tematike dhe shtrirje, në shërbim të dëgjuesit të çdo moshe dhe grupimi social, referuar aktualitetit dhe jo vetëm.

Sipas audiencës në dëgjim, vlerësohet përshtatshmëria e përmbajtjes për dëgjuesit tanë, përfshirë dhe fëmijët, si detyrimi ynë ligjor lidhur me natyrën e shërbimit dhe të përmbajtjes. E vlerësuam të rëndësishme që përmbajtja të ngjallë interes për dëgjuesin pavarësisht përkatësisë, gjinisë, grupimit social, apo grupmoshës.

Programet që prodhohen nuk janë rastësore, por ofruar në fashat orare, ku pretendohet niveli i synuar i dëgjueshmërisë së target grupit të cilit i drejtohem, bazuar në zhvillimet aktuale, në koherencë me trendet pa qenë varësi e tyre, por kultivues vlere.

Vlerësuar si metoda me rezultatin më cilësor, puna në grup është alternativë e zgjedhur që ngërthen harmoni idesh dhe realizime profesionistësh, të pasur me pasion e dëshirë për punën. Publiku është gjithmonë pjesë aktive e çdo programi. Përmes protagonizmit të tij realizohen biseda, studio të hapura, konkurse, debat, vox-pop, talk shoë, prodhime artistike, etj.

Sot flasim:

- për mirorganizim të çdo hallke,
- harmonizim të përmbajtjes në një mozaik programor,
- për gazetarë që profilizuan qasjen ndaj produktit,
- për efikasitet të kontributit.

Sot flasim:

- për rikthim të arkivës në cikle nostalgjike për të folurit dhe muzikën shqiptare,
- për risjellje të vlerave artistike të prodhimeve për fëmijë,
- për investim në reputacionin e Radio Tiranës, investim në prestigj, jo vetëm për moshën e saj 85-vjeçare, por edhe si “Nderi i Kombit”.

Në studion e Radio Tiranës u ftuan personalitete të fushave të ndryshme duke trajtuar tema aktuale me mendimin pro dhe kundër, rreth politikës, shëndetësisë, infrastrukturës, ekonomisë, arsimit, kulturës dhe ngjarjeve të ditës. Brenda natyrës së emisioneve u përfshi publiku, i cili u bë pjesë aktive nëpërmjet rrjeteve sociale ku emisionet u publikuan si asnjë sezon më parë me një fluks të admirueshëm.

Kështu formatet informativo-argëtues në vijimësi përsosën qasjen për tek dëgjuesi. Ne shkuam në kohën e zgjimit të shqiptarëve përmes emisionit më të hershëm të mëngjesit “Klubi 5”, nga e hënë-e premte, prej orës 05.05-08.00, për tri orë i cili u ndërtua jo vetëm me formulën klasike të emisioneve të fillim ditës, por duke mbetur i hapur për përsosje në proces. Ai përfshin elemente që e bëjnë motivues veçse informativ dhe social, duke mbetur më i dëgjuari i mëngjeseve radiofonike, me një temporitëm që motivon duke e pasur njëherësh edhe dëgjuesin si protagonist nën sloganin: Gati të kalibrojmë rutinën tuaj të mëngjesit. Me një rekord pjesëmarrje të dëgjuesit si protagonist përmes komunikimit telefonik por aktiv me opinionin e tij po aq edhe me vox pop, duke sjellë opinionin e tij. Kjo tablo me referencë aktualitetin me të përditshmen aq të ndjeshme për audiencën ndiqet nga:

“Kape ditën” nga e hënë – e premte, ora 08.05-10:00, një format argëtues me orientim tri dimensional, kohë –hapësirë- mendësi, me një strukturë që ndikon papërrjashtim te kushdo, sepse gjithkush dëshiron të motivohet nga: Thënia dhe fjala e ditës, të informohet për “Parashikimin e motit”, të mësojë më tepër “Pa kohë”: Old but gold, të ndikohet nga orientimi astronomik me Shenjat e horoskopit gërshetuar me nota humori, të jetë gjithë sy e vesh për më të fundit në Rreth botës për 5 minuta e jo më shumë, e aq më tepër të konsultojë sot në epokën e AI, duke Pyetur CHAT-GPT, por pse jo të shplurosë memorien me “Kalendari Historik”, apo me “Një personazh, një ngjarje, një figurë historike”, një histori për t’u njohur. Pa harruar edhe kalendarin kulturor me “Çfarë do të bëjmë sot pasdite”, “Sugjerimet e ditës”. Sondazhi i përditshëm: “Në radio”, nga e hënë- e premte, 10.05-12.00, solli temat e nxehta dhe zhvillimet aktuale, në optikën e publikut për të marrë prej tij opinionin që ndan në qëndrimin pro dhe kundër, harmonizuar me mendimin e ekspertëve cilësorë në studio, me shumë lidhje direkte për tematikat e ditës, parë në një dinamikë tjetër, ndërthurur me ritmin dhe qasjen bashkëkohore të të bërit radio sot.

Duke vlerësuar detyrimin në shërbim të publikut por edhe duke synuar rritjen e nivelit të dëgjueshmërisë, Radio Tirana në shërbim të dëgjuesit të saj, në një fashë orare prej orës 12:20 – 13:00 nën okelion “Koha e pyetjeve”, me ekspertët e angazhuar ofroi për publikun këshillim. Programet tona gjithëpërfshirëse, kanë ofruar informim e edukim ligjor përmes ekspertëve në studio në mënyrë të herëpashershme. Me këtë synim, ofruam aq të ndjekurat çdo të hënë “Ne ligji e drejta”, çdo të enjte “Fletorja Zyrtare në Radio Tirana”, me ekspertin e sigurimeve shoqërore, apo emisioni legjendë dhe aq i nevojshëm çdo të martë

“Mjeku në shtëpi” me mjekë specialistë nën sloganin: parandalo dhe pastaj kuro, si të kujdesemi për një shëndet të mirë. Nuk ka munguar në strukturën radiofonike cikli “Gjuha, komunikimi të folurit”, çdo të mërkurë, vlerë e shtuar, për dje, sot e nesër, që vijoi të trajtonte problematika lidhur me deformime të të folurit të shqipes, normën dhe zhvillimin e saj drejt standardit, aq më tepër kur kujdesi ndaj vlerës së padiskutueshme kombëtare e kthen Vitin 2024, si Viti i Gjuhës Shqipe. Me misionin: Zgjidhja e problemeve që prekin dëgjuesit nëpërmjet specialistëve të ftuar në studio dhe trajtimi i temave me qëllim zvogëlimin e problemeve, e trajtimi i tematikave që prekin interesat e dëgjuesve, hapësira koha e pyetjeve, e hënë- e premte, 12.20-13.00, mban vlerën utilitare.

Formati talk-shoë, me: “Pod-quiz”, e hënë, e martë, e mërkurë, ora 13.05, informativ argëtues, është matës i mirë i audiencës, përveç se përmbushës i obligimit të statusit si media që edhe argëton publikun e saj përveçse informon e edukon. Ai e ngacmon publikun përmes argëtimit, me element informues, me qëllim njohjen e publikut me figurat artistike, personazhet e rëndësishëm të librit, kinemasë shqiptare, muzikës shqiptare dhe urtësisë popullore. Pod-quiz përmes temave nga merr tharmin: muzikë, urtësi popullore e filozofike, poezi, biografi artistësh e shkrimtarësh, me fokus çdo dëgjues, është një mundësi që nxit publikun e gjerë drejt informimit.

“Radio – trafik”, e hënë, e martë, e diel, ora 18.05-20.00, i ndërtuar mbi bazën e raportit hidh e prit të dy moderatorëve me qëllimin e vetëm, që për dy orë transmetim të jenëshoqëruesit antistres të pasditeve në trafik, erdhi si një produkt live dhe me shumë energji, informativ, argëtues me batuta, informacione, muzikë të mirë, e gjithçka rreth trafikut dhe jo vetëm, por edhe rreth gjithçkaje ka lidhje me të përditshmen.

“Natën”, e enjte & e premte, ora 18.05-20.00, me gjithçka sa ndodh rreth nesh, tematikat të cilat ngjallin më shumë interes dhe reagim, por edhe grimcat e shumëllojshme të cilat i japin kaq shumë ngjyrë dhe ngacmime jetës tonë sociale, tema, aspekte dhe diskutime të ndryshme të jetës njerëzore, duke sjellë në të njëjtën kohë argëtim dhe risi, për nga forma e përcjelljes së informacionit, si dhe komunikimit me audiencën e gjerë. “Prekim botën”, për çdo të premte, ora 13.05, erdhi gjatë 2023, si një guidë në kulturë, traditë, bashkohësi për çdo cep të globit 55’ shoqëruar me muzikën vendase dhe informacione që nxisin jo vetëm përfytyrimin, por edhe programimin për t’i shtuar në destinacionet për t’u vizituar.

“Skena në tri kohë”, e shtunë & e diel, 11.05-13.00, një prodhim që për 120’ minuta ju referua artit shqiptar, filmi shqiptar i cili bëri epokë dje, duke sjellë në studio -aktorë, skenograf etj. Filmi dhe Teatri në kohën tonë. Komponentët që e bëjnë këtë produksion. Njerëzit të cilët nuk dalin asnjëherë në skenë. Mbështetja e të rinjve dhe suportimi i tyre me talentet që kanë kryesisht, në art. Një buletin audio me kinematografinë shqiptare, i freskuar me mjeshtëri me batuta të pavdekshme të saj.

Programet e fëmijëve që gjithashtu sipërmarrin misionin themelor edukativ -argëtues, por duke dashur t’i kushtojmë prioritet transmetimeve për fëmijë të tipit argëtues dhe konkurues, që nxisin te ata shpirtin e garës, por edhe i motivojnë, nuk kanë munguar testet psikologjike

për zbulimin e anëve të personalitetit të tyre, që lidhen me vetëbesimin te fëmijët, punën në grup, kultivimin e dëshirës për punë, apo për të ndihmuar njëri-tjetrin dhe deri tek zbulimi i emocioneve të tyre në kohë dhe situata të ndryshme... I shtuam strukturës, në formatin “Le të luajmë bashkë”-Quiz për fëmijët, nga mosha 5-11 vjeç, e mërkurë & e premte, 14.20-14.45, si test njohurish, por edhe lojë argëtuese dhe “Ajër Muzike” e martë & e enjte, ora 14.20- 14.45, me preferencat muzikore të fëmijëve dhe adoleshentëve, shije muzikore të përshtatshme për çdo grupmoshë dhe faqe informative rreth artistëve dhe këngëve më të njohura.

Zhvillimet aktuale në vend, rajon e më gjerë ishin fokus i informimit dhe përmbajtjes së formatit tip: netëork “Pa kufij”, bashkëprodhim i radiove publike të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, i cili startoi nga 1 Maji 2009, e për gati 15 vjet, u kthye në tribunë e rëndësishme e debatit për çështje me interes publik fillimisht në të tri vendet tona, me vizionin e përbashkët, që konsistonte pikërisht në “ura” të komunikimit ndërqytetar mes Kosovës, Shqipërisë e Maqedonisë së Veriut. Panelet kompetente në studiot e Radio Tiranës, Radio Kosovës dhe Radio Shkupit, kanë trajtuar tema me interes nga fusha të ndryshme si politika, ekonomia, kultura, etj. Ne realizimin e tij respektohet një rotacion për prioritetin e organizuesit, ku çdo javë një nga radiot përkatëse zgjedh temën dhe diskutohet rreth saj me të ftuar analistë e gazetarë të njohur, drejtues e specialistë, protagonistë të jetës publike, zëdhënës të opinionit qytetar etj. Duke parë efektin pozitiv të përpjekjeve të tilla në rrjetin e radiove publike të vendeve tona, në mesvitin e 2023, u afrua bashkëpunim, edhe Radio Mali i Zi. Pretendim fillestar që në krye të herës ishte që Programi “Pa Kufij” i transmetuar në kohë reale në frekuencat e Radio Kosovës, Radio Tiranës dhe Radio Shkupit, të realizohej me cilësi të lartë teknike gjë që edhe gjatë vitit të fundit njohu luhatjet e veta.

Duke kuptuar të qenit e shoqërisë së sotme, jo rrallë herë në udhëkryq e duke dashur të inspirojmë dhe duke e konsideruar këtë si mision, ofruam mentorim me ndikim në krijimin e modeleve të suksesit, në ciklin “Sociologjia e suksesit”, çdo të mërkurë 22.15 dhe të diel 18.05, realizuar me prezencën në studio të Prof. Lekë Sokoli. Radios, nuk i mungoi përsiatja mbi tema dhe detaje ofruar nga librat, reflektimi dhe nxitja drejt të bukurës dhe artit. “Palimpsest”, çdo të mërkurë 17.05, një portret reflektiv, ku emrat e njohur publikë alternohen ndjeshëm, me emra jo masivisht të njohur, por që janë njerëz me përvoja të vlefshme, të shndërruara në leksione jete së pari për ata vetë, e më pas edhe për dëgjuesit radiofonikë. Përmes zgjedhjes së të ftuarve, zvogëlohet gjithnjë e më shumë hendeku mes personazheve që vijnë në radio për t’u dëgjuar dhe dëgjuesve. “Muzeu i përditësisë”, çdo të shtunë në 19.05 erdhi me synimin për besnikëri ndaj ndjekësve që reflektojnë mbi përditësinë të nxitur nga “objekte” dhe “subjekte” që e kanë merituar përfshirjen në stendat e “muzeut” të madh të letërsisë së botës. “Bibliotekë” çdo të premte, ora 16.05, me objektivin e shndërrimit në një pasqyrë ku të pasionuarit e leximit të shohin gjithë ç’ju lypset, pa privilegjuar asnjë libër dhe autor, duke ofruar të dhëna për të gjitha shijet letrare e madje duke mos u ndaluar vetëm te letërsia u kthye në një kalendar sugjerimesh për librin dhe leximin.

I formatit intervistë-portret është “99 pyetje me Almirën”, çdo të premte, ora 17.05, i cili me

një paketë shteruese, përmes pyetësorit, ndërton për dëgjuesin si një biografi, portretin e individëve me relacionin 360⁰ në gjithçka përbën jetën e tyre. Me të njejtin fokus ndërtoam profile për kontribuesit që i japin emrin kohës, në “Alfabeti jetësor i një mjeshtri”, çdo të shtunë, ora 21.05, me almanakun e profesioneve. Një dëshmi e traditës, por edhe risive, imponuar nga koha me të tjera zhvillime, domosdoja dhe qasje. Po i formatit intervist-portret “60’ në fushën time” çdo të hënë ora 14.05, portretizoi kampionët e sportit. Duke rrëfyer histori suksesi si figura të spikatura që shkruan historinë e sportit shqiptar, dëgjuesi gjen shembuj që motivojnë dhe arkiva e Radios u pasurua me rreth 300 profilet e figurave që investuan dhe investojnë për sportin shqiptar. Po kështu në ndihmë të shtresave në nevojë, rinisëm realizimin e ciklit, “Unë mundem”, çdo të premte, ora 12.20 -13.00, për personat me aftësi të kufizuar, çdo të premte, jetë e zakonshme mes sfidash dhe përballjesh- sakrifica që mund të mos lindin heronj, por thirren pse jo histori suksesi. Inspirim për shumë e shumë persona, që e shohin të pa shpresë të nesërmen. Dedikuar pakicave, në fund nëntor 2023, nisëm, emisionin e përjavshëm, “Romët krenarë”, çdo të enjte, 13.05, - që i referohet përmes tingujve dhe rrëfimeve, historisë së një pakice që jeton mes shqiptarëve, që i jep zë këtij komuniteti duke treguar historinë, vështirësitë për të integruar dhe vlerat që ka ky komunitet.

“Nga njëra ndeshje në tjetrën” me jetëgjatësi gati 40 vjeçare, vijoi pa njohur pauz prej krijimit 2 tetor 1983, t’i ofroj dëgjuesit takimet sportive kombëtare e ndërkombëtare në futboll. Kurse cikli “Sporti shqiptar në fonoarkivin e Radio Tiranës”-çdo të shtunë, ora 09.05-10.00, për 55’-erdhi me fokus rivitalizim të arkivës duke risjellë figurat që bënë historinë e sportit shqiptar. Formateve sportive i takon “Rubrika sportive” çdo të hënë ora 17.05, me panelin e eksperteve të sportit që sollën, parashikime, rezultate, analiza rreth çdo discipline të sportit shqiptar dhe jo vetëm. Përvoja ka dëshmuar gjithmonë se kemi nevojë për çdo gjini radiofonike dhe profilizim të elementeve që formojnë ekipin. Kështu produkti si një ansambël do të plotësonte pazëllin e kontentit. Duke stimuluar atë që duhet të bëjë radio, pra t’i flasë dëgjuesit, realizuam ciklin e përnatshëm e orëve të vona, “Zërat e mesnatës”, e hënë- e premte & e diel, ora 23.05-00.00, i drejtpërdrejtë, duke i ruajtur magjinë dhe intimitetin radios. Minutazhi grishës “Jeta ime si muzikë” me play liste-n e jetës së personaliteteve të njohur, por jo vetëm i ka dhënë origjinalitet dhe detaje të dielave me zërat e mesnatës. Këndvështrimi ynë nuk ka lënë jashtë as një dëgjues të vëmendshëm si ai i diasporës. Emisioni “Larg dhe afër”- çdo të diel, ora 21.00, dedikuar bashkatdhetarëve tanë jashtë kufijve. Synimi për të, është të mbajë gjallë lidhjet me shqiptarët jashtë vendit, t’i informojë ata mbi zhvillimet politiko-ekonomike dhe social-kulturore të vendit. Të trajtojë të drejtat e emigranteve sipas legjislacionit shqiptar dhe atij të BE, si dhe me fokus: Shqipëria në procesion e integrimit europian.

Arkiva dhe krijimtaria artistike si fond i saj, sollën paketën për çdo moshë, “Nëpër fletët e librit për fëmijë”-çdo të martë - të premte, nga letërsia më e mirë për fëmijë, por rivitalizimi i thesareve prej fonoarkivës së radios, ofruan për dëgjuesit nostalgjikë dhe jo vetëm, “Radio dramatizim”- (arkiv)- hënë, e mërkurë, e premte, ora 15.40, “Radio përralla” çdo të shtunë e të diel, ora 19.45, - nga fondi i artë i Arkivës së Radios, “Teatri i

fëmijëve në mikrofon” çdo të diel, 09.05 -09.45 rikthim pas vitesh i produksionit me te veçante radiofonik për të vegjlit, si dhe “Mikrofoni i Teatrit të Radio Tiranës” çdo të shtunë, pas mesnate, ora 01.05 një nga programet më të dashura e të ndjekura ndër vite,realizuar nga rivënia në kameralen e Radios, nga trupat e teatrove të rretheve dhe Teatri Kombëtar, regjistrimi i të cilave na ka lënë një pasuri të vyer.

Një vend të veçantë zenë emisionet dedikuar muzikës si:“Në botën e muzikës”, çdo të mërkurë ora 20.45-22.00 nga me vepra, autorë dhe interpretues të muzikës elitare, klasike. Stina koncertore e Orkestrës Simfonike të RTSH. Koncerte të plota të saj pas një qëmtimi të kujdesshëm kritike artistike.

“Radiohits”- nga Dj. Cool, me kohëzgjatje 60 minuta dy herë në javë, e mërkurë, e shtunë, ora 02.05-03.00, , që ftoi pranë Radio Tirana 1, të gjithë ata shijues të muzikës më të mirë të viteve ’80, përzgjedhur enkas.

Startuam këtë vit me sukses aq të përfolurin formatin e dëshiruar nga dëgjuesit e shikuesit PODCAST. Duke vlerësuar se dëgjuesit e podkasteve po rriten çdo muaj, këto platforma mund të jenë vendet e përsosura për të fituar audiencën e munguar. Njerëzit në përgjithësi e dëgjojnë radion si një shpërqendrim pasiv ndërsa bëjnë diçka tjetër. Podkastet, nga ana tjetër, kërkojnë në mënyrë aktive. Podkastet janë më të veçanta, me tema të përqendruara. Ato ndihmojnë të qëmtohet më thellë në një temë. Aktualisht kemi:

-“Rap shtet” –çdo të mërkurë ora 00.05, nga Big Basta, një hap me kohën. 60 minuta podcast me të ftuar të fushës së muzikës, me fokus pozitivitetin dhe mesazhin e qartë për brezin e ri, për të ardhmen plot prosperitet, njësoj si hip hop kultura dhe qëllimi i saj.

-“Të qeshim seriozisht” -nga Renada Caci, çdo të enjte ora 23.05 me politikanët, pa kostumin e përditshëm ashtu si nuk jemi mësuar t’i shikojmë kurrë, shoë, batutat, humori biseda e lirshme, në nota shumë të sinqerta dhe që si rrallë herë i kemi parë.

-"Të çmendur"- nga Kastro Ziso çdo të premte ora 23.05, Një perspektivë e re dhe një mënyrë ndryshe e të kuptuarit të jetës dhe shoqërisë. Një podcast që nxit ndryshimin e perceptimeve dhe mendimeve mbi atë që quhet "normal", ku koncepti "të çmendurit" përdoret me ngjyrimin e veçantë për të treguar se është e nevojshme të shpërfillen kufijtë dhe paragjykimet.

-"Të gjithë jemi tironsa" nga Rezarta Delisula-çdo të shtunë ora 00.10 zhvillimet që ka pasur Kryeqyteti i shqiptarëve, Tirana, ndër vite, jo vetëm nga pikpamja arkitekturore, por dhe e sjelljes së banorëve të saj, duke kuptuar nevojat e sotme që kanë ata, për të pasur një jetesë më komode.

- “Mjaftueshëm” - nga Tiri Gjoci dhe Enkelejd Çaçë, çdo të diel, ora 00.25 ku nën shoqërinë e tingujve të kitarës informohesh rreth kulturës së përgjithshme, artit, historisë dhe shkencës. Bashkë me të ftuarit, përcjelllet rehatia e kafenesë me pak ngjyra humoristike, ndërkohë që diskutohet rreth universit dhe informacioneve që ju kanë munguar deri tani. Paketës programore ju shtuan:

“Gjallë”- nga Anxhelo Shkreli & Julian Hudhra- çdo të diel, ora 19.05-20.00 kushtuar

personaliteteve të jetës shqiptare që nuk i kemi më midis nesh...

“Dimesioni soul”- nga Armand Xhuli- çdo të shtunë ora 10.05-11.00, muzika është soul, si shpirti i artistit... histori, qytete, protagonistë të muzikës afro-amerikane të ndërtuar artistikisht në formatin e dramatizimit duke i bërë më të parapëlqyera për dëgjuesin...

Sa i takon vitit 2023, RADIO TIRANA 2, si platforma e brezit të ri, nën sloganin: “Nëse je një i ri dhe ke një talent mos nguro të vish në Radio Tirana” solli një paketë që vijon pasurohet me programe:

Lidhur me produksionet për të rinjtë, erdhi formati radio televiziv “TALENT” çdo të diel ora 18.00-19.00, një program radiofonik në formën variete muzikore, që pati për qëllim kërkimin dhe shfaqjen në publik të talenteve vokalistike, nga mosha 10 - 14 vjeç. Nga vetë forma dhe struktura e këtij programi , talentet hynë në rotacion për të përfaqësuar zërat e së ardhmes. “Talent” ishte që shërben në edukimin e brezit të ri dhe krijimin e një edukate të mirë mediatike argëtuese.

“GEN Z”, një emision radiofonik, që u transmetua dy herë në javë, çdo të martë & të mërkurë, 17.00-19.00, me fokus promovimin e të rinjve nga fusha të ndryshme si art, muzikë, kulturë etj, dhe argëtimin e informimin e dëgjuesve me tematika të ndryshme që lidhen me të rinjtë. E orientuar vetëm nga të rinjtë, Radio Tirana 2, është zgjedhje që kultivon shije, promovon vlerë dhe nxit talentet.

“TINGËLLON BUKUR”- çdo të martë, 19.07-21.00, një kritikë dashamirëse mbi artin, veçanërisht në muzikë. Analiza e munguar e veprave dhe interpretuesve të tyre në filtrin e emrave të mirënjohur.

“TË PËRJASHTUARIT”- nga Rael Hoxha & Klodian Burri – çdo të hënë, 18.00-19.30, artistë të njohur e të panjohur që u bënë motivues për shumë artistë të tjerë. Influencer që ndikuan me artin e tyre për të patur jo thjesht ndjekës, por duke formësuar të tjerë personalitete në art.

Ndërsa RADIO TIRANA 3, vijoi të promovoi: turizmin, trashëgiminë kulturore.

Radio Tirana 3, solli Shqipërinë në një revistë informative që ndalet në kulturë, traditë.

“Visare Folklorike” nga e hënë-e diel, ora 18.30-19.00, promovimi i Shqipërisë dhe shqiptarëve me vlerat e patjetërsueshme të folklorit, etnografisë, muzikës.

Ajo ç’ka pretendon dëgjuesi i saj prej shtatë vitesh është rivendosja e transmetimit direkt të Radio Tirana 3, që do t’i mundësonte publikut komunikimin e drejtpërdrejtë, mundësi që e ka pasur deri para shtatë vitesh.

RADIO TIRANA KLASIK, mbështetur në krijimtarinë më të mirë shqiptare e botërore, e ka orientuar tashmë dëgjuesin përmes fashave të ngulitura. Ajo përmes perceptimit të audiencës i takon çdo dëgjuesi. Vijoi që materiali i ofruar të jetë play liste muzikore, ku gjen vend jo vetëm ofrimi i veprave të autorëve shqiptarë, por edhe interpretimi i veprave të autorëve botërorë nga instrumentistë shqiptarë dhe ekskluzivisht nga Orkestra Simfonike të RTSH-së, asset dhe shërbim kombëtar. Edhe gjatë kësaj faze të sezonit jemi rezervuar në konvertimin e fondit të

fonotekës së Radio Tiranës, në vite, për arsye të cilësisë që le për të dëshiruar, dhe ka nevojë që të konsiderohet nga ekspertët teknik për t'i marrë audios maksimumin.

Gjinitë muzikore programuar në ndjekje sipas orës dhe ditës së caktuar ofruan:

Çdo të Hënë - Balet,

Çdo të Martë- Opera,

Çdo të Mërkurë - Të mëdhenjtë shqiptarë,

Çdo të Enjte - kompozitorët e huaj.

Çdo të Premte - kompozitorët kontemporanë brenda dhe jashtë vendit.

Fondit muzikor tashmë i janë shtuar edhe koncerte ofruar pa pagesë me të drejta transmetimi si anëtarë të EBU.

RADIO TIRANA FËMIJË - 24/24 dedikuar fëmijëve, ka ofruar një paketë programesh dedikuar 03-12 vjeç:

Radio Tirana Fëmijë, ka vijuar të ofrojë për vogëlushët 10 tituj, në të përditshmen radiofonike:

“Koha mbi libra”, “Biblioteka e aventurave”, “Përralla e gjyshes”,

“Koha për gjumë”, i

ftojë për çdo ditë nëpër faqet e libri për fëmijë,

“Në shtëpinë tonë”, “Adopto një sjellje”, “Sot drejtoj unë”; dhe “Pjata e preferuar” janë

mundësia më e mirë për t'i patur të vegjlit pranë radios, ku jo vetëm ndjekin bëmat e bashkëmoshatarëve, por edhe argëtohen duke shijuar muzikën e dashur krijuar enkas për ta, e ofruar në minutazhet: “Me interpretues të vegjël”, “Nina nana me këngët tona” nga një

fond i pasur me këngët e Festivaleve për fëmijë në vend, Junior Eurovision Song Contest dhe Zecchino d'Oro ofruar nga RAI.

RADIO TIRANA JAZZ- ofroi për radiodëgjuesin shqiptar, muzikë jazz, nga një fond muzikor i pasur; - Playlista të larmishme me muzikë jazz, konceptuar në fasha orare: mëngjes/ mesditë/ pasdrekë/ natë; duke transmetuar nga të gjitha zhanret e jazz-it.

Me indicje Festalet e Jazz-it, organizuar vit pas viti dhe aktivitetet e interpretuesve dhe krijuesve të kësaj rryme, mbetet pretendim: Krijimi i një emisioni cilësor me të ftuar njohës dhe performues të rrymës jazz.

Radio vijon të jetë utilitare, sepse ka të gjithçka u nevojiten dëgjuesve:

-lajmet,

-aktualitetin,

-informimin se çfarë është në trend, etj.

Fokus mbetet:

-krijimin i përmbajtjes popullore, tërheqëse,

-promovimi i fortë i transmetimeve

-ndërveprimi i intensifikuar.

Përmbajtja duhet të vijojë të orientohet te:

-lajmi

-produkti argëtues

-ngjarje të drejtpërdrejta

-eksplorim i mundësive (alternativa)

Vlerësojmë se: Aktualisht flasim për ndërhyrje operacionale në studio e regjistrimit, që ka ofruar kushte optimale mbështetur nga logjistika.

Është investuar në 4 studiot e amortizuara të regjistrimit, ku së pari u ndërhy parcialisht teknikisht, por edhe në arredim, pa ndërhyrë në asnjë element që ndikon në akustikë.

U rregullua interfonia e studiove.

U ndërhy në ndriçimin e studiove për të lehtësuar leximin e sforcuar, si dhe për të ruajtur shikimin e folësve e gazetarëve.

U mundësua të pasurit Ëireless në studiot e transmetimit në përdorim të gazetarit dhe të ftuarve.

U rivendosën llambat treguese të jashtme, që njoftojnë se po regjistrohet & transmetohet.

U krijua mundësi transporti në orët e hershme të ditës dhe të vona të natës.

U krijuan kushte për të lënë në pritje të ftuarit.

Përsa i përket formimit profesional, gjatë kësaj periudhe, Radio Tirana në bashkëpunim me Akademinë e RTSH-së, ka organizuar trajnime për gazetarët, të tipit Ëork shop. Gazetarë profesionistë, të vlerësuar si trajnerë, kanë organizuar në mjediset e RTSH-së, një numër të konsiderueshëm trajnimesh, vlerësuar si nevojë e përditësimit të stafit krijues me njohuri më të thella, apo edhe risi që i imponon e sotmja me synim promovimin dhe mbështetjen e zhvillimit personal dhe profesional të stafit të RTSH-së, në përmbushje të misionit, strategjive dhe objektivave institucionale. Aktivitetet u fokusuan si tek punonjësit e rinj për të siguruar integrimin optimal të tyre, njohjen dhe përshtatjen e shpejtë me vlerat, principet dhe organizimin operacional të punës edhe për stafin aktual, duke synuar zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që në një treg mediatik kombëtar dhe ndërkombëtar tejet konkurrues, përsa i përket produktivitetit dhe cilësisë së programeve, vlerësimi, motivimi, dhe maksimizimi i potencialit të kapitalit njerëzor është themelor. Potenciali i burimeve njerëzore, performanca aktuale, ekspertiza, avantazhet, nevojat për përmirësim, detyrimet e kuadrit ligjor relevant dhe në të njëjtën kohë synimet, planet strategjike afatshkurtra apo afatgjata, inkuadruar në strategjinë institucionale, kërkojnë kontribut profesional të gazetarëve të radios, i cili është për t'u vlerësuar për nga cilësia e realizimit, por kjo nuk i ka penguar që secili syresh të jetë i hapur për shkëmbim experience, apo për formim në ngritje.

A ka nevoja të paplotësuara e sugjerime që duhen marrë parasysh?

Jemi në kohë për perfeksionim teknik të studiove regjistrim & transmetim.

Duhet ndërhyrë për përditësim, për tregues optimal të cilësisë së zërit që në burim.

Duhet vlerësuar të vendosurit e kamerave robotike në studio e regjistrimit dhe transmetimit që do të lehtësonte të paturit si vlerë e shtuar edhe imazhin për publikim në rrjet dhe platforma.

- Të ndërhyhet në mjedisin zyrtar të gazetarëve të Radio Tiranës, për t'ia përshtatur mbarëvajtjes së punës: të pajisjen me PC dhe materiale të domosdoshme.
- Të rivlerësohen tarifat honorare që janë përpiluar që në 1994
- Të vlerësohen në strukturën e re organizative hallkat e munguara: zëri zyrtar, ëbmaster, profesionist PR që jo vetëm të menaxhojë, por dhe promovojë Radion, duke qenë aktiv me mekanizma të ndryshëm për ta bërë publikun sa më të interesuar dhe prezent.

Në fund të kësaj analize: Mund të themi pa pikë dyshimi se Radio Tirana është i vetmi stacion radiofonik në vend, i cili duke përmbushur qëllimin e saj publik, ka realizuar edhe gjatë kësaj periudhe emisione cilësore me vlera të padiskutueshme, të cilat nuk bien pre e strategjive të komercialitetit duke bjerrë vlerën, por mbeten pasuri jo vetëm e arkivit të saj, por thesar i gjeneratave që do të vijnë.

Transmetimi radiofonik 85 vjeçar i Radio Tiranës, falë angazhimit me përkushtim të stafit të gazetarëve, përtej çdo sfide dhe me suportin e faktuar tashmë të drejtuesve të çdo niveli, do të vijojë të dëshmojë profesionalizëm, në përmbushje të misionit për dëgjuesin, nën sloganin: Ju flet Tirana!

QVA KUKËS

Gjatë vitit 2023 Radio dhe RTSH Kukës, kanë shënuar arritje në punën e tyre, duke shtuar sasinë e prodhimeve radio – televizive, por dhe cilësinë e tyre më një larmi tematikash, programesh dhe idesh.

Problematika e jetës së përditshme të banorëve, ngjarjet e ndodhura, shqetësimet, dhe eventet e tyre kanë qenë në fokus të punës tonë .

Në një vit në ekranin e RTSH Kukësit dhe Radio Kukësit janë pasqyruar ngjarjet kryesore që kanë ndodhur në territorin që mbulon media jonë.

Vlen të përmenden pasqyrimi i fushatës së zgjedhjeve parlamentare të 15 majit dhe më pas e ripërsëritur e 24 shtatorit për zgjedhjet lokale, ku kemi zbatuar me rigorozitet parimet e paanësisë, kodin e etikës dhe udhëzimet të KQZ –së për mbulimin në median vendore të fushatës.

Ngjarjet e përditshme kanë qenë në fokusin e punës së gazetarëve. Ndërtimi i objekteve të reja, sidomos ato më rëndësi strategjike si ura me hark, përfundimi i stadiumit të ri, spitalit dhe investimeve të tjera madhore, por dhe të tjera në nivel më të ulët.

Në fokus të punës sonë kanë qenë qenë dhe hallet e përditshme të banorëve, papunësia, varfësia, emigrimi, shëndeti etj.

Kemi rritje të numrit të emisioneve të drejtepërdrejta të atyre të regjistruar, të kronikave në lajmet e radios dhe tv –së me afro 10 % për shumë se viti 2022

PROGRAMACIONI

Në Radio Kukësi në 100;4 MHz, kemi program të larmishëm 24 orësh.

Muzika e llojeve të ndryshme ka zënë afro 50 % të trasmetimeve. Fonoteka jonë disponon ende shumë materiale me vlera të papërsëritshme, por duhet që të bëhet dixhitalizimi i tyre në mënyrë që të bëhen të trasmetueshme.

Redaktorja e re e muzikës që ka nisur punë në mesin e këtij viti ka bërë një program të larmishëm për të gjithë moshat dhe grupet që ndjekin radion tone, duke pastruar mjaft tarsmetimin dhe nga materialet jo pa vlera dhe vulgare, që mund të kenë depërtuar nga pakujdesa e bashkëpunëtorëve, apo dhe gazetarëve. Programi publikohet çdo ditë dhe ndiqet në mënyrë rigoroze.

Kemi bërë inventarizimin e materialeve në shirit nga arkivi i fonotekës, ku rezulton se janë afro 8700 tituj të padixhitalizuara, që pitet t'i nënshtrohen këtij procesi.

Në një ditë kemi 4 orë trasmetime live nga studio, dhe po kaq të ripërsëritura gjatë orëve të natës.

Në radio kemi realizuar çdo ditë 2 – 3 emisione të drejtpërdrejta të përgatitura nga gazetarët që nisin në ora 08 - 09 me “Radiomëngjesin”, më pas në ora 12 e 30 sërish emission i dpd – të, që zgjat një orë, Ky emission është sipas fushave që mbulojnë gazetarët, aktualitet, kulturë, sport, shëndetësi, arsim, dhe në drekë e pasditë emisionet e bashkëpunëtorëve, që kontrollohen nga gazetarët.

Risia në RTSH Kukësi ka qenë ndërtimi i studios së re televizive në një cilësi shumë të mirë, nga donatorë falas nga Kosova, ku ish- Amabadori ynë në Prishtinë, Qemal Minxhozi, ka dhënë ndihmesë të madhe.

Programi i RTSH Kukësit këtë vit ka qenë dhe më i larmishëm dhe i pasuruar me materiale që janë prodhuar nga redaksia jonë, dhe që përcjellin tek shikuesit vlera të fushave të ndryshme, kryesisht nga Kukësi. Përgjegjësi i trasmetimit në bashkëpunim me atë të programacionit çdo ditë e javë kanë hartuar play - listën e emisioneve që trasmetohen, duke minimizuar përsëritjet.

Risi në prgramacion ka qenë dërgimii material për ekranin e RTSH 2, RTSH1, dhe RTSH24.



Arkivi në radio e tv ka nevojë të freskohet më prodhimet më të reja e të mira nga fondi i RTSH – së.

REDAKSIA

Ne këtë sektor janë 6 gazetarë, dhe 1 redaktor muzike , 2 kameramanë. Puna e redaksisë në Kukës në vitin 2023 në QAV Kukës është përqëndruar tek pasqyrimi

me korrektësi e profesionalizëm i gjithë ngjarjeve që kanë ndodhur në rajonin që ne mbulojmë si radio e tv, Kukës, Has , Tropojë, por dhe Dibër e ngjarjet që kanë patur rëndësi në Kosovë . Sfida jonë ka qenë RTSH Kukësi, ku kemi vitin e pestë të çeljes së ekranit tonë. Ne jemi përqëndruar tek emisionet e lajmeve që nisnin në ora 15 dhe ripërsëritjet në ora 19 dhe 22, si dhe futjen e ajmeve edhe në ditët e shtuna e të diela. Më vëniën në punë të studios së re më 2 prill 2023 arritën që të bëjmë lajmet me spikerim. Ne ende nuk prodhojmë sinjal dhe lajmet i dërgojmë pasi i përfundojmë në sektorin e transmetimit në Tiranë dhe luhen nga andej. Kohëzgjatja është mbi 15 min dhe të gjitha janë lajme të prodhuara brenda ditës dhe janë ende pa spikerim.

Shumë prej këtyre kronikave dërgohen dhe në RTSH 2 të paktën 3 ose 4 në ditë dhe çdo ditë një speciale mbi 15 minuta gjatësi.

Gazetarët kanë përkushtim dhe profesionalizëm. Kryeredaktorja duhet të jetë më shumë e pranshme në komunikimet sin e QVA ashtu dhe me Tiranën dhe më efikase dhe organizuese në ndarjen e punës dhe menaxhimin e redaksisë.

Në radio çdo gazetar ka realizuar çdo ditë kronikë për RTSH Kukësin e radion, një emision në javë të drejtpërdrejtë.

Kontaktet me redaksinë e rretheve në RTSH, janë të përditshme dhe ne ekranin e madh të RTSH shkojnë çdo ditë informacione dhe kronika që kërkohen. Në RTSH Kukësi çdo gazetar ka realizuar një cikël dokumentarësh sipas fushave që mbulojnë , duke sjellë personalitete e ngjarje të fushave të ndryshme.

Janë prodhuar te trasmetuar nga gazetarët 637 emisione radiofonike duke përfshirë Radiomëngjesi, Aktualitet, Dritë, Shëndet e jetë, Restrospektivë, Ora Arsimore. Zonat rurale, Rubrika sportive.

Janë prodhuar e tarsmetuar nga bashkëpunëtorët 343 emisione të drejtpërdrejta.

Për 12 muaj (nga 1 janari deri në 31 dhjetor) janë transmetuar 2190 kronika televizive në edicionet e RTSH Kukësi të cilat janë trasmetuar audio dhe në radio 2010, si kronika radiofonike në edicionet e lajmeve në Radio Kukësi.

Janë përgatitur dhe transmetuar për , RTSH1, RTSH2 dhe RTSH 24, 540 kronika ku përfshihen edhe lidhjet direkte në rrethana të caktuara).

Gjatë këtij viti, janë prodhuar 51 dokumentarë, reportazhe, intervista, profile të ndryshme të transmetuara në RTSH Kukësi, radio Kukësi dhe RTSH 1. RTSH2

Në Radio Kukësi janë transmetuar 2034 fleshe informative dhe 1355 edicione qendrore nga secili gazetar sipas grafikës ditore.



Edicionet informative:

Në RTSH Kukësi janë transmetuar 1620 edicione informative. Në një ditë kemi transmetim 3 edicione informative. Lajmet u pasyqrohen edhe në faqen zyrtare të RTSH Kukësit në FB.

Detaje konkrete:

1. Matilda Dokle përgjegjëse e redaksisë

- 51 emisione Aktualitet
- 7 dokumentare, intervista, reportazhe/ lajme për RTSH Tirana
- 36 kronika për RTSH, RTSH1 ku përfshihen edhe lidhjet direkte në rrethana të caktuara).

- 296 kronika radio-televizive RTSH Kukës

2. Besjana Gjermiza gazetare

- 192 emisione Radiomëngjesi
- 14 dokumentare, intervista, reportazhe
- 58 kronika për RTSH, RTSH1 ku përfshihen edhe lidhjet direkte në rrethana të caktuara).
- 525 kronika radio-televizive RTSH Kukës

3. Bujar Muçmata gazetar

- 52 emisione Dritë
- 10 dokumentare, intervista, reportazhe/
- 51 kronika për RTSH, RTSH1(ku përfshihen edhe lidhjet direkte në rrethana të caktuara).
- 490 kronika radio-televizive RTSH Kukës

4. Dashmir Shehu gazetar

- 3 emisione Rubrika Sportive
- 3 intervista, speciale, profil
- 12 kronika për RTSH, RTSH2, ku përfshihen edhe lidhjet direkte në rrethana të caktuara).

30 kronika radio-televizive RTSH Kukës

5. Irda Bajraktari gazetare

- 80 emisione : Shëndet e jetë”, dhe “Radiomëngjesi”
- 7 dokumentare, intervista, reportazhe
- 38 kronika për RTSH, RTSH1 ku përfshihen edhe lidhjet direkte në rrethana të caktuara).
- 392 kronika radio-televizive RTSH Kukës

6. Shkurte Elezaj gazetare

- 66 emisione Ora arsimore dhe Radiomëngjes
- 10 dokumentare, intervista, reportazhe
- 425 kronika për RTSH, RTSH1 ku përfshihen edhe lidhjet direkte në rrethana të caktuara).
- 360 kronika radio-televizive RTSH Kukës

7. Alida Ismailaj redaktore muzike. Ka inventarizuar arkivin dhe përditëson e ndjek emisionet në radio e tv.

- 53 emisione Retrospektivë


8 Jonuz Hallacci drejtor. 40 kronika radio- televizive, 9 speciale.

Emisionet e bashkëpunëtorëve:

343 emisione me tematika të ndryshme. Emisionet zgjasin nga 50 minuta deri në 120 minuta.

Duhet theksuar se një emision i caktuar mund të drejtohet nga 1 ose më shumë persona.

Nr i emisioneve / Kronika	Përshkrimi
637	Prodhime emisione radiofonike duke përfshirë Radiomëngjesi ora 08:00 - 09:00 nga e hëna në të diel; Aktualitet, Dritë, , Restrospektivë, Ora Arsimore, Rubrika sportive, Shendet e jete.
392	Emisione me tematika të ndryshme. Emisionet zgjasin nga 50 minuta deri në 120 minuta. Duhet theksuar se një emision i caktuar mund të drejtohet nga dy ose më shumë persona.
2190	Kronika televizive në edicionet e RTSH Kukësi.
2190	Kronika radiofonike në edicionet e lajmeve në Radio Kukësi.
540	Kronika ku përfshihen edhe lidhjet direkte në rrethana të caktuara), për RTSH1.RTSH 24, RTSH 2
51	Dokumentarë, reportazhe, intervista, profile të ndryshme të transmetuara në RTSH Kukësi, dhe RTSH 1. RTSH 2
1825	Fleshe informative, në Radio Kukësi
1095	Edicione qendrore, në Radio Kukësi
1095	Edicione informative, në RTSH Kukësi. Në një ditë kemi ritransmetim edhe 5 edicione informative. Lajmet pasyqrohen edhe në faqen zyrtare të RTSH Kukësit në FB.



BSHKËPUNËTORËT.


Rrjeti i bashkëpunëtorëve në radio i ka dhënë impulse të reja emisioneve që janë trasmetuar. Ne bësojmë fort se emisioni i fëmijëve i përgatitur nga artistët, Qazim Velia dhe Elvana Krasniqi, është ndër më të mirët në këtë lloj në vend.

Janë hartuar të gjitha kontratat dhe pagesat janë bërë në kohë dhe konform rregullit dhe kontributit që ata kanë dhënë. Synojmë që në këto emisione të mos ketë përsëritje të tematikave. Kryeredaktorja dhe gazetarët përgjegjës do të kontrollojnë të gjitha emisionet e bashkëpunëtorëve dhe nuk do të hyhet në emision pa një skenar të miratuar më parë.



SEKTORI TEKNIK

Teknika është mundur që të përmirësojë cilësinë e punës , figurës dhe zërit, por kemi ende nevojë për apartura dhe kualifikime të personelit. Në këtë sektor kanë punuar 8 montazhierë, teknikë trasmetimi, grafisti. Përgjithësisht këtë në këtë sektor punojnë punonjës me përvojë. Teknika ka mangësi në aparatuara dhe në na mungon studio e prodhimit dhe regjistrimit të prodhimeve televizive. Personeli duhet të bëjë me shumë në kapjen e proceseve të punës , pasi



teknologjia po avancohet me hapa të shpejtë. Pulti i trasmetimit ka afro 20 vite që është vendosur dhe duhet vënë një i ri. Kemi nevojë për ndihmë nga RTSH – ja për blerjen e kompjuterave të montazhit dhe trasmetimit.

Kemi projekte për bërjen e tyre, por ende mungojnë fondet. Domosdoshmëri është riberja e studios së radio, pasi në disa raste trasmetimi i dpd –të është ndërprerë për disa orë, pasi struktura e mureve dhe studios ka bërë që në të mos ndërhyjmë dot , sidomos kur në brendësi ka ndotje nga minjtë. Për këtë kemi hartuar projektin.

Domosdoshmëri është dhe një gjeneratori për të përballuar ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike. Teknikët e trasmetimit duhet të jenë 8 orë në punë dhe në asnjë rast të mos ndryshojnë programin. Ing. i mirëmbajtjes duhet të jetë më shumë në krye të punës dhe të kontrollojë gjithë punën që i ngarkon funksioni.

Domosdoshmëri mbetet paisja e institucionit me xhenerator.

FINANCA DHE PERSONELI.

Fiananca ka përmbushur gjithë detyrat që ka në kontratë. Janë dhënë në kohë pagat, honoraret, mbikoha dhe shërbimet e udhëtimeve. Planifikimi i lejeve të zakonshme ka qenë në kohë. Dosjet e punonjësve janë pasuruar mëgjithë kërkesat e reja gjatë këtij viti siç janë deklaratat e konfliktit të interesit, dypunësimve dhe formulari i vlerësimit të punonjësve. Janë mbajtur parasysh veretjet e lëna nga kontrollet e mëpërparëshme të auditit, apo KLSH –ja. Nuk kemi detyrime ndaj institucioneve të tjera me të cilat kemi kontrata.

Janë bërë gjithë kontratat dhe dokumentacionet që kanë ardhur nga RTSH –ja.

Janë bërë në kohë analizat e punës dhe vlerësimi vjetor i punonjësve.

Çdo ditë janë bërë raportimet në RTSH për prezencën dhe raportin ditor.

Gjatë viti 2023 kemi punësuar dy gazetarë të reja të diplomuar, njëri përkohësisht, dhe një teknike montazhi në bazë të konkurseve në Tiranë, kemi 3 gazetarë të rinj që ende u duhet shumë punë për të arritur treshen tjetër të gazetarëve që kanë përvjen e duhur dhe bëjnë dallimin në punë me gazetaret e reja, që mendojmë duhet t'u nështrohen dhe kualifikimeve. Gjatë vitit 2023 janë zhvulluar disa trajnime në qendrën tonë dhe online.

Në organikë dhe për nevoja punë do na duhen dhe një shofer dhe një kameraman i tretë. Në do kërkojmë që të hapjen këta vende punë, e nëse jo duhet të bëjmë ndryshime në strukturën organizative në mënyrë që në trasmetim në radio të lëmë një teknik dhe përgj, i tras. dhe tekniku tjetër të bëjnë kameramanin dhe shoferin. Disa vende punë në bazë të avancimit të teknologjisë thuajse kanë dalë jashtë loje ndaj duhen rikompozuar për të qenë më efikas

Rëndësi i është kushtuar ruajtjes dhe inventarizimit të bazës materiale.

Janë krijuar në kohë komisionet përkatëse. Shumë materiale tashmë nuk kanë asnjë vlerë dhe duhet të nxirren jashtë përdorimit.

Blerjet nga ana jonë kanë qenë minimale. Kemi kërkuar që dhe furnizimi të bëhet në magazinat qëndrore.

Gjatë këtij viti kemi patur dy automjetet nepunë. Njëra shumë amortizuar. Problem kemi patur furnizimin me naftë pasi kompania që furnizon RTSH –në, nuk ka distributor në Kukës dhe detyrohemi të udhëtojmë deri në Tiranë për furnizim duke shtuar koston.

Buxheti i vitit 2023

N/R	ART.	Projekt/Plani
		vjetor
		2023
1	Paga e shpenzime te tjera personeli	22,231,300
a	Paga personeli	17,850,000
b	Kontributi i sigurimeve shoqerore	3,181,300
c	Kontributi i sigurimeve shendetesore	
d	Mbikohe	1,200,000
e	Shperblime	
2	Materiale	55,000
a	Materiale kryesore (teknike)	
b	Materiale Ndhimese (Kanceleri,detergjente)	55,000
c	Pajisje zyre	
d	Materiale Ndhimese (Miremb kondic, hidraulike etj.)	
e	Materiale te tjera Veshje	
f	Materiale te tjera Vegla muzikore	
3	Karburante e lende djegese	
4	Sherbime nga te tretet	772,000
a	Energji elektrike	700,000
b	Uje	20,000
c	Telefon	50,000
d	Posta e sherbimi korrier	2,000
e	Shpenzime interneti	
f	Shpenzime te tjera	
5	Shpenzime per roje civile	
6	Shpenzime per qiramarrje ambjentesh dhe pajisje teknike	
7	Shpenzime mirembajtje rrjeti digjitalizimi (mirembajtje e sistemit te transmetimit DVB-T2, OTT, Playout, Head-end satelitor etj.)	
8	Shpenzime per trajnime, seminare, e drejte e autorit, shpenzime gjyqesore, siguracione te ndryshme.	
9	Shpenzime udhetimi e dieta	1,200,000
10	Shpenzime per honorare	1,500,000
11	Shpenzime te tjera operative	150,000
a	Shpenzime per pritje e percjellje	
b	Shpenzime per tatime e taksa te tjera	150,000
12	Shpenzime per mirembajtje automjetesh	
13	Shpenzime per organizma nderkombetare	-
a	Pagesa e kuotave te anetaresise ne institucione nderkombetare (EBU,Circom,Copeam, Rai etj.)	
b	Sherbime satelitore (Eutelsat,Ses Astra etj.)	
14	Blerje te drejtash per evente sportive&artistike nderkombetare	
15	Projekte filmike artistike	
16	Fond i prodhimit te pavarur	
17	Shpenzime per investime	
18	Shpenzime Keste dhe interesa kredie	
	TOTALI	25,908,300

MARKETINGU DHE SIGURIA

Mbetet në shifra simbolike , edhe pse në rritje arkëtimet nga të ardurat nga reklamat dhe marketingu. Rajoni ynë është i varfër dhe mungon kultura e e bizneseve në këtë fushë, duke shtuar se nuk kemi një person që ka mbaruar në këtë fushë, dhe që nuk kemi transmetim tonin të dpd. Rëndësi i është kushtuar dhe ruajtjes së objektit dhe vlerave materiale që janë në insitucion.Nuk kemi asnjë rast të konstatimit të hyrjes në objekt nga persona të jashtëm. Në recepsion janë katër punonjës sipas turneve. Në disa raste është kontstuar që personi i turnit të tretë nuk është gjetur në objekt. Nuk do të tolehrohet askush nëse nuk gjendet në detyrë.

Punonjësit kanë zbatuar rregullat dhe janë vaksinuar në kohë. Gjithashtu janë marrë masat për dezinfektimin e ambientev dhe masat parandaluese kanë qenë në kohë.

SFIDAT, 2024

Për vitin 2024 jemi përballë shumë sfidave për të bërë sa më të shikueshëm ekranin e RTSH Kukësit dhe të dëgjueshëm Radio Kukësin.

Kemi personelin e duhur, por jo mundësitë teknike. Ne kemi mjedise të bollshme për studio e televizionit, por mungojnë aparaturat. Hapi i parë do jetë prodhimi i sinjalit televiziv nga qendra jonë. Ne kemi projektet e gatshme për ndriçimi, dekor e gjithçka tjetër për këto studio të hartuara dhe me specialitet më të mirë në RTSH.

Kryesore do jetë fakti që në të prodhojmë sinjalin vetë dhe të realizojmë emisione nga studio tona televizive.

Jemi në bisedime në Ambasadën tonë ne Kosovë , e cila është angazhuar me disa biznese dashamirëse në Kosovë, që të gjenden rrugët e finacimeve për këto projekte, kjo falë dashamirësisë që ata kanë për Radio Kukësin dhe misionin e saj në shërbim të “Çështjes së Kosovës” për afro 6 dekada.

Kemi zgjeruar dhe do të vijojmë bashkëpunimin me RTK –në, RTV 21 në Kosovë.

Profesionalizmi, korrektësia dhe balanca do jenë përdithsmëria e punës sonë.

Rritja e orareve të programeve dhe cilësisë së tyre, përmirësimi i teknologjisë dhe thithja e projekteve, që sjellin të ardhura në institucion, do jete sfida jonë e përherëshme.

Detyrë e përditshme mbetet disiplina në punë. Të gjithë punonjësit do të zbatojnë oraret e parashikuara nga rregullorja dhe kontrata.

Prioritet do të këne dhe kualifikimet e punonjësve të sektorëve të ndryshëm dhe përmirësimi i etikës në punë dhe institucion.

QVA Korça

Në kuader të fillimit të punës sonë për këtë vit ja vlen të bëjmë retrospektivën e vitit që sapo lamë pas. Si një pjesë e rrjetit radioteleviziv shqiptar, të ndërgjegjshëm për misionin që përfaqësojmë, ballafaqimi i sotëm përmes kësaj analize na jep mundësinë të korektojmë vetveten për vitin që kemi përpara. Qendra Vendore Audiovizive RTSH Korça padyshim që në përmbushjen e detyrave të veta ka mbajtur parasysh Statutin e RTSH, Parimet Editoriale të tij, përsosjen e etikës së punonjësve të vet në marrëdhënie me opinionin publik e më gjerë. Të nisur nga këto motive gazetarët, kameramanët, teknikët dhe punonjësit e institucionit tonë kanë punuar me përgjegjësi të plotë për të qenë në lartësinë e misionit të medias publike. Gjatë vitit 2023 në Qendrën Vendore Audiovizive RTSH Korça, mbi bazën edhe të detyrave të lëna nga drejtoria mbi “Planin e punës” për vitin kalendarik 2023 janë realizuar mjaft emisione, biseda, telereportazhe e kronika të ndryshme. Konkretisht është bërë një punë e mirë në drejtim të marrjes e përpunimit të informacionit kryesisht në edicionet e lajmeve por edhe në emisione të ndryshme.

Televizioni Korça

Departamenti i informacionit

Departamenti i informacionit i përbërë prej kryeredaktorit, 5 gazetarë dhe 4 operatorë ka punuar me përgjegjësi të plotë në drejtim të gjetjes dhe përcjelljes së lajmit, i cili është siguruar nga burime konkrete, të besueshme dhe serioze. Tematika e edicionit informativ ka qenë e larmishme duke u përqendruar kryesisht në zhvillimet e çdo dite në rajonin e Korçës, si dhe tema në lidhje me problematikat dhe zhvillimet sociale, ekonomike, politike, shëndetësore, çështje të arsimit, bujqësisë, kulturës e traditave. Pjesë e edicioneve informative kanë qenë edhe vëzhgimet e ndryshme që kanë pasur lidhje direkt me shqetësime të ndryshme qytetare. Në këtë kuadër një vend të rëndësishëm në edicionet informative kanë pasur edhe rubrikat “Intervista jonë” dhe “Speciale e ditës”, duke bërë të mundur pasqyrimin sa më real të veprimtarive të caktuara apo për të trajtuar të plotë dhe me paanësi probleme të ndryshme. Edicionet e lajmeve janë transmetuar në oraret e mëposhtme 09:00, 12:00, 15:00, 19:00, 22:00, 00:00 dhe 03.00 si dhe kanë pasur në përbërje të tyre rreth 12-14 kronika, në një kohëzgjatje 25-30 min, gjë që flet qartë për angazhimin maksimal të gazetarëve, kameramanëve, montazhierëve dhe teknikëve të transmetimit, në një stad akoma më të lartë. Profesionalizmi i tyre natyrisht që nuk është ende aty ku duhet të jetë por ka bërë hop; e ardhmja me siguri që do të jetë më afër asaj që kërkohet.

Programacioni

RTSH Korça transmeton 24 orë në të shtata ditët e javës. Programacioni është i përbërë kryesisht nga materiale të marra nga arkivi apo të regjistruara gjatë viteve nga rrjeti i RTSH,

të cilat herë pas here kanë pasur probleme në drejtim të cilesisë, gjë e cila ka kërkuar vëmendje të veçantë për të parandaluar transmetimin e materialeve defekte.

Gjatë vitit 2023 është bërë një punë e mirë në drejtim të prodhimit dhe çeljes së programeve të reja televizive nga vetë stafi i RTSH Korça por edhe me ndihmën e bashkëpunëtorëve të jashtëm. Gjatë vitit që lamë pas kemi realizuar edhe një numër të konsiderueshëm reportazhesh e dokumentarësh me tematika të ndryshme të cilat kanë pasuruar akoma edhe më shumë arkivin e televizionit tonë. Kemi arritur të ndërtojmë dhe transmetojmë tre emisione live çdo ditë. Konkretisht çdo javë u prodhuan e u transmetuan këto emisione:

1. Thuaj Mirëmëngjes E Hënë - E Premte ora 8.00 - 10.00

Emision radio televiziv që drejtohet nga gazetari Mikel Qirjaj. Në përbërje ka rubrika të vecanta informuese dhe argëtuese të përshtatshme për fillimin e ditës. Pjesë e emisionit janë edhe bisedat me të ftuar në studio, si dhe një larmishmëri kuriozitetesh. Kohëzgjatja e emisionit 120 minuta.

2. Studio Sport E Hënë ora 20.30 - 22.00

Emision i përjavshëm që drejtohet nga gazetari Llazi Saro. Ka të ftuar të përhershëm si dhe dy apo tre të ftuar të tjerë të cilët ndryshojnë sipas ngjarjeve sportive duke pasqyruar çdo zhvillim të sportit në rajonin tonë. Kohëzgjatja 90 minuta

3. Pak nga të gjitha E Enjte ora 20.30-21:30

Emision që moderohet nga bashkëpunëtorja Erjona Pambuku.

4. Miq në RTSH Korca E Marte ora 20:30 - 21.30

Personalitete nga fusha të ndryshme, vijnë të ftuar në një format të vecantë duke treguar gjithçka rreth aktivitetit të tyre, krijimtarisë dhe misionit. Kohëzgjatja 60 minuta

6. Mes Yjesh (Podcast) E Premte ora 17.00 - 18.00

Emision i përjavshëm radioteleviziv që drejtohet nga bashkëpunëtori Sardi Cizi. Yjet e muzikës botërore sjellë dhe punuar me kujdes për tu njohur më gjerësisht nga publiku. Kohëzgjatja 60 minuta

7. Ritmi i së dielës E Diel ora 16.15 - 17.00

Emision që drejtohet nga gazetarja Geralda Sali dhe ka në qendër këngët më të pëlqyera të momentit, si dhe informacione të ndryshme për këngëtarët shqiptarë dhe të huaj. Kohëzgjatja 45 minuta

Gjatë këtij viti janë realizuar 2840 kronika për edicionin informativ. Është punuar për ndërtimin e 41 specialeve të kërkuara nga RTSH 2. Është punuar me ngarkesë të plotë për të përballuar kërkesat e RTSH në lidhje me kronikat për edicionet informative dhe specialet e kërkuara gjatë kësaj periudhe. Janë mbuluar me lidhje direkte edicione informative në RTSH 1 dhe RTSH 24

sa herë që është parë e arsyeshme nga qendra. Po kështu, lidhje të vazhdueshme me emisionin e mëngjesit fillimisht çdo ditë të javës e më pas tre herë në javë të mbuluara nga kryeredaktori Llazi Saro dhe operatorët përkatës sipas një grafiku të përcaktuar. Dy lidhje direkte me emisionin “Jetë Shqiptare” mbuluar nga gazetarja Geralda Sali dhe materiale të tjera dërguar për emisionin Auditor Arsimi nga gazetarja Eftjola Fili.

Radio Korça

Gjatë vitit 2023 në sektorin e transmetimit dhe montimit në Radio Korça ka qënë një punë me rritëm të lartë, për transmetimin 24 orë të lajmeve, emisioneve, spoteve, njoftimeve, reklamave dhe muzikës. Gjatë këtij viti janë realizuar 12 emisione me tematika të larmishme. Është punuar për regjistrimin dhe montimin e 11 emisioneve të përjavëshme. Është pasuar arkivi me muzikë dhe emisione të ndryshme nga arkivi i Radio Tiranës. Një punë që do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2024. Çdo ditë janë përgatitur, rregjistruar, montuar dhe transmetuar lajmet shkurt të ores 12 dhe 14 si dhe lajmet kryesore ku përfshihen të gjitha kronikat e përgatitur ne redaksi në oraret 16, 18 dhe 20, kjo pershtatur për radion në tekst dhe intervista. Gjithashtu janë regjistruar, montuar dhe transmetuar lajmet në gjuhën maqedonase, çdo ditë në orën 18:30. Çdo ditë është punuar për përgatitjen, rregjistrimin dhe montimin e rubrikave që janë pjesë e emisionit “ Thuaj mirëmengjes ” një emission që transmetohet ngë e Hëna në të Premte ora 08-10 në radio dhe televizion.

Emisione të rregjistruara, të montuara dhe transmetuara gjata vitit 2023:

- “ Thuaj mirëmengjes ” 223 emisione
- “ Emisioni sportiv start ” 50 emisione
- “ Emisioni sportiv finish ” 50 emisione
- “ Emisioni nata poezi ” 20 emisione
- “ Emisioni arumun ” 20 emisione
- “ Emisioni pas pune ” 15 emisione
- “ Emisioni ne të dy dhe ata ” 6 emisione
- “ Emisioni inteligjenca emocionale ” 8 emisione
- “ Emisioni të pathenat e yjeve ” 40 emisione
- “ Emisioni Turizmi ne focus ” 12 emisione
- “ Emisioni të huajt shkruajnë për shqiperinë ” 30 emisione
- “ Emisioni pa skenar ” 42 emisione
- “ Ka një mesazh për ty ” 46 emisione
- Podcasti “Mes Yjesh” 8 emisione

Relacion shpjegues mbi shpenzimet dhe të ardhurat e Qendrës Vendore Audiovizive Korçë për periudhën Janar-Dhjetor 2023

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 në Qendrën Vendore Audiovizive Korçë janë kryer shpenzime për funksionimin sa më të efektshëm dhe produktiv.

Plani për shpenzimet vjetore 2023 është 5 994 383 lekë dhe realizimi 5 008 597 lekë.. Tek planifikimi vjetor dhe tek realizimi vjetor për vitin 2023 nuk paraqiten shpenzimet mbi fondet e pagave të punonjësve dhe Sigurimeve.

Zëri : “Mallra e shërbime” planifikuar në vlerën 265 000 lekë (përkatësisht 210 000 lekë materiale dhe 55 000 lekë materiale ndihmëse kancelari). Realizimi për këto zëra është përkatësisht:

Materiale 114 180 lekë dhe materiale ndihmëse kancelari 52 420 lekë , në total 166 600 lekë, më kryesisht përmendim shpenzime ne blerje të : pajisje kompjuterike vlera 107 380 lekë, blerje

materialesh pastrimi dhe desinfektimi 24 620 lekë, kancelari 5 600 lekë, gas për ngrohje 16 500 lekë dhe pjesa tjetër përfshin blerje të vogla emergjence, dhe materiale konsumi si llampa etj. Në vlerën 10 500 lekë. Tek vlerat e mësipërme përfshihet edhe TVSH.

Zëri: “Shpenzime operative” plani I realizimit për 2023 është 3 315 100 lekë dhe realizimi në vlerën 3 084 373 lekë.

Këtu përfshihen :tatime, taksa siguracione makine planifikimi në vlerën 315 100 lekë dhe realizimi në vlerën 86 123lekë: përkatësisht kontrolli teknik dhe taksat vjetore për 4 (katër) automjetet që ka në ngarkim RTSH Korça vlera 59 723 lekë dhe pagesa e programit financiar mbi hapjen e vitit të ri fiscal në vlerën 26 400 lekë.

Gjithashtu tek shpenzimet operative përfshihen edhe fondi I Honorareve I planifikuar në vlerën 3 000 000 lekë dhe I realizuar në vlerën 2 998 250 lekë. Këru rendisim kontratat e bashkëpunëtorëve mbi emisjonet dhe realizimet për gjithë vitin 2023 në vlerën :1 908 250 lekë , si dhe 4 projektet artistike te fundvitit , këto në vlerën : 1 090 000 lekë.

Zëri: “dieta dhe shërbime” I planifikuar në vlerën 320 283 lekë për vitin 2023 dhe I realizuar në vlerën 104 211 lekë.

Zëri: “Shpenzimet për shërbime” (energji,ujë, telefon +internet, posta e shërbimi korrier, shpenzime të tjera dhe komisione) janë planifikuar në vlerën 2 094 000 lekë dhe realizuar në vlerën 1 653 413 lekë. Përkatësisht :Energji Elektrike vlera 1 547 563 lekë, Ujë 49 800 lekë, Tel+Internet vlera 44000 lekë (këtu citojmë se që prej majit prill 2023 e deri dhjetor 2023 është lidhur kontratë kleringu vlera 30 000 lekë/muaj me Tring për ofrimin e internetit në ambientet e punës), Pota e shërbimi korrier në vlerën 3 300 lekë,Shpenzime të tjera de Komisione në vlerën 8 750 lekë.

Për gjatë vitit 2023 janë gjeneruar vetëm prej kontratave të reklamave, ,bisedave në studio,shorte live, kronika me pagesë, njoftimeve, ku sipas faturave të prera kanë vlerën 2 435 697 lekë prej të cilave 1 607 200 lekë e kanë shlyer detyrimin dhe pjesa tjetër prej 828 497 lekë janë debitorë të cilët do ta paguajnë në muajin Janar 2024.

Gjithashtu , kemi shlyerje për pagesat e vitit 2022 e më parë në vlerën 680 500 lekë.

Të ardhurat në total të xhiruara në drejtorinë e Rtsh-së janë në vlerën 2 175 205 lekë.

Kemi dhe kontrata kleringu në vlerën 50 000, të cilat I rendisim si më poshtë:

1. Albanian Satellite Communication (Prill-Dhjetor 2023)

Që prej periudhës prill 2023, kontrata që në këmbim të spoteve publicitare ofron shërbim internet në institucioni Vlera 270 000 lekë.

2 . Ylli Myteveli

Material për studio dekori, material pune, bateri etj, vlera 90 000 lekë.

3 . KO Market

Dekore studioje, vlera 90 000 lekë.

4 . Textile Fashion

Dekore studioje, vlera 30 000 lekë.

5 . Kids Zone (fillon në Nëntor)

Dekore për studion e fëmijëve, vlera 20 000 lekë.

Sektori Teknik

Gjatë vitit 2023 në RTSH Korca janë kryer disa investime për përmiresimin e punës. Ndër to vlen të përmendet rindertimi i ambienteve të dy studiove dhe përmiresimi i ndricimit në to. Kjo bëri të mundur që krahas rinovimit të siglave, emisionet dhe programet që prodhohen tek ne , të kenë një paraqitje më komode për teleshikuesit tane.

Gjithashtu, u realizua furnizimi me sinjal internet më të shpejtë dhe më cilësor. Keto bënë të mundur përmiresimin e punës jo vetëm në realizimin e edicioneve informative, por edhe të programeve të tjera që tashmë janë shtuar ndjeshëm, duke shtuar jo vetëm larmishmerinë por edhe arkivin e ri të prodhimeve tona.

Megjithatë, edhe pse janë bërë keto përmiresime mbetet ende për të punuar në disa drejtime si në rritjen e sigurisë së furnizimit me energjinë elektrike, përmiresimin e ndricimit, rritjen e kapaciteteve kompjuterike dhe pajisjeve audio, duke filluar nga mikrofonet .

Duke besuar që edhe vitin në vazhdim do të kemi mbështetjen dhe bashkëpunimin si deri tani në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH si dhe angazhimin e përkushtimin e stafit tonë, shpresojmë të ngremë më lart cilësisht punën tonë.

Sektori Montazhit

Gjatë vitit 2023 në sektorin e montazhit ka qënë një punë me rritëm të lartë. Gjatë këtij viti janë realizuar 2840 kronika për edicionin informative. Është punuar për montimin e 41 specialeve. Nga regjistrimet të realizuara nga ekipi i RTSH KORCA janë montuar 22 koncerte dhe mbremje poetike. Gjate 2023 janë montuar 5 dokumentare dhe reportazhe. Nga ana tjetër gjithashtu ky

sektor ka realizuar montimin e materialet çdo ditë për emisionin e mëngjesit, emisionin “Studio sport”te cdo te hene. Gjatë këtij viti janë montuar 67 edicione informative relizuar në gjuhën maqedonase, disa etyde për prezantimin e atraksioneve turistike në qarkun e Korçës, materiale

të cilat transmetohen gjatë programit ditor. Pë gjatë ketij viti janë montuar inserte për emisionit “Mirmëngjes Shqipëri” në RTSH 1, si material mbulim i lidhjeve në këtë emision dhe emisioni “Auditor arsim” në RTSH 1.

Emisione te montuara gjata vitit 2023:

- “Pak nga te gjitha” 14 emisione
- “Miq ne RTSH KORCA” 9 emisione
- Podcasti “Mes Yjesh” 10 emisione
- “Pimbi Pumbi dhe miqte” 10 emisione
- “Ritmi i se djeles” 12 emisione
- Podcasti “Ne te dy dhe keta” 6 emisione
- Per festat e fundvitit u montua emisioni per femije “Gezuar Krishtlindjen” 29 min,
- U montua Shfaqja “Grinci vjedh Krishtlindjet” e rregjistruar ne teatrin A. Z. Cajupi ne Korce
- “12 muaj RTSH KORCA ME FEMIJET” 1 ore 30 min
- “12 muaj RTSH KORCA” programi i nderimit te viteve 4 ore
- “Sofra Kolonjare” 1 ore 30 min

Mungesa e arkivimit të planeve dhe regjistrimeve vazhdon të jetë një ndër problematikat kryesore që has ky sektor. Momentalisht të gjitha materialet mbahen në kompjuterat e montazhit duke sjellë kështu edhe mbingarkesë të tyre. Zgjidhja e vetme do të ishte montimi i një PC Storage me disa vende hardisqesh për të arkivuar të gjitha materialet e sjella nga terreni apo regjistrimet.

Sektori I transmetimit

Puna në sektorin e transmetimit gjatë gjyemës së parë të vitit 2023 ka vazhduar normalisht gjatë gjithë kohës. Emisionet e planifikuara që në fillim të sezonit 2022-2023, janë rregjistruar dhe janë transmetuar rregullisht sipas orareve përkatëse. Kështu emisioni i mëngjesit që fillon në orën 08:00 dhe vazhdon deri në orën 10:00 është transmetuar direkt, çdo ditë, nga e hëna në të premte.

Gjithashtu “live” është transmetuar edhe emisioni sportiv, “Studio Sport” i gazetarit Llazi Saro, çdo të hënë, nga ora 20:30 deri në orën 22:00.

Ditët e marta ka vazhduar transmetimi i emisionit të drejtpërdrejtë “Unë gruaja”, i moderatores Erjona Pambuku, nga ora 19:30 deri 20:30.

Ditët e enjte është transmetuar emisioni i moderatorit Arjan Kallço me titull “Kafe Art”, nga nga ora 19:30 deri 20:30. Duhet përmendur që ky emision është i rregjistruar dhe rregjistrohet nga teknikët e studios së transmetimit ditën e mërkurë në mesditë.

Ditët e premte në orën 18:00 deri në orën 18:55 është transmetuar drejtpërdrejt emisioni “Kujdesi për shëndetin” i moderators Nikolina Bode.

Gjithashtu në studion e transmetimit është bërë edhe regjistrimi dhe montimi i edicioneve të lajmeve si edhe regjistrimet me Skype ose me Messenger të të ftuarve për edicionet e lajmeve ose të

emisioneve të ndryshme, të cilët ndodhen jashtë qytetit të Korçës dhe nuk mund të paraqiten në studio në orarin e caktuar.

Me fillimin e sezonit të ri televiziv 2023-2024, në muajin Tetor 2023, ndryshoi edhe struktura programore e RTSH Korçës.

Kështu veç emisioneve të mëngjesit dhe atij sportiv që janë drejtpërdrejt u shtuan një sërë emisionesh të reja.

Ditët e Hëna në orën 17:00 filloi të transmetohet podcast-i me titull “Ne të dy dhe këta”, i cili është i rregjistruar.

Ditët e Marta në orën 20:30 filloi të transmetohet cikli i bisedave me titull “Miq në RTSH Korça”

Ditët e Mërkura në orën 17:00 filloi të transmetohet podcast-i me titull “Pas pune” i cili transmetohet drejtpërdrejt.

Ditët e Enjte në orën 20:30 filloi të transmetohet emisioni me titull “Pak nga të gjitha”

Ditët e Premte në orën 17:00 filloi të transmetohet podcast-i me titull “Mes yjesh” i cili edhe ky është i rregjistruar.

Ditët e Shtuna po në orën 17:00 filloi të transmetohet emisioni i fëmijve me titull “Pimbi, Pumbi dhe Katerina” i cili rregjistrohet ditët e shtuna paradite.

Ndërsa ditët e Diela po në orën 17:00 rifilloi të transmetohet emisioni me titull “Ritmi i së Dieles”, i cili është po ashtu i rregjistruar.

Në këtë sezon risi nga ana teknike, ishte përdorimi më i gjerë i Green Screen-it, i cili solli larmishmëri në sfondet e emisioneve të ndryshme.

Duhet theksuar që gjatë kësaj periudhe nuk kanë munguar defektet dhe vështirësitë e ndryshme të dala gjatë punës.

Kështu më datën 03 Janar 2023, u difektua mikseri (pulti) i figures Kayak (nuk ndizej), i cili shërbente si për transmetimin e misioneve direkte ashtu edhe për rregjistrimin e atyre të rregjistruara.

Pasi na u sigurua një mikser tjetër nga Drjtoria Teknike në Tiranë, u bë i mundur zëvendesimi i tij me një mikser tjetër figure FOR.A Hanabi HVS3800HS, i cili bëri të mundur vazhdimin e transmetimit të emisioneve të drejtpërdrejta dhe të rregjistruara si më parë.

Gjithashtu së bashku me mikserin erdhi një analizator figure VIDEOTEK VTM-2000 i cili u instalua së bashku me mikserin e figurës.

Ndërrimi i mikserit të dëmtuar me mikserin e ri, si edhe instalimi i analizatorit të figurës u krye nga përgjegjësi i transmetimit z. Adrian Rapushi.

Gjithashtu defekte na kanë paraqitur edhe mikrofonat me valë “Shure” Tip mizë, të cilët janë që në vitin 2000. Kështu në datën 21 Mars 2023, ditën e Martë, gjatë emisionit të drejtpërdrejtë “Unë gruaja” njëri nga mikrofonat pësoi defekt duke ndërprerë zërin e moderatores. Pasi u ndërrua me një tjetër, emisioni vazhdoi normalisht.

Të nesërmen mikrofoni i difektuar u riparua nga përgjegjësi i transmetimit Adrian Rapushi. Gjithashtu duhet përmendur puna vetmohuese e sektorit të transmetimit që megjithë vështirësitë teknike, përballuan me sukses fushatën elektorale si edhe Zgjedhjet Vendore të pranverës 2023.

Në muajt e verës, nga temperatura e lartë, u difektua serveri 1 i transmetimit, fikej gjatë punës. Për këtë arsye u modifikua një kompjuter HP Z640, për transmetim, i cili pasi u formatua dhe u përshtat për transmetim, funksionoi shumë mirë dhe aktualisht është kompjuteri kryesor i transmetimit. Kompjuteri u përshtat nga përgjegjësi i transmetimit Adrian Rapushi.

Në muajin Dhjetor 2023, pësoi difekt CCU e kameras 1 në studion e transmetimit. Pasi u hap u konstatua difekt në bllokun e ushqimit, si pasojë e mosftohjes nga ventilatori ftohës në system. Pasi u ndërrua ventilatori (fun) dhe u riparua defekti në bllokun e ushqimit, gjithçka u normalizua dhe pajisja funksionoi normalisht. Gjithashtu kompjuterit të titrave Dajang, iu ndërrua karta grafike, pasi kishte muaj që nuk funksiononte normalisht. Këto riparime u kryen nga përgjegjësi i transmetimit Adrian Rapushi.

QVA SHKODËR

Gjatë vitit 2023, puna e Redaksisë së QVA Shkodër është përqendruar në realizimin e edicioneve të lajmeve, përmbushjen e detyrave të lëna nga kryeredaktorët e drejtuesit e RTSH1, RTSH2 dhe RTSH24, realizimin e specialeve dhe mini reportazheve, të emisioneve dhe programeve në RTSH Shkodra dhe Radio Shkodra.

Në punën e përditshme, janë respektuar në maksimum parimet profesionale si për edicionet e lajmeve ashtu edhe prodhimet e tjera. Çdo ditë, në orën 09.00 është zhvilluar mbledhja e redaksisë, ku janë ndarë detyrat e ditës, është përcaktuar mënyra e ndërtimit të lajmit, specialeve, mini reportazheve etj. Në jo pak raste, idetë e propozuara janë pasuruar e përmirësuar përmes shkëmbimit të ideve të pjestarëve të Redaksisë.

Temat e përcaktuara çdo ditë për lajmet dhe prodhimet e tjera, janë raportuar edhe tek kryeredaktorët e drejtuesit e RTSH1, RTSH2 dhe RTSH24, të cilët kanë bërë përzgjedhjen e tyre për ti transmetuar në programacionet respektive. Këto kanë qenë prioritet i punës tonë dhe përgjithësisht, i kemi realizuar të gjitha. Me përjashtim të rasteve kur për arsye që nuk vareshin nga ne, është shtyrë në kohë realizimi i tyre.

Interesi i publikut, paanshmëria, mbyllja e ciklit të lajmit, verifikimi në të paktën dy burime të pavarura, përfshirja e të gjitha palëve të interesuara me opinionet e tyre, standardi profesional (minutazhi, voxpop, stand- up) kanë qenë udhërrëfyes në punën tonë të përditshme.

Në fokus të punës tonë ka qenë promovimi i vlerave natyrore dhe njerëzore të Shkodrës, Malësisë së Madhe, Vau Dejësit etj. Vëmendje të veçantë i kemi rezervuar evidentimit të kontributit të personaliteteve me ndikim në Shkodër dhe në rajonin e Veriut, duke i vënë në qendër të lajmeve, specialeve dhe mini reportazheve. Të gjitha këto, janë transmetuar edhe në RTSH1, RTSH2 dhe RTSH24.

Redaksia e RTSH Shkodra ka këtë përbërje:

Mirsad Rakaj, Merisa Gjoni, Mario Gjini, Luan Kadia, Virtyt Omari, Blerta Cina, Gaspër Marku.

Në funksion të Redaksisë, janë dhe 4 kameramanë:

Kujtim Draçini, Fisnik Smaja, Elton Shllaku, Medin Guri.

Brenda Redaksisë, gazetarët kanë këtë angazhim të përditshëm:

Gazetarë terreni

1. Mirsad Rakaj; 2. Merisa Gjoni; 3. Mario Gjini; 4. Luan Kadia.

Gazetarë ëb dhe rrjete sociale

1. Virtyt Omari; 2. Blerta Cina

Gazetar sporti

Gaspër Marku

Kameramanët, përveç ngarkesës së përditshme, me turne (javë), mbulojnë nevojat e Redaksisë edhe në turnin e dytë.

Prioritete të Redaksisë janë:

1. Përgatitja e edicioneve të lajmeve.

2. Realizimi i detyrave të ngarkuara në funksion të RTSH1, RTSH2, RTSH24, Radio Tirana, etj.

3. Ideimi dhe realizimi i lidhjeve direkte, kronikave të lajmeve, specialeve, mini reportazheve sipas detyrave të ngarkuara nga RTSH1, RTSH2, RTSH24, Radio Tirana, etj.

4. Ideimi, realizimi dhe mbështetja e emisioneve dhe programeve të ndryshme në TV dhe Radio.

Gjatë vitit 2023, janë realizuar edicionet informative të lajmeve në oraret 15.00, 19.00 dhe 22.00. Dy prej edicioneve 15.00 dhe 19.00 transmetohen live në televizion dhe në mediat tona sociale. Mesatarisht, çdo ditë janë përgatitur 10 kronika, me një kohëzgjatje të edicionit të lajmeve nga 20 deri në 30 minuta. Paralelisht, sipas raportimit ditor në mëngjes dhe kërkesave nga RTSH2 dhe RTSH24, janë përgatitur dhe montuar mesatarisht 4 kronika në ditë. Sipas kërkesave të RTSH2 dhe RTSH24, kemi realizuar lidhje direkte me edicionet e lajmeve të tyre.

Një drejtim i veçantë i punës tonë, ka qenë përgatitja e speciale apo mini-reportazheve për programacionin e RTSH2 por edhe për emisionin “Mirëmëngjes” në RTSH1 nën përgjegjësinë e gazetarit Mario Gjini. Në total, gjatë kësaj periudhe kemi përgatitur 62 speciale dhe mini-reportazhe, me minutazh mesatarisht mbi 15 minuta secili. Në mëngjes, ka lidhje direkte dhe radio kronikë edhe me Radio Tirana, realizuar nga gazetari Virtyt Omari.

RTSH Shkodra ka një programcion ditor të konsoliduar prej rreth 2 vitesh, me një grilë që

synon të gjitha moshat dhe kategoritë sociale. Gjatë periudhës gusht- dhjetor 2023, kanë qenë në transmetim në televizion dhe radio “Mirëmëngjes Shkodër” nga Merita Sokoli, “Rubrika Sportive” nga Gaspër Marku, “Shkodra Biznes” nga Albana Kraja, “Pena e Shkodrës” nga Arjola Zadrima, “Rindezim yjet” nga Adrian Hoti, “Kënga juaj” me Martina Serreqi, “Debat” nga Brunilda Dibra. Në muajin shtator kemi paraqitur projektet e reja për emisione në RTSH por për shkaqe kryesisht teknike, për të cilat kemi vënë në dijeni periodikisht, nuk janë jetësuar. Edhe për sezonin e ri, që nis nga janari 2024, kemi prezantuar projektet tona për programe dhe emisione.

Aty ku ka qenë e mundur, kemi transmetuar në sinkron në radio dhe në televizion emisione si “Mirëmëngjes Shkodër”, “Pena e Shkodrës”, “Kënga juaj” etj. Synimet tona janë që nga emisione radiofonike që transmetohen edhe në televizion, t’i transformojmë në emisione televizive që transmetohen në radio, duke i dhënë prioritet programacionit të RTSH Shkodra.

Gjatë punës së përditshme, nga muaji gusht dhe deri në fund të vitit 2023, jemi përballur edhe më disa vështirësi. Herë pas here, një nga makinat ka qenë jashtë pune për shkak të defekteve si pasojë e amortizimit pas shumë viteve përdorim. Nga muaji nëntor, makina është jashtë përdorimit. Aktualisht, e gjithë ngarkesa përballohet vetëm nga një makinë.

Për realizimin e lajmeve dhe prodhimeve të tjera, na duhet të lëvizim edhe jashtë qytetit të Shkodrës. Në jo pak raste, për shkak të mungesës së mjeteve të transportit për grupet e xhirimit, shumë lajme, speciale apo mini reportazhe nuk janë realizuar.

Po ashtu, probleme paraqiten edhe me kamerat që përdoren nga operatorët. Në shumë raste, veçanërisht kur ka luhatje të temperaturave, ato krijojnë avull dhe pamundësojnë xhirimin për shumë minuta deri në mbi 1 orë deri në stabilizimin e tyre. Në këto kushte, shpesh herë operatorët janë detyruar të përdorin celularët për të mos humbur lajmin apo realizuar prodhimin me të cilin janë angazhuar. Vështirësi kemi ndeshur, për shkak të amortizimit të përdorimit të pandërprerë, edhe me bateritë e kamerave dhe të mikrofonëve “akullore” të terrenit.

Dy pikat e montazhit (dy PC) për shkak të amortizimit të përdorimit, ngarkesës së punës që duhet të suportojnë, tejkalimit të pajisjeve HARD dhe të softeve, krijojnë probleme në ecurinë normale të punës. Mendojmë se është e domosdoshme që të shihet mundësia e furnizimit me kompjutera montazhi me parametra teknike më të mirë se aktualët. E njëjta gjë vlen edhe për kompjuterat e transmetimit, qoftë në parametrat HARD por edhe softet që përdoren për play dhe REC.

Siç e cekëm edhe më sipër, realizimi i disa emisioneve apo programeve, është në varësi të pajisjeve dhe fuqisë teknike, skenografisë apo edhe ndriçimit, aksesorëve të tjerë si tavolina, karrige etj. Duke u ndaluar te programacioni i RTSH Shkodra, i cili është 24 orë në transmetim, konstatojmë se ka mangësi në materiale që mund të rrisin audiencën. Herë pas here drejtuesit e QVA Shkodër kanë paraqitur kërkesat e tyre pranë sektorit të Arkivës në RTSH, por përsëri gjykojmë se nuk jemi kompletuar me elementë të domosdoshëm të një programacioni që krijon e tërheq audiencë.

Prodhime në vite, para dhe pas 1990-ës, të cilat kanë në fokus Shkodrën por edhe Veriun,

mendojmë se duhet të jenë pjesë e programacionit tonë. Regjistrime të shumta në vite, të humorit, artit, kulturës, historisë, filma shqiptarë dhe prodhime me të drejta transmetimi që RTSH i posedon, mendojmë se duhet të bëhen pjesë e programacionit tonë në **RTSH Shkodra**.

Një vëmendje të veçantë, i kemi kushtuar edhe rrjeteve sociale, si një mundësi reale, e mirë dhe e shpejtë për të arritur tek audienca. Fatkeqësisht, një faqe e RTSH Shkodra në Facebook me rreth 14 mijë ndjekës, është hakëruar. Jemi detyruar të krijojmë një hapësirë të re, të cilën po përpiqemi ta rrisim. Jemi prezentë me prodhimet tona edhe në rrjetin Youtube, ndërsa publikojmë rregullisht lajme dhe prodhime të tjera në portalin rtsh-shkodra.live të cilin e kemi hapur, në pritje të krijimit të një portali nga RTSH në Tiranë, siç e kanë edhe QVA- të tjera.

Hekerimi i faqes në Facebook, e cila vetëm në muajt maj-qershor-korrik të vitit 2023 gati u trefishua (nga 5 mijë e ca ndjekës në 14 mijë e ca) që një goditje për përhapjen e gjërë që morën kronikat dhe minireportazhet apo emisionet si Studio Sport. Rekordet e shikueshmërisë në rrjetin Facebook arritën me kronikat e gazetarit Mirsad Rakaj si psh “20 vite që thur çadra kashte për plazh” e datës 21 qershor 2023 me 256 mijë shikime, “I fundit i çakmakëve në Shkodër” e datës 30 qershor 2023 me 234 mijë shikime etj. Megjithëse bëmë denoncim zyrtar në Sektorin kundër krimit kibernetik, faqja nuk arriti të kthehej sërish.

Gjatë netëve të fundit të vitit 2023 RTSH Shkodra realizoi një program të pasur, duke realizuar inçizime si prodhime të kanalit tonë si koncerti festiv “Ndërmendje”, “Ahëngu shkodran”, “Koncerti i këngëtarit Frederik Ndoci”, “Koncerti i grupit “Berti dhe miqtë” dhe këngëtares Blerta Cina”, humor nga estrada e Shkodrës vitet e fundit etj.

Për vitin 2024, Redaksia e QVA Shkodër ka përcaktuar objektivat në vijim:

-Rritje profesionale e edicioneve të lajmeve, mbulim i një territori më të gjërë, evidentim dhe promovim i resurseve natyrore dhe njerëzore të Shkodrës dhe Veriut përmes specialeve, mini reportazheve, emisioneve, programeve në RTSH Shkodra dhe Radio Shkodra.

-Ndërtim dhe ridimensionim i programeve dhe emisioneve televizive dhe radifonike, duke vënë theksin në ndërthurjen e tyre në aspektin e transmetimit dhe shpërndarjes me të gjitha mjetet e mundshme.

-Identifikimin dhe afrimin e të rinjve, të rejave, me aftësi, të dhëna dhe talent në fushën e medias, krijimin e hapësirës së nevojshme për afirmimin e tyre.

-Evidentimin e personaliteteve të fushave të ndryshme të jetës, promovimin e vlerave dhe kontributeve të tyre në nivel vendor dhe kombëtar.

-Promovimin e arritjeve aktuale të individëve dhe institucioneve në shërbim të interesit publik.

Të gjitha sa më sipër, realizohen duke rritur mbështetjen dhe vëmendjen ndaj QVA Shkodër, për zgjidhjen e problematikave që na pengojnë në përditshmërinë e punës tonë. Shprehim bindjen se, me kapacitetet njerëzore që kemi në dispozicion, me mbështetjen nga drejtoria e përgjithshme e RTSH-së, RTSH Shkodra brenda pak kohësh, do të jetë pikë reference në territorin që mbulon, njëkohësisht, duke përmbushur në kohë dhe me cilësi edhe detyrat e

përditshme nga RTSH1, RTSH2 dhe RTSH24.

Aktiviteti ekonomik-financiar për vitin 2023

1. Aktiviteti ekonomik-financiar për vitin 2023, për institucionin tonë është kryer në mbështetje të ligjit 8410, dt 30/09/1998 (për RTSH)
2. Pas datajimit të buxhetit të vitit 2023, kemi bërë analizën duke llogaritur çdo element shpenzimi të nevojshëm dhe të domosdoshëm për vazhdimësinë dhe mbarëvajtjen e punës në institucion.
3. Në zbatim të buxhetit të shtetit (*sipas burimeve të financimit*) kemi ndjekur realizimin e të gjitha zerave, sipas shpenzimeve mujore ,tre mujore , **6** mujore, **9** mujore dhe vjetore. Duke respektuar kuotat e planifikuara dhe administruar mirë keto shpenzime në raport me planifikimin vjetor.
1. Janë përgatitur dhe raportuar pranë drejtorisë ekonomike nga ana jone çdo muaj, situacionet mujore dhe librat e blerjeve dhe shitjeve.
2. Sipas planeve të hartuara janë kryer kontrole të herëpashërshme në magazinën e institucionit, për të verifikuar ruajtjen dhe gjëndjen e materialeve, ku nuk janë vërejtur mungesa. Janë të evidentuara kartelat me dokumentat justifikues për çdo shpenzim. Është mbajtur dokumentacioni i rregullt për lëvizjen e materialeve brenda institucionit dhe nga magazina
3. Është punuar dhe azhornuar programi i Financa 5, duke hedhur të gjitha faturat dhe duke leshuar faturat e fiskalizuara. Janë kryer veprimet e mbylljes së vitit dhe po punohet për çeljen e vitit të ri.
4. Janë kryer inventarët periodike për vitin 2023, ku vërehet se pajisjet teknike janë të amortizuara dhe me rrezik të lartë për mbarëvajtjen e punës.
5. Bazuar dhe në sugjerimet e auditit të brendshëm është punuar me kujdes në përgatitjen dhe mbajtjen e dokumentacionit për lisprezencat mujore, listat për pagesën e honorarëve dhe kërkesat për pagesën e orëve shtesë të kryera nga stafi ynë. Janë përgatitur dhe ruajtur dokumentat mbështetës për lëvizjet e stafit të QVA bazuar në nevojat e institucionit.
6. Problematikat e institucionit tonë mbetet mbajtja në inventare e makinave të dala nga përdorimi dhe totalisht të amortizuara, të cilat gjenden në oborrin e institucionit

- Realizimi I shpenzimeve sipas buxhetit të miratuar për vitin 2023.
Në 000/lek

Nr.	Emertimi	Plani	Fakti	Përqindja e realizimit
1.	Materiale kryesore (teknike)	350	232	66.3 %

2.	Materiale ndihmese (kancel, pastrim, etj)	250	100	40 %
3.	Energji	1.500	1.411	94 %
4.	Uje	140	68	48.6 %
5.	Telefon Internet	480	386	80.4 %
6.	Shpenz gazeta, postare	12	32	83 %
7.	Djeta (<i>dieta stafi</i>)	300	102	34 %
8.	Shpenzime udhëtimi (shërbim mirëmbajtje mchine)	100	85	85%
9.	Honorare	2.000	1.510	75.5%
10.	Qera pajisje	400	60	15%
11.	Shp. Tatime taksa bashkie	419	419	100%

Realizimi i të ardhurave të planifikuara nga QVA Shkodër për vitin 2023.

Në 000/lek

Nr.	Emertimi	Plani	Fakti	Përqindja e realizimit
01.	Te ardhura nga reklamat, emisionet etj	500	315	63 %

Kemi patur probleme ne realizimin e të ardhurave,pasi kanë ndikuar shumë faktorë:

-Mungon në strukturën e QVA Shkodër një specialist marketingu,pasi nuk ekziston një pozicion i tillë në strukturë,siç është në QVA Korçë dhe QVA Gjirokastrë. Mendojmë se ky pozicion duhet të shtohet në vitin 2024 në QVA Shkodër.

-Gjendja në studio(mungesa e ndriçimit,problemet me kompjuterin e transmetimit)na kanë kufizuar mundësinë për të realizuar emisionet që kemi planifikuar dhe kemi gati në skaletë dhe skenar. Kjo ka bërë që edhe kërkasat e bashkëpunimit për marketing(reklama) me bizneset lokale të mos gjejnë gjithnjë disponibilitet.

-Fakti që transmetimi televiziv i RTSH Shkodra ka vetëm dy vite histori,ndërkohë që televizionet lokale në Shkodër kanë histori deri 26 vjeçare,është përsëri një pengesë për të gjetur klientët e nevojshëm për marketing.

TEKNIKA

Spektori teknik është angazhuar në prodhimin dhe transmetimin e programeve radiofonike dhe televizive sipas programacionit ,me cilësi dhe pa nderprerje. Kjo është bërë krejtësisht në formatin dixhital nëpërmjet kompjuterave të instaluar për këtë qëllim. Është punuar për mirëmbajtjen e tyre duke i azhurnuar herë pas here me pjesë dhe softëare të rinj sipas nevojave. Kujdes i vecantë është treguar sidomos gjatë transmetimit te edicioneve të drejtperdrejta informative si dhe emisioneve të përgatitura.

Krahas transmetimit radiofonik nepermjet transmetuesit FM 92 MHz., i cili degjohet ne te gjithë veriun e Shqipërisë, nepermjet faqes në facebook “RTSH-Shkodra”, janë percjelle publikut emisionet më të zgjedhura me audio e video. Kjo e ka rritur audiencën edhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Gjithashtu është pasuruar fondi muzikor nepermjet prurjeve të reja të muzikës së vendit dhe të huaj, të masterizuara në studiot tona. Gatishmeria teknike, gjate ketij viti, ka qenë e plotë.

Eshtë punuar për mirëmbajtjen dhe përmiresimin teknik të studios TV ,megjithë mungesat në investime për teknologjitë e reja gjë që shpresohet që në vitin 2024 do të marrë nje impuls te ri. Lidhjet direkte me RTSH 1 dhe RTSH 24 janë realizuar 100%, pa patur asnjë defekt apo ndërprerje, në çdo orë. Gjate vitit 2023 kemi trasmetuar 4 ndeshje futbollit direkt, 3 mbledhje këshilli bashkiak direkt, 1 dëgjesë publike me rastin e zgjedhjes së drejtuesit të ri të Teatrit Migjeni. Maratonë Transmetimi të zgjedhjeve Lokale e cila ka zgjatur rreth 3 ditë,me lidhje direkte nga terreni me gazetarët e RTSH-Shkodra gjithashtu edhe me lidhje direkte nga jashtë vendit me të ftuar të ndryshem.Jane regjistruar 7 koncerte dhe aktivitete te ndryshme. Gjate vitit që lamë pas jemi hasur me vështërsi të shumta:

1-Kompjuterat e montazhit janë të amortizuar,kjo gjë na sjellë shume anomali,pasi krijojnë vonesa në exportimin e materialeve si kronika lajmesh,speciale etj.

2-Kompjuterat e transmetimit në TV kanë pasur probleme të ndryshme si psh:

Është fikur disa herë gjatë transmetimit ONAIR,nga ngarkesa që rri ndezur me muaj të tërë dhe disa herë nga mbinxehja.,kjo gjë ndodh pasi nuk kemi mundësi ndërrimi në transmetim me Playout sekondar për mungesë të një mixeri ose routeri.

Është bllokuar disa herë në transmetim duke e bërë transmetimin me ngecje.

3-Serveri që kemi aktualisht është nje server LOËCOST i cili për momentin është funksional dhe po e kryen funksionin e tij, por problemin që po hasim është HAPËSIRA qe kemi ne dipozicion pasi formati qe regjistrojme dhe transmetojme eshte FULL HD dhe na zë hapësire të madhe në memorie, kemi nevoje për memorie shtesë me anë të një server te ri ose hardisqeve të jashtem për arkivimin e materialeve.

4-Problem tjetër eshte edhe ndriçimi i Studios se Transmetimit te Lajmeve dhe Emisjonit Sportiv,pasi ka ndriçim të ngrohtë, që varion deri ne 16KË. Kjo na penalizon, pasi xheneratori që kemi aktualisht nuk e suporton kapacitetin e Studios në rast se energjia elektrike shkëputet (me këtë problem jemi hasur shpesh). Që nga momenti i montimit jemi hasur me problemin e djegies dhe mungesës së llambave të ngrohta.Aktualisht nga 11 ndriçues kemi mbetur me 3 ndriçuesa në gjëndje pune, duke penalizuar cilesinë e figures në trasnmetim.

5-Një tjetër problem që jemi hasur janë kamerat e terrenit, pasi shpesh herë kanë marrë lagështirë duke e bërë të pamundur regjistrimin e aktiviteteve. Bateritë e kamerave nuk mbajnë kohë të gjatë perdorimi.

OVA GJIROKASTËR

I – HYRJE.

Radio Televizioni Gjirokastra, nuk është thjesht një ndërtesë me një arkitekturë unikale, që ka të kombinuar modernen me tradicionalen, që ngrihet në kufi të zonës historike dhe asaj moderne të qytetit në UNESCO, por një nga institucionet kulturore mediatike më të rëndësishëm të rajonit jugor. Ky institucion prej afro 80 vjetësh vazhdon të përhapë papushim informacione dhe vlerat autoktone të muzikës shqiptare dhe atë tradicionale polifonike të zomës jugore të vendit, ndërkohë që ka dëshuar se është shenbulli më i mirë i bashkëjetesës dhe respektimit të diversitetit kulturor, etnik dhe fetar mes komunitetit shqiptar dhe komuniteteve të pakicave kombëtare greke dhe arumune.

Analiza Vjetore në QVA Gjirokastrë ka rëndësi dhe qëllim që të pasqyrojë në detaje të gjithë sfidat, sukseset, problematikën dhe treguesit e punës për vitin 2023, për ti patur ato si një referencë bazë për ecurinë e punës gjatë vitit 2024.

Analiza vjetore është një mundësi e madhe për të kthyer kokën mbrapa, për të parë ku shkelëm dhe çfarë bëmë, çfarë duhet të përmirësojmë dhe ku duhet të shkojmë. Sigurisht, jo me zakonet dhe mentalitetet e vjetra “me ne nis historia” e institucionit dhe as me sjelljen “pas mua tokë e djegur”.

Vetën një analizë reale, dhe objektive vlen. Sherret, mlllefet, mëritë, ambicjet individuale, jo vetëm nuk vlejnë, por ato shërbejnë si një barierë për ndryshime pozitive në vitin që vjen. Personalisht i ftoj të gjithë kolegët, nga recepsioni deri tek transmetimi që të bëhen pjesë e kësaj analize, të japin mendime dhe opinione objektive dhe racionale.

Çështjet kryesore që do të trajtohen gjatë kësaj analize përfshinë kryesisht probleme të punës e redaksisë, sektorit teknik (operatorët, montazhi, transmetimi), programacioni, marketingu, administrata mbështetëse të administratës, financa, transporti, recepsioni.

Treguesit kryesore që do të analizohen janë: cilësia dhe sasia e produktivitetit televiziv dhe radiofonik, shpejtësia e dhënies së informacionit, mbulimi gjeografik, cilësia e imazhit, etika e paraqitjes.

Personalisht mendoj se stafi pa përjashtim ka punuar mirë. Ky vit ka qënë vit me ngarkesë të jashtëzakonshme: Zgjedhjet vendore, Festivali Foklorik Kombëtar, proçioni i jashtëzakonshëm turistik, 100 vjetori i Gjimnazit, investimet infrastrukturore, investimet në trashëgimime kulturore, rendi, veprimtaritë kulturore, pasqyrimi i jetës në zonat e thella malore, shkollat, biznesi, pasqyrimi i këtyre detyrave është kryer nëpërmjet koordinimit të punës dhe bashkëpunimit mes të gjithë sektorëve.

Disa nga objektivat kryesore të rishikuar në muajit Prill 2023 pas paraqitjes së platformës strukturore të drejtorit të ri (E.Serjani), në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve dhe stafin në përtgjithësi u realizuan duke bërë të mundur që në të dy programet e transmetimit (24 orë transmetim tv dhe 24 orë transmetim radiofonik) të bëhën ndryshime cilësore dhe sasiore dhe audiencia e këtyre programeve të rritet dukshëm.

Megjithë mungesat e theksuara të fondeve pothuaj në të gjitha zërat, në bashkëpunim me disa miq e donatorë u bënë disa ndërhyrje të rëndësishme në përmirësimin e kushteve të punës: si ljerjet e pjesëshme të mjediseve të brendëshme të godinës dhe studios së regjistrimit të

emisioneve, ndryshimi i banerave të emisionit në gjuhën greke, sistemimin e territorit të jashtëm, ngritjen e studios moderne së regjistrimeve audio, ngritjen garderobës së re, ndriçimin e mjediseve të brendëshme. Ndërkohë duke shfrytëzuar kontratat e reklamës me “kling” u bë e mundur kompletimi me karrige të reja i studios së regjistrimit, sallës së mbledhjeve, zyrës së redaksisë dhe zyrës së minoriteteve.

Në përfundim të kësaj hyrjeje për analizën vjetore të institucionit tonë, dëshiroj të theksoj se rëndësi i duhet kushtuar përcaktimit të objektivave për 2024. Të rekomandojmë drejtimet e duhura me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të punës dhe performancës në çështje të cilat kërkojnë përkushtim dhe angazhim nga të gjithë sektorët. Këtë vit produktiviteti, imazhi, profesionalizmi dhe integriteti do të jenë kusht thelbësor i ndryshimit.

II – REDAKSIA.

Prej fillimit të vitit të kaluar dhe në fillim të këtij viti, stafi i redaksisë dhe ai i sektorit teknik i Qendrës Vendore Audiovizive Gjirokastër është përfshirë në punë të gjithanshme për përmirësimin e strukturës programore, futjen e emisioneve premierë, rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së transmetimeve televizive dhe radiofonike.

Për shkak se deri në mesin e vitit të kaluar 2023, në transmetimet e Radio Gjirokastrës kishin humbur zëra njerëzorë dhe komunikimi me dëgjuesit bëhej vetëm nëpërmjet tingujve muzikorë, gazetarët dhe teknikët e Radio Gjirokastrës u angazhuan në ringritjen e emisioneve dhe programeve të harruara televizive dhe radiofonike. Mandej duhet theksuar se ndryshimet më pozitive të vitit 2023 janë shënuar pikërisht në ndryshimet e bëra në program duke futur emisione të reja javore si: “Ora e fëmijëve” me bashkëpunëtore aktoren Liljana Ristani, “Oda e madhe” me bashkëpunëtor gazetarin veteran Thanas Dino, “Sfida Rinore” me bashkëpunëtore gjimnazisten Athalia Koçiu. Ndërkohë që ndryshimi përfshiu edhe të gjitha emisionet egzistuese duke i kompletuar me gazetarë dhe bashkëpunëtorë të rinj e të aftë si: “Teleshëndeti” me moderatorin Bledar Ahmeti, “E hëna sportive” me përfshirjen në moderim të gazetares së re Ledia Fili, emisionin e mëngjesit me përfshirjen e gazetarit Vangjel Shumeli dhe moderators Klara Stefanidhi. Një ndryshim të thellë pësoi edhe emisioni në gjuhën vllahe me aktivizimin e dy bashkëpunëtorëve të rinj Vangjeli Gega dhe Thoma Puriqi.

Ndryshime të thella përfshinë edhe programet radiofonike. “Ju flet Radio-Gjirokastra”, ky zë i njohur për rreth 80 vjet, i dashur dhe i ngrohtë për dëgjuesit e saj, tani ka fituar më shumë audiencë, sepse është bërë një ristrukturimi i plotë i programeve të saj, sepse tani ka më shumë informacion rreth ngjarjeve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, por ka edhe një muzikë më të përzgjedhur nga ana cilësore dhe të adresuar ndaj interesave të të gjitha moshave.

Tre emisione radiofonike krejt të reja të realizuara nga bashkëpunëtorë të rinj si: emisioni 2 orësh i paradites “Mozaik radiofonik” me moderator Klara Stefanidhi, emisioni 2 orë i mbasditës “Mbasditja ime” moderuar nga studentja Joana Çepuni, emisioni “Sporti në Radio Gjirokastra” që përcillet çdo ditë për 30 minuta nga komentatori sportiv Fatos Lamaj, krahas

emisionit informativ argëtues në gjuhën greke “Festa e traditës” që përgatitet dhe transmetohet me cilësi në mënyrë të përditëshme nga bashkëpunëtori dhe gazetari i njohur Dhimitër Qiqi.

Kjo analizë e punës së redaksisë nisi nga disa risi e ndryshime në në strukturën programore të radios dhe televizionit, por nuk mund të lëmë pa evidentuar ndryshimet e thella sasiore dhe veçanërisht ato cilësore në përmirësimin e informacionit nëpërmjet edicionin të lajmeve, përgatitjen e kronikave speciale me histori njerëzore nga të gjitha fushat e jetës; prodhimi, biznesi, kultura, shërbimet, turizmi, shëndeti, trashëgimia kulturore, poshteti vendor, zonat e thella malore, sporti, arsimit, bota akademike. Ndryshime janë bërë në rritjen e produktivitetit me emisione speciale, intervalet dhe dokumentarët, për të cilat kemi marrë shumë opinionet he falenderime nga shikuesit.

Do të falenderoja bashkëpunëtorin time më të ngushtë kryeredaktoren Sipvana Spaho për përkushtimin e saj në të dy pozicionet, edhe si një koordinatorë e punës së redaksisë, por edhe si një gazetare productive. Një falenderim të veçantë kam për gazetarin Kristaq Xha me kontributin e tij të dyfishtë, në raportimet në greqisht me emisionin “60 minuta me grekët” dhe në kronikat në edicionin në shqip. Xhai është një model dhe she shembull i përkryer e për planifikimin individual të punës, përdorimin racional të kohës, për bashkëpunimin e shkëlqyer më të gjithë kolegët, gazetarë, operatorë, montazhierë, shëferë dhe eprorë. Pavarësisht nga debatet dhe përplasjet konstruktive për punën dhe vetëm për punën, unë kam një falenderim të veçantë për të gjithë kolegët gazetarë, për punën e mirë të Yllkës, Lëdias, Elidës, Leonidës, Vangjelit. Pa lënë mënjanë edhe dy koleget Boralda Pëllumbi dhe Enkejleda Ballo të rikthyera së fundi në redaksi. Të gjithë kanë punuar dhe janë lodhur. Kanë sjellë lajme dhe histori të jashtëzakonshme nga të gjitha fushat.

III - SEKTORI TEKNIK


Në sektorin teknik gjatë vitit 2023, kemi pasur një ecure relativisht të mirë duke pasur parasysh edhe kushtet në të cilat ndodhet teknika. Ky vit (pra viti 2023) ishte shumë i ngarkuar me ngjarje. Viti 2023 ishte vit në të cilin u zhvilluan zgjedhjet lokale dhe vit në të cilin u mbajt edhe Festivali Folklorik Kombëtar. Gjatë këtij viti zona që ne mbulojmë e në vecanti

Operatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
ArdiRexha	52	63	59	32	49	56	67	43	61	61	72	54	669
YlliCapi	57	44	55	56	41	53	44	42	60	64	57	50	623
SkenderCingo	44	36	52	40	44	52	51	47	41	62	63	67	599
Tetjere	14	2	2	31	34	9	6	36	17	12	5	16	184

Gjirokastra dhe Saranda pati një bum në turizëm. Të gjithë grupet që bëjnë pjesë në sektorin teknik, janë munduar të bëjnë një punë cilësore dhe të rrisin produktivitetin në punë. Një aspekt tjetër, që duhet të përmendim, është bashkërendimi i punëve midis grupeve të ndryshme të sektorit teknik. Kjo gjë ka sjelle edhe rritjen e aftësive profesionale të vetë anëtarëve të këtij sektori.


Duke e nisur me paraqitjen e punës së operatoreve (kameramaneve), mund të themi, se janë munduar të mbulojnë punën egazetarëve në të rrendhe në studio të R.T.SH Gjirokastrës, madje mund të themi se shumë kronika dhe reportazhe, që kanë regjistruar operatorët tanë, janë përdorur edhe nga RTSH. Kjo gjë ka ndodhur në saj të bashkëpunimit ngushtë me Redaksinë e Lajmeve. Për emisionet që janë regjistruar ose janë transmetuar live, operatorët, janë munduar të bëjnë një punë cilësore dhe në bashkëpunim me montazhierët dhe grupin e transmetimit. Këto emisione nga ana teknike kanë dalë pa probleme.

Më poshtë kemi një tabelë përmbljedhëse të kronikave të edicioneve informativë, që kanë realizuar kameramanët gjatë 2023, të specifikuar për çdo muaj të vitit.




Pra renditja e operatorëve sipas numrit të kronikave tërealizuara në Ditaret Informativë të RTSH Gjirokastra, përvitin 2023është si mëposhtë:

Operatori	Kronika
Ardian Rexha	669
Ylli Capi	623
Skender Cingo	599
Te tjerë	184




Përveç kronikave dhe specialeve RTSH Gjirokastra ka si produkt të saj edhe emisionet të cilët në përgjithësi janë javorë. Më poshtë kemi tabelën përmbledhëse.

Operatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
ArdiRexha	4	6	6	5	7	3	2	0	5	6	2	7	53
YlliCapi	1	3	5	3	8	2	2	0	3	5	10	7	49
SkenderCingo	12	7	8	7	7	7	4	2	3	9	8	9	83
Tetjere	3	1	2	0	0	1	1	0	1	1	3	0	13



Pra renditja e operatorëve sipas numrit të emisioneve tërealizuara për vitin 2023 është si mëposhtë:

Operatori	Totali
Skënder Cingo	83
Ardian Rexho	53
Ylli Capi	49
Të tjerë	13




Disanga problemet qëjanëvënërenëkëtësektor janë:

- Mikrofonat e terrenit dhe studios kanë pasur ndonjëherë probleme, kështu që operatorët duhet të pajisen me kufje në mënyrë që problemet me audion të pikasen në moment dhe të mundohen ti zgjidhin që në terren dhe jo të vihen re kur vijnë materialet në studiot e montazhit.
- Duhet te pajisen operatorët me bateri kamere rezervë dhe të kenë blica.

Një ecuri të mirë ka pasur edhe grupi i montimit.Montazhierët në bashkëpunim me gazetarët dhe operatorët, kanë montuar me profesionalizëm materialet e terrenit.Gjithashtu pjesë e punës të teknikëve të montazhit është edhepërgatitja e reklamave dhe njoftimeve të ndryshme, të cilatjanëkërkuarnga sektori i marketingut për llogari të biznesit, shoqatatapo institucionet endryshme shtetërore.

Më poshtë po japim nje paraqitje të përmbledhur të punëssëkryer nga montazhierët tanë përsa i përket montimit të kronikave tëlajmeve.

Montazhier	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Arber bala	35	53	69	53	56	61	64	51	57	68	69	61	697
RidvanKuci	61	39	44	48	49	49	36	64	56	68	63	42	619
Dashamir Hide	71	53	55	57	55	70	67	49	62	71	66	66	742
Tetjere	0	0	0	0	0	0	0	20	0	0	0	1	21




Pra sic shikohet edhe nga të dhënat e mësipërme kemi këtë renditje:

Montazhieri	Totali
Dashamir Hide	742
Arbër Bala	697
Ridvan Kuci	619
Të tjerë	21


Tabela më poshtë jep një përmbledhje të punës së montazhiereve, përsa i përket montimit të emisioneve.

Montazhier	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Arber Bala	3	3	4	1	7	8	2	0	3	10	9	4	54
RidvanKuci	7	6	10	9	11	5	9	0	5	12	9	11	94
Dashamir Hide	4	5	4	5	3	10	8	2	2	5	7	8	63
Tetjere	3	3	2	0	1	1	0	0	2	0	2	1	15



Pra sic shikohet edhe nga të dhënat e mësipërme kemi këtë renditje:

Montazhieri	Totali
Ridvan Kuci	94
Dashamir Hide	63
Arbër Bala	54
Të tjerë	15



Duhet të theksojmë se në institucionin tonë montohen dhe transmetohen edhe reklama, njoftime etj. Në këtë pikë një punë të mirë ka bërë edhe grafisti ynë Ridvan Kuci. Nuk duhet lënë pa përmendur edhe puna e madhe që u bë gjatë netëve të zhvillimit të Festivalit.

Problemet dhe vështirësitë e këtij sektori.

- Bashkëpunimi me gazetarët të jetë më i madh, me qëllim shmangien e problemeve të montimit të materialeve.
- Problem i madh është bërë mungesa e kapaciteteve mbajtëse të kompjuteravë. (Na duhet një PC Store ose minimumi tju instalohet kompjutarve aktualë Hard Disqe shtesë dhe me kapacitet të madh)
- UPS e kompjutarave të montazhit të kemi mundësi ti mirëmbajmë ose në rast dëmtimesh të kemi mundësi ti ndërojmë shpejt.

Sektori i studiove, transmetimi dhe transporti.

Edhe ky grup i përbërë nga 4 persona, janë munduar që gjatë 2023 të rrisin cilësinë e transmetimit, pavarësisht mungesës së infrastruktures bashkëkohore. Edhe pse me pajisje “të dobta”, është punuar që cilësia e figurës dhe zërit të jetë në parametrat e duhura, si në emisionet e regjistruara edhe ato drejt përdrejtë.

Problemet e këtij sektori edhe këtë vit kanë të bëjnë me infrastrukturën shumë të vjetër dhe amortizuar, (Kompjuterat, mikrofonat, pulstransmetimi) pasi të gjitha këto pajisje janë amortizuar dhe shfaqin probleme.



Nevojat e Sektorit Teknik

12. Pult transmetimi për radio.
13. Pajisja e kompjuterave dhe me UPS. (Mendojmë që ka nevojë për një inverter të madh **3600** në mënyrë që rryma elektrike të vazhdojë pandërprerje. Ne momentalisht kemi dy linja për furnizimin me energji elektrike.)
14. Mikrofonat për radion, (momentalisht është vetëm një dhe në gjendje jo të mirë).

15. Infrastrukturë e dobët dhe e amortizuar në Studion e Regjistrimit (Ne kemi bërë kërkesa për studio të reja. (çdo vit na është premtua nga Drejtoriae Përgjithshme, që dota kishim por ende jo).
16. Kamerate studios, të kalojnë në formatin HD, ose full HD, mirë do të ishte 4K në mënyrë, që sinjali i transmetimit të dalë HD ose full HD dhe jo të bëhet konvertimi i materialeve. Kjo gjë kërkon automatikisht që të zvendësohen pajisjet në studion e trasmetimit (Pulti i transmetimit, mixer i Videos, të përshtaten kompjuterat e trasmetimit, etj.,)
17. Arredimi i studiove për t'ipërshtatur për realizimin e misionëve (banera, tavolina, karrige). Ndricimi i studiove duhet përmirësuar që të jetë i përditësuar.
18. Linjat e audios duhen ndëruar dhe vendosur sipas përshtatshmërisë me studion e re.

Transporti dhe gjendja teknike e automjeteve.

QVA Gjirokastër për momentin kemi tre automjete, 2 të markës PEUHGOT dhe 1 BENC. Dy automjete janë telet të amortizuara sepse kanë mbi 15 vjet në shërnim dhe duan mirembajtje të vazhdueshme. Njëri prej automjeteve është i mbyllur sepse kërkon shërbime urgjentë. Të gjitha mjeteve duhet tju kryejmë shërbimet e nevojshme në mënyrë që ato të jenë në gjendje pune.

Gjatë vitit 2023 nuk ka patur asnjë fond për serviset dhe riparimin e automjeteve. Disa shërbime të nevojshme janë kryer falas mha donator vendas, me shpenzime të paguara nga vetë shoferët dhe shpenzime personale të stafit drejtues.

Situata sa vete dhe përkeqësohet për shkak se edhe kur automjetet janë në tako dhe nuk lëvizin ato amortizohen e difektohen edhe më shumë se kur janë në lëvizje.

Pavarësisht nga problemet që kanë automjetet jam i detyruar që theksoj se lëvizja dhe puna e përparimit të kronikave nuk është ndërprerë për meritë të gadishmërisë dhe përkushtimit të dy shoferëve Eduart Zani dhe Robert Plaka të cilët i falenderoj.

IV - SEKTORI I FINANCËS & BURIMET NJERËZORE.

Gjatë këtij viti edhe ky sektor ka realizuar në kohë dhe me korrektesë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë. Në akordim me Drejtoritë e Burimeve Njerëzore dhe Ekonomike të RTSH është bërë i mundur zbatimi i procedurave si:

-Hartimi i Buxhetit në bashkëpunim me Sektorët e RTSH Gjyrokastrës dhe paraqitja e këtij projekti në RTSH.

-Çelja në kohë e fondit në RTSH për të mos shkaktuar vonesa në marrjen e pagës të punonjësve dhe bashkëpunorëve.

-Është bërë likujdimi në kohë i faturave të paraqitura për cdo muaj nga të tretët (drita, ujë , telefon, internet, shërbimi postar. si dhe likujdimet,)

Është kryer në kohë protokollimi i dokumentave si dhe plotësimi i **Regjistrit** Themeltar me ndryshimet në Strukturën Organizative dhe Analitike.

Analiza e shpenzimeve, paraqitur në situacionin e vitit 2023.

Drejtoria e Qendrës Audiovizive Gjirokastër gjatë vitit 2023, duke u mbështetur në planin e buxhetit të vitit 2023 nga Drejtoria ePërgjithshme e RTSH-së,ka kryer shpenzimet e mëposhteme :

- **Zëri Paga gjithësejt.**

Në zërin Paga gjithësejt nuk kemi fond të paraqitur, pasi që prej muajit Korrik 2022 nga QVA Gjirokastër nisen listëprezencat e punonjësve ndërsa likujdimi ,sigurimet e tatimi bëhen të gjitha veprimet nga RTSH-ja .

- **Shpërblime**

Ne zërin shpërblime, janë marrë në muajin Dhjetor 2023 shpërblime për fundvitin por edhe këto janë mbuluar nga RTSH-ja.

- **Materiale**

Në zërin materiale ndihmëse jane shpenzuar për blerje:

-sandisk extreme pro 64 gb 200..... 17.100 lekë.

.-Pnele Led, llampa, neonë tub, prozhektorë.... 55.900 lekë.

-Kablla interneti ,fishek,doreza dyesh, fisha interneti etj 10.900 lekë

-Ftesa per promovim librit “Rituali I dassmes Zagorite” 7.500 lekë

-Shërbim karotrec.....4.500 lekë

-Taksa vjetore automjeteve...14.895

-Drum per printera, furrë për printera.... 28.000 lekë.

-Kapak, DVD..... 19.920 lekë

-Letra Higjenike..... 10.670 lekë

-Blerje bateri makine....10.000

Blerjet e mësipërme janë bërë në baze të fondit të miratuar nga RTSH-ja.

Në zërin Materiale janë shpenzuar gjithësej 179.385 lekë, bazuar kjo vlerë në situacionin e shpenzimeve të cilin do ta gjeni bashkangjitur.

1. **Shërbime nga të tretët.**

Në zerin shpenzime nga të tretet është bërë likujdimi i energjiseëelektrike, telefonit, internetit,ujit të pijshem.

Në zërin shërbime nga të tretët nuk ka fatura të pa likujduara për periudhën raportuese.

2. Zëri Dietat

Në këtë zë janë shpenzuar fondet e paraqitura,sipas buxhetit të viti 2023.

-Fondi 2.000 lekë / Realizim 193.945 lekë.

- Shpenzime të tjera operative.

Në zërin Honorare për cdo muaj është paraqitur në RTSH i gjithë dokumentacioni për cdo bashkëpunëtor,bazuar kjo në librin e tarifave të bashkëpunëtorëve.

Likujdimet dhe tatimi është mbajtur nga RTSH-ja.

Në zërin shpenzime për tatim taksa është bërë pagesa e taksave vendore të Bashkisë ,për vitin 2023, mbasi afati kohor ishte data 31 mars 2023,

në shumën 100.000 lekë, gjithashtu po në këtë zë janë bërë edhe pagesat për komisione bankare, taksa vjetore të automjeteve si dhe është likujduar shërbim interneti për periudhën Janar-Prill 2023.

3. Gjendja e Bankës në daten 29 Dhjetor 2023 ishte në vlerën 28.551 lekë, vlerë kjo e cila u derdh në llogarinë e RTSH-së në po këtë datë.

4. Derdhja e të ardhurave në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH-së për vitin 2023 ishte në vlerën 1.009.905 lekë.

V – SEKTORI I MARKETINGUT

Rritja e cilësisë së punës ka ndikuar edhe në shtimin e të ardhurave përmes thithjes së shumë reklamave dhe njoftimeve.

Gjatë këtij viti janë realizuar 51 Reklama dhe 13Njoftime me një vlerë totale 1.168.920(njëmilione njëqindëgjatëdhjetëetëtmijëenëntëqindënjëzet) lekë,ndërkohë qëështë aplikuar skema e kleringut me biznese në fushën e Mobilerisë,si dhe janë nënshkruar kontarta 1-vjecare me biznese të tjera si : (“IGRO SH.P.K”,”SuperMarket PECl” dhe Agjensi Imobilare “Zanat Magjike” . .

Pas largimit me kërkesën e saj të specialistës së marketingut Alba Ruka, për rreth 5 muaj gjatë vitit 2023 në QVA Gjirokastrë ka munguar specialist i marketingut. Në fund të vitity në këtë pozicion pune u emërua David Mamani.

Në bashkëpunim të ngushtë me shefen e financës dhe drejtorin, në fund të vitit nga specialist i marketingur u negociua intesivisht dhe u arrit të nënshkruhen 3 kontrata reklame me disa subjekte të rëndësishme biznesi si ELKA,co, GjiroFARMA.co dhe FRESH.co, sublekte që më parë nuk

kishin praqnuar të bashkëpunonin me marketingun e QVA Gjirokastër për një periudhe disa vjeçare. Nënshkrimi i këtyre reklamave ka një rëndësi të veçantë pasi prezenca e tyre në bllokun e reklamave të QVA Gjirokastër ka një ndikim në rritjen e interesit të subjekteve të tjera të biznesit në rajon.

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Reklama	5	5	3	5	5	5	3	4	0	6	4	6
Njoftime	0	0	1	1	3	2	0	1	0	1	1	3
Kliring	0	0	0	0	0	0	1	0	2	0	0	0
Vlera	94.200	94.200	53.700	93.280	98.140	79.730	67.700	68.370	224.000	116.600	75.650	103.350

Pasqyra e reklamave të kontraktuar gjatë vitit 2023 dhe vlerat përkatëse:

Gjithashtu në bashkëpunim me Drejtorinë e Marketingut të RTSH-së janë transmetuar në RTSH Gjirokastra një sërë spote dhe reklama të dërguara nga RTSH. Realizimi i spoteve dhe reklamave është bërë brenda minutazhit dhe ofertës që ka përcaktuar RTSH për skemën e marketingut.

Objektiva të 2024 për marketingun:

Nisur nga eksperiencia tashmë e fituar dhe njohja e tregut të biznesit mendoj se RTSH Gjirokastra do të ketë një bashkëpunim me të madh me këtë sektor.

Kam nisur eksperiencia e negociatave me dy subjekte të fuqishme të biznesit në rajon. Të cilat operojnë në zonën e Dropulli, konkretisht Kompania “Elka SA”, Kompania “Fresh Sh.p.k” dhe fabrika e përpunimit të qumështit “Gjirofarma” do të përdoret me efikasitet për të tërhequr edhe subjekte të tjera.

Një rëndësi të veçantë do të kushtohet edhe bizneseve të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitetin e tyre në të gjithë rajonin e jugut.

VI -KONKLUSIONE PËRFUNDIMTARE.

Duke falenderuar të gjithë stafin e QVA Gjirokastër për punën e deritanishme për informimin e publikut, po ndaj me ju disa sugjerime të cilat duhet të mbajmë parasysh për vitin 2024.

1. Monitorimi i edicioneve informative është pjesë e përditshme dhe shumë e rëndësishme e punës sonë, jo vetëm për shkak të vlerësimit të cilësisë, shpejtësisë, vërtetësisë sëpunës në këtë sektor, por për faktin se çdo media klasike, e në mënyrë të veçantë mediat publike kanë qëllim kryesor informimin, edukimin dhe argëtimin e publikut.

2. Është shumë e rëndësishme të mos harrojmë asnjë ditë se **RTSH-ja dhe QVA Gjirokastrë si pjesë e saj kanë statusin e televizion publik**. Informacionet duhet gjithnjë të jenë për e në interes të publikut. (Formatet e edicioneve informative, nuk janë formate protokollare pushtetesh.) Edicioni i lajmeve nisët e lajmin më të rëndësishëm të ditës për zonën. Psh është krejt e papranueshme që edicioni i lajmeve të nisët me lajme dy lajme njëri pas tjetrit “Konsituohet këshilli bashkiak...“, ndërsa një lajm për motin e dëmet e shkaktuara në bujqësi apo infrastrukturë „të struket“ diku nga mesi i edicionit. (Kjo është përgjegjësi e kryeredaktorit).
3. **Sa më pak lajme të servitura nga strukturat administrative, nga takime e tryeza të mërzitshme**, në krye të cilave janë të njëjtët njerëz që në një formë a në një tjetër aq më mirë është për audiencën tonë. Një gazetar i mirë është ai që nga këto evente arrin të ndajë lajme dhe informacione me interes për publikun e gjerë/
4. **Zgjerimi i gjeografisë së lajmeve është me rëndësi të jashtëzakonshme, sepse ne kemi si detyrim** të sjellim në ekran të gjitha zhvillimet e bashkive të qarkut dhe rajonit që mbulojmë. Kështushkojmë më pranë publikut dhe zgjerojmë audiencën. Ndonse nuk e kemi luksin e lëvizjes së përditëshme, por egziston bindja se se edhe vetë gazetarët ndihen më mirë kur janë në terren.
5. **Planifikimi i punës, shoqëruar me planet mujore, javore dhe ditore është me shumë rëndësi dhe e lehtësojnë punën e gazetarit**. Shenbulli i kolegut Kristaq Xha që punën e yij ë mbështet në planifikim rigoroz është sekreti i suksesit të tij. Kur gazetari dhe redaksia e lajmeve e planifikojnë më mirë punën, kjo e bën më të lehtë dhe më të frytshme çdo kronikë dhe lëvizje në terren.
6. Konstatohet se në shumë raste nuk **mbahet parasysh struktura e lajmit**, Nuk respektohet në ndërtimin e kronikës regulli që zbatohet në gjithë rruzullion i PESË DABËLLAVE (Ku? Kur? Çfarë? Kush? dhe Si e Pse?)
7. Konstatohet përdorimi i pavend i sinkroneve të zgjatura, i përsëritjes së fjalëve, shprehjeve dhe ideve. Gazetari përsërit fjalët e personit në sinkron.
8. Nuk ka fare kujdes për **kokën e lajmit, titullin dhe nëntitullin. Kërkohet më tepër kujdes me titrat dhe drejtshkrimin e tyre**. Titrat janë prej pjesëve më të vështira të lajmit për t’u gjendur saktë. Ato janë thelbi i lajmit dhe kronikës.
9. **Nëmbledhjet e mëngjesit** gazetarët të raportojnë për temat e kronikave pa përgjegjësi. Kur nuk kanë asnjë komunikim, kur nuk kanë gjetur së paku një burim për ta intervistuar. Është domosdoshmëri që drejtori dhe kryeredaktorja të këmbëngulin për këtë moment. Para se gazetari të dalë në terren duhet ta kenë të qartë çfarë lajmi e kronike kërkon. **Të ketë në bllok pyetjet** që do t’u drejtojnë të intervistuarve.
10. Pothuajse mungojnë, **Ëox Pop-et dhe Stand up-et**. Gazetari, miktofofi, kamera duhet të jënë mes njerëzve për ta bërë më të besueshëm lajmin dhe kronikën. Po kështu ndodh edhe me **lidhjet e drejtpërdrejta me kamera apo me skype**, realizohen lidhje të pa menduara mirë, sa për të dalë nga radha e nga situatë.
11. Një nga pikat më të dobëta jështë **mbulimi me plane filmike dhe efekteve zanore**. Nuk mund ta quash kronikë, ku shikuesi nuk dëgjon as një tingull nga skena e festivalit folklorik, nga zërat e tifozëve në stadium, zogjtë kur jemi në fusha apo pyll.

12. Ju lutem **FOLNI SHQIP~**. Përveç deformimeve gramatikore, gabime që ndonjëherë vinë nga pakujdesia dhe nxitimi, më skandalozja është kur përdorim fjalën e huaj edhe pse në shqip mund të kemi sinonime pafund në vend të tyre.
13. **Kujdes dhe përsëri kujdes me paraqitjen e jashtme, trugin, grimin, veshjen e moderatorëve**, Përdorimi dhe ekspozimi i tatuazheve, bizhuve, krehja e flojëve, veshjeve me xixa-xixa dhe lara-lara, make up shumë i theksuar janë dukuri jashtë estetikë së një ekrani serioz.